



REPUBLIKA E KOSOVËS
INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT

RAPORTI I NJËMBËDHJETË VJETOR
2011

drejtuar
Kuvendit të Kosovës

Telefoni: ++381 38 545 303
Telefaksi: ++381 38 545 302
e-mail: ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org
ueb-faqja: www.ombudspersonkosovo.org

Publikuar nga:
Institucioni i Avokatit të Popullit

Prishtinë, 2012

Z. Jakup Krasniqi
Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës
Prishtinë

I nderuar zoti Kryetar

Bazuar në nenin 135 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 27 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Ju paraqes *Raportin e njëmbëdhjetë vjetor* të Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës.

Njëkohësisht, Ju lutem të pranoni edhe kërkesën për paraqitjen e këtij raporti në seancë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe hapjen e diskutimit në lidhje me këtë raport.

Me nderime,
Sami Kurteshi



Avokat i Popullit i Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 13 korrik 2012

PËRMBAJTJA

FJALA E AVOKATIT TË POPULLIT	7
1. HYRJE	11
1.1. Aspektet e përgjithshme.....	12
2. TË DREJTAT DHE LIRITË E NJERIUT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	15
2.1. Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare.....	15
2.2. Dinjiteti i njeriut.....	16
2.3. Barazia para ligjit	17
2.3.1. Ligjet e zbatueshme në Kosovë me nenet diskriminuese	18
2.3.2. Diskriminimi në sferën e pensioneve	19
2.3.3. Diskriminimi në sferën e shëndetësisë.....	19
2.3.4. Diskriminimi i gjyqësorit dhe nga gjyqësori	20
2.3.5. Pabarazia në sferën e punësimit.....	21
2.3.6. Diskriminimi i personave me aftësi të kufizuara	21
2.3.7. Trajtimi diskriminues nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP).....	23
2.3.8. Trajtimi diskriminues nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).....	23
2.3.9. Barazia gjinore.....	24
2.4. E drejta për jetën.....	27
2.4.1. Dukuri që e shqetëson shoqërinë kosovare	28
2.5. E drejta e integritetit personal	29
2.6. Ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtërues.....	30
2.6.1. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës.....	34
2.7. E drejta e lirisë dhe sigurisë.....	36
2.8. Të drejtat e të akuzuarit.....	37
2.9. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.....	41
2.10. E drejta për mjete juridike.....	44
2.11. Parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në rastet penale.....	46
2.12. Liria e lëvizjes	48
2.13. E drejta e privatësisë.....	50
2.13.1. Mënjanimi i zhurmës dhe e drejta e banimit	51
2.13.2. E drejta për mjedis të shëndetshëm dhe e drejta e banimit	52
2.13.3. Kontrolli i shtëpisë nga autoritetet.....	52
2.13.4. Kontrolli dhe përgjimi i mjeteve të komunikimit	52
2.14. E drejta e martesës dhe familjes.....	54
2.15. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë.....	56
2.15.1. Konfesionet fetare.....	57
2.15.2. Bashkësia fetare islame	57
2.15.3. Kisha Ortodokse Serbe	58
2.15.4. Kisha Katolike e Kosovës	59
2.15.5. Kisha Protestante Evangjelike e Kosovës	59
2.16. Liria e shprehjes.....	61
2.17. E drejta e qasjes në dokumente publike	62
2.18. Liria e mediave.....	65
2.19. Liria e tubimit.....	68
2.20. Liria e asociimit.....	70
2.21. E drejta e zgjedhjes dhe e pjesëmarrjes	72
2.22. E drejta e pronës	74
2.23. E drejta për arsimin	76
2.23.1. Sistemi arsimor për komunitetet.....	77

2.23.2.	<i>Edukimi parashkollor (EPSH) dhe edukimi parafillor (EPF)</i>	78
2.23.3.	<i>Arsimi parauniversitar</i>	78
2.23.4.	<i>Arsimi i lartë</i>	81
2.24.	<i>Liria e artit dhe e shkencës</i>	83
2.25.	<i>E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit</i>	83
2.26.	<i>Të drejtat e fëmijëve</i>	86
2.26.1.	<i>Zbatimi i Strategjisë dhe Planit Nacional të veprimit për të drejtat e fëmijëve</i>	87
2.26.2.	<i>E drejta e fëmijëve për shkollim</i>	87
2.26.3.	<i>Puna e fëmijëve</i>	88
2.27.	<i>Mbrojtja shëndetësore dhe sociale</i>	89
2.27.1.	<i>Problemet sociale dhe mungesa e legjislacionit</i>	90
2.27.2.	<i>Gjendja ekonomike dhe sociale në Kosovë</i>	90
2.27.3.	<i>Braktisja e shkollimit</i>	91
2.27.4.	<i>Çështja e strehimit</i>	91
2.27.5.	<i>Shërbimet shëndetësore</i>	92
2.28.	<i>Përgjegjësia për mjedisin jetësor</i>	93
2.29.	<i>Mbrojtja gjyqësore e të drejtave</i>	98
2.29.1.	<i>Gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it</i>	100
2.29.2.	<i>Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës</i>	101
2.29.3.	<i>Ankesat e qytetarëve ndaj gjyqësorit</i>	102
2.29.4.	<i>Ankesat e qytetarëve ndaj prokurorisë</i>	105
2.30.	<i>Përdorimi i gjuhëve</i>	108
2.30.1.	<i>Komisioni i gjuhëve</i>	109
2.30.2.	<i>Vështirësitë në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve</i>	111
2.31.	<i>Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre</i>	113
2.31.1.	<i>Komuniteti serb</i>	114
2.31.2.	<i>Komunitet e tjera</i>	115
2.31.3.	<i>Sistemi i arsimit të komuniteteve pakicë</i>	117
2.31.4.	<i>Mediat dhe komunitetet pakicë</i>	118
3.	AKTIVITETET E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT	121
3.1.	<i>Aktivitetet e Grupit për Barazi Gjinore</i>	121
3.2.	<i>Aktivitetet e Grupit për të Drejtat e Fëmijëve</i>	122
3.3.	<i>Aktivitetet e Grupit për Mosdiskriminim</i>	124
4.	BASHKËPUNIMI I IAP-SË	127
4.1.	<i>Bashkëpunimi me institucionet vendore</i>	127
4.2.	<i>Bashkëpunimi me shoqërinë civile</i>	128
4.3.	<i>Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare dhe ngritja e kapaciteteve</i>	129
5.	BUXHETI I INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT	133
5.1.	<i>Financimi i IAP-së nga buxheti i Kosovës</i>	133
5.2.	<i>Ndërhyrjet e Qeverisë së Kosovës në buxhetin e Avokatit të Popullit</i>	135
5.3.	<i>Shkaqet e mos realizimit të shpenzimeve sipas buxhetit të ndarë të Avokatit të Popullit</i>	136
5.4.	<i>Mosekzekutimi i pagave të zëvendësve të Avokatit të Popullit</i>	137
5.5.	<i>Financimi i IAP-së nga donatorët</i>	138
6.	PËRMBLEDHJA STATISTIKORE E ANKESAVE DHE RASTEVE PËR VITIN 2011	141
7.	STRUKTURA ORGANIZATIVE E IAP-SË	153
7.1.	<i>Skema organizative e IAP-së</i>	154
7.2.	<i>Gjendja e personelit</i>	154
7.3.	<i>Lëvizjet e nëpunësve</i>	156
7.4.	<i>Struktura e personelit</i>	156
8.	SHKURTESAT	158

Fjala e Avokatit të Popullit

Republika e Kosovës vazhdon të ballafaqohet me njërin prej problemeve më të mëdha, që njëkohësisht përbën shtyllën kryesore të zhvillimit të jetës politike, ekonomike dhe shoqërore – mungesa e shtetit ligjor. Edhe katër vite pas pavarësisë, kjo paraqet sfidë jashtëzakonisht të rëndë. Drejtësia ligjore, e pranueshme dhe e zbatueshme në jetën praktike, për të gjithë individët pa asnjë dallim, në të gjithë territorin e shtetit, përbën bazën e shtetit ligjor, që fatkeqësisht në Kosovë, ndonëse është e domosdoshme, lë shumë për të dëshiruar.



Në Republikën e Kosovës, si pasojë e mosangazhimit të mekanizmave shtetërorë, sidomos në fushën e zbatimit të drejtësisë, humbja e besimit në shtetin ligjor, e rrjedhimisht edhe në të gjitha institucionet shtetërore, shtrihet nga shtresat dhe grupet më të varfra dhe më të pafuqishme të shoqërisë, deri tek individët që gjenden në krye të shtetit. Edhe kur duket se ekziston, drejtësia e shtetit e bazuar në ligj është përzgjedhëse. Humbja e këtij besimi dhe mungesa e angazhimit të mekanizmave shtetërorë për sanimin e kësaj gjendjeje, përkatësisht mungesa pothuajse totale e një ndërgjegjësimit për përmirësimin e kësaj gjendjeje, edhe më tutje sikur forcon pozitën e kastës shkelëse të lirive dhe të drejtave të njeriut përballë qytetarit të pafuqishëm.

Mungesa e ndërgjegjësimit për zbatimin e ligjit dhe për krijimin e shtetit ligjor, ka prekur të gjitha poret e sistemit ligjor në Republikën e Kosovës. Për pasojë, humbja gjithnjë e më e madhe e besimit të qytetarëve në mekanizmat e drejtësisë në Kosovë, shkakton pasojat e tjera shumëfish më të mëdha dhe më të rrezikshme - tentimet gjithnjë e më të shumta të marrjes së ligjit në duar të veta nga ana e qytetarëve. Fatkeqësisht, në Kosovë po krijohet një anarki ligjore, e cila ka kapluar të gjitha poret e shoqërisë sonë. Përkeqësimi i raporteve ndërshoqërore dhe ndërnjerëzore, si pasojë e mosfunksionimit të shtetit ligjor, është në rritje të vazhdueshme.

Institucioni i Avokatit të Popullit në vazhdimësi ka tërhequr vërejtjen për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut në Kosovë, përkatësisht për përmasat e shkeljes së të drejtave dhe të lirive të njeriut, nga institucionet e shtetërore të Republikës së Kosovës, një pjesë e të cilave madje nuk bëjnë as përpjekjen më të vogël për të përmirësuar këtë gjendje. Edhe më tutje është evidente mungesa e ndikimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në organet shtetërore, të cilat janë të thirrura të

zbatojnë ligjet dhe t'u krijojnë mundësi qytetarëve për të zgjidhur problemet e tyre, me çka edhe do të shtonin besimin e në organet shtetërore dhe në shtetin ligjor.

Institucioni i Avokatit të Popullit në vazhdimësi është angazhuar dhe angazhohet në përmirësimin e kësaj gjendjeje, për krijimin e një klime në të cilën qytetarët do të kishin mundësi t'i zgjidhnin problemet e tyre, sa u përket të drejtave dhe lirive të tyre, por fatkeqësisht, me gjithë arritjen e disa rezultateve modeste, shumëçka mbetet nën nivelin e të dëshiruarës.

Gjatë vitit raportues 2011, në Institucionin e Avokati i Popullit janë regjistruar 1453 raste të proceduara, ose 220 raste të proceduara më shumë sesa në vitin paraprak.

Numri më i madh prej tyre ishin ankesa kundër gjyqësorit, në të gjitha nivelet. Ankesat kanë të bëjnë zakonisht me zvarritjen e proceseve gjyqësore – vonimit të drejtësisë; moszbatimit të vendimeve të plotfuqishme të gjykatave të rregullta – pafuqishmërisë së shtetit për të vënë drejtësinë në vend. Fatkeqësisht, një numër i ankesave ka të bëjë edhe me vendimet e padrejta, me elemente të korrupsionit dhe falsifikimeve, që nënkupton padrejtësi nga ata që pritet të vënë drejtësinë në vend. Në këtë drejtim, nuk kemi ndonjë përmirësim në krahasim me periudhën e mëparshme raportuese.

Edhe gjatë vitit 2011, janë regjistruar numër shqetësues i ankesave të qytetarëve që kanë të bëjnë me moszbatimin e vendimeve të plotfuqishme të institucioneve të pavarura shtetërore nga vetë institucionet e shtetërore, apo edhe vendime të paligjshme të institucioneve shtetërore. Raportet e mëhershme vjetore të Avokatit të Popullit, së bashku me rekomandimet, janë miratuar nga shumica e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Deri më tani Avokatit të Popullit nuk ka marrë asnjë informatë apo njoftim nga ndonjë institucion, nëse janë zbatuar rekomandimet e tij. Një praktikë e tillë vazhdon të përcillet nga viti në vit dhe si e tillë është mjaft shqetësuese.

Në këtë drejtim, jashtëzakonisht shqetësuese është tendenca e segmenteve të ndryshme të institucioneve shtetërore për minimizimin e rolit të institucioneve të pavarura kombëtare, qoftë duke mos përfillur të gjeturat e tyre, qoftë duke mos zbatuar rekomandimet e tyre, apo qoftë edhe duke bërë përpjekje të ndryshme, qofshin ato ligjore apo kundërligjore, për cenimin e pavarësisë së tyre kushtetuese.

Meqenëse zbatimi i ligjit është premisa kryesore për funksionim e shtetit ligjor, në Republikën e Kosovës, edhe pse ka përpjekje pozitive, megjithatë moszbatimi i ligjit është indikator kryesor për humbjen e besimit të qytetarit në institucionet shtetërore, që detyrim ligjor dhe kushtetues e kanë zbatimin e ligjit. Ndërkaq, kjo humbje e besimit Avokatin e Popullit e vë në pozicionin drejt të cilit shtrohen kërkesa për të vënë drejtësinë në vend. Kjo ndodhë pikërisht për shkak të mosbrenjosjes së pjesës dërrmuese të institucioneve shtetërore për moszbatimin e ligji.

Me gjithë përpjekjet e vazhdueshme të Institucionit të Avokatit të Popullit për përmirësimin e gjendjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, duhet theksuar se Avokati i Popullit nuk ndan drejtësi. Avokati i Popullit do të vazhdojë të evidentojë dhe të

nxjerrë në pah veprimet apo mosveprimet e parregullta e të paligjshme të autoriteteve publike, pikërisht për të luajtur rolin që ka në ndërtimin e një shoqërie të bazuar në parimin se të gjithë janë të barabartë para ligjit.

Janë institucionet shtetërore ato të cilat nuk do të duhej të shkelnin mbi parimet e drejtësisë ligjore, sepse po qe se shkelin mbi to, atëherë kanë prekur në besimin e domosdoshëm për funksionimin e një shoqërie të lirë dhe demokratike. Kjo nuk duhet lejuar të ndodhë, sepse barazinë para ligjit duhet ta sigurojnë dhe ta garantojnë, në radhë të parë mekanizmat shtetërorë.

Me gjithë gjendjen aspak të lakmueshme në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut, shpresa për një të ardhme më të mirë, edhe pse e nëpërkëmbur, nuk ka humbur. Përpjekjet për vendosjen e rendit dhe të ligjit janë evidente. Por, për këtë duhet më shumë përkushtim dhe përgjegjësi individuale, shoqërore dhe sidomos institucionale të autoriteteve publike për veprimet apo mos veprimet e tyre.

Me gjithë besimin e lëkundur, sinqerisht shpresojmë në një të ardhme më të mirë. Prandaj, ftojmë të gjitha institucionet shtetërore, të ndërmarrin gjithçka është e mundur për të mos thyer shpresat e sinqerta.

1. Hyrje

Misioni kushtetues dhe ligjor i Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) është mbrojtja, mbikëqyrja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose nga mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike në Republikën e Kosovës si dhe të organeve të tjera dhe të organizatave që ushtrojnë autorizime publike për llogari të tyre.

Përkundër faktit se tashmë Republika e Kosovës ka mekanizma ligjor dhe institucional për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, ato vazhdojnë të mos respektohen në masë të duhur. Ndër shkaqet për këtë gjendje janë jo efikasiteti i mekanizmave ekzistues si dhe angazhimi jo i mjaftueshëm i institucioneve publike në zbatimin e ligjeve që janë në fuqi. Format e ndryshme të shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut ende janë evidente.

Prandaj, angazhimi i IAP-së nuk është i përqendruar vetëm në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, por edhe në mbikëqyrjen dhe promovimin e tyre.

Një nga format e angazhimit të tillë është edhe raporti vjetor i IAP-së (i njëmbëdhjeti), në të cilin përveç që reflektohet gjendja aktuale e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë, njëkohësisht paraqitet edhe veprimtaria e institucionit në përgjithësi dhe e Avokatit të Popullit në veçanti.

Qytetarët e Kosovës kanë paraqitur ankesa të shumta në IAP për raste të ndryshme të shkeljes së të drejtave të njeriut. Këto raste janë shqyrtuar me kujdes dhe kur është konstatuar se ka shkelje të të drejtave, Avokati i Popullit ka dalë me rekomandime të cilat u janë dërguar institucioneve përkatëse, por ato nuk janë marrë parasysh çdo herë.

Raporti vjetor ka renditje logjike të strukturuar duke marrë për bazë misionin kushtetues të IAP-së, përkatësisht mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Pjesa më e madhe e raportit përfshinë gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë, në përputhje me përmbajtjen e kapitullit të dytë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në bazë të renditjes që është në këtë Kushtetutë. Kjo pjesë përfshinë edhe aktivitetet e grupeve dhe njësive të caktuara që veprojnë në IAP, siç janë: Grupi kundër diskriminimit, Njësia për të drejtat e fëmijëve dhe Njësia për barazi gjinore.

Gjithashtu, në raport është paraqitur bashkëpunimi me institucionet vendore, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare si dhe veprimtaria e përditshme në IAP, duke përfshirë takimet brenda dhe jashtë, pjesëmarrjen në trajnime, seminare, vizita studimore, pastaj çështjet e personelit dhe çështjet financiare si dhe përmbledhjen statistikore të ankesave dhe rasteve në IAP.

1.1. Aspektet e përgjithshme

Republika e Kosovës, me Kushtetutën e saj ka siguruar bazë solide normative për të drejtat e njeriut, në pajtim të plotë me shumicën e standardeve ndërkombëtare. Për më tepër, Kushtetuta shprehimisht garanton zbatimin e drejtpërdrejtë të pothuajse të gjitha marrëveshjeve dhe instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut (neni 22).

Ligji për Avokatin e Popullit, përkundër disa mungesave të theksuara, duke qenë një mekanizëm ligjor i cili sanksionon mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, kur ato nuk respektohen nga institucionet publike, ka arritur të fuqizojë zërin e Avokatit të Popullit, si dhe të krijojë një frymë të re në trekëndëshin ndërlidhës të të drejtave dhe lirive të njeriut: Institucioni i Avokatit të Popullit - institucionet publike - qytetarët.

Edhe pse ekziston bazë e mirë normative, si dhe mekanizma për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, te autoritetet publike të Republikës së Kosovës, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal, ato ende po tregohen neglizhente e joefikase dhe jo rrallë edhe mospërfillëse ndaj respektimit dhe zbatimit të të drejtave dhe lirive të qytetarëve, që janë pasojë e zbatimit jo përkatës të ligjeve.

Ndër sfidat kryesore me të cilat po përballet Kosova, edhe më tej janë: zbatimi efektiv i standardeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe i ligjeve në fuqi, konsolidimi i mëtejshëm i sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë, si dhe luftimi i krimit të organizuar dhe i korrupsionit.

Gjithsesi, sfidë e madhe për ligjvënësit dhe autoritetet e tjera shtetërore të Kosovës, mbetet nxjerrja dhe miratimi i disa ligjeve tejet të rëndësishme të cilat drejtpërdrejtë prekin të drejtat e njeriut të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, siç janë Ligji për sigurim invalidor dhe pensional, si dhe Ligji për sigurim shëndetësor. Mungesa e këtyre ligjeve paraqet shkelje evidente të të drejtave themelore të njeriut në Republikën e Kosovës.

Krahas kësaj, vështirësi të theksuara në zbatimin përkatës dhe efikas të ligjeve po paraqet edhe vonimi i nxjerrjes së akteve nënligjore (rregulloreve dhe udhëzimeve administrative). Madje, këto çështje janë theksuar vazhdimisht edhe në raportet e mëparshme të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP).

Në raportet e mëhershme të IAP-së është shtruar edhe çështja e mungesës së gjykatës administrative e cila do të merrej me zgjidhjen e konflikteve administrative. Vendosja për çështjet e konflikteve administrative ende është kompetencë e Gjykatës Supreme të Kosovës. Por, me miratimin e Ligjit për Gjykatat, çështjet e konflikteve administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe çështjet e tjera të përcaktuara me ligj do të gjykohen dhe vendosen nga Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore, si gjykatë e shkallës së parë (nenet 12 e 14) dhe i Gjykatës së Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë (neni 20).

Një nga çështjet më të rëndësishme për sundimin e ligjit dhe njëkohësisht bazë e shtetit të së drejtës është edhe funksionimi i mirëfilltë i sistemit gjyqësor dhe i prokurorisë në Republikën e Kosovës. Gjyqësori ende mbetet fusha e identifikuar me numrin më të madh të ankesave të paraqitura nga qytetarët e Kosovës në IAP. Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore, zvarritjet e

theksuara të procedurave gjyqësore dhe korrupsioni në sistemin gjyqësor, janë ndër mangësitë kryesore të identifikuara nga Avokati i Popullit që cenojnë rëndë bazat e shtetit të së drejtës.

Problem tjetër i sistemit të drejtësisë në Kosovë, që i ka rrënjët në sistemin arsimor të juristëve në Kosovë, është njohuria e pamjaftueshme e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, me theks të posaçëm në interpretimin e normave ligjore vendëse sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas kuptimit të Konventës Evropiane për të Drejtave Njeriut, ashtu siç është sanksionuar në nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ky nen obligon shprehimisht që “të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë të interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”. Ndërsa, neni 22 i Kushtetutës kërkon që të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të “zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës” dhe që “në rast konflikti”, të kenë përparësi “ndaj dispozitave ligjore dhe akteve të tjera të institucioneve publike“.

2. Të drejtat dhe liritë e njeriut në Republikën e Kosovës

2.1. Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare

Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut është obligim i shteteve. Ato duhet t'iu përmbahen marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përkatësisht t'i ratifikojnë dhe t'i zbatojnë ato. Republika e Kosovës ka shkuar një hap më tej, duke i përfshirë ato në Kushtetutë dhe duke i bërë drejtpërdrejt të zbatueshme, si dhe duke iu dhënë prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike të Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës shprehimisht garanton zbatimin e drejtpërdrejtë të këtyre instrumenteve ndërkombëtare: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj, Konventa kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.¹

Institucioni i Avokatit të Popullit ka vërejtur shkelje serioze të këtyre instrumenteve në disa raste të caktuara. Ato kryesisht kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt.² Mbingarkesa e gjykatave me lëndë të vjetra të pazgjidhura, vonesa në trajtimin e lëndëve të reja, moskzekutimi i vendimeve të formës së prerë, janë disa nga çështjet që kanë rënduar dhe vazhdojnë të rëndojnë mbi gjyqësorin tash e sa vite, duke cenuar kështu të drejtën e qytetarëve të Kosovës për një proces të drejtë, të rregullt dhe të paanshëm.

Riorganizimi i sistemit gjyqësor dhe prokurial të Republikës së Kosovës, krahas përmirësimit të dukshëm të pozitës materiale të gjykatësve dhe prokurorëve, të realizuar në vitin 2011, si dhe fillimi i aplikimit të ndërmjetësimit dhe funksionalizimi i prituri i Shërbimit Noterial pritet të ndikojnë dukshëm në ngritjen e efikasitetit dhe të efektivitetit të punës në gjyqësor, përkatësisht në zgjidhjen e lëndëve.

Me qëllim të monitorimit më të plotë, efektiv dhe efikas të institucioneve ku mbahen personat e ndaluar, Avokati i Popullit e sheh të nevojshme zbatimin e dispozitave të Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese. Në këtë drejtim, IAP, në maj të vitit 2011, ka formuar grupin punues me disa OJQ vendore (Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut - KMDLNJ dhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës - QKRMT) me të cilat ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Ky grup punues do të veprojë si

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

² Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ), neni 6, para. 1. "Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij."

pararendës i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, krijimi i të cilit parashihet me këtë protokoll.³ Ky mekanizëm do të mbrojtjen më efektive dhe më efikase të të drejtave të njeriut të personave të ndaluar. Republika e Kosovës nuk është nënshkruese e Protokollit, por me Kushtetutë ka obligim të zbatojë drejtpërdrejt Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Avokati i Popullit, ripërsërit shqetësimin e tij për mospërfshirjen në Kushtetutë edhe të Konventës për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, si dhe të Kartës Sociale Evropiane. Disa nga të drejtat që përmban kjo Konventë, siç janë: e drejta për strehim adekuat, e drejta në punë dhe ato që burojnë nga marrëdhënia e punës, e drejta për sigurim shëndetësor dhe një sërë të drejtash tjera, vazhdojnë të mos kenë mbrojtjen e duhur ligjore. Përfshirja e kësaj Konvente në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, është e domosdoshme dhe do të ishte një garanci shtesë për qytetarët e Kosovës dhe për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Vlen të theksohet se ndër rekomandimet e Tryezës së organizuar nga IAP dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë, më 2 dhjetor 2011, në Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar, ishte edhe përfshirja e Konventës për të Drejtat e Personave me Invaliditet dhe Protokollit fakultativ në Kushtetutën e Kosovës. Sipas kësaj Konvente, *“Personat me invaliditet përfshijnë ata që kanë lëndime të kohëzgjatshme trupore, mentale (mendore), intelektuale dhe shqisore, të cilat në bashkëveprim me pengesat e ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në bazë të barabartë me të tjerët”*.⁴

Avokati i Popullit rekomandon që në Kushtetutën e Kosovës të përfshihen Konventa për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore si dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Invaliditet, përkatësisht që Kushtetuta të garantojë zbatimin e tyre të drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

2.2. Dinjiteti i njeriut

Dinjiteti i njeriut me aktin më të larë juridik përkufizohet si e *drejtë e pacenueshme dhe bazë e të gjitha të drejtave dhe e lirive themelore*.⁵ Dinjiteti i njeriut është pjesë e pandashme e qenies njerëzore dhe personalitetit të tij. Ai nuk është krijim i asnjë sistemi politik ose ideologjik, por thjesht buron nga brendia e qenies njerëzore dhe i takon çdo njeriu pa marrë parasysh përkatësinë e tij nacionale, fetare, racore, gjinore, sociale, partiake etj.

Në preambulën e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut thuhet: *“Dinjiteti i lindur i të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, i drejtësisë dhe i paqes në botë”*.⁶ Nga kjo shihet qartë lidhshmëria embrionale ndërmjet të drejtave të njeriut dhe dinjitetit të njeriut. Nuk mund të ketë mbrojtje të të drejtave të njeriut pa respektimin e dinjitetit të tij dhe anasjelltas.

³ Protokoll i Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese, neni 3 *“Çdo Shtet Palë krijon, projektton ose mban në nivel kombëtar një ose disa organe vizitore për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, jonjerëzor ose poshtëruës”*.

⁴ Konventa për të Drejtat e Personave me Invaliditet, neni 1, paragrafi 2.

⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 23.

⁶ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Preambula.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar ankesa për shkeljet e pohuara të dinjitetit të njeriut, në rastet e disa të punësuarve në institucione ndërkombëtare që operojnë në Kosovë.⁷ Punëtorët janë keqtrajtuar në vazhdimësi, ndaj tyre është ushtruar presion i vazhdueshëm në punë, është ushtruar dhunë fizike, si dhe janë fyer në baza etnike dhe fetare.

Avokati i Popullit, me anë të ndërmjetësimit, është informuar për të gjitha masat e ndërmarra nga institucionet ndaj të cilave janë parashtruar ankesat. Ai, gjithashtu, nga institucionet e tilla, ka kërkuar trajtim të barabartë dhe pa diskriminim, duke i respektuar ligjet në fuqi.

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë viteve të fundit, një vëmendje të posaçme ua ka kushtuar vizitave në institucionet ku mbahen personat e privuar nga liria. Trajtimi i tyre në këto institucione, mbrojtja nga keqtrajtimi dhe tortura, është në një vijë të drejtë me mbrojtjen e dinjitetit të njeriut. Si rezultat i vizitave të mëhershme dhe monitorimit në këto institucione, të gjeturave dhe rekomandimeve të viteve të kaluara, Avokati i Popullit është angazhuar për krijimin e Mekanizmit Nacional për Parandalim të Torturës.⁸ Ky mekanizëm synon inspektime të rregullta të gjitha vendeve dhe hapësirave ku mbahen personat me liri të kufizuar të lëvizjes dhe të veprimit. Krijimi i këtij mekanizmi do të mund të ndikonte në një masë të madhe në avancimin e dinjitetit të njeriut, në hapësirat ku ai mund të shkelet më shumë, siç janë qendrat e ndalimit, qendrat e paraburgimit, burgjet dhe spitalet.

IAP e vlerëson pozitivisht mbylljen e kampeve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas në Çeshmilluk dhe Osterode, në pjesën veriore të Mitrovicës. Pas njëmbëdhjetë vitesh të kaluara në këto kampe dhe vendosjen e tyre në shtëpitë e rindërtuara në Lagjen e Romëve, në pjesën jugore të Mitrovicës, në koordinim të plotë me USAID-in, BE-në dhe me institucionet vendore, kampet në këtë lagje përfundimisht janë mbyllur gjatë vitit 2011.⁹ Ndërsa sa i përket kampit në Leposaviq është në mbyllje e sipër, pasi gjatë vitit 2012, pritet rindërtimi edhe i disa shtëpive të tjera në Lagjen e Romëve, në pjesën jugore në Mitrovicë.

Sfidë me të cilën ballafaqohen qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës edhe më tutje është mbrojtja e dinjitetit të njeriut, të banorëve në pjesën veriore të Kosovës, të komunitetit shqiptar dhe të gjitha komuniteteve të tjera joserbe. Që nga përfundimi i luftës e deri më sot, ata nuk mund të kthehen të jetojnë në pronat e tyre, ndërkaq për shkak të kufizimit të lëvizjes së lirë të tyre, ata detyrohen të jetojnë nëpër shtëpi të ndryshme, me qira apo nëpër strehimore të ndryshme kolektive, në kushte të vështira të banimit, në pjesën jugore të Mitrovicës dhe në qytetet e tjera të Kosovës.

2.3. Barazia para ligjit

Të jesh i barabartë para ligjit, do të thotë të mos jesh i diskriminuar. Në këtë frymë edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës *barazinë para ligjit për të gjithë individët* e ka njërën

⁷ Rasti i të punësuarve lokalë në EULEX, A. nr. 147/2011.

⁸ Më 10 maj 2011, në Prishtinë, është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit për krijimin e Mekanizmit Nacional për Parandalim të Torturës, ndërmjet IAP-së, QKRMT-së KMLDNJ-së me përkrahjen e OSBE-së.

⁹ IAP ka publikuar dy raporte për këto kampe: Raporti ex-officio nr. 304/2008, publikuar më 1 prill 2009 dhe Raporti ex-officio 50/2010, publikuar më 23 shkurt 2010. Shih për këtë: www.ombudspersonkosovo.org.

prej normave të saj sipërore, duke e trajtuar si bazë të *ushtrimit të i autoritetit publik* në Republikën e Kosovës.¹⁰

Barazia në ligj dhe para ligjit, si dhe ndalimi i diskriminimit, janë parime të përgjithshme që kushtëzojnë gëzimin dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare, janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës, përmes Kushtetutës së Kosovës.¹¹

Mungesa e integritimit të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, bën që grupet në pozita të dobëta kundrejt diskriminimit,¹² kanë probabilitet më të madh për t'u diskriminuar nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe të mos mund të mbrohen drejtpërdrejtë me Kushtetutë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në vitin 2004 e ka miratuar Ligjin kundër diskriminimit,¹³ i cili për shkak të mangësive të caktuara, edhe më tutje vazhdon të mos jetë i zbatueshëm në praktikë.

Amendamenti i Ligjit kundër diskriminimit, përkatësisht i nenit 7 dhe nenit 9, do të krijojnë një mundësi që ky ligj të mos mbetet edhe më tej i pazbatueshëm në realitet.¹⁴ Një veprim i tillë është urgjentisht i domosdoshëm, sepse do të dëshmonte përpjekjet e institucioneve përgjegjëse, përkatësisht Kuvendit dhe Qeverisë, për të siguruar barazinë dhe mosdiskriminim për të gjithë qytetarët e Kosovës, ashtu siç është e garantuar me Kushtetutë.¹⁵

2.3.1. Ligjet e zbatueshme në Kosovë me nenet diskriminuese

Edhe pse për Ligjin për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë¹⁶ është diskutuar shumë herë, mangësitë e të cilit janë evidentuar edhe në raportet mëparshme vjetore të IAP-së, madje është diskutuar edhe në takimet me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), edhe më tutje disa dispozitat të këtij ligji mbeten diskriminuese për shtresën e popullatës së Kosovës me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale.

Sipas nenit 4 të këtij ligji, bazuar në kriteret jofinanciare për ndihmë sociale, veçohen dy kategori përfituesish të ndihmave sociale. Përfituesit e ndihmës sociale të përfshirë në kategorinë e dytë, duhet të plotësojnë kushtin që familja me një anëtar të aftë për punë të ketë të paktën një fëmijë nën moshën pesë (5) vjeç.¹⁷ Neni 4 i këtij ligji, bie ndesh me vetë këtë ligj, sepse në nenin 2, pika iv, persona të varur konsiderohen edhe “personat deri në moshën

¹⁰ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, 2008, neni 3.

¹¹ Po aty, neni 22.

¹² Grupet në pozita të dobëta kundrejt diskriminimit janë shtresa të popullatës të cilët mund të jenë shumë lehtë viktima të diskriminimit si fëmijët, personat me aftësi të kufizuar, pakicat etnike, fetare, individët dhe familjet me gjendje të rëndë ekonomike-sociale, gratë apo burrat e papunësuar, pensionistët etj.

¹³ *Ligji Kundër Diskriminimit*, nr. 2004/3, datë 20 gusht 2004.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, 2008, neni 3.

¹⁶ *Ligji 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë*.

¹⁷ Po aty, neni 4.

katërbëdhjetë (14) vjeç.”¹⁸ Ky nen është, po ashtu në kundërshtim të plotë edhe me nenin 24 dhe nenin 22, pika 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.¹⁹ Kufizimi i moshës së fëmijës deri në 5 vjeç, si kusht që familja të jetë përfituese e ndihmës sociale, bie në kundërshtim edhe me nenin 1 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës.²⁰

Gjithashtu, neni 4 i këtij ligji, i cili kërkon që “*familja me një anëtar të aftë për punë dhe (i) me një fëmijë nën moshën pesë (5) vjeç*” për të qenë përfitues i ndihmës sociale, shkel nenin 3 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, sepse nuk përfilllet fare “*interesi më i lartë i fëmijës*”, që duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.²¹ Me këtë rast fare nuk është menduar për interesin e fëmijës pas moshës 5 vjeçare. Ky nen (neni 4) është në kundërshtim edhe me nenin 26 dhe nenin 40, pika 4, të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Sipas informatave të datës 8 dhjetor 2011, nga MPMS, kjo ministri e ka dorëzuar në Qeverinë e Kosovës Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë. Mirëpo, deri në përmbyllje të këtij raporti IAP nuk ka marrë asnjë informatë lidhur me proceduarat për ndryshimin eventual të këtij neni.

2.3.2. Diskriminimi në sferën e pensioneve

MPMS, qysh në vitin 2005 e ka përgatitur Projektligjin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor. Projektligji është dërguar për miratim në Qeverinë e Kosovës, mirëpo ende nuk është proceduar për votim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Me këtë shihet se edhe më tej infrastruktura ligjore për rregullimin e pensioneve në Kosovë nuk është e plotësuar. Në Kosovë, edhe sot i zbatueshëm është vetëm Ligji mbi Pensionet Bazë. Kjo bën që situata e pensionistëve në Kosovë të mbetet akoma e pakënaqur, duke e vështirësuar në masë të madhe pozitën e tyre në shoqëri.

2.3.3. Diskriminimi në sferën e shëndetësisë

Duke pas parasysh faktin se popullata e Kosovës jeton në varfëri dhe në kushte të rënda ekonomike, elemente këto të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e tyre, investimi në infrastrukturën shëndetësore duhet të jetë prioritet i Qeverisë së Kosovës.

Miratimi i Ligjit për Sigurime Shëndetësore, i cili do të jetë zgjidhje për shumë probleme në sistemin shëndetësor, edhe më tej ka mbetur çështje e hapur në Kuvendin e Kosovës. Kjo

¹⁸ Po aty, neni 2, pika 7.

¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 24, si dhe neni 22, pika 7.

²⁰ Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, neni 1, sipas së cilës me fëmijë nënkuptohet “*çdo njeri nën moshën 18-vjeçare, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet*”.

²¹ Neni 3 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës konstaton se “*Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të mirëqenies shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore*”.

zvarritje nga institucionet përgjegjëse, dëmton qytetarët e Kosovës, të cilët përballen me një gjendje të rëndë shëndetësore.

2.3.4. Diskriminimi i gjyqësorit dhe nga gjyqësori

Me gjithë përmirësimet e natyrës materiale, si dhe të bazës ligjore në sistemin gjyqësor në Kosovë, edhe pas riemërimit të gjyqtarëve, situata situata në gjyqësorin e Republikës së Kosovës mbetet pothuajse e njëjtë. Numri i vogël i gjyqtarëve dhe prokurorëve të emëruar, kushtet fizike dhe ambienti i papërshtatshëm dhe jofunksional, numri në rritje i lëndëve në pritje për t'u zgjidhur, janë faktorët të cilët pothuajse e kanë paralizuar sistemin gjyqësor. Ende nuk vërehet ndonjë përparim i dukshëm. Edhe më tej qytetarët ballafaqohen me problemin e zvarritjes së procedurave për shqyrtim dhe vonesa të shumta, si dhe me drejtësinë joefektive.

Bazuar në rastet e regjistruara dhe të hetuara në Institucionin e Avokatit të Popullit, shkelje e drejtpërdrejtë e nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe nenit 1 të Protokollit shtesë të KEDNJ-së, janë ankesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës, lidhur kontestet pronësore, të paraqitura në ish-Drejtorinë për Çështje Pronësore dhe Banesore të transferuar në Agjencinë Kosovare të Pronës.

Këto konteste pronësore, pas zvarritjeve procedurale për t'u vendosur në ish-Drejtorinë për Çështje Pronësore dhe Banesore të transferuar në Agjencinë Kosovare të Pronës, tani sipas kompetencave lëndore janë në procedura tek gjykatat e rregullta. Është shqetësues fakti kur qytetarëve të Republikës së Kosovës, u duhen më shumë se 10 vite për të arritur deri te një vendim gjyqësor përfundimtar, lidhur me pronën e tyre.²²

Shkelje të drejtpërdrejtë e nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 1 të Protokollit shtesë të KEDNJ-së, përbëjnë edhe rastet e shqyrtimit të ankesave në gjykatat e qarkut. Lidhur me këtë janë të shpeshta rastet e ankesave në IAP,²³ ku vazhdimisht, në përgjigjet e gjykatave hasim në togfjalëshin se “*rasti do të vendoset sipas radhës.*”

Gjatë kësaj periudhe raportuese në IAP nuk është parashtruar asnjë ankesë për punën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Edhe më tej Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës, gjatë punës së saj nuk i respekton të drejtat e qytetarëve, të garantuara me Kushtetutë dhe ligj. Përdorimi i gjuhëve zyrtare për paraqitje të padive në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, edhe më tej mbetet një shkelje, e cila është vërejtur në Raportin e 10-të vjetor të Avokatit të Popullit,²⁴ edhe nuk vërehet ndonjë lëvizje pozitive për eliminimin e kësaj shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë.

²² Rasti i regjistruar në IAP A nr. 413/2011.

²³ Rastet e regjistruara në IAP A nr.82/2011 dhe A nr.182/2011.

²⁴ Raporti i 10 vjetor i IAP-së, Prishtinë, 2011, f. 30-31.

2.3.5. Pabarazia në sferën e punësimit

Sipas ankesave të qytetarëve të Republikës së Kosovës në IAP, rastet më të shpeshta të diskriminimit nga marrëdhënia e punës gjatë këtij viti janë paraqitur kundër Drejtorive Komunale të Arsimit dhe atë nga gjinia femërore. Të shpeshta ishin rastet kur për shkak të shtatzënisë disa mësimdhënësive nuk u është vazhduar kontrata e punës.²⁵

Gjithashtu, kundër drejtorive komunale të arsimit në IAP janë regjistruar edhe ankesa tjera, në të cilat parashtuesit kanë pohuar se punësimi dhe ndarja e orëve të mësimi është bërë në mënyrë të padrejtë dhe pa kritere profesionale, e në shumë raste sipas lidhjeve familjare.²⁶

Sa i përket diskriminimit në moshë me rastin e punësimit, Avokati i Popullit, në raportin paraprak vjetor, me theks të veçantë ka nënvizuar vendimin e senatit të Universitetit të Prishtinës, i cili ka të bëjë me kufizimin e moshës, si kriter për punësim për herë të parë në pozitën e mësimdhënësit në Universitetin e Prishtinës.²⁷ Megjithatë, edhe sot nuk ka ndonjë lëvizje rreth ndryshimit të këtij vendimi me elemente diskriminuese të Senatit të Universitetit të Prishtinës.

2.3.6. Diskriminimi i personave me aftësi të kufizuara

Edhe pse infrastruktura ligjore, lidhur me të drejta të caktuara për personat me aftësi të kufizuara është plotësuar pjesërisht, në mungesë të akteve nënligjore ajo nuk zbatohet plotësisht në praktikë. Ashtu siç e kemi cekur edhe në raportet paraprake të IAP-së, lidhur me infrastrukturën rrugore për lëvizje të lirë për personat me mjete ndihmëse, kjo situatë edhe më tutje vazhdon të mbetet problematike.²⁸ Pavarësisht faktit se ekziston udhëzimi administrativ për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, kjo dukuri nuk është e rregulluar as edhe në vendet më frekuentuese si spitale, shkolla, gjykata e kuvende komunale.²⁹

Në përgjithësi, qasja në objektet shëndetësore është e vështirë për të gjitha llojet e aftësisë së kufizuara. Në QKUK, spitalet në hyrjen e tyre kanë rregulluar qasjen fizike (pjerrinat) për karroca, ndërsa ashensori (qasja vertikale), në shumicën e rasteve, është i pashfrytëzueshëm, pasi shumica e ashensorëve nuk mirëmbahen dhe janë jashtë përdorimit. Dhomat në QKUK janë të mbingarkuara me shtretër dhe është e pamundur lëvizja e lirë e personit me karrocë nëpër to. Tualetet ekzistuese në spitale dhe në qendra të mjekësisë familjare janë shumë të vogla dhe nuk janë të përshtatshme për përdorim nga personat me karrocë.

Përfshirja në arsimin fillor, sipas Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës është i obligueshëm për të gjithë fëmijët.³⁰ Përmirësime të dukshme ka në fushën e arsimit gjithëpërfshirës, d.m.th. përfshirja në sistemin arsimor të fëmijëve me nevoja të veçanta. Në

²⁵ Lidhur me këtë në IAP janë regjistruar rastet A. nr. 341/2011 dhe A nr. 410/2011.

²⁶ Po aty, rastet A nr. 495/2011 dhe A nr. 431/2011.

²⁷ Raporti i 10 vjetor i IAP-së, Prishtinë, 2011, f. 31-32.

²⁸ Raporti i 10 vjetor i IAP-së, Prishtinë, 2011, f. 32-33.

²⁹ Udhëzimi Administrativ për kushte teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, nr. rendor 33, numri i protokollit 07/07, neni 1.

³⁰ Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 9, pika 2 dhe 3.

vitet e fundit, janë ngritur objektet adekuate, janë avancuar aftësitë teknike dhe janë rritur kapacitetet, për ta bërë sistemin arsimor në Kosovë më të hapur për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta.

Megjithatë, shkollat e rregullta nuk kanë infrastrukturë për vijim të mësimit për fëmijët me aftësi të kufizuar në lëvizje, pra fëmijët të cilët lëvizin me karroca ndihmëse. Asnjë shkollë nuk ka qasje për këtë kategori fëmijësh. Edhe nëse ka qasje, ajo mund të jetë vetëm në katet e para të objektit shkollor. Kjo i pamundëson fëmijëve që të vijojnë mësimin me bashkëmoshatarët e tyre dhe të ndihen të barabartë në shoqëri. Ata obligohen që mësimin ta vijojnë në qendra burimore.

Papunësia dhe mungesa e aktiviteteve ekonomike janë ndër problemet kryesore që prekin pjesën më të madhe të shoqërisë kosovare, por janë shumë më të theksuara te personat me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre. Pa dyshim, njerëzit me aftësi të kufizuar përjetojnë shkallën më të lartë të papunësisë.

Numri i personave me aftësi të kufizuar të përfshirë në punësim, sidomos në shërbimin civil, është shumë i vogël. Deri sot nuk është vërejtur ndonjë lëvizje rreth krijimit të ambientit të përshtatshëm të punës, duke përfshirë këtu përshtatshmërinë e vendit të punës; sigurimin e mjeteve teknologjike asistuese; infrastrukturës përcjellëse të përshtatshme si: tualeti, ashensori, pjerrinat, mjetet komunikuese, transporti etj., në mënyrë që personave të tillë t'u mundësohet e drejta në punësim.

Aftësia e kufizuar e përhershme apo edhe përkohshme, ndryshon nga individi në individ. Varësisht nga diagnoza të cilën e ka një person me aftësi të kufizuar, ndryshojnë edhe nevojat elementare për jetesë. Në Kosovë nuk ka ndonjë bazë ligjore e cila bën kategorizimin e aftësisë së kufizuar.

Sipas ligjit ekzistues, të gjithë personat me aftësi të kufizuar përfshihen në një kategori.³¹ Me këtë rast dhe në bazë të këtij ligji, të diskriminuar mbesin vetë personat me aftësi të kufizuar, sepse, aftësia e kufizuar nuk është e njëjtë tek të gjithë personat. Ky trajtim egalitar shprehet konkretisht te mbështetja financiare, si dhe rregullimi i beneficioneve, sepse sipas këtij ligji të gjithë kompensohen njëjtë.

Ligji për pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë, me asnjë nen nuk parasheh kategorizimin e aftësisë së kufizuar, e cila do të përcillej me kompensim material përkatës, me shkallën objektive të aftësisë së kufizuar. Mungesa e një norme apo e një udhëzimit administrativ për kategorizimin e aftësisë së kufizuar, ka shkaktuar konfuzion të përgjithshëm, sepse ka edhe shumë raste që pretendojnë se janë persona me aftësi të kufizuar, ndërsa komisioni vlerëson se fare nuk ekziston aftësia e kufizuar.

Duke pas parasysh faktin se sa më e lartë të jetë aftësia e kufizuar, aq më të mëdha janë edhe nevojat për ndihmë materiale për personin me aftësi të kufizuar, është nevojë urgjente që Ligji për pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë të rishqyrtohet, të ndryshohet apo të plotësohet me nene shtesë, sipas të cilave do të caktohej shkalla e aftësisë së kufizuar, e cila do të përcillej me një ndihmë materiale përkatëse, varësisht nga shkalla e aftësisë së kufizuar.

Lidhur me të gjitha këto të gjetura të Avokatit të Popullit, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar, ka organizuar një tryezë të rrumbullakët me temën “Stop

³¹ Ligji për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë, nr. 2003/23.

Diskriminimit - barazi për të gjithë”. Në këtë tryezë është diskutuar për problemet me të cilat drejtpërdrejt ballafaqohen personat me aftësi të kufizuar në jetën e tyre të përditshme, si dhe veprimet e ndërruara apo të planifikuara për t’u ndërmarrë nga niveli qendror dhe lokal i qeverisjes, në mënyrë që kjo kategori e personave të jetë dhe të ndjehet pjesë e barabartë e shoqërisë sonë. Fatkeqësisht, ftesës së IAP-së për të diskutuar nuk i janë përgjigjur shumë institucione kompetente dhe përgjegjëse të nivelit qendror dhe lokal.

Nga kjo tryezë kanë dalë rekomandime, të cilat do t’u përcillen institucioneve përgjegjëse nga njësia për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, e krijuar në kuadër të departamentit për mosdiskriminim në Institucionin e Avokatit të Popullit.

2.3.7. Trajtimi diskriminues nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP)

AKPedhe më tej në skemën e qirasë nuk i ka të përfshirë pronarët shqiptarë, të cilët pronat e tyre i kanë në veri të Mitrovicës, ndërsa pronat e pronarëve serbë dhe të komuniteteve të tjera, nëpër vendet e tjera të Kosovës, i kanë të përfshira në skemën e qirasë. Një numër i vogël i qytetarëve shqiptarët të veriut të Mitrovicës, vetëm për dy muaj e kanë vjelë qiranë nga prona të cilën e kanë lënë nën administrim të AKP-së dhe pastaj u është ndërprerë sërish, pa kurrfarë njoftimi dhe arsyetimi. Kjo ka bërë që qytetarët e kësaj pjese të Republikës së Kosovës të mos ndihen të barabartë, sepse nga AKP-ja po trajtohen ndryshe nga bashkëshitasit e komuniteteve të tjera. Me këtë rast AKP shkel nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 1 i Protokollit shtesë të KEDNJ-së.

2.3.8. Trajtimi diskriminues nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

Në IAP janë të regjistruara ankesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës kundër KEK-ut, lidhur me kategorizimin e energjisë elektrike në A, B dhe C.³²

KEK në faqen zyrtare pothuajse çdo ditë publikon orarin e furnizimit dhe kategorizimin për furnizim me energji elektrike në zonat A, B dhe C.³³ Sipas zyrtarëve të KEK-ut, kategorizimi për furnizim me energji elektrike në A, B dhe C bëhet për shkak të mospagesës së rregullt të energjisë elektrike të shpenzuar nga qytetarët e Kosovës.

Pa dyshim se ky kategorizim në A, B dhe C, nga ana e KEK-ut, për furnizim me energji elektrike është diskriminues për qytetarët dhe është në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ky kategorizim është paushall dhe diskriminon qytetarët e kategorizuar në B dhe C, në mënyrë arbitrare nga KEK-u, e që janë pagues të rregullt të energjisë së shpenzuar, ashtu si privilegjon në mënyrë paushall ata të cilët janë kategorizuar në A nga vetë KEK-u dhe që kanë borxhe të papaguara, madje në shuma të mëdha, për energjinë e shpenzuar. Ky është rast tipik i keqpërdorimit të monopolit në treg.

³² Rasti i regjistruar në IAP, A nr. 512/2011.

³³ <http://kek-energy.com/orariKat.asp>, e premte, 9 dhjetor 2011 ora 15:07.

2.3.9. Barazia gjinore

Parimi i barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit është njëri nga parimet bazë të të drejtave të njeriut. Shtetet moderne demokratike nuk mund të paramendohen pa krijimin e parakushteve të barabarta për realizimin e të drejtave të njeriut. Me gjithë përpjekjet në shtetin e ri të Kosovës, pabarazia gjinore ende është shumë e pranishme në pjesën më të madhe të formave të jetesës shoqërore dhe institucionale në Kosovë.

Kushtetuta e Kosovës parasheh zbatimin e drejtpërdrejtë të Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas - CEDAW.³⁴ Barazia gjinore rregullohet me Ligjin për Barazi Gjinore,³⁵ i cili ka përfshirë plotësisht parimet e Konventës së lartpërmendur. Sipas kërkesës së këtij ligji,³⁶ IAP ka themeluar Njësine për Barazi Gjinore (NJBGJ), e cila ka për mision të shqyrtojë ankesat të bazuara në shkeljet lidhur me gjininë dhe të promovojë dhe monitorojë barazinë gjinore në Kosovë.

Ligjin për Barazi Gjinore identifikon NJBGJ-në në kuadër të IAP-së, si organ kompetent për pranimin, hetimin dhe për të vendosur për ankesat të cilat kanë të bëjnë me barazinë gjinore.³⁷ Por, duke pasur parasysh juridiksionin dhe rolin e IAP, si dhe faktin se Avokati i Popullit bënë rekomandime të cilat nuk janë të karakterit ekzekutiv, është e domosdoshme që të bëhet plotësimi i këtij ligji. Në të vërtetë, Ligjin për Barazi Gjinore do të duhej shprehimisht dhe qartë të theksojë kompetencën gjyqësore apo administrative për rastet në të cilat ndonjë personi i është shkelur e drejta apo liria për shkak se i takon një gjinie të caktuar. Pra, t'i mundësojë fillimin e procedurës sipas ankesës para gjykatës kompetente apo organit më të lartë administrativ.

Në LBGJ nuk është përcaktuar mënyra e fillimit të procedurës lidhur me diskriminimin në bazë të gjinisë. Prandaj, nuk habit fakti se ky ligj vazhdon të mbetet vetëm shkronjë në letër, i pazbatueshëm në praktikë nga organet gjyqësore dhe nga organet administrative.

2.3.9.1. Vendimmarrja dhe e drejta në punë

Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje është jashtëzakonisht domethënëse dhe njëkohësisht tregon shkallën e demokracisë së arritur në një shoqëri. Eliminimi i pabarazisë ndërmjet meshkujve dhe femrave në pozitat vendimmarrëse, deri diku është arritur me futjen e masave të posaçme në legjislacion, më saktësisht, me përcaktimin e kuotës për gjininë më pak të përfaqësuar, që në praktikë paraqet mënyrën për eliminimin e diskriminimit ndaj gruas.

Duhet theksuar se në Kuvendin e Kosovës është respektuar kuota e përfaqësimit për gjininë më pak të përfaqësuar e cila është 30%.³⁸ Kuota e përfaqësimit në thelb mundëson fillimisht,

³⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22. "Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve Publike".

³⁵ Ligji për Barazi Gjinore, nr. 2004/2, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 19 shkurt 2004

³⁶ Ligji për Barazi Gjinore, neni 6.

³⁷ Po aty.

³⁸ Po aty, neni 3.2.

krijimin e kulturës së pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje dhe punë në një shoqëri. e cila natyrisht në intervalin e caktuar kohore do të zëvendësohet me konkurrencën reale. Gjendja e rëndë ekonomike dhe sociale dhe papunësia e madhe në Republikën e Kosovës, në masë të madhe kanë ndikuar në pozitën marginale të grave në tregun e punës. Ky diskriminim, në mënyrë të veçantë paraqitet në zonat rurale dhe në mesin e grave të komuniteteve ashkali, rom dhe egjiptas. Gratë, jo vetëm që hasin në vështirësi me rastin e konkurrimit në tregun e punës, por ato kanë edhe gjasa më të vogla për të gjetur punë, veçanërisht në vendet udhëheqëse, madje edhe kur janë kompetente për një vend të tillë të punës aq sa edhe meshkujt.

Diskriminimi fillon që me rastin e shpalljes e konkurseve të vendeve të punës,³⁹ duke përmendur gjininë si një nga kriteret për punësim. Ashtu si edhe në periudhën e mëparshme raportuese, edhe në këtë periudhë ka pasur ankesa lidhur me shkeljen e së drejtës së amësisë.⁴⁰ Vërehet se punëdhënësit më së shpeshti shkelin të drejtat e grave ashtu që nuk u ofrojnë kontrata pune kur e kuptojnë se ato janë shtatzënë.⁴¹ Edhe më rëndë është, e kjo është një praktikë e zakonshme në përgjithësi, kur institucionet publike shkëpusin kontratat e punës në mënyrë të paligjshme dhe sillen në mënyrë diskriminuese ndaj grave të punësuarat të cilat kthehen në punë pas pushimit të lehonisë.⁴²

Gjatë vitit 2011, IAP, përveç të tjerash ka pranuar ankesën, e cila i referohej ndërprerjes së marrëdhënies së punës të një punëtoreje, nga një spital privat në komunën e Prishtinës. Arsyeja e thjeshtë për ndërprerjen e kontratës ishte fakti se punëtorja ishte shtatzënë. Pala është udhëzuar të përdorë mjetet ligjore, përkatësisht që të parashtrojë ankesë dhe gjithashtu është udhëzuar që t'i drejtohet inspektoratit të punës. Pas intervenimit të Avokatit të Popullit, punëtorja është kthyer në punë brenda një afati shumë të shkurtër.

E tërë kjo flet shumë qartë se, sistemi juridik me mekanizmat e ndërtuar mbrojtës nuk është i fuqishëm sa duhet në parandalimin dhe ndaljen e diskriminimit në fushën e punës dhe punësimit. Për sa i përket legjislacionit, gjithashtu duhet theksuar se duhet të bëhet harmonizimi i Ligjit të Punës me Ligjin për Shërbimin Civil, gjë që gjithashtu parqet një nga arsyet për diskriminim.⁴³

2.3.9.2. E drejta e trashëgimit të pronës

Një fushë tjetër me rëndësi jetike, ku gratë trajtohen në mënyrë jo të barabartë është pamundësia e realizimit të së drejtës për trashëgim të pronës në Kosovë. Lidhja e ndërsjellë shkak-pasojë ndërmjet të drejtës së trashëgimit të pronës dhe rolit social të gruas, është një ndër faktorët vendimtarë për diskriminimin gjinor të femrës. Mohimi i pronës grave, arsimimi i pamjaftueshëm, analfabetizmi dhe përparësia e anëtarëve meshkuj të familjes për t'u shkolluar janë faktorët tipik për shoqërinë tonë tradicionale kosovare.

Në Kosovë ekziston ligji i veçantë për trashëgiminë, i cili të drejtën në trashëgimi e trajton pa diskriminim, ku femra ka plotësisht të njëjtën të drejtë në trashëgimi si mashkulli.⁴⁴ Por, në

³⁹ Raporti i IAP-së, rasti *ex officio* nr. 48/05.

⁴⁰ Rasti në IAP, A.nr.515/2011.

⁴¹ Po aty.

⁴² Rasti në IAP, A.nr.357/2011.

⁴³ Raporti i QKSGJ, Ndikimi i Ligjit të punës te gratë në Kosovë.

⁴⁴ Ligji nr.2004/26, Ligji për trashëgiminë, neni 3.

praktikë ekziston numër i madh i rasteve ku gratë të cilat kërkojnë të realizojnë të drejtat e tyre pronësore nëpërmjet trashëgimisë i nënshtrohen kërcënimeve, qoftë fizike, qoftë psikike, nga bashkëshortët e tyre apo nga anëtarët tjerë meshkuj të familjes.⁴⁵

Në vitin 2011 IAP ka pranuar ankesën e një vajze të re lidhur me të drejtën e trashëgimisë. Pas vdekjes së babait të saj ajo dhe e ëma thjeshtë janë nxjerrë në rrugë nga shtëpia familjare e cila gjendej në oborrin e përbashkët me xhaxhain e saj. Ajo ka parashtruar kërkesën për ndarjen e pronës. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur në favor të saj, por lënda ndodhej në procedurën e ankesës në shkallë të dytë. Ankuesja iu drejtua IAP, për shkak të zvarritjes së procedurës në gjykatën e shkallës së dytë. Pas intervenimit të IAP-së procedura para gjykatës së shkallës së dytë ka përfunduar.⁴⁶

2.3.9.3. E drejta në edukim dhe arsimim

Në fushën e arsimit, nga aspekti i barazisë gjinore është shënuar progres, por jo i mjaftueshëm. Gratë në shoqërinë kosovare janë më pak të arsimuara se meshkujt dhe te ato ekziston përqindje më e lartë e analfabetizmit.⁴⁷ Diskriminimi shoqëror i cili shprehet edhe në institucionet publike në Kosovë, shprehet gjithashtu edhe te profilet e arsimuara të cilët flasin për formën patriarkale të ndarjes së profesioneve për meshkuj dhe për gratë.

Baza ligjore në Kosovë nuk njeh diskriminimin gjinor, ajo është po e njëjta si për djemtë ashtu edhe për vajzat në Kosovë.⁴⁸ Por në praktikë, tradita në Kosovë ndikon shumë që t'u jepet përparësi në shkollim anëtarëve meshkuj të familjes. Gjithashtu, braktisja e shkollës ndodhë më shpesh te vajzat dhe është karakteristike për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët. Gjithashtu, për këto grupe është karakteristike martesë e hershme e cila ndërlihet me dukurinë e braktisjes së shkollës.

2.3.9.4. Mbrojtja shëndetësore

Ligji për mbrojtjen shëndetësore dhe sociale në Kosovë ende nuk ekziston. Rekomandimi i Avokatit të Popullit nga raporti vjetor i vitit të kaluar 2010, nuk është zbatuar.⁴⁹ Kosova është i vetmi vend në Evropë i cili nuk ka një ligj të tillë. Kjo përbën një shkelje të rëndë të drejtave të njeriut. Mungesa e tij shkakton pasiguri të madhe në popullatën kosovare, sidomos te gratë, lidhur me mbrojtjen shëndetësore. I vetmi ndryshim pozitiv në këtë plan ishte miratimi i Ligjit të Punës, i cili rregullon pushimin e lehonisë. Dispozitat e këtij ligji garantojnë pushim të paguar të lehonisë për 6 muaj dhe pushim për 6 muaj i cili paguhet pjesërisht.⁵⁰

⁴⁵ Tawil Edward, Të drejtat pronësore në Kosovë, Një trashëgimi e vështirë e shoqërisë në tranzicion. Po ashtu shih, rasti A.nr.316/2011.

⁴⁶ Rasti A.nr.316/2011, komuna e Prishtinës.

⁴⁷ MASHT, UNICEF dhe ESK, *Shqyrtim i çështjeve gjinore në Kosovë*, 2002 f.7. Në pjesët rurale të Kosovës 14 % e femrave krahasuar me 4 % të meshkujve, janë analfabetë.

⁴⁸ *Ligji nr.2004/3, Ligji kundër diskriminimit*, neni 2.

⁴⁹ IAP, *Raporti i dhjetë vjetor*, Barazia gjinore, Rekomandimet, fq. 36.

⁵⁰ *Ligji Nr. 03/L-212, Ligji i Punës*, neni 49.

IAP ka pranuar edhe gjatë këtij viti ankesa që ndërlidhen me diskriminimin nga Ministria Shëndetësisë dhe nga Ministria e Financave. Ministria e Financave nuk ia aprovoi një ankueseje shërimin jashtë vendit, me arsyetimin se mungojnë mjetet materiale. Megjithatë, pala nëpërmjet IAP ka marrë ndihmën materiale nga organizata punuese në të cilën është e punësuar.⁵¹

2.3.9.5. Dhuna në familje

Dhuna në familje është problem serioz i shoqërisë kosovare. Dukuria e dhunës nuk është e re, ajo ka ekzistuar gjithmonë në shoqëri. Në periudhën e pasluftës është miratuar Ligji kundër dhunës në familje.⁵²

Dhuna si e tillë ka shumë aspekte, mundë të jetë dhunë fizike, psikike, sociologjike dhe ekonomike. Viktimat më të shpeshta të dhunës janë fëmijët dhe gratë, por ekziston edhe një numër i vogël i rasteve kur viktimat të dhunës janë meshkujt.

Shumë shpesh dhuna në familje trajtohet si problem i brendshëm, privat i një familje, i cili në asnjë mënyrë nuk guxon të dalë në shesh. Ndodh që raportimi i dhunës te organi kompetent të tërheq pas vetes hakmarrjen e kryesit ose që në një rast të tillë gruaja të bëhet objekt i gjyqimit moral të rrethit në të cilin jeton.

Në Kosovë gjatë vitit 2011 kanë ndodhur 3 vrasje në të cilat viktimat ishin gra. Vrasjet ishin pasojë e dhunës në familje. Ende shumica e gjykatave, pas kërkesës së parashtruar pranë gjykatës kompetente nga ana e viktimës për urdhërbrojtje, gjykatat nuk marrin vendim për masën mbrojtëse adekuate brenda afatit të duhur kohor të paraparë me ligj.⁵³ Megjithatë, nuk ka tregues se gjendja gjatë kësaj periudhe të raportimit ka ndryshuar për të mirë.

Sipas Raportit të Policisë të Republikës së Kosovës për rastet të dhunës familjare në komunën e Prishtinës për vitin 2011, janë regjistruar 268 raste, komuna e Gjilanit, ka pasur 109 raste, në komunën e Ferizajit janë shënuar 108 raste, komuna e Pejës 207, komuna e Prizrenit 172 raste dhe në komunën e Mitrovicës janë regjistruar 182 raste.

2.4. E drejta për jetën

E drejta për jetën, si një e drejtë themelore dhe kushti i parë për ekzistimin e të drejtave të tjera, garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kjo e drejtë është e sanksionuar edhe me Kodin Penal të Kosovës.⁵⁴

Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 25, p. 2, dënimi me vdekje është ndaluar. Me Protokollin nr. 6 të KEDNJ-së, neni 1 dënimi me vdekje është i hequr. Askush nuk mund të ndëshkohet me një dënim të tillë, as të ekzekutohet. Neni 2 i KEDNJ-së, parasheh një detyrim pozitiv të shteteve për të hetuar rastet e vdekjeve, që kanë elemente të shkeljes së këtij neni.

⁵¹ Rasti A.nr.247/2011, komuna e Prishtinës.

⁵² Ligji Nr.03/L -182, Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje.

⁵³ Raporti i Policisë të Republikës së Kosovës për rastet të dhunës familjare për vitin 2011.

⁵⁴ Kodi Penal i Kosovës, neni 146.

Në Kosovë, veprat penale kundër jetës shfaqen në forma të ndryshme. Disa nga format e cenimit të drejtës për jetën janë krimet për gjakmarrje, konfliktet që kanë për bazë problemet e pronësisë, krimet kundër moralit, mandej krimet e ndërlidhura me forma të ndryshme të trafikimit, si ai me drogë dhe me qenie njerëzore. Në disa zona të vendit, ka ende familje që ndodhen të ngujuara për shkak të gjakmarrjes. Të gjithë këta individë të pafajshëm, si pjesëtarë të shoqërisë, detyrohen të shkëputen prej saj, duke e privuar veten nga ushtrimi i këtyre të drejtave. Në të gjitha këto raste tragjike, Avokati i Popullit konstaton dështimin e veprimit të shtetit ligjor.

2.4.1. Dukuri që e shqetëson shoqërinë kosovare

Nga janari deri në nëntor 2011, janë raportuar 156 raste të vrasjeve në tentativë, për çka janë arrestuar 222 persona.⁵⁵

Sipas informatave të pranuar në IAP në të shumtën e rasteve hetimet e Policisë së Kosovës përfundojnë me arrestimin e personave përgjegjës për vepra penale kundër jetës, por janë organet gjyqësore që vendosin. Dhe, me gjithë reformimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë dhe rritjes së numrit të prokurorëve dhe gjykatësve, kapacitetet e gjykatave në Kosovë ende mbeten të kufizuara. Numri i madh i lëndëve të mbetura nga vitet e mëparshme dhe dukuritë e tjera negative të pranishme në sistemin e drejtësisë, vënë në dyshim edhe të drejtën për gjykimin e drejtë, të rasteve që ndërlidhen me veprat penale kundër jetës.

Shqetësim i veçantë për Avokatin e Popullit, paraqet mungesa e hetimeve për rastet e paraqitura, në lidhje me shkeljen e të drejtës për jetën. Edhe në këtë periudhë raportuese IAP, ka pranuar disa ankesa që kanë të bëjnë me zvarritjen e procedurave dhe mungesën e hetimeve nga autoritetet publike, lidhur me ndriçimin e rasteve të vrasjeve. AP, në vitin e kaluar ka publikuar një raport me rekomandim për mungesën e hetimeve efektive nga autoritetet kompetente (Prokuroria Publike në Pejë).⁵⁶ Ky rekomandim ende nuk është zbatuar dhe IAP, nuk ka pranuar asnjë përgjigje, përkritazi me rekomandimin e dërguar.

Në shumicën e rasteve të paraqitura, në lidhje me shkeljen e kësaj të drejte, konstatohet mungesa e hetimeve zyrtare dhe zvarritja e procedurave për një proces të rregullt gjyqësor nga organet kompetente.

IAP, pas raportimit të mediave për rastet e lëndimeve të qytetarëve nga përdorimi i mjeteve piroteknike gjatë festave të fundvitit, në bazë të nenit 15.3 të Ligjit për AP, ka vendosur që të hapë hetime sipas detyrës zyrtare (*ex officio*),⁵⁷ duke e parë shumë të rrezikshëm përdorimin e mjeteve piroteknike, të cilat drejtpërdrejtë cenojnë të drejtën për jetë. Pas raportimit të mediave për lëndimin e qytetarëve nga përdorimi i mjeteve piroteknike, përfaqësuesit e IAP-së vizituan disa qendra spitalore në Kosovë, si dhe kontaktuan me zyrtarë përgjegjës për t'u informuar rreth gjendjes shëndetësore të të lënduarve nga mjetet piroteknike.

⁵⁵ Gazeta ditore "Kosova Sot", 21 nëntor 2011, faqe 13.

⁵⁶ Rasti nr. 1546/2004.

⁵⁷ Raport *ex-officio*, nr. 4/2011, me datë 19 janar 2011.

Lidhur me çështjen e tregtimit dhe të përdorimit të mjeteve piroteknike AP, mbështetur në faktet e mbledhura në terren konstaton se, institucionet dhe organet përgjegjëse kanë dështuar të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara me ligj dhe, me veprimet apo mosveprimet e tyre kanë bërë një varg shkeljesh ligjore. Përkitazi me këtë rekomandim dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, IAP nuk ka pranuar asnjë përgjigje.

Avokati i Popullit, vazhdon të apelojë për kujdes të shtuar gjatë përdorimit të mjeteve piroteknike. Nga organet kompetente kërkon zbatimin me përpikëri të të gjitha normave ligjore në fuqi përkitazi me mjetet piroteknike. Mjetet piroteknike rrezikojnë drejtpërdrejt jetën e njerëzve, prandaj kujdesi duhet të jetë i shtuar si nga institucionet edhe nga vetë ata që i përdorin.

Prandaj, Avokati i Popullit ka ripërsëritur kërkesën për një zbatim efikas të ligjit dhe një sistem gjyqësor të efektshëm. Një sistem ku krimet hetohen në mënyrë të efektshme dhe të plotë, ku kryesit e krimeve kundër jetës gjykohen shpejt dhe me drejtësi. Deri atëherë, sistemi juridik në Republikën e Kosovës vazhdon të mos jetë në pajtim me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare, lidhur me garantimin e të drejtës për jetën.

Rekomandime

- *Policia e Kosovës, duhet të jetë ma azhure në zbulimin e kryerësve të veprave penale kundër jetës.*
- *Duhet të rritet numri i prokurorëve dhe gjyqtarëve, në lëmin penal, në mënyrë që të mos ketë zvarritje të procedurave, në rastet kur kemi të bëjmë me veprat penale kundër jetës së njeriut.*
- *Instituti Gjyqësor i Kosovës, duhet të vazhdojë edhe më tej me trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga lëmi penal, në lidhje me hetimin e veprave penale kundër jetës dhe gjykimin e tyre.*
- *Qytetarëve duhet t'u ofrohen mjete të përshtatshme juridike për realizimin e kompensimit për dëmet e shkaktuara në rastet e dështimit të institucioneve publike kompetente për hetimin, ndriçimin, zbulimin dhe dënimin e kryerësve të veprave penale.*
- *Të zbatohen rekomandimet e Avokatit të Popullit nga organet përgjegjëse.*

2.5. E drejta e integritetit personal

Koncepti i integritetit personal definohet si pacenueshmëri ose paprekshmëri e trupit të njeriut, në kuptim të respektimit të vlerave të tij fizike dhe psikike. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, “mbron të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të secilit person”,⁵⁸ përfshirë të drejtën për të marrë vendime për riprodhim, të drejtën për të pasur kontroll mbi

⁵⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 26.

trupin, të drejtën për të mos iu nënshtroar trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tij, dhe të drejtën për të mos qenë pjesë e eksperimenteve mjekësore ose shkencore pa pëlqimin e tij.

E drejta e integritetit personal, përveç me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në vendin tonë rregullohet edhe me një sërë ligjesh që ndërlidhen me paragrafët 1, 2, 3, 4 të nenit 26 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.⁵⁹

E drejta e mbrojtjes së integritetit personal përfshin edhe mbrojtjen e dëshmitarëve. Kuvendi i Republikës së Kosovës, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, ka miratuar Ligjin Nr. 04/-L-015, për Mbrojtjen e Dëshmitarëve. Është inkurajues fakti që në grupin punues për hartimin e ligjit të ri, janë përfshirë edhe përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, shoqërisë civile, si dhe të organizatave ndërkombëtare.

IAP ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve, përkatësisht të përputhshmërisë/kundërshtisë së tij me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe kompetencat e Avokatit të Popullit, dhe ka bërë komentet e veta nëpërmjet një rekomandimi të dërguar me datën 7 korrik 2011, te kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kryetari i Komisionit për Legjislacion në Kuvendin e Republikës së Kosovës, rekomandime të cilat pjesërisht janë marrë për bazë. Vërejtja themelore e IAP-së në Ligjin për dëshmitarët e mbrojtur ka të bëjë me faktin se me asnjë normë nuk garantohet mbrojtja e dëshmitarëve nga vetë autoritetet në rast të shkeljes së të drejtave nga autoritetet publike.

Gjatë kësaj periudhe raportuese IAP ka trajtuar vetëm një ankesë për shkeljen e të drejtës së integritetit personal. Avokati i Popullit ka shprehur shqetësimin e vet në lidhje me vdekjen tragjike - vetëvrasjen e Agim Zogajt, të ashtuquajturit dëshmitari X në Republikën Federale të Gjermanisë, derisa ishte nën mbrojtjen e misionit të EULEX-it.

2.6. Ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës

Se “*Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës*”, garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës⁶⁰ dhe instrumentet ndërkombëtare⁶¹.

Ligji për Avokatin e Popullit, parasheh se zyrtarët e IAP-së, në çdo kohë dhe pa paralajmërim mund të monitorojnë institucionet në të cilat është e kufizuar liria e personave.⁶² IAP vizitat

⁵⁹ Ligji për të Drejtat dhe për Përgjegjësitë e Qytetarëve për Kujdesin Shëndetësor, nr. 2004/38; Ligji për Shëndetin Riprodhues, nr. 02 /L-76 dhe Ligji për Kujdesin Shëndetësor Emergjent, nr. 02/L-50.

⁶⁰ Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 2008, neni 27.

⁶¹ Po aty, neni 22, pika 8; Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 10.12.1948, neni 5; KEDNJ, Romë, 4. XI. 1950, neni 3; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile Politike, 2200 A (XXI), 16 12 1966, neni 7 dhe neni 10.

⁶² Ligji për Avokatin e Popullit, nr.03/L-195, neni 16.7 I, sipas të cilit “*Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit në çdo kohë dhe pa paralajmërim mund të hyjnë dhe të inspektojnë çdo vend ku personat janë privuar nga liria si dhe në institucionet tjera me liri të lëvizjes së kufizuar dhe mund të jenë të pranishëm në mbledhje ose séance dëgjimore ku përfshihen personat e tillë. Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit mund të mbajnë edhe takime me personat e tillë pa praninë e zyrtarëve të Institucionit përkatës. Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Institucionin e Avokatit të Popullit nuk pengohet apo kontrollohet*”.

monitoruese i realizon në vendet e ndalimit, për të vlerësuar trajtimin e personave të cilëve u është mohuar liria. Këto vende përfshijnë burgjet, qendrat e paraburgimit, rajonet e policisë, spitalet psikiatrike etj.

Burgjet janë institucione të mbyllura, në të cilat liria, në të gjitha kuptimet e saj, është e kufizuar dhe të drejtat e të burgosurve mund të shkelen më lehtë. Ankesave të këtyre personave u kushtohet vëmendje e veçantë nga IAP.

Gjatë kësaj periudhe raportuese IAP, në baza të rregullta mujore, ka vizituar të gjitha burgjet (Dubravë, Lipjan dhe Smrekonicë) dhe qendrat e paraburgimit (Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjilan dhe Mitrovicë), sikurse edhe vendet e ndalimit në stacionet policore, Institutin e Shëndetit Mendor në Shtime etj. Vizitat e realizuara kanë pasur për qëllim sigurimin e një vlerësimi të trajtimit të personave të privuar nga liria, kushteve në të cilat mbahen, shëndetësinë, etj. Ndërkaq rekomandimet janë drejtuar Shërbimit Korrektues të Kosovës, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë etj.

Torturë, në kuptimin klasik nuk ka hasur IAP, përveç ndonjë rasti të izoluar, por ka pasur raste të sjelljeve jo të hijshme të pasuara me fyerje dhe sharje, ankesa për furnizimin me barna, për përzgjedhje subjektive të privilegjeve dhe beneficioneve, zvarritje të procedurave gjyqësore në marrje të vendimit final etj.

Në shumicën e rasteve, ankesat e të burgosurve janë bërë me shkrim dhe janë vendosur në kutitë e ankesave, por edhe përmes telefonit, familjarëve, avokatëve apo punonjësve të administratës së burgut. Avokati i Popullit ka pranuar ankesa për mënyrën e sjelljes së stafit të burgut, të cilët kanë ofenduar dhe sharë të burgosurit; ankesa të drejtuara kundër vendimeve të gjykatave, me pretendimin se nuk janë fajtorë për veprat për të cilat janë dënuar dhe se gjykatat nuk i kanë vlerësuar drejt provat; ankesa për mosfurnizim me barna, sipas nevojës, e në disa raste për mosfurnizim me metadon - për të varurit nga droga. Në të gjitha këto raste, përfaqësuesit e IAP-së i udhëzojnë ankuesit për rrugën që ata duhet të ndjekin për të realizuar të drejtën e tyre. Gjithashtu, një numër i madh i ankesave kanë qenë të drejtuara kundër vendimeve të Panelit për Lirim me Kusht (PLK), me ç'rast përfaqësuesit e Avokatit të Popullit edhe në këto raste i njoftojnë të burgosurit për procedurat e marrjes së vendimeve të Panelit.⁶³ Bashkëpunimi me autoritete ka qenë i kënaqshëm, pasi edhe qëllimi i IAP-së është mbrojtja e personave të cilëve u është mohuar liria dhe jo dënimi për abuzime të mundshme.

Me qëllim të hetimit së ankesave kundër vendimeve të Panelit për lirim me kusht, IAP ka zhvilluar disa takime me koordinatorin e Panelin për Lirim me Kusht, si dhe ka realizuar obligimin ligjor për të monitoruar punën e panelit. Kërkesa e IAP është konfirmuar nga zëvendëskryeministri dhe Ministri i Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi për mandatin e IAP-së për të qenë monitorues i punës së Panelit për Lirim me Kusht, që nga inicimi i procedurave deri të marrja e vendimit të panelit, respektivisht monitorimin e të gjitha procedurave: para, gjatë dhe pas shqyrtimit të rasteve për lirim me kusht. Nga prilli i vitit 2011, IAP ka monitoruar Punën e Panelit dhe për periudhën tre mujore të monitorimit, Avokati i Popullit e ka njoftuar Ministrinë e Drejtësisë dhe Panelin për Lirim me Kusht. Avokati i Popullit do të vazhdojë

⁶³ Me ftesën e MD-së, në muajin mars është kërkuar që një përfaqësuese i IAP-së të jetë pjesë e Komisionit të ngritur nga MD, me qëllim të rishikimit të vendimeve të Panelit për Lirim me Kusht, nga data 16 tetor deri më 22 shkurt 2011, në kohën kur MD kishte mbetur pa staf politik dhe rrjedhimisht pa ministër. Ky komision ka shqyrtuar 189 raste dhe ka nxjerrë rekomandime të cilat i janë përcjellë MD dhe PLK.

bashkëpunimin me Panelin për Lirim me Kusht dhe do të monitorojë punën e tij edhe në të ardhmen.

Avokati i Popullit, për gjetjet nga monitorimi i burgjeve dhe ankesave të burgosurve si dhe me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe intensifikimit të këtij bashkëpunimi, është takuar me Komisararin e SHKK-së.⁶⁴ Me këtë rast është diskutuar për trajtimin shëndetësor të të burgosurve; kategorizimin e të burgosurve, për rastet e të dënuarve që transferohen në Smrekovnicë dhe kushtet që duhet të plotësojnë të burgosurit për t'u transferuar në këtë burg që konsiderohet gjysmë i hapur etj. Po ashtu është diskutuar edhe për qasjen në dokumente publike, pasi përfaqësuesit e IAP-së kanë hasur në vështirësi në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan që të fotokopjojnë dokumentacionin e një të paraburgosuri, i cili ishte keqtrajtuar gjatë arrestimit, duke kërkuar që në të ardhmen IAP të mos pengohet në punën e tij.⁶⁵

Shqetësim i IAP-së është edhe mosndriçimi i rastit të tragjedisë së vitit 2003 në Burgun e Dubravës. Për këtë qëllim Avokati i Popullit është takuar me zyrtarin e lartë ligjor të Komisionit për të Drejtat e Njeriut të EULEX-it (HRRP),⁶⁶ për të biseduar për rastin në burgun e Dubravës, në vitin 2003, ku kanë mbetur të vrarë pesë të burgosur, ndërkohë që familjarët e tyre ende janë duke kërkuar përgjigje se çka ka ndodhur dhe kush duhet të përgjigjet. Përfaqësuesit e IAP-së janë njoftuar se në këtë fazë HRRP nuk ka çfarë të raportojë, pasi janë duke mbledhur informata. Janë zhvilluar disa takime me familjarët e të vrarëve dhe në fund nga HRRP familjarët janë njoftuar se ky Panel nuk është kompetent.

Më 31 mars 2011, IAP ka monitoruar seancën gjyqësore, në rastin e regjistruar në IAP, A. nr. 271/2010, i cili me vite ishte në pritje të vendimit të plotfuqishëm. Për shkak të mospërpilimit të aktgjykimit, në afatin e paraparë, sipas LESP,⁶⁷ Avokati i Popullit i është drejtuar me raport me rekomandim, Gjykatës Supreme, pas të cilit gjykata ka marrë vendim dhe e ka njoftuar për këtë Avokatin e Popullit.⁶⁸

Avokati i Popullit është takuar me përfaqësues të misionit të Komisionit Evropian, i caktuar për Kosovë dhe me drejtorin e përgjithshëm të shëndetësisë në SHKK, ku është diskutuar për identifikimin e nevojës për krijimin e Institutit të Forenzikës Psikiatrike (IFP) dhe kontributin e IAP-së në këtë drejtim.⁶⁹ Pas prezantimit të gjerë të punës së IAP-së, u pa nevoja që IAP të përfshihet, si institucion i domosdoshëm në këtë skemë (draft projekt).

Në vazhden e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave të privuar nga liria, AP u takua me përfaqësuesit e OJQ nga Leskovci, të cilët merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave të ndaluar. Ky takim kishte për qëllim bashkëpunimin për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të Kosovës që gjenden në burgjet e Serbisë dhe anasjelltas. IAP ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me këtë OJQ duke zhvilluar hetime

⁶⁴ Më 7 mars 2011, Avokati i Popullit është takuar me Komisararin e SHKK, z. Resmi Hoxha.

⁶⁵ Raport me Rekomandim drejtuar MD, lidhur me ankesën, A. nr. 32/2011, R.A. kundër Qendrës së Paraburgimit në Gjilan.

⁶⁶ Më 9 mars 2011, Avokati i Popullit është takua me Zyrtarin e Lartë Ligjor, z. John Ryan, me qëllim të ngritjes së shqetësimeve lidhur me rastin.

⁶⁷ Në nenin 395, pika 1, të LESP parashihet se: "Aktgjykim i shpallur duhet të përpilohet me shkrim brenda pesëmbëdhjetë ditë nga shpallja e tij kur i akuzuari gjendet në paraburgim, ndërsa brenda tridhjetë ditë në raste të tjera[...] dhe 45 ditë në raste të tjera".

⁶⁸ Raport me Rekomandim, lidhur me ankesën A.nr.271/2010, A.K. kundër Gjykatës Supreme të Kosovës.

⁶⁹ Në prill të vitit 2011, Avokati i Popullit është takuar me z. Nigel McC Carly, përfaqësues i Komisionit Evropian dhe z. Milazim Gjoci, drejtor i përgjithshëm i shëndetësisë në SHKK.

për disa raste të burgosurve kosovarë, të cilët janë ndihmuar në forma të ndryshme, sidomos për mbrojtjen e tyre ligjore.⁷⁰

Në dhjetor të periudhës raportuese IAP monitoroi seancën gjyqësore në një rast me elemente të tejkalimit të detyrës zyrtare nga ana e tre policëve me rastin e marrjes në pyetje të një personi të ndaluar. Në këtë rast IAP ka gjetur se ka pasur përdorim të tepruar të forcës dhe lënda është duke u zhvilluar në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Rasti do të përcillet nga Avokati i Popullit deri në vendosje.⁷¹

Duke pasur parasysh numrin e ankesave kundër shërbimit shëndetësor në burgje, Avokati i Popullit është takuar me drejtorin e përgjithshëm të shëndetësisë së SHKK, tek i cili ka ngritur shqetësimet dhe ku është diskutuar edhe për punën dhe vështirësitë e sistemit shëndetësor në shërbimin korrektues.⁷² Sipas informatave të marra nga SHKK, ky sistem i shëndetësisë së shpejti do të bartet në Ministrinë e Shëndetësisë. IAP e përkrah këtë bartje të kompetencave dhe e konsideron më se të domosdoshme, për shkak të ndërhyrjeve dhe cenimit të autonomisë profesionale të stafit shëndetësor.

Gjatë këtij viti nuk ka pasur asnjë epidemi në burgjet apo vendet e ndalimit në Republikën e Kosovës. Ka pasur tri raste të vdekjes, të cilat pas autopsisë kanë rezultuar se kanë qenë vdekje natyrore. Rastet e tentimit të vetëvrasjes dhe vetëlëndimet janë në rënie, ashtu si dhe veprat e tjera (abuzimet seksuale dhe grevat e urisë). Burgjet janë pajisur me kontrata për të gjitha barnat. Në Projektligjin për shëndetësi dhe sigurime shëndetësore është bërë integrimi i të burgosurve, të cilët do të trajtohen si kategori sociale - pra shteti do të paguajë sigurimin e tyre shëndetësor.

Si mangësi të sistemit shëndetësor, gjatë këtij viti, mund të numërohen: mungesa e psikologut në stafin e burgjeve për nevojatë të burgosurve; furnizimi me barna gjatë vitit nuk ka qenë i plotë; Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale është i papërshtatshëm për sistemin e shëndetësisë. Një mangësi e theksuar është buxheti i zvogëluar, i cili nuk do të mund t'i përmbush nevojat, ndërsa stafi mjekësor nuk është i stimuluar me pagesën për rrezikshmëri të punës që kryejnë.

Një vërejtje brengosëse, sipas drejtorit të shëndetësisë së SHKK-së është se futja e dënimit të përjetshëm në ligj do të përcillet me detyra dhe obligime shtesë dhe domosdoshmërisht kërkon krijimin e kushteve, si: objekti, stafi, përkujdesja etj.

Për këtë periudhë të raportimit, në IAP janë të regjistruara 14 raste me pohime për shkelje të normave ligjore kundër torturës, të cilat janë duke u proceduar. Këto ankesa janë kundër Policisë së Kosovës - për përdorim të tepruar të forcës, shqetësim ky që është ngritur edhe me Raportin e Komitetit për Parandalimin e Torturës (CPT) të Këshillit të Evropës.⁷³

⁷⁰ Më 21.11.2011, në IAP është mbajtur takimi me përfaqësuesit e Committee for Human Rights nga Leskovci, Serbi.

⁷¹ Ankesa e regjistruar në IAP, A. nr.60/2010, kundër Njësisë së Hetimeve Rajonale në Prishtinë, monitorimi i seancës më 21 dhjetor 2011.

⁷² Avokati i Popullit, në dhjetor 2011, u takua me z. Milazim Gjoci, drejtor i shëndetësisë në SHKK.

⁷³ *Council of Europe*, CPT/Inf (2011) 26, Strasburg, 6 October 2011.

Marrë në tërësi, gjendja në burgjet e Kosovës është e kënaqshme dhe në përputhje me ligjet vendore dhe ndërkombëtare, numri i ankesave ka pësuar rënie dhe gjendja vazhdon të përmirësohet, por ka edhe shumë për t'u bërë në këtë drejtim.⁷⁴

2.6.1. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta me OJQ-të, jo vetëm si detyrim ligjor për bashkëpunim me shoqërinë civile, por edhe duke u nisur nga interesi i përbashkët për të luftuar çdo fenomen torture apo trajtimi johuman dhe degradues, Avokati i Popullit e ka vazhduar bashkëpunimin me OJQ-të, të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të personave të ndaluar, të cilët janë dëshmuar dhe kanë një përvojë të veçantë në këtë drejtim.⁷⁵

Gjatë vitit 2011, Grupi Punues i Përbashkët (*Task Force*) ka realizuar veprime monitoruese në terren, trajnime e punëtori të përbashkëta, në mbështetje të OSBE, Zyrës së Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut dhe EULEX.

Më 13 korrik 2011, në kuadër të vizitave të përbashkëta, IAP, QKMRT dhe KMDLNJ realizuan vizitën e parë të përbashkët në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë dhe në Burgun e Smrekonicës. Kjo vizitë u përcoll edhe nga përfaqësuesja e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (CPT), nga Danimarka. Qëllimi i vizitës ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave të njeriut në vendet e ndalimit, si dhe të kontribuojë në rritjen e transparencës, duke rritur kështu plotësimin e standardeve ndërkombëtare nga autoritetet e vendit.

Ekipi monitorues është përqendruar në kushtet në të cilat mbahen të paraburgosurit dhe të burgosurit. Për punën dhe aktivitetet e Qendrës së Paraburgimit në Mitrovicë (QPM) ekipi monitorues është informuar nga drejtori i Qendrës. Realizimi i kësaj vizite ishte i mundur vetëm me përcjellje nga Policia e Kosovës, ngase QPM gjendet në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës, ku liria e lëvizjes për banorët institucionet e Republikës së Kosovës dhe për personat me përkatësi etnike joserbe është pothuajse tërësisht e ndaluar.⁷⁶

Po gjatë kësaj dite ekipi ka vizituar edhe Burgun e Smrekonicës, i cili momentalisht është duke u rinovuar dhe akoma nuk është mbushur në kapacitetin e plotë.⁷⁷

Avokati i Popullit së bashku me QKRMT dhe KMDLNJ, me mbështetjen e Qendrës për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës nga Danimarka (RCT), janë duke punuar në

⁷⁴ Raport vjetor Janar - dhjetor 2011 i QKRMT-së, Standardet e të Drejtave të Njeriut në Institucionet Korrektuese në Kosovë, që pasqyrojnë në mënyrë të detajuar gjendjen në burgjet e Kosovës, i cili në disa pjesë të monitorimit të përbashkët është qëndrim edhe i IAP-së.

⁷⁵ Më 10 maj 2011, ky bashkëpunim është zyrtarizuar me nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit IAP-QKRMT-KMDLNJ. Nënshkrimi i marrëveshjes është bërë në kuadër të angazhimit të përbashkët në përmbushje të fushatës kombëtare kundër torturës dhe me qëllim të inicimit të krijimit të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), i cili parashihet me Protokollin Opcional të Konventës së OKB kundër Torturës – OPCAT.

⁷⁶ Rekomandimet e dala nga vizita i janë adresuar drejtorit të QPM, z. Milan Radoviq dhe këto rekomandime do të adresohen me shkrim në raportin e QKRMT-së, që planifikohet të dalë në mars të vitit 2012, pasi vizita ka qenë e përbashkët.

⁷⁷ Rekomandimet e dala nga vizita ekipi ia ka përcjellë u.d. së drejtorit Muharrem Bajrami, në fund të vizitës, si dhe do të përcillen me shkrim në raportin e QKRMT-së.

përpilimin e doracakut, i cili do të shërbejë, jo vetëm për Kosovën, por edhe për vendet e rajonit. Ky doracak do t'u shpërndahet edhe institucioneve relevante.⁷⁸

Në kuadër të vizitave të përbashkëta dhe forcimit të bashkëpunimit, e më qëllim të marrjes së përvojave më të mira, Grupi Punues i përbashkët (*Task Force*), me iniciativën e IAP-së dhe me mbështetjen e OSBE-së, organizoi vizitë studimore në Shqipëri (15 - 18 nëntor 2011). Në këtë vizitë grupi u takua me u.d. të Avokatit të Popullit në Shqipëri, me Njësitin e MKP, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, Institutin Evropian të Tiranës dhe drejtorin e Burgut të Fushë Krujës. Arsyeja ishte e modeli i MKP-së në Shqipëri (Ombudsperson Plus), si dhe përvoja e tyre janë një model i suksesshëm, prej nga mund të merret mësim i mirë për krijimin e MKPT në Republikën e Kosovës.

Nga 24 - 26 nëntor, me iniciativën e QKRMT-së, mbështetur nga RCT e Danimarkës, u mbajt trajnim treditor me qëllim të harmonizimit të qasjes së *Task Force* (IAP - QKRMT - KMDLNJ). Gjatë këtyre ditëve u realizua edhe vizita e dytë e përbashkët në monitorimin e Burgut të Dubravës dhe Qendrës së Paraburgimit në Pejë. Të gjeturat do të publikohen në raport të përbashkët.

Më 26 e 27 dhjetor, në kuadër të vizitave të përbashkëta, u realizua vizita në Maqedoni, e cila për përfaqësuesit e QKRMT dhe KMDLNJ u mbështet nga OSBE. Vizita kishte për qëllim njoftimin me punën e MKPT-së dhe bashkëpunimin e tyre me OJQ-të. Gjatë kësaj vizite u takuan Avokati i Popullit të Maqedonisë dhe disa OJQ. Përveç krijimit të kontakteve dhe shkëmbime të përvojave, u diskutua edhe mundësia e bashkëpunimit rajonal në të ardhmen.

Rekomandime për Shërbimin Korrektues të Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme

- *Të organizohen seminare ose kurse trajnimi për stafin në institucionet ku mbahen personat e ndaluar, me qëllim të zgjerimit të njohurive rreth natyrës dhe përmbajtjes së konventave ndërkombëtare për të drejta të njeriut, e sidomos të atyre që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë.*
- *Të njoftohen të paraburgosurit dhe të burgosurit për të drejtat dhe obligimet e tyre, si dhe mënyrën e parashtrimit të ankesës.*
- *Të bëhet kategorizimi i të ndaluarve, sipas natyrës së veprës, historisë kriminale, rrezikshmërisë, moshës etj.*
- *Të ndërmerren masa që gjykatat, në afat të arsyeshëm kohor dhe në pajtim me ligjin të marrin vendim, me sa më pak zvarritje.*
- *Të organizohen trajnime dhe tryeza me faktorët relevantë për mundësinë e cilësimit të dokumenteve që janë të qasshme pasi që kjo edhe në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike nuk është e specifikuar.*
- *Të ndërmerren masa për trajtim të barabartë të të dënuarve, në kuptim të ofrimit të beneficioneve dhe privilegjeve.*

⁷⁸ Avokati i Popullit, në tetor 2011, është takuar me përfaqësuesen e RCT nga Danimarka, znj. Louise Johannsen, për të diskutuar për ndërhyrjet e fundit që mund t'i bëhen Doracakut.

- *Shërbimi shëndetësor duhet të transferohet nga Ministria e Drejtësisë në Ministrinë e Shëndetësisë, në mënyrë që të ofrojë një shërbim më efikas.*
- *Të përfillen rekomandimet e drejtorit të shëndetësisë së SHKK, për LESP, pasi sipas tij ky ligj është i papërshtatshëm për shëndetësi.*
- *Të organizohen trajnime për Policinë e Kosovës, me qëllim të zgjerimit të njohurive dhe respektimit të drejtave të njeriut, që personat e ndaluar të trajtohen me humanizëm dhe respekt.*

2.7. E drejta e lirisë dhe sigurisë

Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës “*Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj [...]*”.⁷⁹ Kjo drejtë është në harmoni të plotë me instrumentet ndërkombëtare të drejtave të njeriut si KEDNJ⁸⁰ dhe Paktin për të Drejtat Civile dhe Politike.⁸¹

Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm në rastet e parapara me ligj.⁸² Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës ka paraparë se gjykata mund të caktojë paraburgim ndaj një personi vetëm nëse ekziston dyshimi i bazuar se personi i tillë ka kryer ndonjë veprë penale dhe nëse përmbushet njëri prej këtyre kushteve: ekziston rreziku i ikjes se personit, rrezikut se personi mund të ndryshojë provat e veprës penale dhe rreziku se personi mund ta përsërit veprën penale.⁸³

Në bazë të një analize të përgjithshme të gjendjes dhe ankesave të trajtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP),⁸⁴ mund të themi se përkundër faktit se ekziston një mbrojtje e mirë ligjore si me ligjin vendor ashtu edhe me normat ndërkombëtare, e drejta për liri dhe siguri në praktikë nuk mbrohet në masën e duhur.

Sado e shkurtër të jetë periudha kohore e paraburgimit, paraburgimi mund të caktohet vetëm në rastet kur një gjë e tillë është e domosdoshme. Vendimi për shqiptimin e një masë të tillë duhet të jetë i arsyetuar mirë, pasi që kjo shërben për mbrojtje të lirisë individuale dhe mbron individët nga privimet arbitrare të lirisë nga ana e autoriteteve. Caktimi i paraburgimit me një vendim të arsyetuar ligjërisht, është i nevojshëm dhe i rëndësishëm për të pandehurin për ushtrimin e të drejtës së tij për të kundërshtuar atë vendim.⁸⁵

Në disa prej vendimeve të veta Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar rëndësinë e së drejtës për liri dhe siguri, duke kërkuar që çdo privim i lirisë të jetë në pajtim me qëllimin e nenit 5, që do të thotë në mbrojtjen e individit nga rreziku i arbitraritetit.⁸⁶

⁷⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 29.

⁸⁰ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, neni 5.

⁸¹ Konventa Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike, neni 9.

⁸² Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, neni 279.

⁸³ Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, neni 281.

⁸⁴ Raportet zyrtare të IAP-së nga vizitat në qendrave e ndalimit, qendrave e paraburgimit dhe burgjet e Kosovës.

⁸⁵ Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, neni 283.

⁸⁶ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, “Erkalo kundër Holandës”, Aktgjykimi, 2.9.1998, paragrafi 56.

Ndërsa sa i përket periudhës kohore të paraburgimit, GJEDNJ ka theksuar, po ashtu se pa marrë parasysh për çfarë periudhe kohore të paraburgimit bëhet fjale, ato duhet të arsyetohen bindshëm nga ana e autoriteteve.⁸⁷ Sipas GJEDNJ-së kjo duhet të ndodhë për faktin se vendimet e arsyetuara mirë shërbejnë për t'i treguar palës së është dëgjuar, i japin palës mundësinë që të parashtrijë ankesë dhe përfundimisht garantojnë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë.⁸⁸

Gjatë kësaj periudhë raportuese zyrtarët e IAP-së kanë realizuar një numër të konsiderueshëm të vizitave në burgje, qendrat e paraburgimit dhe qendra të ndalimit në stacionet policore në Kosovë. Nga intervistat e realizuara me personat e ndaluar, në disa raste ka pasur pohime të shkeljes së të drejtës së lirisë, duke iu referuar vendimeve për paraburgim dhe zvarritjes jashtëligjore të procedurave gjyqësore deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë.

Një nga instrumentet ndërkombëtare të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, të drejtës për liri dhe siguri i ka kushtuar një rëndësi të veçantë dhe shprehimisht kërkon që: *“Çdo Fëmijë i privuar nga liria të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin që i takon dinjitetit të njeriut dhe në mënyrë të tillë, që të kihet parasysh nevojat e personave të moshës së tij[...].”*⁸⁹

Institucioni i Avokatit të Popullit e ka vlerësuar si mjaft pozitive iniciativën e Policisë së Kosovës e cila në mbështetje të Zyrës së Komisionit Evropian në Kosovë dhe UNICEF ka filluar një program për reforma në sistemin e drejtësisë për të mitur. Në kuadër të këtij programi si fazë e parë në tetor 2011 në shtatë qendra të Kosovës janë themeluar dhomat miqësore të intervistimit të fëmijëve, ndërsa në fazën e dytë ky program ka për qëllim të garantojë se trajtimi i të miturve në konflikt me ligjin të jetë në pajtim me standardet vendore dhe ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve.⁹⁰

IAP rekomandon që autoritetet përgjegjëse, në radhë të parë gjyqtarët dhe prokurorët, të jenë më të kujdesshëm në mbrojtjen e kësaj të drejte dhe aplikimi i paraburgimit të bëhet vetëm në ato raste kur është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

2.8. Të drejtat e të akuzuarit

Aktet dhe dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare, në fushën e të drejtave të njeriut, drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë, kërkojnë shprehimisht respektimin e të drejtave të të akuzuarit.⁹¹

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në përputhje me këto dokumente, garanton që çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale që: të njoftohet menjëherë në gjuhën që e kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij; të njoftohet për të drejtat e tij, sipas

⁸⁷ *Po aty*, “Belchev kundër Bullgarisë”, Aktgjykimi, 8.4.2004, paragrafi 82.

⁸⁸ *Po aty*, “Suominen kundër Finlandës”, Aktgjykimi, 1.7.2003, paragrafi 37.

⁸⁹ *Konventa për të Drejtat e Fëmijëve*, neni 37 paragrafi c.

⁹⁰ http://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/press_corner/all_news/news/2011/20111031childrooms_sq.htm
Policia e Kosovës themelon Dhoma Miqësore për Intervistimin e Fëmijëve, 31 tetor 2011.

⁹¹ Neni 11 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 14 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

ligjit; të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet; të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi nëse nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procesi gjyqësor; të ketë ndihmën e një mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të komunikojë lirisht me të dhe nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtje falas dhe, të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.⁹²

IAP në kuadër të misionit kushtetues dhe ligjor ka vazhduar monitorimin e qendrave të ndalimit dhe të mbajtjes të të akuzuarve për vepra të ndryshme penale dhe ka zhvilluar vizita të rregullta në këto qendra, si në Lipjan, Dubravë, Gjilan, Prishtinë, Pejë, Mitrovicë dhe Prizren.

Nga këto vizita është vërejtur se disa qendra të paraburgimit janë të mbipopulluara⁹³ dhe kushtet e mbajtjes në disa prej tyre nuk janë ende në nivel të kënaqshëm, sidomos sa i përket ndriçimit natyral, ajrosjes dhe pastërtisë.⁹⁴ Në lidhje me këtë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në rastin *Mandic and Jovic vs. Slovenia* dhe *Strucl and others vs. Slovenia*⁹⁵ deklaroi se kushte e mbajtjes së të paraburgosurit në një hapësirë prej vetëm 2.7 metra katror, ku temperatura në muajin gusht ishte 28 gradë celsius dhe të paraburgosurit kishin kaluar kohën më të madhe në qeli, përbënte shkelje të të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁹⁶

Edhe pse KPPPK i mundëson drejtorit të qendrës së paraburgimit të kërkojë transferimin e një të paraburgosuri,⁹⁷ largësia e vendosjes së të akuzuarve për vepra të ndryshme nga vendbanimi i tyre iu vështirëson familjarëve dhe të afërmeve të tyre mundësinë që të vizitojnë ata. Një i akuzuar, banor i komunës së Gjilanit, i cili është vendosur në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, paraqet problem për familjarët e tij, ngase për shkak të largësisë gjeografike vizitat janë më të rralla për shkak të shpenzimeve të udhëtimit, që në disa raste janë të papërballueshme.

Një problem më vete paraqet, po ashtu, edhe procedura e marrjes së lejes për vizitë të të akuzuarve. Kjo është një procedurë e komplikuar dhe e shtrenjtë, ashtu si dëshmon edhe shembulli i një të akuzuari për vepër penale, banor i komunës së Skenderajt, i cili mbahet në qendrën e paraburgimit në Pejë. Për të realizuar një vizitë, familjarët apo të afërmit e tij duhet të udhëtojnë në Prishtinë, të marrin leje për vizitë, në mënyrë që të kenë mundësi të vizitojnë atë në Pejë. Duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të shumë familjeve në Kosovë, kjo formë e rregullimit të vizitave vështirëson realizimin me rregull të tyre dhe paraqet ngarkesë materiale të papërballueshme.

⁹² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 30.

⁹³ Në Qendra e Paraburgimit në Prizren gjatë vizitës së rregullt të përfaqësuesve të Institucionit të Avokatit të Popullit më 21 dhjetor 2011 numri i të paraburgosur dhe të burgosur ishte 92 (10 të dënuar dhe 82 të paraburgosur), sa është edhe i gjithë kapaciteti i Qendrës. Më 22 dhjetor 2011 qendra e paraburgimit në Prishtinë numëronte 63 të paraburgosur, ndërsa kapaciteti i saj është në total 65.

⁹⁴ Konstatim nga vizita në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan më 10 nëntor 2011.

⁹⁵ *Mandic and Jovic v. Slovenia (application 5774/10 and 5985/10)* and *Strucl and others v. Slovenia (application 5903/10, 6003/10 and 6544/10)*.

⁹⁶ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 3 "Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese".

⁹⁷ Neni 291, Paragrafi 3, i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale: "Gjykata kompetente, me propozim të drejtorit të qendrës së paraburgimit në të cilën është vendosur i paraburgosuri, mund ta transferojë të paraburgosurin nga lokalet e një institucioni të paraburgimit në tjetrin për shkaqe sigurie dhe mbajtjeje të disiplinës ose për zbatim të suksesshëm dhe të arsyeshëm të procedurës penale."

Qendrat e paraburgimit janë ende larg Rregullave Evropiane të Burgut, të miratuara nga Komiteti i Ministrave të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës më 12 shkurt 1987.⁹⁸ Gjendja mbetet e pandryshuar, krahasuar me vitet e kaluara. Kjo shpjegohet me pamundësinë ekonomike.

Në lidhje me njoftimin e të akuzuarit për veprën për të cilën akuzohet, nga intervistat me të paraburgosur dhe të ndaluar në Burgun e Pejës dhe Dubravës, IAP nuk ka vërejtur mangësi dhe nuk ka pranuar asnjë ankesë, në lidhje me mohimin e kësaj të drejte.⁹⁹

I një rëndësie të veçantë për realizimin e kësaj të drejte është standardizimi i procedurave të marrjes në pyetje të të akuzuarve nga hetuesit policorë dhe prokurorët publikë. Kjo do të mundësonte krijimin e një modeli unik të veprimeve procedurale. Kështu do të eliminoheshin qasjet e ndryshme ndaj marrjes në pyetje të të akuzuarve. Standardizimi i këtij procesi do t'iu mundësonte hetuesve policorë dhe prokurorëve publikë që të zbatojnë drejtë ligjin.¹⁰⁰ Kurse mungesa e një procedure standarde mund të shpie deri te arbitrarizimi i këtij procesi, ngase brenda të njëjtit stacion policor apo prokurorie të caktuar aplikohen standarde të ndryshme të marrjes në pyetje, çka do të thotë se interpretimi i normave juridike bëhet në mënyrë arbitrare.

Respektimi i të drejtave të njeriut edhe në rastin kur personi është i dyshuar, madje edhe për vepër të rëndë penale, nuk e pengon efikasitetin e hetimeve, por përkundrazi është tregues i profesionalizmit të organeve të hetuesisë nga këndvështrimi i përdorimit të mjeteve dhe metodave ligjore për zbulimin e kryesit të veprës penale. Në raste të tilla sigurimi e provave nga aspekti i ligjshmërisë nuk do të mund të kontestohet. Po ashtu, kjo do të ndikonte që edhe besimi i qytetarëve për funksionimin e shtetit të së drejtës të rritej.

Çështje që është ngritur edhe në raportin e kaluar dhe vazhdon të mbetet shqetësuese, është çështja e angazhimit të avokatëve sipas detyrës zyrtare. Edhe sipas KPPPK e KEDNJ-së, çdo personi i njihet dhe garantohet e drejta për ta mbrojtur veten, personalisht apo përmes ndihmës ligjore të zgjedhur vet ose nëse nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar ndihmën ligjore kjo t'iu ofrohet falas kur interesat e drejtësisë kërkojnë një gjë të tillë.¹⁰¹ Institucioni i Avokatit të Popullit nuk ka pranuar ndonjë ankesë që lidhet me mohimin e kësaj të drejte nga autoritetet, por Avokati i Popullit, gjatë vizitave në qendrat e paraburgimit, ka pranuar ankesa

⁹⁸ Rregulla 94: “Të burgosurve të pagjykuar do t’u jepet mundësia të kenë dhoma të veçanta, me përjashtim të rasteve kur ka rrethana që e bëjnë një gjë të tillë të padëshirueshme”.

⁹⁹ Intervistimi i të paraburgosurve N.D., SH.SH., K.N., M.M., F.R., S.F. dhe A.N., me rastin e vizitës në Qendrën e Paraburgimit në Pejë dhe Dubravë, më 25 nëntor 2011.

¹⁰⁰ Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, Neni 155 paragrafi “(1) Gjatë çdo intervistimi ose marrjeje në pyetje ndalohet që: 1) Liria e të pandehurit për të formuluar dhe shprehur mendimin e tij të ndikohet nëpërmjet keqtrajtimin, lodhjes së shkaktuar, ndërhyrjes fizike, përdorimit të drogës, torturës, shtrëngimit ose hipnotizimit; 2) I pandehuri të kanoset me masa të ndaluara me ligj; 3) Të premtohet ndonjë përfitim i paparaparë me ligj; dhe 4) Të dobësohet kujtesa e të pandehurit ose aftësia e tij për të kuptuar. 5) Ndalea nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohet pavarësisht nga pëlqimi i personit të intervistuar ose të marrë në pyetje. 6) Kur intervistimi ose marrja në pyetje është zbatuar në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni, procesverbali i intervistimit ose marrjes së tillë në pyetje është i papranueshëm.”

¹⁰¹ Neni 6, paragrafi 3 (c) të KEDNJ-së, neni 12 i KPPPK, paragrafi 3 “Në qoftë se i pandehuri nuk angazhon mbrojtës për të siguruar mbrojtjen, kurse mbrojtja është e detyrueshme, të pandehurit i caktohet mbrojtës i pavarur me përvojë dhe me kompetencë në përputhje me llojin e veprës penale dhe sipas kushteve të parapara me këtë Kod” dhe paragrafi 6 “Në pajtim me dispozitat e këtij Kodi, çdo person i privuar nga liria ka të drejtë në shërbimet e mbrojtësit që nga arresti e tutje”.

nga shumica e të akuzuarve, në lidhje me shërbimet e mbrojtjes të ofruar nga autoritetet sipas detyrës zyrtare.

Mosangazhimi në nivelin e duhur i mbrojtësve në fazën fillestare mund të jetë përcaktues, për tërë procesin. Në këtë mënyrë drejtpërdrejtë ndikohet në të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm në kuptimin e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.¹⁰²

Paraburgimi duhet të ekzistoj vetëm në ato rrethana kur kjo është e domosdoshme. Ai është mjeti më i rëndë për sigurimin e prezencës të të akuzuarit. Në disa raste, për shkak të mbingarkesës me lëndë të pazgjidhura, të dyshuarit mbahen nga gjykatat shumë më gjatë në qendrat e paraburgimit, të cilat edhe ashtu janë të mbingarkuara.

Edhe masat disiplinore që merren ndaj gjykatësve që neglizhojnë këtë çështje janë shumë simbolike. Në praktikë nuk janë të rralla rastet kur gjykata “harron” se një person është në paraburgim, edhe pas skadimit të afatit ligjor. Në raste të tilla vetë qendrat e paraburgimit kontaktojnë gjykatën për t’i “kujtuar” asaj se duhet të vendosë në lidhje me afatin e paraburgimit. Dhe, në këto raste vendoset shpejt, pa u analizuar mirë çështja e moszgjatjes së paraburgimit. Rrjedhimisht, edhe vendimet mbi zgjatjen e paraburgimit nuk janë të arsyetuara sa e si duhet.

Rekomandime

- *Paraburgimi, si mjet për sigurimin të akuzuarit të mos jetë rregull. Masa e paraburgimit të shqiptohet vetëm në rast kur nuk ka vend për shqiptimin e masave të tjera alternative.*
- *Vendimet mbi paraburgimin të arsyetohen më gjerësisht, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit në fjalë.*
- *Të synohet zgjerimi i hapësirave të ndalimit, paraburgimit dhe burgjeve dhe të përmirësohen kushtet, sidomos në evitimin e lagështisë, e cila mund të ndikojë drejtpërdrejt në shëndetin e të akuzuarve, por edhe të punonjësve të këtyre institucioneve.*
- *Të standardizohen procedurat e marrjes në pyetje të të akuzuarve nga hetuesit policorë dhe prokurori publik, ngase kjo do të ndihmonte në krijimin e modelit unik të veprimeve procedurale dhe do të eliminoheshin qasjet e ndryshme ndaj marrjes në pyetje të të akuzuarve.*
- *Oda e Avokatëve të Kosovës të ushtrojë mbikëqyrje më të madhe dhe të marrë masa disiplinore ndaj avokatëve, të cilët shkelin Ligjin për Avokatinë dhe Kodin e Etikës Profesionale të Avokatit.*

¹⁰² Neni 6 i KEDNJ, “E drejta për një proces të rregullt”.

2.9. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës¹⁰³ dhe ka një interpretim gjithëpërfshirës, sipas kuptimit të nenit 6 të Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut.¹⁰⁴

Kjo e drejtë, po ashtu, është rregulluar edhe me ligje të tjera bazike, nga fusha penale dhe civile si Ligji mbi gjykatat të Republikës së Kosovës, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale dhe Ligji për Procedurën Kontestimore.¹⁰⁵ Ligjet e lartpërmendura mbrojnë të drejtën për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, në mënyrë të njëjtë, të drejtat në procedurë civile dhe penale.

Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Publikimi i vendimeve gjyqësore mund të kufizohet në raste të veçanta nga gjykata, kur konstatohet se do të dëmtonte interesat e drejtësisë sipas ligjit.

Në këtë periudhë të raportimit, për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka pranuar gjithsej 171 ankesa të qytetarëve. Prej tyre 54 ankesa janë vendosur si të papranueshme sipas nenit 19.1.3 të ligjit të Avokatit të Popullit,¹⁰⁶ ndërsa për 111 ankesa është marrë vendim për të hapur hetime, kurse 6 ankesa janë në pritje për shqyrtim.

Pas analizës së natyrës së ankesave rezultoi se pjesa më e madhe e tyre kishin të bënin me pretendimet për shkeljet e së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, sidomos të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor. Një numër i konsiderueshëm i ankesave kanë të bëjnë me dyshime në objektivitetin e vendimeve gjyqësore, me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore nga vetë gjykatat, si dhe të vonësive në dorëzimin e vendimeve gjyqësore.

¹⁰³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 31, paragrafët 1 dhe 2. "(...) Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."

¹⁰⁴ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6. paragrafi 1. "(...) Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo persona të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallë të gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit ose të sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose nga mbrojtja private e palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë."

¹⁰⁵ Ligji për Gjykatat, nr. 03/L-199, neni 7, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 79, 24 gusht 2010; Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, nr. 03/L-199, neni 7.par 2; Ligji për Procedurën Kontestimore, nr. 03/L-006, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38, 20 shtator 2008, neni 10, par.1.

¹⁰⁶ Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, neni 19, p. 1.3. "Ankesa nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit, ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë me këtë ligj; ankesa është anonime; ankesa paraqet keqpërdorim të së drejtës për paraqitjen e ankesës; ankuesi ka dështuar të sigurojë informatat e kërkuara nga Avokati i Popullit."

Nga ankesat e pranuar të qytetarëve, për zvarritje të procedurave gjyqësore për rastet civile, më të shumtat në numër janë kontestet pronësore, detyrimore, nga marrëdhënia e punës, jokontestimore, por edhe ato të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Procedurat gjyqësore të vendimmarrjes nga gjykata në shumë raste zgjasin mbi 5 vite. Në këto raste kemi drejtësi të vonuar për palën dhe humb efekti dhe kuptimi i të gjykuarit. Në të gjitha rastet, ku janë konstatuar shkelje të tilla, Avokati i Popullit ka hapur hetime dhe ka kërkuar njoftime nga gjykatat e niveleve të ndryshme, lidhur me veprimet që janë marrë për zgjidhjen këtyre çështjeve.

Nga përgjigjet prej gjykatave të ndryshme të Kosovës, Avokati i Popullit nuk është i kënaqur me trajtimin e rekomandimeve të tij nga ana e gjyqësorit. Në të shumtën e përgjigjeve me shkrim, gjykatat theksojnë *“se rasti do të shqyrtohet kur t’i vijë radha”* apo *“se rasti gjendet në radhë për shqyrtim”*. Avokati i Popullit është mjaft i shqetësuar posaçërisht nga përgjigjet e tilla, ku nuk dihet koha e shqyrtimit të çështjeve të qytetarëve. Natyrisht, Avokati i Popullit ka parasysh edhe ngarkesën e gjykatave me lëndë të trashëguara si të pazgjidhura nga vitet paraprake, si dhe mungesën e stafit të nevojshëm për përshpejtimin e procedurave.

Gjykata Komunale në Prishtinë, në përgjigje të shkresës së Avokatit të Popullit, lidhur me zvarritjet e lëndëve nga kjo gjykatë, znj. Makifete Saliuka, u.d. kryetare e gjykatës njofton se *“Gjykata nuk ka mundësi teorike të respektojë standardet kohore të përcaktuara me ligj prandaj edhe ndodhin ankesat e palëve, gjykata është e ngarkuar me 65’000 lëndë civile, penale dhe përmbartimore dhe se gjykata ka pak gjyqtarë”*.¹⁰⁷

Ankuesi nga Ferizaji, është ankuar ndaj Gjykatës Komunale në Ferizaj për zvarritje pa shkaqe ligjore në gjykimin e një çështje pronësore.¹⁰⁸ Nga shqyrtimi i kësaj ankese rezultoi se kërkesëpadia e tij me objekt, kthimin e paluajtshmërisë në posedim ishte paraqitur për gjykim në gjykatë më 3.5.2004. Nga hetimi rezultoi se ishin ndërruar disa gjyqtarë dhe çështja nuk kishte përfunduar akoma nga gjykata. Duke analizuar shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore rezultoi se ish-pronari, pronën e njëjtë ua kishte shitur dy herë, personave të ndryshëm shqiptarë dhe se në gjykatë ishin iniciuar tri procedura gjyqësore për të njëjtën çështje.

Nisur nga rasti konkret, Avokati i Popullit, më 4.7.2011 kërkoi nga Gjykata Komunale në Ferizaj, që rasti të procedohet pa zvarritje të mëtejme, sipas kuptimit të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndërsa gjykata më 6.7.2011, njofton me veprimet gjyqësore lidhur me rastin dhe se lënda do të shqyrtohet në shtator vitit 2011.

Avokati i Popullit në rastin e ankesës për zvarritje të procedurës penale nga Gjykata Supreme e Kosovës, më 17.6.2011 i dërgoi Raport me Rekomandime Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me kërkesën që të respektohet neni 395 i Kodit të Përkohshëm i Procedurës Penale, për nxjerrjen e aktgjykimeve penale në afatet ligjore prej 15 ditëve nga shpallja e aktgjykimit.¹⁰⁹

¹⁰⁷ Gjykata Komunale në Prishtinë, u.d. kryetare e gjykatës, Makifete Saliuka, shkresa 295/11, datës, 1.11.2011, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

¹⁰⁸ Rasti i regjistruar në Institucionin e Avokatit të Popullit, nr. 64/2011, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, neni 31. Ankuesi më 03.05.2004, kishte ngritur padi pronësore në Gjykatën Komunale në Ferizaj dhe rasti i tij ende nuk ishte vendosur, sepse ai nuk kishte një vendim përfundimtar gjyqësor.

¹⁰⁹ Rasti i regjistruar në Institucionin e Avokatit të Popullit, nr. 271/2010, e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të paanshëm, neni 31, Raport me rekomandime dërguar Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ankuesi ishte shpallur fajtor

Faktorët vendimtarë që po ndikojnë në rritjen e numrit të lëndëve të pazgjidhura në gjykatat e Kosovës dhe zvarritjen jashtë të gjitha standardeve kohore ligjore, janë numri i pa mjaftueshëm i gjyqtarëve, mungesa e bashkëpunëtorëve profesionalë dhe e personelit tjetër administrativ, si dhe infrastruktura e dobët.

Për Avokatin e Popullit, veçanërisht shqetësuese janë zvarritjet e paarsyeshme dhe gjithsesi joligjore gjatë pritjes së gjykimit në rastet e paraburgimit, pastaj zvarritjet në konfirmimin e aktakuzave, caktimin e seancave dëgjimore, si dhe lëshimin e vendimeve gjyqësore. Gjendje jashtëzakonisht shqetësuese dhe e rëndë është në rajonin e Mitrovicës, për shkak të mosfunksionimit të gjyqësorit, si pasojë e drejtpërdrejtë e kalkulimeve politike dhe e dështimit të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare kompetente dhe përgjegjëse për ruajtjen e sigurisë dhe mbrojtjen e rendit dhe të ligjit në rajonin e Mitrovicës.

Me gjithë autorizimet e kufizuara, në fushën e gjyqësorit,¹¹⁰ Avokati i Popullit, në të gjitha rastet e ankesave të qytetarëve megjithatë ka dërguar shkresa dhe rekomandime, veçanërisht në gjykatat e shkallës së parë, përmes së cilave ka kërkuar përsheptimin e procedurës gjyqësore për vendosjen e parashtresave të palëve. Por, Avokati i Popullit nuk është i kënaqur me nivelin e trajtimit të shkresave dhe përgjigjeve të marra nga ana e gjykatave.

Shqetësim i veçantë i Avokatit të Popullit, është cenimi i kësaj të drejte kushtetuese, me rastin e parashkrimit të parashtresave të qytetarëve, përkatësisht të lëndëve gjyqësore nga gjykatat. Sipas raportit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011, në gjykatat e qarkut, në vitin 2011, janë parashkruar 4 lëndë, ndërsa në gjykatat komunale janë parashkruar 2.367 lëndë gjyqësore.¹¹¹ Nga raporti nuk mund të konstatohet natyra ligjore e lëndëve të cilat janë parashkruar nga gjykatat, e nuk ka të dhëna as lidhur me vitet prej kur datojnë lëndët e paraqitura në gjykata.

Gjendja e rëndë e sistemit gjyqësor të vendit ka ndikuar që të nëpërkëmbet e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me Kushtetutë dhe ligjet bazike,¹¹² të një numër i konsiderueshëm i qytetarëve të vendit. Joefikasiteti i gjyqësorit, në shqyrtimin e lëndëve, në afate kohore dhe parashkrimi i lëndëve, për pasojë ka humbjen e besimit të qytetarëve në drejtësinë institucionale dhe shoqërore dhe njëkohësisht përbën një nga shkeljet më të rënda të drejtave të njeriut.

dhe dënuar me 7 vite burg, më 3 korrik 2009, por ende nuk e kishte një vendim të plotfuqishëm nga Gjykata Supreme e Kosovës.

¹¹⁰ Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, neni 15, p. 6. “Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedurat ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç në raste të zvarritjeve të paarsyeshme apo keqpërdorimit të dukshëm të pushtetit.”

¹¹¹ Këshillit Gjyqësor i Kosovës, Raporti vjetor 2011, Statistikat e gjykatave të rregullta, <http://kgjk-ks.org> (2.4.2012).

¹¹² Ligjit mbi Gjykatat nr. 03/L-199, Neni 7paragrafi 2, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 79, 24 gusht 2010, “Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor”.

Kodi Përkohshëm i Procedurës Penale nr. 03/L-199, Neni 5, paragrafi 12 “Çdo person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale ka të drejtë të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme.”

Ligji për Procedurën Kontestimore, nr. 03/L-006, neni 10. paragrafi 1, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 38, 20 shtator 2008, “Gjykata ka për detyrë të përpiket që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji”.

Avokati i Popullit konsideron se institucionet shtetërore duhet të angazhohen për një sistem të pavarur dhe efikas gjyqësor, i cili do të jetë garancia më e mirë për realizimin e së drejtës kushtetuese, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Gjyqtarët në Kosovë duhet ta kenë sigurinë institucionale që të mund ta kryejnë obligimin e tyre ligjor drejt dhe në mënyrë plotësisht të pavarur, nga çdo ndikim i jashtëm, në mënyrë që të kthehet besimi i qytetarëve në gjyqësorin e Kosovës, që paraqet një rën nga tri shtyllat kryesore të funksionimit të shtetit të së drejtës dhe demokracisë.

2.10. E drejta për mjete juridike

E drejta e përdorimit të mjeteve juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e qytetarëve është një nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.¹¹³

Sikurse Kushtetuta, po ashtu edhe legjislacioni penal, civil dhe administrativ, ia garantojnë qytetarit mundësinë e shfrytëzimit të mjeteve juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, me të cilat atij i cenohen të drejtat ose interesat e tij në mënyrën e përcaktuar me ligj. E drejta për t'i shfrytëzuar mjetet juridike garantohet edhe me marrëveshjet dhe instrumentet juridike ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.

Qytetarët e Republikës së Kosovës mund t'i shfrytëzojnë mjetet juridike kundër çdo vendimi të nxjerrë nga autoritetet publike shtetërore dhe gjyqësore. Ata, kërkesën për mbrojtje juridike mund t'ia dërgojnë edhe Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, por vetëm pasi paraprakisht t'i shterojnë të gjitha mjetet ligjore të përcaktuara me legjislacionin përkatës të Kosovës.

Legjislacioni i Kosovës është mjaft i qartë kur bëhet fjalë për ofrimin e mjeteve juridike, mirëpo ka probleme të theksuara te procedurat që duhet të zhvillohen pas paraqitjes së tyre. Për pasojë, në një mori rastesh kemi zvarritje të procedurave gjyqësore ose administrative nga ana e autoriteteve publike.

Në procedurat gjyqësore penale, mjetet juridike dhe afatet kohore për shqyrtimin e ankesave, si ato kundër ndalimit, caktimit ose vazhdimin të paraburgimit, ankimimit të vendimeve gjyqësore, si dhe të ushtrimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, janë të rregulluara dhe të përcaktuara me ligj.¹¹⁴ Mjete juridike për kundërshtimin e paraburgimit parashihen edhe me instrumente ndërkombëtare.¹¹⁵

Të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme e garanton ligji përkatës i Kosovës¹¹⁶ dhe KEDNJ¹¹⁷. Kjo vlen për çdo procedurë gjyqësore në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor.

¹¹³ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 32. “Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.

¹¹⁴ *Kodi i Procedurës Penale*, i miratuar më 6 korrik 2003, i plotësuar dhe i ndryshuar më 3 nëntor 2008.

¹¹⁵ *Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ)*, neni 5, paragrafi 4 “Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhëroj lirinë, në qoftë se burgimi është i paligjshëm”.

¹¹⁶ *Ligji nr.03/L-006 për procedurën kontestimore*, neni 10.1. “Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të të drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji”.

Afatet për zhvillimin e procedurës dhe për nxjerrjen e vendimit në rastet administrative, janë të parapara me Ligjin e Procedurës Administrative. Nëse, sipas këtij ligji, 30 ditë nga dita e paraqitjes së mjetit juridik nuk merret vendimi nga organi kompetent administrativ, palët e fitojnë të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës në përputhje me Ligjin për Konfliktet Administrative.

Gjatë vitit 2011 përkitazi me procedurat gjyqësore dhe administrative gjatë shfrytëzimit të mjeteve juridike, IAP ka hetuar 76 raste, prej të cilave 64 janë të hapura, kurse 12 janë mbyllur. Në bazë të analizës së ankesave të paraqitura, shihet se gati gjysma e rasteve (31) janë të paraqitura kundër gjyqësorit, pastaj ministrive dhe administratës (21 raste) si dhe komunave (14 raste), ndërsa ndaj subjekteve tjera janë gjithsej 10 raste. Ankesat janë paraqitur për shkak të joefektivitetit të mjetit juridik, përkatësisht të mos shqyrtimit të ankesave në afatet ligjore dhe moszbatimit të vendimeve administrative.

Shkaqet më të shpeshta për papranueshmërinë e ankesave na IAP janë: mosshfrytëzimi i mjeteve juridike, apo pala është në shfrytëzim të këtyre mjeteve dhe është në pritje të përgjigjes nga gjykatat apo autoritetet tjera publike, si dhe kur ato janë jashtë juridiksionit të IAP-së. Disa nga ankesat e qytetarëve, faktikisht ishin kërkesa drejtuar IAP-së për përpilimin e ankesave, kërkesave dhe padive për çështje të caktuara për të cilat ankuesit kanë pretenduar se u janë shkelur të drejtat e tyre. Nga kjo mund të konstatohet se, përkundër faktit që qytetarët kanë besim në IAP, ata nuk kanë njohuri të mjaftueshme për kompetencat, misionin dhe mandatin e Avokatit të Popullit. Në raste të tilla ankuesit janë këshilluar që t’u drejtohen Komisionit për Ndihmë Juridike dhe OJQ-së vendore CLARD,¹¹⁸ që kryen shërbime të ndihmës juridike.

Sa i përket ankesave për mjetet juridike drejtuar gjyqësorit, më se gjysma e tyre (30 raste) janë paraqitur kundër Gjykatave Komunale, kurse të tjerat kryesisht kundër Gjykatave të Qarkut dhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Ka pasur dy raste kundër Gjykatave për Kundërvajtje dhe vetëm një rast kundër Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme, në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ankesat e qytetarëve kishin të bëjnë me pakënaqësinë e vendimeve të gjykatave përkatëse, por edhe me zvarritjet e tepruara të procedurave gjyqësore deri në marrjen e vendimit gjyqësor pas ushtrimit të mjeteve juridike. Gjithsesi kjo ndikon në joefektivitetin e mjeteve juridike, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të garantuara me dispozitat ligjore dhe marrjen e vendimeve brenda afateve të arsyeshme ligjore.

Ankesat e qytetarëve drejtuar ministrive, administratës dhe komunave për mjete juridike përfshijnë çështje të fushave të ndryshme: marrëdhëniet e punës, çështjet pronësore, strehimi (banimi), lejet për ndërtimin dhe renovimin e shtëpive dhe lokaleve afariste etj. Në vijim do të veçojmë dy raste të zgjedhura pozitivisht.

¹¹⁷ KEDNJ, neni 6, paragrafi 1. “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”

¹¹⁸ CLARD është OJQ lokale e themeluar në 2007, si trashëgimtare e aktiviteteve të OJQ-së spanjolle, MPDL - Lëvizja për Paqe, e cila ka qenë aktive në Kosovë që nga viti 2002, me fondet e qeverisë nga Agjencia Spanjolle për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (AECID). IAP ka nënshkruar Marrëveshje Mirëkuptimi me CLARD për bashkëpunim dhe mbështetje në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Ankueses nga Prishtina i është zvarritur dhënia e nënshtetësisë së Republikës së Kosovës nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), me pretekste të ndryshme edhe pse e ka plotësuar tërë dokumentacionin në bazë të kërkesës së organeve përkatëse të MPB-së. Rasti i saj është zgjidhur pozitivisht pas 5 muajve, pas intervenimit të Avokatit të Popullit dhe ajo ka marrë vendimin me të cilin i është dhënë nënshtetësia e Republikës së Kosovës.¹¹⁹

Ankuesi nga Prishtina, i punësuar në Doganat e Kosovës, me kontratë të vlefshme të punës deri më 31 dhjetor 2011, me vendim të drejtorit të përgjithshëm të Doganave të Kosovës, nr. i protokollit 225/20.07.2010, është suspenduar me pagesë nga puna, deri në marrjen e vendimit të ri. Më 17 mars 2011, drejtori i përgjithshëm i Doganave të Kosovës njoftoi se ankuesi është risistemuar në punë në Doganat e Kosovës.¹²⁰

Në të gjitha rastet e ankesave të paraqitura te Avokati i Popullit, si në procedurat administrative edhe ato gjyqësore, kur janë konstatuar shkelje të së drejtës për mjete juridike, për shkak të veprimit apo mosveprimit të paligjshëm të autoriteteve publike, Avokati i Popullit ka hapur hetime dhe ka kërkuar informata nga organet e administratës dhe gjykatat e niveleve të ndryshme, përkritazi me shkaqet e vonesave.

Avokati i Popullit, në përputhje me kompetencat ligjore, pas konstatimit të shkeljes së të drejtës, u është drejtuar me letra autoriteteve publike, me kërkesë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, me qëllim të eliminimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut të garantuara me kushtetutë dhe ligje.

Avokati i Popullit konstaton se, për të qenë mjetet juridike efikase dhe efektive, si dhe për të evituar shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut, duhet të respektohen afatet ligjore nga institucionet kompetente, lidhur me lëndën, ose përndryshe të bëhet sigurimi i kompensimit përkatës, kur këto të drejta shkelen. Prandaj, Avokati i Popullit u rekomandon institucioneve të Kosovës në nivel qendror dhe komunal, organeve administrative dhe gjykatave, të bëjnë zbatimin konsekuent të ligjeve vendore dhe instrumenteve ndërkombëtare për ushtrimin e mjeteve juridike nga autoritetet publike.

2.11. Parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në rastet penale

Parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit është ndër parimet themelore të sundimit të ligjit dhe në gjitha sistemet juridike bashkëkohore është ngritur në rangun e parimeve kushtetuese. Parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, në rastet penale, është i garantuar me nenin 33 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.¹²¹ Po ashtu ky parim është një nga parimet fundamentale të së drejtës penale sipas Kodit Penal të Kosovës (KPPK).¹²² Me këto akte ligjore, qytetarëve dhe të gjithë personave në territorin e Republikës së Kosovës u garantohej siguria ligjore në çështjet penale dhe mbrojtja e të drejtave të tyre. Parimi i ligjshmërisë (*Nullum crimen sine lege, nulla poene sine lege*) është parim themelor i së drejtës penale nga

¹¹⁹ *Institucioni i Avokatit të Popullit*, Rasti nr. 312/2011.

¹²⁰ *Institucioni i Avokatit të Popullit*, Rasti nr. 37/2011.

¹²¹ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008*, Neni 33, Parimi i legalitetit dhe Proporcionaliteti në rastet penale.

¹²² *Kodi i Përkohshëm Penal të Kosovës, UNMIK/ Rregullore/2003/25*, Neni 1 “Veprat penale, sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm përcaktohen vetëm me ligj.”

perspektiva e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, drejtësisë dhe paanësisë. Asnjë i pandehur nuk mund të ndëshkohet në mënyrë arbitrare ose retroaktive, për veprimin i cili nuk ka qenë i përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat në kohën e kryerjes së tyre, sipas të drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit. Në këtë drejtim, në përputhje të plotë me frymën e KEDNJ-së, edhe legjislacioni kosovar garanton se “Nuk ka dënim pa ligj”.¹²³

Në rast të ndryshimit të legjislacionit, edhe në sistemin ligjor të Republikës së Kosovës, ndaj kryesit të veprës penale, do zbatohet ligji i cili është më i favorshëm.¹²⁴

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë periudhës për të cilën raportohet, ka pasur ankesa të qytetarëve përkitazi me cenimin parimit të proporcionalitetit. Avokati i Popullit, në të gjitha rastet e ankesave të kësaj natyre, duke pasur kompetenca të kufizuara në gjyqësor, palët i ka udhëzuar për shfrytëzimin e mjeteve juridike.

Institucioni i Avokatit të Popullit, cenimin e parimit të proporcionalitetit e ka konstatuar edhe me rastin e dënimeve të shqiptuara nga gjyqësori ndaj abuzuesve me votat e qytetarëve në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010. Avokati i Popullit gjatë monitorimit të zgjedhjeve, kishte konstatuar shkelje të rënda të rregullave të procesit zgjedhor dhe manipulim të votës në zgjedhje. Në Raportin për vëzhgimin e procesit të rivotimit të zgjedhjeve Parlamentare në Republikën e Kosovës, nr. 010/2011, datë 20 janar 2011, Avokati i Popullit kishte kërkuar nga Prokuroria e Shtetit, ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të manipulimit të zgjedhjeve të vitit 2010, ndaj të gjithë abuzuesve të votës, ngritjen e aktakuzës dënimin e merituar në raport me veprën penale,¹²⁵ ashtu siç parashihet me normat ligjore në fuqi.¹²⁶

Sipas Raportit gjashtëmuor të Prokurorisë së Shtetit, lidhur me lëndët për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura më 12 dhjetor 2010 në Republikën e Kosovës, nga prokuroritë komunale janë akuzuar 502 persona për veprat penale të keqpërdorimit të drejtës së votimit nga neni 178, dhe veprës penale mashtrimi në votime nga neni 180 i KPK-së. Lëndët që kanë përfunduar me aktgjykime, kryesisht kanë pasuar dënime me kusht dhe dënime me gjobë.¹²⁷

Po ashtu Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED), kishte konstatuar se gjykata komunale me rastin e vendosjes së çështjeve penale të manipuluesve të zgjedhjeve për 92 % të rasteve, dënimet e shqiptuara ishin me gjobë, me kusht, apo të dënuarit

¹²³ KEDNJ, neni 7. 1., Nuk ka dënim pa ligj “Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.”

¹²⁴ Kodi i Përkohshëm Penal të Kosovës, UNMIK/ Rregullore/2003/25, Neni 2 “Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryerësit zbatohet ligji që është më i favorshëm.”

¹²⁵ Raporti, Ex officio, për vëzhgimin e procesit të rivotimit të zgjedhjeve Parlamentare në Republikën e Kosovës, nr.010/2011, datë 20 janar 2011, drejtuar z. Ismet Kabashi, Kryeprokuror i Shtetit, z. Jakup Krasniqi, u.d. President i Republikës Kosovës, z. Bajram Rexhepi, ministër i Punëve të Brendshme, znj. Valdete Daka, kryetare e KQZ, z. Shukri Sylejmani, kryetar i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia dhe z. Enver Peci, kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

¹²⁶ Kodi i Përkohshëm Penal të Kosovës, UNMIK/ Rregullore/2003/25, Neni 180, Mashtrim në votime “Kushdo që i falsifikon rezultatet e zgjedhjeve ... dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet”.

¹²⁷ Zyra e Prokurorit të Shtetit, Raporti gjashtëmuor (janar – qershor 2011), lidhur me lëndët që kanë të bëjnë me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura më 12 dhjetor 2010 në Republikën e Kosovës, www.psh-ks.net, 23.11.2011.

janë liruar, ndërsa dënimi me burg efektiv ishte shqiptuar në raste të rralla.¹²⁸ Dënimet e shqiptuara nga gjykatat komunale për manipuluesit e zgjedhjeve në Kosovë ishin të ulëta, të pamjaftueshme dhe joproportionale në krahasim me peshën dhe natyrën e veprës së kryer.

IAP konstaton se parimi i proporcionalitetit në rastet penale të manipuluesve të zgjedhjeve nuk është zbatuar në kuptimin e ligjit, me shqiptimin e dënimeve të lehta dhe simbolike nga ana e gjykatave komunale dhe dënimet nuk përkojnë me qëllimin dhe efektet e ligjit, sidomos kur kihen parasysh pasojat e rënda të shkaktuara, shpenzimeve financiare të taksapaguesve me përsëritjen e zgjedhjeve dhe humbjes të besimit të qytetarëve në institucione. Kjo kërkon interpretim praktik të pavarësisë së punës së institucioneve të drejtësisë, prokurorisë dhe gjyqësorit, në zbatimin e ligjeve në fuqi.

2.12. Liria e lëvizjes

E drejta për lirinë e lëvizjes është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës¹²⁹ dhe nëpërmjet ligjeve vendore,¹³⁰ në përputhje me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.¹³¹ Këto dokumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të gjithë atyre të cilët legalisht qëndrojnë në territorin e një shteti, iu garantojnë të drejtën e lirisë së lëvizjes pa asnjë kufizim. Secili ka të drejtë ta lëshojë secilin shtet, përfshirë edhe shtetin e vet dhe askush nuk ka të drejtë ta privojë askënd nga e drejta që të kthehet, përkatësisht të hyjë në shtetin e vet.

Siguria dhe liria e lëvizjes e komuniteteve të caktuar etnike brenda Kosovës, gjatë kësaj periudhe raportuese ka qenë e ndryshueshme në disa rajone.

Kur flasim për lirinë e lëvizjes së komunitetit serb, ajo gjatë vitit 2011, ka qenë paksa më e keqe sesa gjatë vitit 2010. Kanë ndodhur disa incidente, në një rast kur pjesëtarët e bashkësisë serbe kanë tentuar t'i vizitojnë pronat e tyre në Pejë.¹³²

Këto dhe ngjarje të ngjashme edhe më tutje shkaktojnë frikën dhe ndjenjën e pasigurisë, tek pjesëtarët e komunitetit serb. Ata edhe më tutje shumë rrallë shfrytëzojnë transportin publik për udhëtimet jashtë vendbanime të tyre, kështu që kryesisht shfrytëzojnë transportin privat, shërbimet e taksisë dhe transportin humanitar, në linjat të cilat lidhin lokacionet e fshatit me qendrat e qytetit.

Rastet e shkeljes së lirisë së lëvizjes i janë paraqitur Policisë së Kosovës, me qëllim të zhvillimit të hetimeve.

Kur flasim për të drejtën e lirisë së lëvizjes, përparimi më i madh është arritur në rajonin e Prishtinës dhe të Gjilanit, ku pjesëtarët e komuniteteve pakicë kanë liri të plotë të lëvizjes.¹³³

¹²⁸ *Krimet e Zgjedhjeve, Analizë e ndjekjes penale dhe gjykimin të rasteve të krimeve të zgjedhjeve në Kosovë-KIPRED*, tetor 2011, www.kipred.net 23.11.2011.

¹²⁹ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 35.

¹³⁰ *Ligji për vendbanimin dhe vendqëndrimin*, nr. 02/L-121, GZRK, nr 40/15, tetor 2008; *Ligji për nënshtetësinë*, nr.03/L-034, i cili është ndryshuar dhe plotësuar 04/L-059, GZRK, nr.26/25, nëntor 2011; *Ligji për të huajt*, br.03/L-126, *Ligji për azilin*, nr.03/L-066, GZRK, nr. 30/2008.

¹³¹ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, neni 13; Pakti ndërkombëtar për të drejtat qytetare dhe politike, neni 12; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 2, Protokolle 4.

¹³² Rasti ka ndodhur në tetor të vitit 2011, në fshatin Dobrushë të komunës së Pejës.

Siguria dhe liria e lëvizjes së komuniteteve tjera si turk, boshnjak dhe goran është stabile. Këto komunitete kryesisht e gëzojnë të drejtën e lëvizjes pa pengesa. Shfrytëzojnë transportin publik dhe privat dhe janë mirë të integruara në shoqërinë kosovare, sepse e flasin gjuhën e komunitetit shumicë, për çka komunikojnë më lehtë me institucionet dhe popullatën.¹³⁴

Pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas, kryesisht e gëzojnë të drejtën e lëvizjes në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe shumica e tyre i shfrytëzon mjetet private dhe publike të transportit. Disa pjesëtarë të komunitetit rom, herë pas here shfrytëzojnë shërbimet e transportit humanitar, të cilat i lidhin fshatrat dhe qytetet e banuar me romë dhe serbë.¹³⁵

Popullata kroate e cila jeton në Kosovë është kryesisht e moshuar. Ata janë të vendosur në komunën e Lipjanit në fshatin Janjevë, si dhe në katër fshatra të komunës së Vitisë. Sa i përket lirisë së lëvizjes në komunën e Vitisë, situata nuk është shumë e mirë, për shkak të problemeve të përhershme të sigurisë, me ç'rast tek ata janë të shfaqura ndjenjat e izolimit dhe të pasigurisë.¹³⁶ Kjo bashkësi nuk ka përfaqësuesin e vet në këshillin komunal për sigurinë e komuniteteve në komunën e Vitisë. Për shkak të mungesës së telefonisë fikse në trevat ku jeton komuniteti kroat dhe për arsye se shumica nuk kanë mundësi të ketë telefona mobilë, këta njerëz e kanë të vështirë t'i lajmërojnë incidentet eventuale në polici ose të kërkojnë ndihmë kur të kenë nevojë.¹³⁷

Në komunat në pjesën veriore të Kosovës të banuara me shumicë serbe: Zubin Potoku, Leposaviqi, Zveçani, si dhe pjesa verore e Mitrovicës situata është jostabile. Pjesëtarët e komunitetit shqiptar kanë vështirësi të mëdha sa i përket lirisë së tyre të lëvizjes. Komuniteti shqiptar në këtë pjesë të Kosovës kryesisht shfrytëzon transportin privat, si dhe shërbimet e transportit humanitar deri në pjesën jugore të Mitrovicës.

Shikuar në përgjithësi situata e sigurisë në veriun e Kosovës është përkeqësuar në pjesën e dytë të vitit 2011, pas kundërshtimit serbëve lokalë në veri të Kosovës, gjatë kohës kur institucionet e Kosovës morën qëndrimin që të vendosin kontrollin mbi tërë territorin e Kosovës. Për shkak të barrikadave të cilat serbët lokal i kishin vendosur në rrugë, si dhe në vendkalimet kufitare në veri të Kosovës, ka ardhur deri te vetizolimi i banorëve serbë dhe sidomos izolimi i dhunshëm i banorëve joserbë. Në këtë pjesë të Kosovës në një periudhë të shkurtër, për shkak të vendosjes së barrikadave i është pamundësuar liria e lëvizjes, madje edhe pjesëtarëve të institucioneve të Republikës së Kosovës, të misionit të EULEX-it në Kosovë, si dhe të misionit të KFOR-it. Barrikadat duhet të hiqen, sepse ato paraqesin një formë të kufizimit të lirisë së plotë e cila duhet të jetë e siguar plotësisht.

Në dialogun në Bruksel është arritur një marrëveshje për lirinë e lëvizjes, ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e cila ka filluar të zbatohet më 26.12.2011. Marrëveshja e arritur për lirinë e

¹³³ Deklaratat e zyrtarëve të komunave të këtyre rajoneve u janë dhënë përfaqësueseve të Institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë takimeve të rregullta mujore.

¹³⁴ Informatat të cilat i kanë marrë përfaqësuesit e IAP, gjatë vizitave të rregullta mujore nëpër komunat e Kosovës dhe në bisedat me zyrtarët e tyre gjatë vitit 2011.

¹³⁵ Po aty.

¹³⁶ Problemi është paraqitur në Raportin e OSBE-së "Kroatët e Kosovës të komunës së Vitisë: Komuniteti i rrezikuar", tetor 2011.

¹³⁷ Informatat e marra në takimin me përfaqësuesit e Zyres për të drejtat e njeriut të komunës së Vitisë, të mbajtur më 15.12.2011.

lëvizjes deri në fund të fund kësaj periudhe raportuese, nuk është zbatuar në veri të Kosovës, sepse ende nuk janë larguar barrikatadat.

Sa i përket transportit humanitar të cilin e financon qeveria e Kosovës ai edhe më tutje vazhdon të ketë rol të veçantë, kur është në pyetje liria e lëvizjes. Gjatë vitit kaluar është zhvilluar sipas planit dhe pa kurrfarë problemesh. Janë lejuar edhe tri linja të reja: dy në rajonin e Mitrovicës dhe një në relacionin Shtërpçë- Ferizaj. Është planifikuar që këto linja të jenë funksionale nga janari i vitit 2012. Pas vërejtjeve nga ana e shfrytëzuesve të këtyre shërbimeve, sepse disa linja nuk ishin të rregullta, janë ndërmarrë masa për vendosjen e tahografëve në autobus, të cilëve iu kanë matur kilometrat e kaluara, si dhe koha e vajtje-ardhjeve në destinacione. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë parashtruar edhe disa kërkesa për vendosjen e linjave të reja të transportit humanitar. Këto kërkesa do të shqyrtohen në periudhën e ardhshme. Ndërkaq sa u përket problemeve është paraqitur një rast i gjuajtjes me gur të një autobusi të transportit humanitar në relacionin Babush – Ferizaj.¹³⁸

Rekomandime:

- *Qeveria e Kosovës si dhe institucionet përgjegjëse në pajtim me obligimet e tyre ligjore, qytetarëve të Kosovës, pa kurrfarë diskriminimi dhe kufizimi, t'u mundësohet siguria dhe liria e lëvizjes në gjithë territorin e republikës së Kosovës, që paraqet një parakusht për sundimin e ligjit.*
- *Reagimet e institucioneve qendrore dhe lokale si dhe të policisë së Kosovës duhet të jenë më të ashpra dhe më efikase, kur janë në pyetje incidentet që kanë të bëjnë me lirinë e lëvizjes.*

2.13. E drejta e privatësisë

E drejta e privatësisë është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).¹³⁹ Sipas Kushtetutës dhe KEDNJ, në të drejtën e privatësisë përfshihen e drejta në mbrojtje ligjore, kundër ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën private të njeriut, në familje, në shtëpi ose letërkëmbim, të telefonisë dhe komunikimeve të tjera, mbrojtja e nderit dhe reputacionit etj.

Rëndësi të veçantë për të drejtën e privatësisë ka edhe qasja e lirë në informatat me karakter publik, si dhe mbrojtja e të dhënave personale. Ndonjëherë këto dy të drejta bien ndesh, sidomos gjatë publikimit të lajmeve nga mediat, të cilat duke u thirrur në të drejtën për qasje të lirë në informata dhe të drejtën e publikut për t'u informuar, harrojnë më kryesoren, se ndonjëherë informata të caktuara shkelin privatësinë e qytetarëve.

¹³⁸ Informatat janë marrë nga takimi me drejtorin e Departamenti të Transportit në Ministrinë e Infrastrukturës të mbajtur më 20.12.2011

¹³⁹ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 36; *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, neni 8.

2.13.1. Mënjanimi i zhurmës dhe e drejta e banimit

KEDNJ në nenin 8, si shkelje i konsideron edhe ndërhyrjet e tërthorta, të cilat janë rezultat i pashmangshëm i veprimeve, që nuk kanë prekur personat konkretë p.sh, zhurma e madhe nga rrethinat.¹⁴⁰ Edhe Ligji nr. 02/2 për Mbrojtjen nga Zhurma, mbron të drejtën e privatësisë.

Lidhur me këtë, Avokati i Popullit ka shprehur shqetësim, për zhurmën e banorëve në fshatin Stanishor, të komunës së Novobërdës. Ata janë ankuar se gurëthyesi i kompanisë private “Bejta Commerce”, me makinerinë punuese u shkaktonte zhurmë, sidomos në mbrëmje dhe gjatë natës, prej orës 20:00h deri në orët e hershme të mëngjesit. Për këtë, banorët ishin ankuar në komunë, mirëpo nuk kishin marrë përgjigje.

Përfaqësuesi i IAP-së, kishte kontaktuar koordinatoren e Njësisë për të Drejtat e Njeriut të komunës së Novobërdës. Qëllimi i kontaktimit ka qenë marrja e informatës për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit Komunal, ku do të shqyrtohej kërkesa e ankuesve. Pas vizitës së përfaqësuesit të IAP-së në terren dhe kontaktit të drejtpërdrejtë me drejtorin e kompanisë në fjalë dhe premtimit për ndërprerjen e punës në mbrëmje dhe gjatë natës, zhurma ishte ndalur dhe çështja e ankuesve ishte zgjidhur pozitivisht.

Më 23 nëntor 2011, ankuesi e ka njoftuar IAP-në se kishte pranuar përgjigjen - një vendim nga KK Novobërdë, me të cilin pala ishte udhëzuar që të parashtrijë ankesë në Inspektionin Komunal, e nëse paraqitet ndonjë mosmarrëveshje, ta paraqesë rastin në gjykatë.¹⁴¹

Avokati i Popullit ka shprehur shqetësimin edhe për rastin e një qytetareje e cila është ankuar kundër Drejtorisë së Inspektionit të komunës së Prishtinës, për mosndërmarrje të veprimeve për largimin e aparaturës ventiluese në objekt banimi kolektiv në Prishtinë. Kompania “Lesna Trade”, ka vendosur pajisje ventiluese në objektin e banimit kolektiv. Sipas Aktvendimit nr. 07 NR 355-9855, të datës 19 prill 2010, kompania “Lesna Trade” është urdhëruar të largojë pajisjen e ventilimit. Përfaqësuesja e IAP-së, është takuar me drejtorin e Administratës, drejtorin e Inspektionit të komunës së Prishtinës, drejtorin e Shërbimeve Publike, si dhe ka kontaktuar inspektorin e mjedisit në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Qëllimi ishte informimi se si është lëshuar pëlqimi për përdorimin e sistemit ventilues të kompanisë “Lesna Trade”. Avokati i Popullit i ka dërguar pesë shkresa kryetarit të komunës së Prishtinës dhe kopjen e shkresës drejtorit të Inspektionit për ndërmarrjen e veprimeve, lidhur me rastin. Kryetari i komunës së Prishtinës nuk është përgjigjur në asnjë shkresë. Gjithashtu, gjendja nuk ka ndryshuar, në drejtim të zgjidhjes së rastit dhe për këtë rast, Avokati i Popullit e ka njoftuar Komisionin Parlamentar për Mjedis të Kuvendit të Kosovës, për moszbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Zhurma.¹⁴²

¹⁴⁰ Marek Antoni Nowicki, “Rreth Konventës Evropiane”, Komentari i shkurtër mbi KEDNJ, Tiranë, 2003.

¹⁴¹ Rasti A. nr. 443/2011, IAP.

¹⁴² Rasti A. nr. 365/2010, IAP.

2.13.2. E drejta për mjedis të shëndetshëm dhe e drejta e banimit

E drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe e drejta e banimit zënë një vend të veçantë në nenin 8 të Konventës. Avokati i Popullit, ka pranuar ankesën e një qytetari, i cili është ankuar për derdhjen e ujërave të zeza nga Kolegji “Mehmet Akif”, në afërsi të shtëpive të lagjes së tij. Edhe banorët e tjerë të po asaj lagjeje disa herë kishin kërkuar nga përfaqësuesit e Kolegjit sanimin e gjendjes. Pas kërkesës dhe ankesave të qytetarëve, përfaqësuesit e IAP-së kanë vizituar Kolegjin “Mehmet Akif” në fshatin Banullë të Lipjanit, por nuk kanë vërejtur derdhje të ujërave të zeza, si përshkruhej në ankesë. Për të sqaruar pohimet e ankuesit, si dhe gjendjen faktike pas vizitës së përfaqësuesve të IAP-së, në vendin e ngjarjes, ankuesi u kontaktua nga përfaqësuesi i IAP-së. Edhe ankuesi pohoi se Kolegji “Mehmet Akif” kishte ndërmarrë veprime, duke e sanuar gjendjen dhe se ishin evituar problemet.¹⁴³

2.13.3. Kontrolli i shtëpisë nga autoritetet

Neni 8 paragrafi, 1 i Konventës, parasheh respektin për jetën private dhe familjare të çdo njeri, në vendbanimin dhe korrespondencën e tij. Mirëpo, paragrafi 2, parasheh se autoriteti publik mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, duke e njohur nevojën legjitime për përmasa të tilla “*në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose parandalimin e krimit*”.¹⁴⁴

Avokati i Popullit, ka pranuar ankesën e një qytetareje kundër Policisë së Kosovës, e cila është ankuar për mosprezantim të urdhrit për bastisje nga pjesëtarët e policisë. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka kontaktuar zyrtarët përgjegjës në Policinë e Kosovës, lidhur me rastin. Zyrtarët e policisë i kanë ofruar dëshmi Avokatit të Popullit se kanë marrë urdhër bastisjeje nga prokurori i Prokurorisë Publike të Qarkut, për shkak të dyshimit të bazuar. Nga dëshmitë e paraqitura, nuk është konstatuar ekzistimi i ndonjë shkelje të drejtave të njeriut, duke u bazuar në nenin 201 dhe nenin 242, paragrafi 4, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, sa i përket ankesës për urdhër për bastisje.¹⁴⁵

2.13.4. Kontrolli dhe përgjimi i mjeteve të komunikimit

Avokatin e Popullit e shqetëson fakti se në Projektligjin mbi përgjimin e telekomunikimeve, nuk është paraqitur në mënyrë të detajuar procedura ligjore e përgjimit të telekomunikimeve në Kosovë. Problemi i mospërcaktimit të qartë të përgjimit ligjor të telekomunikimeve në Kosovë krijon vështirësi për institucionet e drejtësisë dhe sigurisë, në marrjen e masave të

¹⁴³ Rasti A. nr. 6/2010, IAP.

¹⁴⁴ Mark W. Janis, Richard S. Kay, Anthony W. Bradley, *E drejta evropiane e të drejtave të njeriut*, Prishtinë, 2002.

¹⁴⁵ Rasti A. nr. 115/2011, IAP.

nevojshme për hetimin e krimit dhe mbledhjen e informatave të natyrës së inteligjencës, sepse jo të gjitha masat e vëzhgimit, përgjimit dhe hetimit, ku përfshihen shërbimet e telekomunikacionit, kualifikohen për t'u hetuar me përgjim të telekomunikimeve dhe jo të gjitha këto masa kanë bazë në legjislacionin e Kosovës.¹⁴⁶

Për Avokatin e Popullit jashtëzakonisht shqetësues është natyra dhe mandati i institucionit të sigurisë në Kosovë. Këto kanë ndryshuar disa herë përgjatë dekadës së kaluar. Edhe pse mandati për të ofruar shërbime të inteligjencës dhe për të marrë masa speciale të hetimit ka kaluar gradualisht nga aktorët ndërkombëtarë të sigurisë tek ata vendorë, veçanërisht pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, përgjimi i telekomunikimeve vazhdon të qëndrojë në errësirë.

Dyshimi i ministrit të Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës se komunikimi i tij, e madje edhe i Kryeministrit të Republikës së Kosovës, po përgjohej nga organet ndërkombëtare në Kosovë, më saktësisht nga EULEX-i, është jashtëzakonisht shqetësues. Ky deklaram i njeriut të parë të Republikës së Kosovës në këtë fushë, se edhe vetë është i përgjuar dhe i pafuqishëm të ndërmarrë çfarëdo qoftë në këtë drejtim, jo vetëm nuk ka ndihmuar në sqarimin e rrethanave ekzistuese të pasqaruar, në këtë drejtim, por ka shkaktuar një pasiguri të përgjithshme shoqërore dhe institucionale. Realisht, sot në Republikën e Kosovës asnjë person nuk është i sigurt sa i përket përgjimeve, por edhe masave të tjera të sigurisë, sidomos të masave speciale të vëzhgimit, përgjimit dhe të hetimit, kur për këtë botërisht dhe me përgjegjësi institucionale deklarohet personi përgjegjës, misioni i të cilit është të ndërtojë dhe të ruajë sigurinë për të gjithë qytetarët në Kosovë.¹⁴⁷

Njëra nga arsytet pse ndodhë që këto autoritete në Republikën e Kosovës, institucionet përgjegjëse dhe kompetente vendore dhe ndërkombëtare, të punojnë në mënyrë të pavarur dhe pa një bashkëpunim të përhershëm ndërmjet tyre, është fakti se institucionet vendore dhe ndërkombëtare të drejtësisë dhe sigurisë kanë nënshkruar marrëveshje ndaras dhe në mënyrë të pavarur me operatorët e telekomunikacionit. Një aranzhim i tillë jep hapësirë që ankesat t'i drejtohen aktorëve të ndryshme të sigurisë veç e veç.¹⁴⁸ Në çdo rast, humbësi më i madh dhe më i rrezikuar në këtë rast është qytetari i Republikës së Kosovës, pa fajin e tij. Përfundimisht, bazuar në të gjeturat e deritanishme për vitin 2011, Avokati i Popullit konstaton se e drejta e privatësisë nuk është respektuar dhe vazhdon të mos respektohet në shkallë të kënaqshme.

Duke u bazuar, nga të cekurat më lartë, në lidhje me të drejtën e privatësisë, Avokati i Popullit, **rekomandon që:**

¹⁴⁶ Shpend Kursani, *Përgjimi i telekomunikimeve në Kosovë: Implikimet për sigurinë*, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Prishtinë, 2011.

¹⁴⁷ www.koha.net, më 14 shtator 2011, ka paraqitur deklaratën e ministrit të Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, Bajram Rexhepi, si në vijim: *"Bisedat e mia me Kryeministrin Thaçi, përgjohen nga ndërkombëtarët, e më pas dekonspirohen. Në të kaluarën ka pasur bashkëpunëtorë nga UNMIK-u që kanë bashkëpunuar me strukturat ilegale. Për këtë arsye është planifikuar shpejt aksioni në veri"*.

¹⁴⁸ Shpend Kursani, *Përgjimi i telekomunikimeve në Kosovë: Implikimet për sigurinë*, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Prishtinë, 2011.

- *Institucionet publike, sidomos ato komunale, të përgjigjen më me azhuritë dhe pa komplikime burokratike në kërkesat – ankesat e qytetarëve, duke shtuar përgjegjësinë ndaj qytetarëve dhe duke përmirësuar komunikimin me ta.*
- *Institucionet publike, sidomos ato komunale, të mos delegojnë në gjykatat e Kosovës, edhe ashtu të stërngarkuara me lëndë të pazgjidhura, zgjidhjen e problemeve të thjeshta të qytetarëve, të cilat bien në fushën e përgjegjësisë të tyre.*
- *Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, urgjentisht, sa më shpejt të jetë e mundur, të procedojnë për miratim Ligjin për përgjimin e telekomunikimeve në Republikën e Kosovës.*

2.14. E drejta e martesës dhe familjes

Martesa nënkupton një bashkësi midis dy personave të gjinive të ndryshme, të regjistruar sipas ligjit, të cilët lirshëm vendosin të jetojnë bashkë dhe të krijojnë familje.¹⁴⁹ Në bazë të pëlqimit të lirë çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të krijojë familje, në pajtim me ligjin.¹⁵⁰

Familja përbën një bashkim personash të cilët për shkak të martesës, gjinisë ose birësimit, janë lidhur mes veti në marrëdhënie psikologjike, morale, ekonomike dhe juridike, jetojnë në një ekonomi të përbashkët familjare dhe mbajnë përgjegjësi shoqërore për njëri tjetrin. Familja, sipas mënyrës së themelimit, është familje martesore, jashtëmartesore dhe familje e birësimit (adoptimit).

Avokati i Popullit, edhe gjatë kësaj periudhe të raportimit, ka marrë një numër të ankesave, që kanë të bëjnë me zvarritjen e procedurave të shkurorëzimit; mosrealizimin e kontakteve të rregullta me fëmijë; zvarritjen e procedurave për të vendosur, përkritazi me të drejtën e besimit të fëmijëve dhe mosekzekutimit të vendimeve, lidhur me pagesën e alimentacionit për fëmijë.

Posaçërisht brengosëse për Avokatin e Popullit janë ndarjet e bashkëshortëve, të cilët kanë fëmijë, sepse në këto raste, fëmijët janë viktimë të pafajshme. Ata pa fajin e tyre duhet të jetojnë ndaras nga njëri prind, e kjo ndikon negativisht në zhvillimin, edukimin dhe mirëqenien e tyre.

Në rastet e shkurorëzimeve lindin problemet e kujdestarisë për fëmijët e mitur, kontaktit të prindërve me fëmijët dhe pagesa e alimentacionit për fëmijë ose për njërin bashkëshort, i cili mbetet pa mjetet e domosdoshme për jetesë pas shkurorëzimit. Pastaj problemet e ndarjes së pasurisë së përbashkët martesore dhe procedurat e gjata gjyqësore. Nga Departamenti i Shërbimeve Sociale (DSHS) të MPMS-së rezulton se më shumë kujdestarinë e kanë fituar nënat, si nga bashkësia martesore, ashtu edhe ajo jomartesore.¹⁵¹ Një ankuesë ka shprehur shqetësimin e saj, për shkak të zvarritjes së procedurës së ekzekutimit të vendimit nga Gjykata

¹⁴⁹ Ligji mbi familjen i Kosovës, nr. 32/2004, neni 14, pika 1.

¹⁵⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 37, pika 1.

¹⁵¹ Informata nga Departamenti i Mirëqenies Sociale të MPMS, 11 janar 2012. 121 raste dhe nga këto raste kanë qenë 136 fëmijë, 69 prej të cilëve i janë besuar nënës dhe 67 i janë besuar babait. Numri i rasteve nga bashkëjetesa - 7 raste me 16 fëmijë, 14 nga të cilët i janë besuar nënës dhe 2 babait. Numri i përgjithshëm i rasteve martesore dhe jashtëmartesor 128 raste me 83 fëmijë të besuar nënës dhe 69 fëmijë të besuar babait.

Komunale në Suharekë, në lidhje me pagesën e alimentacionit për fëmijën e saj të mitur. Edhe pas letrës nga Avokati i Popullit, më 13 shtator 2011, nuk është pranuar asnjë përgjigje nga organi përgjegjës.¹⁵² Dështimi i tillë i gjykatave është i kundërligjshëm dhe shkel standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në veçanti nenin 6 dhe 13 të KEDNJ-së, si dhe Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF).

Mirëpo, ka raste të atilla, në të cilat gjykatat reagojnë me një azhuritë më të madh. Sipas ankesës së ankuesit, i cili në cilësinë e përfaqësuesit të vajzës së vet kërkonte të hetohet arsyeja e zvarritjes së procedurës gjyqësore, në rastin e shkurorëzimit për të bijën në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.¹⁵³ Pas një takimi formal të përfaqësueses së Avokatit të Popullit me gjyqtarin e lëndës në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe interesimit të vazhdueshëm lidhur me ecurinë e kësaj çështje, Avokati i Popullit u informua nga vetë ankuesi se Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka vendosur në favor të nënës, lidhur me kujdestarinë dhe besimin e fëmijëve. Në kuadër të së drejtës martesore dhe familjare janë të përfshira edhe çështjet e adoptimit (birësimi). Avokati i Popullit, gjatë kësaj periudhe raportuese nuk ka pranuar asnjë ankesë, përkitazi me këtë çështje. Ligji për Familjen, nuk bënë dallim ndërmjet procedurës që duhet të ndiqet në rast të fëmijës së braktisur dhe procedurës që duhet të ndiqet në rast të fëmijës, prindërit e të cilit janë të njohur (përveç pjesëve të veçanta, lidhur më atë se si duhet të iniciohet kërkesa për birësim).¹⁵⁴

Sipas Avokatit të Popullit, Ligji për Familjen parasheh se Qendra për punë Sociale (QPS) do të luajë rol të rëndësishëm, si në ndihmën, ashtu edhe në këshillimin e gjykatave, gjatë gjykimit të disa llojeve të caktuara të kontesteve martesore.¹⁵⁵ Në rastet kur ka fëmijë të mitur nga martesa, QPS-të do të zhvillojnë procedura të pajtimit.¹⁵⁶ Veç kësaj, kur ajo thirret për të vendosur, lidhur me çështje të pazgjdhura që përfshijnë “ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve”, gjykata para se të vendosë, do të “marrë mendimin dhe propozimin” e QPS-së.¹⁵⁷ Përfshirja e QPS-ve kërkohet në procedurat për vërtetimin e atësisë apo amësisë, procedurat e shkurorëzimit, ku bashkëshortët kanë fëmijë të mitur dhe për të cilat janë paraparë procedura formale të pajtimit dhe paditë për kujdestarinë e fëmijëve të mitur. Mirëpo, përkundër këtyre kërkesave ligjore, është vërejtur se gjykatat, në të shumtën e rasteve dështojnë t’i përfshijnë QPS-të në procedura të tilla.¹⁵⁸

Prandaj, Avokati i Popullit konstaton se për respektimin e kësaj të drejte duhet një sistem ligjor më i efektshëm dhe në harmoni me ligjet vendore dhe standardet ndërkombëtare të aplikueshme për të drejtat e njeriut në Kosovë.

Rekomandime

¹⁵² Rasti nr. 266/2011.

¹⁵³ Rasti nr. 99/2011.

¹⁵⁴ Ligji për Familjen, neni 182.

¹⁵⁵ Ligji nr. 2005/02-L17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, neni 14 dhe 7.2.

¹⁵⁶ Ligji për Familjen, neni 80 (1).

¹⁵⁷ Ligji për Familjen, neni 140 (2).

¹⁵⁸ Raporti i OSBE-s, shkurt 2011, gjykimi i rasteve familjare, fq. 17.

- *Të rritet azhuriteti me rastin e gjykimit të lëndëve në procedurat gjyqësore të rasteve familjare.*
- *Instituti Gjyqësor i Kosovës të vazhdojë me trajnimin e gjyqtarëve për rolin e gjykatave në zgjidhjen e kontesteve gjyqësore familjare: aplikimin e Ligjit për familjen dhe Ligjit të Procedurës Kontestimore, si dhe rëndësinë e shfrytëzimit të tërësishëm të procedurave në lëndët civile, përfshirë edhe rastet e shkurorëzimit dhe të kujdestarisë së fëmijëve të mitur.*
- *Zyrtarët e QPS-ve të përgjigjen në kërkesat e gjykatave për ndihmë, brenda afatit kohor të paraparë nga legjislacioni përkatës dhe të ofrojnë vlerësimet profesionale në rolin e ekspertëve, kur kjo kërkohet nga gjykatat.*

2.15. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

Liria e besimit fetar, bindjes dhe ndërgjegjes është e drejtë e cila garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës¹⁵⁹ dhe KEDNJ.¹⁶⁰ Lidhur me respektimin e kësaj të drejte, bashkësitë fetare në Kosovë kanë paraqitur vërejtje të ndryshme.

Bashkësia Islame e Kosovës, si njërin prej formave të shkeljeve e konsideron ndalimin mbajtjes së shamive për nxënëset në shkollat e Kosovës. Gjithashtu, besimtarët në shumë raste nëpërmjet organizimit të protestave kanë kërkuar nga Qeveria që të gjejë një zgjidhje për këtë problem.

IAP, në periudhën për të cilën raportohet, ka regjistruar tri raste ku ankueset janë ankuar lidhur me ndalimin e tyre që të vijojnë mësimin për shkak të bartjes së shamisë. Prej tyre, një rast nuk është pranuar në IAP për shkak të mosshfrytëzimit e mjeteve juridike, ndërsa në dy raste tjera nxënëset kanë vazhduar shkollimin në një shkollë tjetër me korrespondencë. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në shtator të vitit 2011, ka vendosur lidhur me rastin e ankueses Arijeta Halimi, e cila është ankuar për mosekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, me të cilin ankueses i është lejuar mbajtja e shamisë gjatë vijimit të mësimin në shkollën e mesme.¹⁶¹

Një prej problemeve të cilit i është kushtuar vëmendje në raportet e përmarrshme të IAP-së, ku më së shumti janë ankuar përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Serbe, gjatë viteve të kaluara, është përdhosja dhe shkatërrimi i varrezave ortodokse në gjithë Kosovën.

Një prej hapave në drejtim të zgjidhjes së këtij problemi është pastrimi i varrezave ortodokse në Prishtinë, të cilin më 18 nëntor 2011 e ka organizuar Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkëpunim me komunën e Prishtinës.¹⁶²

¹⁵⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 38.

¹⁶⁰ KEDNJ, neni 9, Liri e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit.

¹⁶¹ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për papranueshmërinë e kërkesës për vlerësimin kushtetues të parashtrësës së znj. Arijeta Halimi (30.9.2011), në <http://www.gjk-ks.org>, 29.2.2012.

¹⁶² Pastrojnë varrezat serbe në Prishtinë, *Kuririnfo* (27. 6. 2011.g.), <http://www.radiokim.net>, 22.11.2011.

Me probleme të ngjashme po përballet edhe komuniteti kroat i përqendruar në Viti.¹⁶³ Ata në disa raste kanë tërhequr vëmendjen në përdhosjen e varrezave katolike në këtë pjesë, gjatë viteve të kaluara.

Një incident i kësaj natyre ka ndodhur më 2 dhjetor 2011 në varrezat hebreje në Prishtinë, kur mbi përmendoret e tyre u gjetën të vizatuar simbolet naziste.¹⁶⁴

2.15.1. Konfesionet fetare

Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës¹⁶⁵ dhe Ligjin për liritë fetare në Kosovë,¹⁶⁶ mbrohen dhe garantohen të drejtat dhe liritë e bashkësive fetare.

IAP në raportet e mëparshme ua ka tërhequr vëmendjen organeve kompetente për ekzistimin e një numri të madh të problemeve që bashkësive fetare në Kosovë u shkakton Ligji për rregullimin e pozitës së bashkësive fetare. Me qëllim të zgjidhjes së këtij problemi IAP në vitin 2010 ka kërkuar nga Kuvendi i Kosovës që të miratojë normat ligjore me të cilat do të rregullohej kjo fushë. Ky ligj ende nuk është nxjerrë.¹⁶⁷

2.15.2. Bashkësia fetare islame

Bashkësia fetare islame si njërin prej problemeve të saj më të mëdha gjatë këtij viti e ka theksuar nevojën për ndërtimin e një xhamie në qendrën e kryeqytetit të Kosovës— në Prishtinë, në hapësirën universitare, me arsyetimin se ekziston një numër i madh i besimtarëve të cilët jetojnë në këtë pjesë të qytetit dhe nuk kanë hapësirë për të kryer shërbimet e tyre fetare. Bashkësia fetare islame ka kërkuar nga organet e qytetit të Prishtinës lejen për hapësirën në të cilën do të ndërtohej xhamia e re, mirëpo kjo kërkesë nuk është përkrahur nga përfaqësuesit e pushtetit. Në shenjë proteste me këtë qëndrim, me qëllim të tërheqjes së vëmendjes për këtë problem, besimtarët në një masë të madhe, nga fillimi i vitit 2011, në disa raste e kanë falur namazin në platonë afër Xhamisë së vjetër të gurit, ndërmjet Kuvendit të Kosovës dhe ndërtesës së komunës së Prishtinës.¹⁶⁸ Besimtarët në të njëjtën kohë disa herë kanë kërkuar në Prishtinë kanë organizuar protestat (protestat janë organizuar çdo të premte,

¹⁶³ Raporti i OSBE–sw, Kroatët e Kosovës në komunën e Prishtinës: Komuniteti i rrezikuar, f. 12 (tetor 2011), <http://www.osce.org/kosovo>, 22.11.2011.

¹⁶⁴ Amra Zejneli, Gjykimet e ashpra, përdhosja e varrezave hebreje në Prishtinë, Radio Evropa e Lirë, (1.12.2011), <http://www.slobodnaevropa.org>, 29.2.2012; Gjykimi i përdhosjes së varrezave hebreje në Prishtinë, (2.12.2011), <http://www.radiokim.net>, 29.2.2012.

¹⁶⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 39.

¹⁶⁶ Ligji nr. 02/L-31 mbi liritë fetare në Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 13.7.2006.

¹⁶⁷ *Ex- Officio* Raporti i IAP-së nr. 145/2010, IAP, (30.7.2010), lidhur me mungesën e akteve normative për zgjidhjen e pozitës juridike të statusit të bashkësive fetare në Kosovë, dërguar Kuvendit të republikës së Kosovës më 30.7.2010.

¹⁶⁸ Muhamet Brajshori, Xhamia e paarritshme zemëron muslimanët, *See Times*, (15.8.2011) <http://www.setimes.com/>, 8.12.2011.

ndërsa më të mëdhatë kanë qenë më 24 qershor dhe më 1 korrik 2011), në të cilat nga qeveria është kërkuar zgjidhja e problemit të mungesës së hapësirës për ndërtimin e xhamisë së re, si dhe një trajtim të njëjtë për të zgjidhjen e nevojave për bashkësive fetare.¹⁶⁹

Gjithashtu, një prej kërkesave të Bashkësisë fetare islame në Kosovë është edhe futja e mësimit fetar në shkollat publike.¹⁷⁰ Me rastin e zgjidhjes së këtij problemi është parashtruar një kërkesë për ndryshimin e Ligjit për arsimimin parauniversitar, me të cilin është kërkuar që në shkolla të lejohet futja e mësimit fetar si lëndë e re mësimore. Ky propozim nuk ka hasur në përkrahje nga ana e deputetëve dhe Kuvendi i Kosovës në seancën e mbajtur më 29 gusht 2011, e ka refuzuar kërkesën për ndryshimin e Ligjit për arsimin parauniversitar, me të cilin është kërkuar që në shkolla në futet mësimin fetar, si dhe të lejohet mbajtja e shamive, me arsyetimin që në Kushtetutën e Republikës së Kosovës garantohet sekularizmi i shtetit.¹⁷¹

2.15.3. Kisha Ortodokse Serbe

Problemet me të cilat ballafaqohet Kisha Ortodokse Serbe (KOS) janë të ngjashme me ato të viteve të mëhershme. Një prej ngjarjeve më të rëndësishme për KOS gjatë këtij vit është rinisja e procesit të mësimit në “Bogoslovinë” e Prizrenit.¹⁷² Pas riparimit të ndërtesës së “Bogoslovisë” dhe konakëve të saj këtë vit ka vazhduar procesi i mësimit ku janë regjistruar 9 nxënës.

Në krahasim me vitet e kaluara, rastet e sulmeve në manastire dhe kisha janë numerikisht më të pakta, por ka pasur raste. Sipas deklaratave të zyrtarëve të KOS, në Prizren më 13 prill 2011, është vjedhur një pjesë e mbulojës së plumbtë e kulmit të kishës Virgjëresha e Levishkës.¹⁷³ Me rastin e këtyre deklaratave të përfaqësuesit të Kishës serbe, ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, më 17 prill 2011, në deklaratën e dhënë agjencisë serbe të lajmeve “Tanjug”, të cilën e kanë dhënë edhe mediat ditore, ka thënë se “policia i ka kryer hetimet dhe ka vërtetuar se një pjesë e mbulojës së kulmit mungon një kohë të gjatë dhe se kjo nuk është rezultat i jotolerancës fetare në këtë qytet. Ministri Rexhepi ka shtuar se raportin lidhur me këtë ngjarje policia e ka proceduar te ambasadori grek Dimitris Moskopulos, i cili është ndërmjetësues për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare të Kishës serbe në Kosovë, në mënyrë që kjo ngjarje të mos politizohet. Ai ka thënë se sipas hetimeve policore është vërtetuar se një pjesë e mbulojës së kishës është zhdukur më herët dhe kjo mund të jetë

¹⁶⁹ Nuk po kërkojmë tenderë, por xhami, *Bota sot*, <http://www.botasot.info>, 4.06.2011.

¹⁷⁰ Amra Zejneli, „Qeveritarët qëndrojnë kundër mësimit fetar në bankat shkollore“, *Radio Evropa e Lirë*, (28.5.2011) <http://www.slobodnaevropa.org>, 12.2011.

¹⁷¹ Procesverballi nga seanca plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës e mbajtur më 29 gusht 2011, në të cilin është kundërshtuar futja e mësimit fetar në shkolla, <http://www.kuvendikosoves.org>, 1.3.2012.

Deputetët e Republikës së Kosovës kanë votuar kundër futjes së lëndës së edukimit fetar dhe bartjes së shamisë në arsimin publik parauniversitar në Kosovë, që ishte propozuar nga grupet parlamentare Kosova e Re, SLS dhe 6-Plus, pa mbështetjen e Komisionit funksional dhe Komisionit për legjislativ. Neni 3, amendamenti 7 dhe 8, i Ligjit për arsimin parauniversitar, që ka të bëjë me futjen e lëndës së mësimbesimit dhe bartjes së shamive në shkolla. Amendamenti 7 dhe amendamenti 8 u kundërshtua.

¹⁷² „Bogoslovija sërish në Prizren, *Naslovi net*, (19.9 2011) <http://www.naslovi.net>, 2.3.2012.g.

¹⁷³ Agjencia Beta, U vodh një pjesë e kulmit në kishën e Virgjëreshës së Levishkës (13 prill 2011) <http://www.kurir-info.rs>, 3.3.2012.

pasojë e dëmtimeve nga erërat ose ndoshta edhe e mospërfundimit të punimeve nga punëkryesi.¹⁷⁴

Përndryshe kisha Virgjëresha e Levishkës është në listën UNESCO-s të përmendoreve mesjetare në Kosovë dhe gjithashtu gjendet edhe në listën e trashëgimisë kulturore botërore të UNESCO-s, e cila është e rrezikuar nga shkatërrimi.¹⁷⁵

Në një objekt tjetër të Kishës serbe në Prizren ka ardhur deri te dëmtimi. Kështu, më 22 qershor 2011 gjatë zhvillimit të punimeve në ndërtim në afërsi të kishës së të Dielës së Shenjtë janë gërmuar themelet e kësaj kisha, me ç'rast është rrezikuar statika e kishës.¹⁷⁶ Edhe në Zhupën e Siriniqit, më 23 maj 2011 është lajmëruar për thyerjen e kishës, por nuk ka pasur dëme të mëdha.¹⁷⁷

Sipas deklaratave të përfaqësuesit të OJQ-ve, më 10 qershor 2011 kisha e Shën Gjonit në fshatin Samadrazhë të Vushtrrisë është dëmtuar “kulmi i kësaj kisha është shkatërruar, mbi absidën e altarit është bërë një vrimë e madhe, xhamat e dritave dhe të dyerve janë thyer, kambana dhe muri përreth kishës janë shkatërruar, ndërsa brendia është shndërruar në deponi publike”.¹⁷⁸ Përfaqësuesit e OJQ-ve kanë ftuar përfaqësuesit e qeverisjes komunale që të mbrojnë këtë objekt dhe t'i kryejnë riparimet.

2.15.4. Kisha Katolike e Kosovës

Sa i përket Kishës Katolike të Kosovës ajo gjithashtu ka përkrahur rregullimin juridik të bashkësive fetare në Kosovë. Besimtarët e Kishës katolike të Kosovës janë kryesisht shqiptarë, por ka edhe kroatë të cilët janë të vendosur kryesisht në Janjevë dhe në Letnicë. Kroatët të cilët jetojnë në fshatrat e komunës së Vitisë janë kryesisht të vjetër dhe njerëz të sëmurë, ndërsa numri i të rinjve është relativisht i vogël, kështu që për këta njerëz në të shumtën e rasteve kujdeset Kisha katolike e Kosovës, nëpërmjet klerikëve të saj.¹⁷⁹

2.15.5. Kisha Protestante Evangjelike e Kosovës

Vërejtjet e Kishës Protestante Evangjelike të Kosovës edhe këtë vit, sikurse në të kaluarën, kanë të bëjnë me zgjidhjen e pozitës së bashkësive fetare në Kosovë. Përfaqësuesit e kishës protestante insistojnë që ligji duhet të jetë i qartë dhe të përcaktojë pozicionin juridik të

¹⁷⁴ Tanjug, Pjesa e mbulojës së kulmit të Virgjëreshës së Levishkës mungon kaheër, (17.4.2011), <http://www.naslovi.net>, 2.3.2012.

¹⁷⁵ Lista e UNESCO-s, për përmendoret e rrezikuara, <http://www.unesco.org>, 5.12.2011.

¹⁷⁶ Gërmohen themelet e kishës së shekullit XIV në Prizren, *Gradjevinarstvo* (24.06.2011), <http://www.gradjevinarstvo.rs>, 2.3.2012.

¹⁷⁷ U demolua kisha në Zhupën e Siriniqit, *Kurir info* (23.maj.2011), <http://www.kurir-info.rs>, 2.3.2012.

¹⁷⁸ Kisha si deponi, *B92 Net* (10.6.2011), <http://www.b92.net/info/vesti/index>, 4.3.2011.

¹⁷⁹ Raporti i OSBE-s për jetën e kroatëve të Kosovës në Viti, OSBE (tetor 2011), www.osce.org/kosovo, 5.12.2011.

bashkësive fetare.¹⁸⁰ Sikurse edhe vitet e mëparshme, protestantët kanë paraqitur pakënaqësitë për shkak të refuzimit të institucioneve lokale për të dhënë leje për ndërtimin e objekteve fetare, si dhe refuzimin që këtyre besimtarëve t'u lejohet lokacioni për varrezat.

Po ashtu, Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës, përmes përfaqësuesit të saj, më 22 shkurt 2011 dhe 7 mars 2011 ishte ankuar te Avokati i Popullit për regjistrimin e popullsisë që do të mbahet në Republikën e Kosovës në prill 2011, për shkak të formulimit të pikës 10 (dhjetë) të formularit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, pyetësori individual, (formulari R3), me kërkesën që pyetja 10 (dhjetë) të hiqet nga formulari, që pyetja 10 (dhjetë) bazë të zëvendësohet me një formulim sipas Nenit 38 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ose në pyetjen e 10 (dhjetë), pas nën-pyetjes me numër rendor 3. Katolik, numri rendor 4 të jetë Protestant dhe kërkesa për ngritjen e çështjes në Gjykatën Kushtetuese.¹⁸¹

Me qëllim të hetimit të ankesës së Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës, më 24 mars 2011, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit u takuan me Kryeshefin Ekzekutiv të Entit të Statistikave të Kosovës dhe u kërkua që gjatë regjistrimit të mos bëhet pyetja bazë "Cili është besimi Juaj fetar", por "Sipas Kushtetutës së Kosovës, ju mund të zgjidhni "për ose jo" deklarinimin fetar".¹⁸²

Pas sqarimit të ankesës Kryeshefi Ekzekutiv in Entit të Statistika të Kosovës ishte i mendimit se pyetja e 10 nuk është e formuluar më së miri dhe se ndryshimet në formular janë të pamundshme, pasi ata janë shtypur, por premtoi se vërejtjet e AP lidhur me pikën 10 janë të pranueshme dhe se gjatë trajnimit me regjistruerit, ata do të udhëzohen që pyetja do të bëhet sipas kërkesës së AP gjatë regjistrimit.

Avokati i Popullit, pas analizimit dhe hetimit të ankesës, konstatoi se pyetja e 10 (dhjetë) bazë e formularit të regjistrimit, nuk është e formuluar mirë, është mjaftë sugjestive dhe nuk përkon me Ligjin për Liritë Fetare, se formulimi i tillë apriori krijon situatën se personi posedon domosdoshmërisht një fe dhe se duhet ta deklarojë atë te regjistruerit.

Rekomandime

- *Avokati i Popullit rekomandon, plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/l-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës si dhe Ligjit nr. 04/l037 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, lidhur me miratimin e akteve nënligjore me të cilën do të rregullohet çështja e përdorimit të simboleve fetare në institucionet publike të arsimit, po ashtu do të qartësohet qëndrimi institucional.*
- *Avokati i Popullit rekomandon Kuvendin e Kosovës, të miratojë normat ligjore, me të cilat do të rregullohej pozita juridike e bashkësive fetare në Kosovë.*

¹⁸⁰ <http://www.assembly-kosova.org/>, 9.12.2011 g.

¹⁸¹ Rasti Nr. 60/20111.

¹⁸² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 38,2 dhe neni 40.

2.16. Liria e shprehjes

Besimi në vlerat e demokracisë, paqes dhe drejtësisë, hap rrugën për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në secilën shoqëri. Liria e shprehjes është një nga liritë thelbësore të njeriut dhe nuk është vetëm qëllim në vetvete, por gjithashtu luan një rol substancial në mbrojtjen e të drejtave të tjera.

Në Republikën e Kosovës liria e shprehjes është e garantuar me nenin 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.¹⁸³ Liria e shprehjes i njej të drejtën secilit për të kërkuar, marrë apo shpërndarë informacion, mendim apo mesazh tjetër pa u penguar.

Sipas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, *“Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti qoftë, pa marrë parasysh kufijtë.”*¹⁸⁴ Pa lirinë e shprehjes nuk mund të mendohet dhe as të pretendohet që një vend është i lirë dhe demokratik. Proceset dhe zhvillimet shoqërore e politike nuk mund të mendohen pa lirinë e shprehjes.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mbron *“Lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë”*.¹⁸⁵

Në anën tjetër shtetit i legjitimohet e drejta e kufizimit dhe sanksionimit sipas ligjit kur kjo është e nevojshme *“... Në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”*¹⁸⁶

Pikëtakimi i të drejtës së lirisë së shprehjes me të drejta të tjera shpeshherë bëhet objekt debatesh, por gjithashtu e bën më komplekse ndarjen e drejtësisë. Autoritetet duket se më shumë e trajtojnë këtë të drejtë si çështje të kompetencës së tyre, sesa si një nga të drejtat themelore.

Mediet janë burimi kyç i informacionit, por në rastet kur mungon pavarësia e tyre ekonomike, kur ekzistojnë paqartësi ligjore, mungesë ligjesh apo aktesh nënligjore, si dhe mosrespektim të ligjeve relevante, liria e shprehjes me qëllim informacionin e publikut vihet në dilemë.

Mekanizmat ligjorë në fuqi në Republikën e Kosovës, në shumicën e rasteve nuk përmbajnë dispozita ndëshkuese për mosrespektimin e të drejtave në këtë fushë.

Avokati i Popullit konstaton se KEDNJ, inkurajon të gjitha vendet të promovojnë të drejtat e njeriut, duke aprovuar instrumente specifike nacionale që japin mbrojtje shtesë, duke përfshirë edhe marrëveshjet ndërkombëtare.

¹⁸³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë 2008, neni 40.

¹⁸⁴ Universal Declaration of Human Rights, <http://www.ohchr.org>

¹⁸⁵ Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore, neni 10, paragrafi 1. <http://www.echr.coe.int>.

¹⁸⁶ Po aty, paragrafi 2

Gjatë kësaj periudhe raportuese në Institucionin e Avokatit të Popullit është parashtruar vetëm një ankesë kundër komunës së Prishtinës,¹⁸⁷ lidhur me moslejimin e qytetarëve, shoqërisë civile, si dhe mediave për pjesëmarrje në takimet e Komitetit, e që ka të bëjë me shkeljen e së drejtës në lirinë e shprehjes, e cila është në proces të shqyrtimit.

2.17. E drejta e qasjes në dokumente publike

Ndër parimet më të rëndësishme në botën demokratike njihet qeverisja e përgjegjshme dhe ajo funksionale. Qeverisje të përgjegjshme mund të ketë vetëm kur kjo bëhet transparente. E një ndër levat më të rëndësishme të transparencës është informimi dhe qasja në dokumentet publike, të cilat krijohen, grumbullohen, përpunohen, ruhen ose mbahen nga autoritetet publike.

Informatat që mbahen nga institucionet publike janë informacione publike dhe organi publik që i mbanë ato është vetëm një kujdestar i përkohshëm i këtyre informatave. Transparenca dhe llogaridhënia duhen të jenë parime udhëheqëse si për pushtetin qendror ashtu edhe atë lokal. Këto dy komponente të rëndësishme të mirëqeverisjes janë edhe pikësynime kryesore të akteve mbi lirinë e informimit. Pikënisje për të drejtën për të pasur qasje në informacion, e në këtë kuadër edhe për të pasur qasje në dokumentet publike, është Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), e cila çdo personi i njeh, veç tjerash edhe “[...] lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me gfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë”.¹⁸⁸

E drejta për qasje në dokumente publike në Republikën e Kosovës është e rregulluar me ligj. Sipas legjislacionit në fuqi, kërkuesi i informatave apo dokumenteve publike nuk ka nevojë që të arsyetojë kërkesën për pasur qasje në dokumente publike.¹⁸⁹ Organi apo institucioni publik nga i cili kërkohen dokumentet është i obliguar të ofrojë ato, ndërsa në rast se dokumentet apo informatat nuk ofrohen, atëherë refuzimi duhet të arsyetohet.¹⁹⁰ Madje, edhe në rastet kur kërkesa nuk është e qartë, kjo nuk mund të jetë bazë për refuzim. Në këtë rast, institucioni publik ka për obligim që të kërkojë nga kërkuesi i dokumentit që ta precizojë kërkesën.¹⁹¹ Kjo barrë e kërkesës për precizim bie mbi institucionet, për shkak se ato kanë njohuri më të plota për dokumentet që mbajnë, ndërsa sqarimi i kërkesës thjeshtëson punën.

Ligji për Qasje në Dokumente Publike (LQDP) parasheh një procedurë gjithëpërfshirëse dhe të unifikuar të qasjes në dokumente publike. LQDP në analogji me KEDNJ, përcaktojnë arsyet e refuzimit për qasje në dokumente publike. Sipas kësaj, qasja në dokumente publike mund t’i nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve dhe kushteve të cilat parashikohen me ligj dhe

¹⁸⁷ Rasti nr. 223/2009, Iniciativa për Progres INPO kundër Komunës së Prishtinës.

¹⁸⁸ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Neni 19.

¹⁸⁹ Ligji për Qasje në Dokumente Publike nr. 03/1-215, Neni 6, paragrafi 2 ” Kërkuesi i ndonjë dokumenti nuk është i obliguar që të japë arsye për të pasur qasje në dokumente”.

¹⁹⁰ Ligji për Qasje në Dokumente Publike, Neni 13 paragrafi 2, “Institucioni publik i cili refuzon qasjen në dokumentin në tërësi, apo pjesërisht, duhet të japë arsye mbi refuzimin. Kërkuesi ka të drejtë, që pas parashtrimit të kërkesës, të marrë aktvendim të arsyetuar me shkrim, nga ai institucion publik, përkitazi me refuzimin”.

¹⁹¹ Ligji për Qasje në Dokumente Publike, Neni 6, paragrafi 3, “Nëse kërkesa nuk është sa duhet e saktë, institucioni publik kërkon nga kërkuesi që ta qartësojë kërkesën dhe i ndihmon kërkuesit që ta bëjë këtë”.

të cilat janë të domosdoshme për mbrojtjen e interesave që përmenden në KEDNJ.¹⁹² Një hap të rëndësishëm në këtë drejtim ligjvënësit kosovarë kanë bërë me qartësimin e konceptit *informacioni i klasifikuar*, duke e kategorizuar informacionin e klasifikuar në katër kategori: “tepër sekret”, “sekret”, “konfidenciale” dhe “e kufizuar”.¹⁹³ Edhe pse për zbatimin e këtij ligji janë miratuar aktet nënligjore përkatëse,¹⁹⁴ në praktikë ka ende paqartësi rreth asaj se cilat dokumente duhet të klasifikohen dhe kush do të jetë autoriteti, i cili bënë klasifikimin e tyre.

Numri i ankesave për shkak të refuzimit të qasjes në dokumente publike në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) është relativisht i vogël. Gjatë vitit 2011 janë pranuar vetëm 10 ankesa të kësaj natyre, pjesa më e madhe e tyre nga gazetarë dhe anëtarë të shoqërisë civile. Një qytetar për të qenë në gjendje që t’i mbrojë të drejtat e tij, në rend të parë, do të duhet të jetë i informuar mirë për dhe me to. Ky numër simbolik i ankesave është një tregues se qytetarët nuk janë mirë të informuar në lidhje me këtë të drejtë.

Disa organizata të shoqërisë civile, siç janë GAP, Lëvizja Fol etj. kanë organizuar fushata sensibilizuese, qoftë përmes ngritjes së zërit, për zbatimin e ligjit në media apo edhe me paraqitjen e shqetësimeve të tyre, duke marrë pjesë në mbledhje të komisioneve të Kuvendit.

Edhe pse me hyrjen në fuqi të LQDP janë shfuqizuar dispozitat e ligjit paraprak për Qasje në Dokumente Zyrtare nr. 2003/12, janë evidentuar edhe raste kur institucionet kanë vazhduar me aplikimin e dispozitave të ligjit të vjetër.

Mungesa e njohurive për dispozitat e ligjit, në njërën anë dhe mungesa e gatishmërisë për të zbatuar ligjin, në anën tjetër, rezulton me shkeljen e të drejtës për qasje në dokumente publike.¹⁹⁵ Mungesa e njohurive të qytetarëve mbi konceptin e lirisë së informimit dhe në veçanti për të drejtën për qasje në dokumente publike që mbahen nga institucionet, mbetet sfida.

Vazhdon të mbetet problematike jotransparenca e institucioneve në raport me gazetarët. “Shëtitja” e tyre nga një drejtori në tjetrën apo edhe premtimi se do t’iu dorëzohet një dokument i kërkuar, i cili nuk iu dorëzohet asnjëherë, është krijuar si rregull i komunikimit me ta. Edhe kur një dokument i tillë iu ofrohet, ai iu ofrohet me shumë vonesë, kur edhe rëndësia e informimit humbet, prandaj edhe vet gazetarët nuk janë më të interesuar për atë dokument. Kjo formë e punës vetëm sa vështirëson gjithçka.

Në njërën nga ankesat e pranuar në IAP, një organizatë joqeveritare, e interesuar që ta ketë në dispozicion një dokument publik, kishte parashtruar kërkesë institucionit përkatës. Por,

¹⁹² Neni 10, paragrafi 2 i KEDNJ “*Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, Sistemi i klasifikimit të Informacioneve në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial së sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor*”.

¹⁹³ Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë Nr. 03/L-178 Gazeta Zyrtare nr. 76, 10.8. 2010.

¹⁹⁴ Rregullorja nr. 17/2011 për Klasifikimin dhe Deklasifikimin e Informacioneve si dhe Rregullorja nr. 18/2011 për Shpërndarjen dhe Transferimin e Informacioneve të Klasifikuara.

¹⁹⁵ Rasti nr. 473/2011, i regjistruar në IAP, ku ankuesit i ofrohet qasje e pjesshme në një dokument publik duke iu referuar Ligjit të vjetër.

edhe pse zyrtari kryesor menaxhues i këtij institucioni, me vendim e kishte lejuar qasjen në këtë dokument, kërkuesi i atij dokumenti nuk arriti asnjëherë ta kishte në posedim atë, edhe pse disa herë të tjera kishte kontaktuar përmes telefonit. Përveç premtimeve se së shpejti do t'i dorëzohej ai dokument, kërkuesi nuk kishte arritur asnjëherë ta realizojë të drejtën e vet.

Shumë persona, kërkues të dokumenteve publike, vendosin të dorëzohen në betejën për lirinë e informimit. Nga informacionet që posedon IAP, vetëm dy raste kanë përfunduar në gjykatë. Dhe kur një rast përfundon në gjykatë, bazuar në ngarkesën e gjykatave me raste të papërfunduara, do të thotë edhe vite të tëra pritje për të marrë vendimin e saj. Kjo gjendje dekurajuese e shtynë kërkuesin e një dokument që përfundimisht të tërhiqet nga kërkesa, pa marrë asnjëherë përgjigje.

Në disa raste edhe vetë ligjshmëria e një dokumenti publik është vënë në pikëpyetje. Më 15 nëntor 2011, Avokati i Popullit publikoi një raport me rekomandime në të cilin ka ngritur shqetësimin se si një dokument publik (Rregullorja për trajtimin e ndërtimeve pa leje), i miratuar më herët nga komuna e Prishtinës, nuk i është nënshtruar vlerësimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, edhe pse ka shkaktuar pasoja juridike për një numër të madh të qytetarëve.¹⁹⁶ Edhe pse IAP iu ka rekomanduar tri institucioneve (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunës së Prishtinës) të marrin masa në këtë drejtim, Avokati i Popullit mori përgjigje vetëm nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e cila aspak nuk përkiste me realitetin, ndërsa dy institucionet e tjera i injoruan në tërësi rekomandimet. Ato nuk i kthyen përgjigje asnjëherë IAP-së, edhe pse kanë obligim kushtetues dhe ligjor.¹⁹⁷ Refuzimi apo dështimi për t'iu përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit konsiderohet pengim i punës së Avokatit të Popullit. Për pengim të punës së Avokatit të Popullit janë të parapara sanksionet ligjore, por të cilat nuk zbatohen asnjëherë nga institucionet dhe autoritetet publike.¹⁹⁸

Edhe pse Ligji për Qasje në Dokumente Publike parasheh nxjerrjen e akteve nënligjore nga Ministria e Financave, për caktimin e tarifave, të cilat do të ishin unike për të gjitha institucionet, një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur.¹⁹⁹ Kjo zbrazëti juridike lë mundësinë për interpretim dhe caktim të tarifave, sipas dëshirës së institucionit të cilit i drejtohet kërkesa.

¹⁹⁶ Raport me rekomandime datë 15 nëntor 2011, *Ankesa nr. 235/2011 dhe ankesa nr. 233/2011*.

¹⁹⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 3 “Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtetin legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i praqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj.” Neni 26 i Ligjit për Avokatin e Popullit “Organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për masa disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

¹⁹⁸ Ligji për Avokatin e Popullit, Neni 23 paragrafi 2 “Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”.

¹⁹⁹ Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike “Tarifat për shpenzimet e prodhimit dhe dërgimit të kopjes së dokumenteve rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga ministria përkatëse për financa dhe janë unike për të gjitha institucionet publike”.

Rekomandime

- *Të shtohen fushatat dhe aktivitetet për ngritjen e vetëdijes së zyrtarëve përgjegjës të institucioneve dhe qytetarëve për qasjen e papenguar në dokumente publike, përmes fushatave informuese (fushatë mediale, fletëpalosje etj.).*
- *Të hartohet procedurë e përshpejtuar gjyqësore, për rastet që kanë të bëjnë me qasjen në dokumente publike.*
- *Institucionet publike duhet të jenë më të hapura dhe më azhure ndaj kërkesave për qasje në dokumentet publike. Transparenca është gurthemeli i një shoqërie demokratike dhe kusht për luftimin e korrupsionit dhe abuzimin me pushtetin.*
- *Ministria e Financave të nxjerrë aktet nënligjore, për caktimin e tarifave në përputhje, me detyrimet që dalin nga Ligji për Qasje në Dokumente Publike.*

2.18. Liria e mediave

Baza juridike e lirisë së mediave në Republikën e Kosovës është e rregulluar në mënyrë të veçantë me Kushtetutë. Megjithatë garantimi ligjor nuk e zvogëlon dilemat e vazhdueshme të shoqërisë dhe mekanizmave mbikëqyrës të të drejtave dhe lirive të njeriut nëse mediat vërtetë janë të lira në transmetimin e informacionit të saktë, në mënyrë të besueshme e të pavarur.

Edhe pse Kushtetuta ndalon censurën e mediave dhe pengimin e shpërndarjes së informacionit ose të ideve nëpërmjet mediave, duke përjashtuar rastet kur një gjë e tillë është e domosdoshme për rastet që specifikohen në Kushtetutën e Republikës së Kosovës,²⁰⁰ ankesat e vazhdueshme të gazetarëve të shprehura publikisht paraqesin shqetësim për Avokatin e Popullit.

Gjithashtu, për Avokatin e Popullit, shqetësim paraqet edhe publikimi i informatave nëpër medie që cenon jetën private të individëve si dhe informatat jo të plota, të pasakta apo publikimi i informatave të pavërteta. Ashtu siç liria e mediave e mban një shoqëri të informuar dhe një demokraci të shëndetshme, respektimi i të drejtave dhe lirive individuale nga ana e medieve është thelbësore në krijimin e besimit në media të besueshme dhe të pavarura.

Në demokratizimin shoqërisë mediat e lira kanë një rol të veçantë. Për këtë arsye një prej çështjeve që vazhdimisht është ngritur në raportet e ndryshme të institucioneve dhe organizatave vendore e ndërkombëtare për Kosovën është pavarësia e mediave, si dhe infrastruktura ligjore e lirisë së tyre.

Lidhur me këtë, edhe Avokati i Popullit vëren mospërputhjet mes Ligjit mbi Shpifjen dhe Fyerjen²⁰¹ dhe neneve 37 dhe 38 të Kodit Penal të Kosovës²⁰² dhe se çështja e pasigurisë ligjore, lidhur me përfshirjen e shpifjes dhe fyerjes në Kodin Penal krijon zbrastëti juridike.

²⁰⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 107.

²⁰¹ Ligjit mbi Shpifjen dhe Fyerjen, neni 83.

²⁰² http://www.md-ks.org/repository/docs/KODI_pENAL.pdf

Nenet e cekura të Kodit Penal të Kosovës janë po ashtu në kundërshtim edhe me nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Përveç zbrazëtisë juridike dhe mungesës së pavarësisë adekuate të mekanizmave, si Komisioni i Pavarur për Media (KPM), Avokati i Popullit, është shumë i shqetësuar edhe me rastet e ushtrimit presionit dhe të dhunës ndaj gazetarëve.

Institucionet ndërkombëtare, në raportet e veta, në veçanti evidentojnë mungesën e lirisë së mediave. Sipas institucionit vëzhgues me qendër në SHBA, Freedom House,²⁰³ Kosova renditet e 104-ta nga 196 vende për lirinë e shtypit, duke e cilësuar atë vetëm si "pjesërisht të lirë" (maj 2011).

Kjo radhitje është një dëshmi tjetër dhe pasqyrë e qartë, se si shihet Republika e Kosovës nga komuniteti ndërkombëtar në këtë fushë.

Ndërkaq, Komisioni Evropian, në Raportin e Progresit 2011 për Kosovën,²⁰⁴ lidhur me lirinë e mediave konstaton: *“Edhe pse janë marrë masa për të shuar mospërputhjet mes Ligjit mbi Shpifjen dhe Fyerjen dhe Kodit Penal të Kosovës, amendamentimet duhet të miratohen urgjentisht. Megjithëse raportet shpallin mjedis të përmirësuar të lirisë së shprehjes, gazetarët vazhdojnë të përballen me kufizime në raportimin e tyre. Rastet e frikësimit, abuzimit, ngacmimit të gazetarëve, madje dhe sulmet fizike kanë vazhduar. Akte të tilla nuk janë dënuar fuqimisht nga institucionet kosovare dhe ka pasur raste kur janë kryer nga zyrtarë të qeverisë. Për më tepër, Qeveria vazhdon të ruajë rolin e saj dominues në media që e mban përmes reklamimit, të cilin e përdor si mjet për të kontrolluar informacionin. Gjithashtu, pavarësia dhe paanshmëria e RTK-së është një çështje që ende nuk është adresuar.”*²⁰⁵

Nga ana tjetër, Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, pas një takimi me një delegacion të SEEMO (Organizata e Mediave të Evropës Juglindore), ka vlerësuar se liria e shprehjes, liria e medias dhe liria e shtypit janë karakteristikë themelore e shoqërisë demokratike, duke theksuar se: *“Kosova në këto vite ka arritur shkallë të lartë të zhvillimit të të gjitha mediave”*²⁰⁶

Mungesa e fondeve dhe investimeve për përkrahje e mediave i ka lënë gazetatat në një poezitë të palakmueshme ekonomike dhe të dobësuar përballë presionit politik dhe grupeve të veçanta të interesit, të cilat kërcënojnë se do i tërheqin reklamat nëse mediat nuk janë në favor të tyre.

Nga 101 gazetarë pjesëmarrës në sondazh, 47 e përshkruan lirinë e mediave, si "të keqe", 13 "shumë të keqe" dhe 38 "të mirë". Vetëm tre thanë se ajo është "shumë e mirë". Krahasuar me vitet e tjera, gjendja sipas gazetarëve sa vjen e rëndohet.²⁰⁷

²⁰³ <http://www.freedomhouse.org/regions/central-and-eastern-europeeurasia>

²⁰⁴ http://mei-ks.net/repository/docs/Raporti_i_Progresit_per_Kosoven_2011_-_Shqip.pdf

²⁰⁵ Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë, 'Tkurrrja e Hapësirës Publike? Qeverisja dhe Shprehja e Lirë në Kosovë', 24 maj 2010, që gjendet në ks.yihr.org/en/article/8/State-of-Constriction-report lexuar më 27/09/2011

²⁰⁶ Njoftim të presidencës 24 nëntor 2011.

²⁰⁷ www.evropaelire.org/content/article/24361101

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK)²⁰⁸ është një trup vetërregullativ, i formuar për dhe nga sektori i mediave të shkruara. Misioni i tij mbështetet mbi parimet e kodit të mirësjelljes.

Baza e veprimit të KMSHK, është fjala e lirë, e drejta e qytetarëve për t'u informuar plotësisht, me kohë dhe respektimi në tërësi i kodit etik të gazetarisë.

KMSHK, në periudhën e raportimit ka shqyrtuar shumë ankesa lidhur me shkeljet e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës, për fyerje apo gënjeshtër, si dhe nxitje të gjuhës së urrejtjes apo mohim të së drejtës për përgjigje publike.

Avokati i Popullit e vlerëson gjendjen si jo të kënaqshme edhe sa i përket informimit dhe mediave në gjuhën e komuniteteve.

Në mediat e komuniteteve, mungojnë mediat e shkruara në gjuhën turke dhe boshnjake, po ashtu edhe romë.

Ekziston nevoja për zgjerimin e emisioneve dhe forcimin e kuadrit të programeve në transmetuesin publik- RTK-në, si dhe zhvillimin e mediave të shkruara në gjuhën e komuniteteve - turke dhe boshnjake, po ashtu edhe romë.

Mundësitë e kufizuara të shprehjes së lirë për komunitete, tregojnë për nevojën që edhe në mediat e shkruara dhe elektronike në gjuhën shqipe, të jepet më shumë hapësirë për jetën dhe për problemet me të cilat ballafaqohen komunitetet, që do të të kontribuonte në identifikimin dhe evitimin e problemeve, në drejtim sa më shpejtë të integritetit të tyre në shoqëri.

Situata e përgjithshme sidomos ekonomike në Kosovë, shprehet edhe në situatën e përgjithshme të mediave, e në veçanti mediave të komuniteteve. Për këtë arsye, mediat e komuniteteve kanë më shumë nevojë për përkrahje e institucionale.

Nga Fondi i krijuar qeveritar për përkrahjen e mediave të komuniteteve, në vlerë prej afër 180 mijë euro për vitin 2011, vetëm gjysma është ndarë në fund të vitit, e cila nga përfaqësuesit e mediave të komuniteteve është vlerësuar tepër e pakët.

Nga ana tjetër, duhet nënvizuar, sidomos gjendjen absolutisht të papranueshme dhe të keqe të mediave për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas.

Avokati i Popullit konstaton se respektimi i plotë i lirisë së mediave është thelbësor për funksionimin e demokracisë, si dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Liria e mediave është gjithashtu çështje kyçe për të siguruar që qytetarët të kenë rolin aktiv në sigurimin e paqes dhe të proceseve demokratike.

Avokati i Popullit kërkon nga institucionet relevante që të përgatitet një strategji për krijimin e hapësirës së nevojshme, për përmirësimin e lirisë së mediave.

Çështja e financimit të transmetuesit publik RTK vazhdon të jetë një çështje e ndjeshme dhe kërkon vëmendje të vazhdueshme të autoriteteve përkatëse. Po kështu duhet të bëhet harmonizimi i Ligjit për RTK-në me Ligjin për KPM-në, sipas standardeve evropiane.²⁰⁹

²⁰⁸ www.presscouncil-ks.org/

²⁰⁹ www.kpm-ks.org/materiale/dokument/1304587848.809.pdf

Lidhur me këtë edhe Unioni i Transmetuesve Evropian (EBU) ka deklaruar rëndësinë e rregullimit të çështjes së financimit të mediumit publik.²¹⁰

Avokati i Popullit, konsideron se një prej njësive matëse të zhvillimit të nivelit demokratik të Republikës së Kosovës është liria e shprehjes dhe e mediave. Si e tillë, ajo do të jetë vazhdimisht edhe njëra nga aspektet e vlerësimit të organizmave ndërkombëtarë, në të cilat Kosova synon të jetë anëtare.

Prandaj, është shumë e nevojshme të ketë iniciativë parlamentare për të debatuar dhe vlerësuar gjendjen e lirisë së mediave në Kosovë.

Gjatë periudhës së raportimit, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk ka regjistruar raste të veçanta në lidhje me nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Por, në të njëjtën kohë, duhet të ceket se nga përfaqësuesit e mediave gjatë periudhës së raportimit në IAP nuk ka pasur paraqitje të rasteve, lidhur me shkeljen e të drejtës për media të lira.

Bazuar në të gjithë atë që u tha më sipër në lidhje me lirinë e mediave, Avokati i Popullit **rekomandon:**

- *Zbatimin e plotë të Ligjit civil kundër shpifjes dhe fyerjes (Ligji Nr. 02/L-65).*
- *Një rivlerësim të Kodi Penal të Kosovës përkatësisht të neneve lidhur me lirinë e mediave, nenet 37 dhe 38.*
- *Respektimin e parimeve të mediave të lira dhe lirinë e gazetarëve gjatë ushtrimit të detyrës.*
- *Harmonizimin e Ligjit për RTK-në dhe Ligjit për KPM-në të, me standardet evropiane.*
- *Ofrimin e përkrahjes më të madhe financiare për mediat e komuniteteve nga organet shtetërore.*

2.19. Liria e tubimit

Liria e tubimit sikurse edhe liritë dhe të drejtat tjera të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (KRRK),²¹¹ është në harmoni me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.²¹²

²¹⁰ www.assembly-kosova.org/common/docs/.../trans_s_2011_05_05_10_al.pdf

²¹¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 4,3: “Liria e tubimit paqësor është e garantuar. Secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to. Këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse është e domosdoshme për të siguruar rendin publik, shëndetin publik, sigurinë kombëtare, ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve”.

²¹² Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Neni 11: “Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor, ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të

Gjatë kësaj periudhe raportuese në Kosovë janë organizuar një varg protestash. Në disa prej protestave situata ka dalë jashtë kontrollit dhe ka intervenuar policia. Gjatë intervenimeve të policisë, në raste të caktuar ka pasur edhe përdorim të forcës, si nga policia, ashtu edhe nga protestuesit.

Në një rast, Institucioni i Avokati i Popullit (IAP) ka hapur hetime, sipas detyrës zyrtarë (*ex-officio*), por edhe ka pranuar një ankesë nga aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje, të cilët pohojnë se gjatë protestës së organizuar më 12 maj 2011, para ndërtesës së qeverisë, pjesëtarët e Policisë së Kosovës kishin përdorur dhunë ndaj protestuesve, me ç'rast disa nga aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje ishin arrestuar. Po ashtu, edhe mediat kishin raportuar se nga një protestë paqësore situata ishte përshkallëzuar në protestë të dhunshme, ku përveç dëmeve materiale, kishte edhe me dhjetëra policë dhe protestues të lënduar. Pas protestës, përfaqësuesit e IAP vizituan Qendrën Korrektuese në Lipjan dhe biseduan me dy nga të arrestuarit, pasi personat e tjerë të arrestuar në protestë ishin liruar nga arresti.²¹³

Nga kjo vizitë, përfaqësuesit e IAP-së nuk vërejtën se ndaj këtyre dy aktivistëve ka pasur përdorim të forcës. Mirëpo, në deklaratat e tyre ata pohuan se dhuna ishte përdorur ndaj disa personave të tjerë të arrestuar gjatë protestës, të cilët tani ishin liruar nga arresti.

Me qëllim të informimit të mëtejshëm, IAP kontaktoi me Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), lidhur me veprimet që ishin ndërmarrë apo që priteshin të ndërmerreshin, lidhur me rastin e lartpërmendur. IPK, në përgjigjen drejtuar Avokatit të Popullit, njofton se për rastin e lartpërmendur kishte hapur hetime dhe kishte ardhur në përfundim se në rastin e protestës së lartpërmendur nuk kemi të bëjmë me shkelje të rëndë disiplinore dhe për këtë arsye lënda i është kaluar Njësisë së standardeve profesionale, në kuadër të Policisë së Kosovës.

IAP, deri më tani nuk ka pranuar ndonjë informatë shtesë nga ana e IPK apo nga Njësia e Standardeve Profesionale për ecurinë e hetimeve lidhur me këtë rast.

Në një rast tjetër, disa nga veteranët e Luftës së UÇK-së kishin filluar të protestonin dhe të kërkonin realizimin e të drejtave të tyre, me kërkesën kryesore për miratimin e ligjit për vlerat e luftës. Pas disa ditë proteste, para objektit të qeverisë, veteranët e luftës së UÇK-së hynë në grevë, e cila vazhdoi disa ditë me radhë.

Në ditën e 9-të të protestës dhe pas ditës së dytë të grevës së urisë nga të njëjtët, Avokati i Popullit me bashkëpunëtorë, më 31 maj 2011, vizitoi veteranët e luftës, të cilët protestonin para ndërtesës së qeverisë, ku kishin ngritur edhe një çadër fushore, si shenjë pakënaqësie e trajtimit që po iu bëhej nga institucionet publike.

Avokati i Popullit shprehu shqetësimin e tij për shëndetin që po u rrezikohej grevistëve dhe apeloj te organet kompetente (Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës), që në periudhë sa më të shkurtër të ndërmarrin masat e duhura për të miratuar ligjin dhe që gjatë miratimit të tij të merren parasysh edhe vërejtjet dhe kërkesat e veteranëve të luftës.²¹⁴

Një çështje tjetër që ka të bëjë me lirinë e tubimit, e cila është trajtuar nga IAP, edhe në raportet e kaluara, ka të bëjë me Ligjin për tubimet publike.

drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarët të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës”.

²¹³ Raporti nga vizita zyrtare në Qendrën Korrektuese në Lipjan më 7 shtator 2011.

²¹⁴ Komunikata për media e Institucionit të Avokatit të Popullit, 31 maj 2011.

Sa i përket këtij ligji, Avokati i Popullit përsërit se neni 12.3 përmban elemente që konsiderohen të mos jenë në përputhje me parimet e nenit 11 të KEDNJ-së dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), që paraqet detyrimisht bazën e interpretimit të të drejtave në Kosovë.

Neni 12 i Ligjit për tubimet publike e lë një pjesë të kompetencave në duart e të ashtuquajturve “kujdestarë”, që caktohen *ad hoc* nga vetë organizatori i tubimit, ndërsa GJEDNJ potencon se detyrim ligjor i shtetit është veprimi aktiv për mbrojtjen e personave që organizojnë dhe marrin pjesë në tubim. Po ashtu, në një rast tjetër, GJEDNJ tërheq vërejtjen se liria efektive për një tubim paqësor nuk mund të pretendohet, vetëm nëse shteti i ka përmbushur detyrimet e tij, duke mos ndërhyrë, por në rast nevojë kërkon të merren masa pozitive, qoftë edhe në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet individëve, madje edhe të vetë protestuesve.²¹⁵

Avokati i Popullit, edhe një herë rithekson se pika 3 e nenit 12 të Ligjit për tubimet publike, sipas së cilës detyrimi ligjor që ligjvënësi ia delegon “kujdestarit” të një tubimi “*ta kapë dhe ta dorëzojë te policët pjesëmarrësin ose personin tjetër që qarkullon pranë vendit të tubimit publik, nëse i prish rendin, qetësinë, nëse mban armë ose objekte të rrezikshme, ose shenja të ndaluara*”, janë detyrim ekskluziv i organeve shtetërore të rendit dhe nuk mund të delegohet te asnjë person tjetër juridik ose fizik.

Avokati i Popullit rekomandon që neni i lartpërmendur i Ligjit për tubimet publike të kthehet në plotësim dhe ndryshim, në mënyrë që të harmonizohet me standardet evropiane.

Avokati i Popullit konsideron se gjatë vitit 2011, qytetarët e Kosovës, grupet e ndryshme të interesit dhe shoqëria civile, këtë të drejtë kushtetuese dhe ligjore e kanë realizuar me organizimin e një varg protestash. Po ashtu, mund të thuhet se në shumicën e rasteve të tilla Policia e Kosovës e ka kryer detyrën e saj në përputhje me ligjin dhe nuk ka pasur shkelje të së drejtës për tubim paqësor.

2.20. Liria e asociimit

Liria e asociimit është e garantuar më Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Garancitë që ofron neni 44 i Kushtetutës²¹⁶ janë në harmoni të plotë me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, siç është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.²¹⁷

Avokati i Popullit në raportin e vitit të kaluar kishte rekomanduar që gjatë procesit të shqyrtimit të amandamentimit të *Ligjit për lirinë e asociimit* në organizata joqeveritare Kuvendi i Kosovës, respektivisht komisionet parlamentare të marrin parasysh vërejtjet dhe

²¹⁵ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*Vendimi i datës 21 qershor 1988, Aplikacioni nr. 10126/82*).

²¹⁶ Neni 43 Kushtetuta e Republikës së Kosovës: „1. Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate. 2. Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet me ligj për kategori të veçanta të punonjësve. 3. Organizatat ose aktivitetet që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirivedhe të drejtave të njeriut, ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente.“

²¹⁷ Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtat e Njeriut, Neni 11.

sugjerimet e dala nga shoqëria civile, në mënyrë që plotësimet dhe ndryshimet e bëra në ligj të jenë transparente dhe që ligji të jetë në harmoni me standardet evropiane.

Është për t'u vlerësuar lart që në procesin e amandamentimit shoqëria civile ishte treguar vigjilente dhe e vendosur në kërkesat e saj. Përmes ekspertizës profesionale të ofruar, shoqëria civile evitoi disa defekteve të cilat do të rrezikonin kredibilitetin e sektorit joqeveritar në Kosovë dhe që ishin në kundërshtim me parimet ndërkombëtare.

Ligji për Lirinë e asociimit në OJQ u miratua nga Kuvendi i Kosovës, në gusht të vitit 2011²¹⁸ dhe paraqet avancim përmbajtësor, në krahasim me versionin paraprak të tij, i cili ishte miratuar në shkurt të vitit 2009. Ky ligj tani përmban dispozita më të favorshme dhe më të qarta sa i përket qeverisjes së brendshme të OJQ-ve, statusit për përfitim publik, obligimeve për raportim të OJQ-ve, si dhe bashkëpunimit në mes të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës dhe OJQ-ve të regjistruara në bazë të këtij ligji.

Në aspektin kushtetues dhe ligjor, liria e asociimit në Kosovë është e garantuar mirë dhe ushtrohet pa ndonjë problem evident. Megjithatë, në një shoqëri demokratike nuk mjafton vetëm qasja pasive ndaj ushtrimit të kësaj të drejte. Në këtë drejtim, në Kosovë mungon një qasje inkurajuese dhe proaktive e institucioneve publike për të motivuar lirinë e asociimit dhe pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje.

Konkretisht, probleme vërehen në disa nivele praktike të ushtrimit të kësaj të drejte, duke filluar nga qasja në informata dhe dokumente publike; këshillimet me grupet e interesit dhe sidomos të shoqërisë civile dhe gjatë draftimit të ligjeve dhe mungesës së një dialogu të strukturuar dhe të vazhdueshëm mes institucioneve shtetërore dhe të shoqërisë civile.

Kjo ka ardhur si pasojë e faktit se deri me tani, shumica e dispozitave ligjore që e rregullojnë pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje kanë qenë jo obligative, dhe përfshirjen eventuale të qytetarëve dhe shoqërisë civile e kanë lënë në duar të vullnetit politik të zyrtarëve të institucioneve të ndryshme.

Rregullorja e Punës e Kuvendit u lejon komisioneve të kuvendit të mbajnë dëgjime publike dhe të ftojnë ekspertë dhe përfaqësues të OJQ-ve në takimet e tyre. Mirëpo, kjo dispozitë nuk është obligative, prandaj edhe zbatimi i saj varet nga vullneti i kryetarit apo anëtarëve të komisionit. Si rrjedhojë, vetëm rreth 30 % e projektligjeve që kalojnë nëpër Kuvendin e Kosovës, diskutohen me publikun.²¹⁹

Në nivel lokal, Ligji për Vetëqeverisje Lokale përmban një numër të madh të dispozitave të cilat mundësojnë pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje, duke përfshirë takimet e kryetarit të komunës me qytetarë, komitetet konsultative, peticionet dhe iniciativat qytetare.²²⁰ Në praktikë shumica e komunave të Kosovës nuk i zbatojnë këto dispozita dhe pjesëmarrja qytetare në nivel lokal mbetet mjaft e ultë.²²¹

Megjithatë, vlen të theksohet dhe është inkurajues fakti se gjatë kësaj periudhe raportuese ka pasur disa raste dhe shembuj të suksesshëm të përfshirjes së OJQ-ve në vendimmarrje, siç janë draftimi i Ligjit për Nisma Legjislative, Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, Ligjit

²¹⁸ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 14, 9 shtator 2011, Prishtinë.

²¹⁹ Raporti i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile "Ne dhe ata" Pjesëmarrja Qytetare në Kosovë, tetor 2011.

²²⁰ Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040.

²²¹ Raporti i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile "Ne dhe ata" Pjesëmarrja Qytetare në Kosovë, tetor 2011.

për Liri të Asociimit në OJQ etj. Mirëpo, në të njëjtën kohë ka edhe raste tjera negative dhe dekurajuese, ku proceset ligjvënëse janë bërë pa përfshirje të shoqërisë civile dhe qytetarëve, me gjithë shprehjen publike të interesit të tyre për pjesëmarrje, siç është rasti i hartimit të Ligjit për Buxhetin e Kosovës, si dhe rasti i draftimit të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit.

Avokati i Popullit vëren se janë bërë hapa inkurajues në krijimin e kornizës së nevojshme ligjore, sa i përket pjesëmarrjes qytetare, mirëpo sfidat me të cilat ballafaqohen autoritetet publike në raport me motivimin e pjesëmarrjes qytetare, mbesin të shumta.

Njëra nga sfidat kryesore që duhet të adresohet është se, nga autoritetet publike në të gjitha nivelet, krahas vullnetit politik, kërkohet krijimi i mekanizmave funksionalë dhe të zbatueshëm për pjesëmarrje qytetare.

Avancimet e fundit të kornizës ligjore rreth këshillimeve publike, duhet të plotësohen me një sistem të përgjithshëm të rregullave dhe mekanizmave konkretë për të gjitha nivelet, duke siguruar që qasja e autoriteteve publike ndaj përfshirjes së qytetarëve të jetë e qëndrueshme, efikase dhe motivuese.

Shoqëria civile duhet të rrisë komunikimin me qytetarë për të motivuar dhe ndikuar në aktivitetin qytetar. Ndërmarrja e aktiviteteve në përputhje me nevojat e identifikuara nga ky komunikim, patjetër se do të ndikonte pozitivisht në ndikimin që organizatat e ndryshme të shoqërisë civile mund ta ushtrojnë në bërjen e politikave publike. Përmes komunikimit dhe aktivitetit qytetar, do të arrihej edhe zvogëlimi i varësisë nga donatorët e jashtëm, që është vetëm njëri ndër hapat e rëndësishëm që kontribuojnë në adresimin e kësaj sfide.

Avokati i Popullit thekson se liria e organizimit është themelore për demokracinë dhe vlerat kushtetuese, një e drejtë e cila kontribuon në zhvillimin e pluralizmit dhe tolerancës në shoqëri. Ekzistenca e marrëdhënieve të forta shoqërore, në mënyrë indirekte i japin një mbështetje suksesit dhe rritjes së ekonomisë.

Prandaj, nisur nga kjo që u tha më lart, Avokati i Popullit rekomandon që autoritetet publike duhet të dëshmojnë vullnet të duhur politik për t'u hapur sinjerisht ndaj kontributit të shoqërisë civile në punën e tyre.

2.21. E drejta e zgjedhjes dhe e pjesëmarrjes

Kushtetuta e Republikës së Kosovës²²² e ka paraparë të drejtën themelore për zgjedhje dhe pjesëmarrjen në zgjedhje si kategori të veten kushtetuese. Në këtë drejtim është miratuar Ligji për zgjedhjet e përgjithshme,²²³ si dhe Ligji për zgjedhjet lokale,²²⁴ i cili është në pajtim me

²²² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 45, pika 1, “Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor”

²²³ Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, nr. 03/L-073.

²²⁴ Ligji për zgjedhjet lokale, nr. 03/L-072.

nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,²²⁵ si dhe me instrumentet e tjera ndërkombëtare, të cilat zbatohen në Kosovë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me rastin e procesit zgjedhor po ballafaqohet me sfida të ndryshme, si në nivelin lokal, ashtu edhe në atë qendror. Viti në të cilin nuk ka pasur zgjedhje për KQZ-në, me gjithë planet e parapara të veprimit, është shfrytëzuar për evidentimin dhe përmbledhjen e procesit të kaluar zgjedhor. Në këtë kuptim KQZ ka organizuar takime dhe seminare me qëllim të analizës së zgjedhje dhe identifikimit të dobësive, të cilat e kanë përcjellë procesin zgjedhor. Institucioni i Avokatit të Popullit, në pajtim me përgjegjësitë e veta ligjore dhe kushtetuese, ka përcjellë zgjedhjet në cilësinë e vëzhguesit dhe ka rekomanduar KQZ-në, që me rastin e rishikimit të rezultateve të punës së vet dhe të ketë vëmendje të posaçme në:

- listën e votuesve,
- votimin familjar,
- mungesa e të kuptuarit të seriozitetit dhe përgjegjësisë së komisioneve të votimit,
- konfuzioni në gjetjen emrave dhe vendin e votimit.

Qëllimi i çdo komisioni zgjedhor është organizmi i zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike. Një prej kriterëve të cilat ndikon në besimin e votuesve është lista zgjedhore. Sa më azhure të jetë lista zgjedhore aq më i madh do të jetë besimi i qytetarëve.

Në këtë aspekt KQZ ka organizuar gjatë këtij viti jozgjedhor trajnime me temën për avancimin e listave zgjedhore me qëllim të eliminimit të problemeve të cilat po i përcjellin listat zgjedhore. Puna kryesore që duhet të behët në këtë drejtim është përditësimi i listave dhe para se gjithash, heqja nga lista e personave të vdekur, si dhe përditësimi i adresave dhe vendeve të votimit e ngjashëm. Në listat e deritashme zgjedhore, jo vetëm që ka pasur emra të personave të vdekur, por jorrallë me emrat e tyre edhe është manipuluar gjatë votimit, kështu që ka ndodhur që nga ato lista të shihet se kanë “votuar” edhe të vdekurit.

Në mënyrë që zgjedhjet të zhvillohen në mënyrë demokratike dhe të ndërpriten keqpërdorimet gjatë votimeve, për herë të parë është filluar me procedimin e sanksioneve ndaj kundërvajtësve të normave zgjedhore nga ana e gjykatave komunale.

KQZ në takimet e veta të rregullta ka përcjellë raportin për çështjet penale lidhur me zgjedhjet. Në këtë drejtim i ka angazhuar edhe zyrtarët e lartë të KKZ-ve,²²⁶ që të jen në lidhje me prokuroritë komunale dhe ato të qarkut, me të cilat ka një bashkëpunim të ngushtë e posaçërisht me stacionet policore (njësitë e hetimeve) në komunat e tyre, në mënyrë që prej tyre të marrin raportet për sanksionet penale të kundërvajtësve të normave zgjedhore. Për fat të keq, gjykatat nuk shqiptojnë sanksione përkatëse në raport me peshën e veprimit kundërvajtës dhe shkeljet e rregullave zgjedhore. Këto dënime nuk do t'i frikësojnë kundërvajtësit e ardhshëm, por vetëm sa do t'i stimulojë ata. Shtrohet pyetja se a është KQZ e kënaqur me dënimet e shqiptuara gjyqësore për kundërvajtësit e rregullave zgjedhore e ligjore.

²²⁵ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Protokoll 1, neni 3.

²²⁶ Komisionet Komunale Zgjedhore.

Për të vërtetuar këtë konstatim po e marrin Raportin vjetor të punës së zyrës së Kryeprokurorit të Shtetëror.²²⁷

Prokuroria Shtetërore përcjellë punën e prokurorive komunale, duke iu dhënë përparësi këtyre lëndëve. Nga një numër i konsiderueshëm i personave të cilët janë akuzuar, për veprën penale mashtrimi zgjedhor, sipas nenit 180, të Kodit Penal të Kosovës dhe për veprën penale keqpërdorimi i të drejtës zgjedhore, sipas nenit 178 të KPK-së, gjykatat komunale kanë nxjerrë një numër të vogël të aktgjyqimeve dhe gati në të gjitha rastet aktgjykimet kanë të bëjnë me dënime në të holla.

Institucioni i Avokatit të Popullit shpreh shqetësimin me reagimet e tilla nga ana e gjykatave, në të cilat nuk kanë efektin e duhur, sepse në këtë mënyrë kundërvajtësit e ardhshëm potencialë do të jenë më të inkurajuar në shkeljen e rregullave ligjore. Prandaj, Avokati i Popullit konstaton se gjykimet duhet të jenë në përputhje me veprimet kundërvajtëse, të caktuara sipas Kodit Penal të Kosovës, sipas të cilit këto dënime janë të parapara deri në 5 vjet.

Ligjet e deritashme për zgjedhjet lokale përmbajnë mjaft paqartësi dhe mëdyshje gjatë zbatimit. Është vendosur që ligjet aktuale të revidohen, ndërkohë është Ligji i zgjedhjeve është në procesin e revidimit nga ana komisionit për rishikimin ndryshimin e ligjeve.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në këtë drejtim pret që të dy ligjet zgjedhore (Ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe Ligji për zgjedhjet lokale) të përmbajnë dispozita ligjore të qarta dhe koncize, si dhe të kenë lehtësi në interpretimin dhe zbatimin e tyre. Gjithashtu IAP pret që zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së të bëhet në një mënyrë tjetër, që do të përbëhej nga personat të cilët nuk u takojnë partive politike.

2.22. E drejta e pronës

E garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës,²²⁸ si dhe me Protokollin shtesë të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut,²²⁹ e drejta e pronës edhe më tej mbetet e drejtë e cenuar.

Edhe më tej në Kosovë problemet pronësore-juridike mbeten të mëdha. Natyra e problemeve nuk dallon nga ato të theksuara në raportin e 10-të vjetor të IAP-së.²³⁰ Shkelja e të drejtave

²²⁷<http://www.psh-ks.net/>.

²²⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 46. [Mbrojtja e Pronës]: “1. E drejta e pronës është e garantuar. 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik. 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose për krahejen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet. 4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë eksproprijimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente. 5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.”

²²⁹ Protokollin shtesë Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, neni 1. Mbrojtja e pronës: “Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.”

²³⁰ IAP, Raporti i 10 vjetor, 2011, faqe 70.

pronësore, si dhe problemet me prona, bazuar nga rastet e regjistruara në IAP, për nga natyra janë njëjtë, si dhe me aktorët e njëjtë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh që të gjitha pasuritë në pronësi shoqërore dhe në ndërmarrje në Kosovë, do të jenë në pronësi të Republikës së Kosovës.²³¹ Por ky nen nuk është i qartë sa i përket asaj se a bëhet fjalë për pronat shoqërore ekzistuese apo për pronat të cilat janë transformuar në pronë shtetërore, pas hyrjes së saj në fuqi. Ligji për pronësinë dhe të drejtat sendore, nuk ka një përkufizim të qartë për të gjitha të drejtat pronësore p.sh prona private, publike, shoqërore dhe të drejtën e shfrytëzimit të pronës shoqërore.²³²

Tokat në pronësi të ndërmarrjeve publike janë të regjistruara edhe sot si prona shoqërore. Ndërmarrjet publike e kanë vetëm të drejtën e shfrytëzimit në këto prona, por jo edhe të drejtën pronësore. Në bazë të ligjeve në fuqi edhe sot nuk është e qartë se a ekziston mundësia për të fituar pronësinë mbi pronën shoqërore përmes parashkrimit.

Gjithashtu, banesat në pronësi shoqërore paraqesin problem për regjistrimin e tyre. Problemi qëndron në faktin se është e vështirë të përcaktohet se kush është mbajtës legjitim i të drejtës së shfrytëzimit për një banesë të tillë dhe kush është pronar i saj.

Edhe pse themelimi i regjistrave të drejtave të pronës së paluajtshme është e rregulluar me Ligjin për themelimin e regjistrit të drejtave të pronës së paluajtshme,²³³ edhe sot qytetarët e Republikës së Kosovës ballafaqohen me probleme për regjistrimin e pronave të tyre në regjistra kadastral.²³⁴ Procedurat administrative kërkojnë që parashtruesit e kërkesave për regjistrimin e transaksioneve pronësore, duhet t'i paraqesin konfirmimet e pagesave të tatimeve dhe taksave tjera komunale të cilat lëshohen nga departamente tjera komunale, para se ata të regjistrojnë pronën në zyret kadastrale komunale. Nuk ekziston ndonjë koordinim i departamenteve për kryerje të punëve e cila do t'ua kursente kohën qytetarëve për t'i regjistruar pronat e tyre në regjistra kadastralë. Sepse të dhënat kadastrale shpesh janë të pasakta dhe të papërditësuara. Kjo paraqet vështirësi në identifikimin e mbajtësve legjitim të drejtave pronësore dhe vë në dyshim vlefshmërinë e certifikatës kadastrale si dëshmi e titullit në atë pronë.

Bashkëpunimi në mes të zyrave të regjistrimit civil, gjykatave dhe zyrave kadastrale komunale lidhur me rastin e raportimeve për personat e vdekur, nuk funksionon. Dëshmitë për rastet e vdekjeve të familjarëve nga zyra e regjistrimit civil, vetë palët i prezantojnë në gjykatë për ta rregulluar çështjen e trashëgimisë. Kjo procedurë, zakonisht për palët është e mundimshme dhe u merr shumë kohë për shkak të zvarritjes së procedurave. Kjo bën që në të shumtën e rasteve qytetarët e rregullojnë trashëgiminë vetëm kur atyre u duhet për nevoja personale. Kjo bën që edhe të dhënat e kadastrale të mbajtësve të titujve pronësorë të mos konsiderohen të sakta.

Të gjitha këto procedura të komplikuar që qytetarët e Kosovës duhet t'i kalojnë për ta regjistruar pronën e tyre në regjistra kadastralë, krijojnë probleme edhe tek rastet e

²³¹ *Kushtetutën e Republikës së Kosovës*, neni 159 pika 2, [Pronat dhe Ndërmarrjet në Pronësi Shoqërore]: “2. Të gjitha interesat në pronësi shoqërore në prona dhe ndërmarrje në Kosovë do të jenë në pronësi të Republikës së Kosovës.

²³² Ligji për pronësinë dhe të drejtat sendore, nr. 03/L-154.

²³³ Ligji për themelimin e regjistrit të drejtave të pronës së paluajtshme, nr. 2002/5.

²³⁴ IAP, rastet A. 237/2009, A. 286/2011.

shpronësimeve. Derisa nuk ekzistojnë të dhëna të sakta kadastrale, dëshmia e pronësisë duhet të vërtetohet përmes dokumenteve tjera, siç janë kontratat apo dokumente tjera publike, ligjshmëria e të cilave është e dyshimtë.

Të gjitha institucionet publike janë të detyruara të respektojnë dhe mbrojnë të drejtat pronësore. Në mënyrë që të dhënat në regjistra kadastral të jenë sa më të sakta, Qeveria e Kosovës duhet të eliminojë pengesat administrative dhe procedurat komplekse administrative të panevojshme, në mënyrë që qytetarët e Kosovës të mos e marrin si mundim çështjen e rregullimit të kontesteve pronësore.

Qytetarët e Republikës së Kosovës edhe më tej kanë problem me sigurimin e lejeve të ndërtimit. Sipas ankesave të regjistruara, në Institucionin e Avokatit të Popullit, komuna e Prishtinës edhe më tej zvarrit procedurat për pajisje me leje të ndërtimit për qytetarët e Komunës së Prishtinës.²³⁵

Për t'i realizuar të drejtat e tyre pronësore, qytetarët e Kosovës edhe më tej hasin në pengesa nëpër gjykata të rregullta. Zvarritjet e procedurave para gjykatave i pengojnë qytetarët e Kosovës që të kanë qasje të lirë në prona, si dhe ato t'i shfrytëzojnë në mënyrë të lirë dhe të papenguar. Lidhur me pengimin në posedim të pronës, për shkak të zvarritjeve procedurale në gjykata vendore për të vendosur në konteste pronësore, qytetarët e Kosovës ankohen në Institucionin e Avokatit të Popullit.²³⁶

Edhe më tej Agjencia Kosovare e Pronës, si pasardhëse e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore, vazhdon të mos e përmbushë misionin e vet ligjor, për të krijuar një skemë funksionale, për kompensimin e arsyeshëm për bartësit e të drejtës pronësore, të cilët pronat e tyre i kanë në pjesën veriore të Mitrovicës nën administrim të tyre.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, vetëm disa dhjetëra familje, të cilat pronat e tyre i kanë në pjesën veriore të Mitrovicës, nën administrim të Agjencisë Kosovare të Pronës, vetëm për dy muaj kanë vjelë qira dhe atë nën vlera normale të çmimit të tregut. Edhe më tej, qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët i kanë pronat e tyre në pjesën veriore të Mitrovicës, janë të penguar në posedim dhe shfrytëzim të lirë të tyre.

Qeveria e Kosovës duhet t'i mundësojë secilit person të ushtrojë të drejtat pronësore, në mënyrë të plotë e të papenguar dhe pa diskriminim.

2.23. E drejta për arsimin

E drejta për arsimim, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (KRRK) parasheh që “*secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi financohet me ligj nga fondet publike.*”²³⁷ Kushtetuta përcakton detyrimin që institucionet publike t'i sigurojnë mundësi të barabarta arsimimi çdo personi sipas aftësive dhe nevojave të tij/saj.²³⁸ Po këtë e

²³⁵ IAP, rastet A. 157/2011, A. 83/2011.

²³⁶ IAP, rastet A. 413/2011, A. 397/2011.

²³⁷ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 47, paragrafi 1.

²³⁸ *Po aty*, neni 47 paragrafi 2.

garanton edhe KEDNJ dhe Protokollet e saj,²³⁹ që zbatohen drejtpërdrejt sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.²⁴⁰

Çështja e arsimit dhe të drejtës për t'u arsimuar, sa i përket infrastrukturës ligjore, ka shënuar përparim kualitativ me miratimin e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës²⁴¹ dhe Ligjit për Arsimin Parauniversitar (LAP) në Republikën e Kosovës.²⁴² Qëllimi i LAP është që të rregulloj edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në nivelin 4,²⁴³ sipas Standardeve Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit (ISCED).²⁴⁴ Ky nivel i ri i arsimit hyn në fuqi nga data e cila do të caktohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.²⁴⁵ Edukimi para fillor sipas LAP do të jetë i obligueshëm nga viti shkollor 2015/2016, nëse këtë e lejojnë kushtet financiare.²⁴⁶

Me qëllim të sigurimit të cilësisë së materialeve që përdoren në institucionet arsimore dhe aftësuese, është miratuar Korniza e Kurrikulit të Ri të Kosovës dhe pritet implementimi i saj.²⁴⁷

Arsimi është caktuar si një nga prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në kuadër të këtij prioriteti është ngritja e cilësisë dhe infrastrukturës. Detyrë parësore dhe e ngutshme për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) mbetet nxjerrja e akteve nënligjore për të mundësuar zbatimin e ligjeve të miratuara.

2.23.1. Sistemi arsimor për komunitetet

Sa i përket të drejtës për arsimim të komunitetit serb, komunat kanë kompetenca për krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve edukativo-arsimore në gjuhën serbe.²⁴⁸ Shkollat të cilat zhvillojnë mësimin në gjuhën serbe, kanë të drejtë të përdorin plan-programet e hartuara nga Ministria e Arsimit të Republikës së Serbisë. Këto plan-programe mund të përdoren vetëm pas njoftimit të MASHT-it.²⁴⁹ Deri më tani komunitetet nuk e kanë njoftuar MASHT-in me plan-programet e tyre.²⁵⁰

Komisioni i pavarur për shqyrtimin e materialeve mësimore në gjuhën serbe, ka shqyrtuar përputhshmërinë e teksteve mësimore në gjuhën serbe me Kushtetutën e Republikës së

²³⁹ *Protokolli nr. 1 i KEDNJ, neni 2 "Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim..."*.

²⁴⁰ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 47 paragrafi 2.*

²⁴¹ *Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, nr.04/L-037, 31.08.2011.*

²⁴² *Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-032, 31.08.2011.*

²⁴³ Niveli 0(edukimi parafillor), niveli 1 (klasat 1-5), niveli 2 (klasat 6-9), niveli 3 (klasat 10-12/13) dhe niveli 4 (arsimi pas sekondar jouniversitar).

²⁴⁴ *Po aty, neni 1, paragrafi 1.*

²⁴⁵ *Po aty, neni 49, paragrafi 3.*

²⁴⁶ *Po aty, neni 49, paragrafi 2.*

²⁴⁷ *Vendimi nr.262/01B, 29.08.2011.*

²⁴⁸ *Ligji për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës, nr. 03/L-068, neni 12, paragrafi 12.1, 21.05.2008.*

²⁴⁹ *Po aty, neni 12, paragrafi 12.2; Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, neni 8, paragrafi 8.5.*

²⁵⁰ *Intervistë, Enesa Kadiq, udhëheqëse e Divizionit për komunitete MASHT.*

Kosovës dhe legjislacionin në fuqi.²⁵¹ Sipas raportit të komisionit është konstatuar se ekzistojnë dallime esenciale në mes të kurrikulave.²⁵²

Qeveria e Kosovës ka zhvilluar një Strategji për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali e egjiptian - 2007-2017. Disa aktivitete të parapara në këtë strategji janë implementuar, ndërsa të tjerat janë në proces të implementimit. Vlen të përmendet hartimi i plan programeve të gjuhës rome me elemente të kulturës dhe historisë rome si dhe mësimi i gjuhës rome nga nxënësit e klasave të dyta, si pilot projekt në një shkollë fillore në Prizren. Mësimdhënia në Republikën e Kosovës zhvillohet në gjuhën shqipe, serbe, turke dhe boshnjake. Komuniteti turk dhe boshnjak janë integruar në sistemin unik të arsimit në Kosovë.²⁵³

Sipas Strategjisë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë 2007-2017 dhe sipas Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016, parashihet qeverisje efikase e sistemit të arsimit, sigurimi i cilësisë së të nxënësve, gjithë përfshirje në arsim, mjedis fizik i përshtatshëm dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve. Këtë vit janë trajnuar 2500 mësimdhënës për integrimin e Teknologjisë Informative dhe Komunikutimit (TIK) në sistemin arsimor dhe janë furnizuar me teknologji informative 39 institucione shkollore.²⁵⁴

2.23.2. Edukimi parashkollor (EPSH) dhe edukimi parafillor (EPF)

Republika e Kosovës ka zhvilluar një qasje të integruar në EPSH, në të cilin kombinohen edukimi, shkollimi, loja e fëmijëve dhe përkujdesja profesionale. Vitet e hershme të të nxënësve janë vendimtare për zhvillimin e fëmijës. Me gjithë rritjen e numrit të fëmijëve të përfshirë në arsimin parashkollor, në shumë komuna mungon infrastruktura dhe nuk mund të përfshihen të gjithë fëmijët e interesuar, sidomos fëmijët e fshatrave dhe të komuniteteve.

2.23.3. Arsimi parauniversitar

Arsimi parauniversitar në Republikën e Kosovës ofron shërbime për fëmijët e moshës 6-18 vjeçare, të cilët vijnë nën nga tri nivelet e shkollimit në vijim: shkolla fillore (klasat 1-5), shkolla e mesme e ulët (klasat 6-9), këto dy nivele janë të obligueshme për të gjithë fëmijët, dhe arsimi i mesëm i lartë (klasat 10-12/13).

Një pjesë e popullatës ka migruar në qytete, duke mbingarkuar infrastrukturën, në anën tjetër, disa shkolla rurale kanë numër të vogël të nxënësve, në këtë mënyrë është rritur numri i nxënësve në paralelet në zonat urbane dhe është zvogëluar numri i nxënësve në paralelet në zonat rurale. Për pasojë ka mungesë të hapësirave mësimore e sanitare. Shumë shkolla fillore

²⁵¹ Ligji për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, neni 12, paragrafi 12.4.

²⁵² Raporti i komisionit të pavarur për shqyrtimin e materialeve mësimore në gjuhën serbe, 24.6.2010, MASHT.

²⁵³ Po aty.

²⁵⁴ www.masht-gov.net/, Konferenca përmbyllëse e pilot programit "Zbatimi i Teknologjisë Informative dhe të mësuarit elektronik në shkollat e Kosovës (TIK)", 09.12.2011.

dhe të mesme në zonat urbane punojnë në disa ndërrime, gjë që rezulton me orë të shkurtuara, të cilat kufizojnë zbatimin e plan programeve mësimore.

Në disa shkolla mungojnë kushtet themelore sanitare dhe është vështirë të flitet për një mjedis të shëndetshëm fizik. Mungesa e hapësirës në shkollat e mesme pamundëson mbajtjen e praktikës profesionale, sigurimin e laboratorëve të ndryshëm, mungojnë tekstet shkollore për shumicën e lëndëve mësimore, kështu që nxënësit janë të obliguar të marrin shënime dhe të mësojnë prej tyre.

Nxënësit me nevoja të veçanta vijnë mësimin në shkollat speciale dhe njësitë që ofrojnë arsimim të veçantë. Kushtet të cilat ofrojnë Shkolla speciale “Lef Nosi“ në Prizren dhe Shkolla speciale për të verbër dhe të parë të dobësuar “Dr Xheladin Deda” në Pejë, janë mjaft të mira. Këto shkolla janë të pajisura sipas standardeve evropiane, transporti për nxënës është i siguruar. Mirëpo, në shkollën speciale “Qendra Burimore Nëna Terezë” në Mitrovicë, objekti shkollor është shumë i vjetër dhe nuk i plotëson kushtet për shkollë, mjetet për transportin e nxënësve, po ashtu janë në gjendje të keqe dhe shkolla ka vështirësi në sigurimin e transportit të sigurt.

Edhe pse numri i nxënësve të cilët e kanë braktisur shkollimin e obliguar këtë vit ka rënie, kjo dukuri mbetet ende shqetësuese. Shkollimin e obliguar në Kosovë e kanë braktisur 1485 nxënës. Deri më tani nuk kemi njohuri se është ndërmarrë ndonjë masë ndëshkuese ndaj përgjegjësve për braktisjen e shkollimit të obliguar edhe pse sipas ligjit kjo është e dënueshme.²⁵⁵

Për krijimin e një ambienti më të sigurt dhe më të përshtatshëm, në institucionet arsimore MASHT ka nënshkruar Memorandumin e mirëkuptimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Edhe pse sipas Ligjit të Arsimit Parauniversitar, ndalohet ndëshkimi fizik apo çfarëdo forme tjetër e ndëshkimit nënçmues në të gjitha institucionet arsimore dhe aftësuese, qofshin ato publike ose private,²⁵⁶ megjithatë ka indikacione se dhuna është e pranishme në institucionet arsimore.

Për arsimimin e personave të privuar nga liria, MASHT ka nënshkruar Memorandumin e mirëkuptimit me Ministrinë e Drejtësisë. Në Burgun e Dubravës, 81 të dënuar vijnë mësimin e rregullt, në degën e Shkollës së mesme teknike “Mit’hat Frashëri” në Gurakoc. Të dënuarit, ashtu si në shkollat e rregullta, vijnë mësimet në të gjitha drejtimet. Një problem ende i pazgjidhur është se këta nxënës ballafaqohen me mungesën e teksteve shkollore. Këtyre nxënësve certifikatat u lëshohen nga shkolla amë.

Në Qendrën Korrektuese në Lipjan, zhvillohet mësimi për të mitur. Nxënësit janë të pajisur me tekste shkollore dhe me çanta. Mbetet sfidë funksionimi i bibliotekave në Qendra Korrektuese, burgje dhe në qendra të paraburgimit. Problem më vete është fakti se në shumicën e rasteve bibliotekat ekzistuese janë pak të furnizuara me libra, librat janë botime të vjetra dhe me vështirësi sigurohen tituj të rinj.

²⁵⁵ Ligji për Arsimin Parauniversitar, neni 15, paragrafi 4.

²⁵⁶ Po aty, neni 3, paragrafi 7.

Ngritja e cilësisë dhe funksionalizimi i arsimit, duhet të bëhet përmes pranimit të kuadrit të duhur drejtues dhe mësimitdhënës, përmes konkurseve dhe respektimit të kriterëve dhe procedurave të zgjedhjes së personelit,²⁵⁷ si dhe respektimit të normave ligjore.²⁵⁸ Deri më tani është vërejtur se ka pasur shumë pakënaqësi dhe ankesa të shumta pas konkurseve të shpallura nga drejtoritë komunale të arsimit (DKA). Një sfidë e madhe mbetet përsheptimi i procedurave për ankesa dhe zbatimi i vendimeve të cilat në shumicën e rasteve zvarriten apo nuk zbatohen fare nga punëdhënësi. Edhe procesi i licencimit të mësimitdhënësve është filluar, por ka ngecje,²⁵⁹ ky proces duhet të përfundohet sa më parë.

Ngritja e cilësisë dhe funksionalizimi i arsimit, duhet të bëhet me angazhimin e mësimitdhënësve në kuadër të shkollës, megjithatë ka indikacione se mësimitdhënësit mbajnë kurse plotësuese private me nxënësit.

Sipas Udhëzimit Administrativ dhe sipas planit vjetor të punës së shkollës parashihet realizimi i ekskursioneve për maturantë.²⁶⁰ Mënyra e organizimit shpesh përcillet me probleme si: akomodimi në hotel, vendosja e shumë nxënësve në një dhomë, ushqimi i papastër, përdorimi i alkoolit dhe substancave narkotike të nxënësve gjatë ekskursionit, mos përmbushja e kënaqshme e obligimeve nga kompania e kontraktuar, etj. DKA-të nuk respektojnë ose nuk janë shumë të përgjegjshme në zbatimin e Udhëzimit Administrativ në këtë drejtim. Një shembull i keq është ekskursionit i maturantëve të një shkolle të mesme në komunën e Gjilanit.²⁶¹

Këtë vit ka pasur kërkesa për mësimin fetar dhe bartjen e veshjes fetare në shkolla, mirëpo sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar, institucionet publike arsimore duhet të përmbahen nga mësimitdhënësia fetare ose veprimtarit tjera, të cilat propagandojnë një fe të caktuar.²⁶² Me rastin e shpërndarjes së dhuratave për krishtlindje, nga Bashkësia Ungjillore “Ringjallja” në Gjilan, në disa shkolla fillore, nxënësve u janë shpërndarë edhe fletushka me propagandë fetare.²⁶³ Në kundërshtim me ligjet e aplikueshme, në disa shkolla të mesme dhe fillore vijojnë mësimin nxënësor me veshje fetare.²⁶⁴ Këshilli drejtues i shkollës ka detyra dhe kompetenca të vendosë për kodin e veshjes së punonjësve dhe nxënësve.²⁶⁵

²⁵⁷ Udhëzimi Administrativ nr. 17/2009, Procedurat e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë.

²⁵⁸ Udhëzimi Administrativ nr. 19/2009, Normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm.

²⁵⁹ Udhëzimi Administrativ nr. 5/2010, Licencimi i mësimitdhënësve.

²⁶⁰ Udhëzimi Administrativ nr. 35/2008, Piknikët, vizitat, shëtijtjet, ekskursionet dhe festimet-ceremonialet në shkolla.

²⁶¹ Ekstrakt nga procesverbali i Komitetit për Arsim, paragrafi 4, 21.10.2011, Raporti nr. Pr. 201/11, Gjinnazi “Zenel Hajdini” në Gjilan, 29.09.2011.

²⁶² Ligji për Arsimin Parauniversitar, neni 3 paragrafi 7.

²⁶³ <http://2lonline.com>, Shefik Surdulli, përgjegjës i Zyrës për Informim në Gjilan, 20.12.2011. Fletushka, “Dhurata më e madhe për të gjithë”, Envoy House Publishers, botuar në Gjermani, 2011.

²⁶⁴ Shkresa nr. 1029, 12 nxënësve vijojnë mësimin me veshje fetare, Drejtoria e Arsimit në Gjilan, 20.12.2011.

²⁶⁵ Ligji për Arsimin Parauniversitar, neni 17 paragrafi 11, nënparagrafi 11.6. Udhëzimi Administrativ 6/2010, neni 4, paragrafi 1, “nxënësit i ndalohet”, nënparagrafi 1.13, “bartja e uniformës fetare”.

2.23.4. Arsimi i lartë

Numri i studentëve në Kosovë është duke u shtuar për çdo vit. Kjo paraqet një sfidë për qeverinë lidhur me financimin e universiteteve, sfidë tjetër është që të sigurohen kurrikulat, të cilat pasqyrojnë nevojat e tregut të punës, ndihmojnë në rritjen e punësimit për të diplomuarit dhe ndikojnë në përmirësimin e imazhit të arsimit të lartë. Arsimi i lartë ballafaqohet me mungesën e hapësirave të mjaftueshme, laboratorëve, pajisjeve të teknologjisë informative dhe mungesën e teksteve universitare për studentë, të cilët në shumicën e lëndëve duhet të mësojnë prej skripteve të ndryshme. Po ashtu, mbetet sfidë sigurimi i një mjedisi modern për mësimdhënie, mësimnxënie dhe kërkime shkencore në institucionet e arsimit të lartë.

Strategjia e Zhvillimit të Arsimit të Lartë në Kosovë 2005-2015, është një propozim për transformimin, reformimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë sipas një modeli, planifikimi, administrimi dhe menaxhimi më efikas. Zhvillimi i një sistemi efikas të arsimit të lartë do t'i kontribuonte ngritjes së mirëqenies së shoqërisë kosovare, duke ofruar një arsimim dhe kërkim shkencor të cilësisë së lartë, me mundësi të barabarta për të gjithë.

Infrastruktura ekzistuese nuk e mbështet një përfshirje më të madhe të studentëve në arsimin e lartë, sepse ajo nuk e mbështet një shumëllojshmëri programesh të arsimit të lartë dhe nuk mbështet në mënyrë të kënaqshme kategorinë e studentëve me nevoja të veçanta.

Në kuadër të integritit të komuniteteve këtë vit, në universitete publike janë regjistruar 84 studentë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, por nuk ka të dhëna për studentë/e të regjistruar të komuniteteve tjera.²⁶⁶

Në vitin 2011, IAP ka hetuar 8 ankesa kundër MASHT-it dhe 30 ankesa kundër drejtorive komunale të arsimit. Nga ankesat të cilat janë zgjidhë vlen të përmendet ankesa e prindërve të 22 nxënësve të një shkolle të mesme në Gjilan,²⁶⁷ të cilët janë ankuar kundër MASHT-it për shkak të shkeljeve gjatë testit shtetëror të maturës: Me kërkesën e IAP, MASHT ka reaguar në kohën dhe mënyrën e duhur dhe është përsëritur testi shtetëror i maturës për këta nxënës. Me ndërmjetësimin e IAP janë zgjidhur edhe ankesat e sekretarëve të shkollave²⁶⁸ dhe motrave edukatore në institucionet parashkollore,²⁶⁹ të cilët janë ankuar për mospagesën e të ardhurave personale në bazë të kualifikimit dhe përvojës së punës.

Avokati i Popullit rekomandon:

- **Avancimin e mëtutjeshëm të TIK-u dhe të sigurohet infrastrukturë përkatëse e TIK-ut në të gjitha nivelet e arsimit.**
- **Të sigurohet qasje gjithëpërfshirëse dhe e barabartë për të gjithë fëmijët në edukiminë parashkollor dhe edukimin parafillor, nëpërmjet rritjes së kapacitetit të**

²⁶⁶ Intervistë, Enesa Kadiq, Udhëheqëse e Divizionet për komunitete MASHT.

²⁶⁷ Ankesa A. nr. 222/2011.

²⁶⁸ Ankesa A. nr. 375/2010.

²⁶⁹ Ankesa A. nr. 86/2011.

infrastrukturës fizike, avancimit të kurrikulave dhe përmes programeve për zhvillimin profesional të edukatore/ëve dhe të personelit administrativ.

- *Avokati i Popullit inkurajon themelimin e paraleleve të reja për ekukimin parashkollor dhe parafillor për të përmirësuar gjithë përfshirjen pa diskriminim, për të inkurajuar fëmijët nga grupet minoritare, fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët nga zonat rurale si dhe fëmijët nga familjet e varfra.*
- *Të zgjerohet dhe plotësohet infrastruktura shkollore dhe të përmirësohet cilësia e objekteve, sidomos në zonat urbane, të cilat janë të mbipopulluara.*
- *Të sigurohen kushte sa më të mira për nxënësit me nevoja të veçanta.*
- *Avokati i Popullit shprehë shqetësimin dhe kërkon marrjen e masave ligjore për parandalimin e dhunës në institucionet e arsimit dhe të sigurohet shërbimi pedagogjik në shkolla.*
- *MASHT në bashkëpunim me DKA të organizojnë fushata vetëdijesimi për nxënës, prindër dhe mësime dhënë, për rëndësinë e shkollimi, dhe luftimin sa më efikas të braktisjes së shkollimit.*
- *Avokati i Popullit rekomandon MASHT-in që në bashkëpunim me DKA të ndalojë mësime dhënë të mbajnë kurse private me nxënësit e tyre, për nxënësit të cilët kanë nevojë për mësim plotësues të gjinden forma për mësim në kuadër të shkollave.*
- *Të forcohet karakteri edukativ dhe mësimor i ekskursioneve, të kyçen në vendimmarrje këshilli i prindërve dhe këshilli i nxënësve, të krijohen mekanizma të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nr. 35/2008.*
- *Kërkon që të merren masa e duhura ligjore për mbrojtjen e nxënësve nga propaganda fetare dhe të zbatohen ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.*
- *Përkrahë dhe inkurajon programet studimore të cilat krijojnë mundësi të barabarta për përfshirje në arsimin e lartë për të gjitha grupet etnike, si dhe grupet me nevoja të veçanta arsimore dhe grupet e tjera sociale.*
- *Kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht nga MASHT-i, që të vazhdojë me një përkushtim më të madh implementimin e të gjitha strategjive dhe memorandumeve të miratuara deri më tani.*
- *Kërkon nga MASHT, që në afatin ligjor, brenda një viti të nxjerr aktet nënligjore për çështjet të cilat mbulojnë me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.*

2.24. Liria e artit dhe e shkencës

Liria e artit dhe e shkencës, është e garantuar me Kushtetutën e Kosovës,²⁷⁰ Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike,²⁷¹ si dhe është në përputhje me KEDNJ, sipas së cilës liria e artit dhe e shkencës dhe liria akademike, duhet të ushtrohen brenda kuadrit të njëjtë të lirive dhe të kufizimeve të përcaktuara në nenin 10 të saj.²⁷²

Në Republikën e Kosovës po ashtu ekziston edhe një infrastrukturë ligjore bazike, e cila mbrohet zhvillimin e pronës intelektuale dhe të drejtat e autorit.²⁷³

Liria e artit dhe e shkencës, si dhe liria akademike, janë zgjerim i lirive të mendimit dhe të shprehjes. Çdo njeri gëzon të drejtën e lirisë për të kërkuar, për të marrë dhe për të përhapur njoftime dhe ide të çdo lloji, pavarësisht nga kufijtë, me gojë ose me shkrim, në mënyrë të shprehur ose artistike, ose me çdo mjet të zgjedhur prej tij.

Gjatë vitit 2011 IAP ka pranuar vetëm një ankesë kundër Kuvendit Komunal në Gjakovë,²⁷⁴ lidhur me moslejimin e ansamblit folklorik “Shqiponja e Dukagjinit” për të shfrytëzuar Pallatin e Kulturës për veprimtarinë e saj. Bazuar në kompetencat e veta ligjore, përfaqësuesi i IAP-së ka biseduar me palën përgjegjëse në KK të Gjakovës dhe ankuesin, nga të cilët ka kërkuar që të gjendet një zgjidhje për rastin konkret.

Në këtë rast Avokati i Popullit i rekomandoi Kuvendit Komunal të respektojë dispozitat ligjore për institucionet e kulturës²⁷⁵ dhe si themelues i institucionit në mënyrë solidare dhe të pakufizuar përgjigjet për obligimet e tyre. Me ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, rasti është zgjidhur pozitivisht.

2.25. E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 49 i garanton secilit person të drejtën e punës dhe lirinë për të zgjedhur profesionin dhe vendin e tij të punës.²⁷⁶ Gjithashtu kjo e drejtë është e garantuar edhe me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut,²⁷⁷ të cilat së bashku me instrumentet e tjera ndërkombëtare zbatohet drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.²⁷⁸

Që nga hyrja në fuqi e Ligjit të Punës,²⁷⁹ problemet me zbatimin e tij në praktikë vazhdojnë. Shumë të drejta që u garanton ligji punëtorëve nuk respektohen nga ana e punëdhënësve, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Me gjithë ligjet bazike që e rregullojnë të drejtën e

²⁷⁰. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 48.

²⁷¹. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 19.

²⁷². Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, neni 10.

²⁷³. Ligji për të Drejta të Autorit dhe të Drejta të Përafërta, nr. 2004/45, 29 qershor 2006, Ligji për Patenta, 2004/49, Ligji për Dizajnin Industrial, 2005/02 L 45. Ligji për Markat Tregtare, 2006/2 L 54.

²⁷⁴ Rasti në IAP, A. nr. 455/2011.

²⁷⁵ Ligji për Institucionet e Kulturës, nr. 02/L-57.

²⁷⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 49.

²⁷⁷ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e OKB-së (1948), neni 23.

²⁷⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve ndërkombëtare].

²⁷⁹ Ligji i Punës nr. 03/L-212, i miratuar në Kuvendin e Kosovës, më 1 nëntor 2010.

punës si Ligji për Shërbimin Civil,²⁸⁰ Ligji për Pagat e Nëpunësve Civil²⁸¹ dhe Ligji për Këshillin Ekonomiko Social,²⁸² mungesa e miratimit të akteve nënligjore bën të pamundur zbatimin e plotë të Ligjit të Punës.²⁸³

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, vetëm pas një viti të hyrjes në fuqi të Ligjit të Punës, IAP ka pranuar një numër të konsiderueshëm të ankesave dhe ka hapur 90 raste hetimi, lidhur me pretendimet për shkeljet e të drejtave nga marrëdhënia e punës.

Avokati Popullit konstaton se shkeljet më të mëdha janë vërejtur me rastin e punësimit - shkeljeve të procedurave të punësimit, procedura për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, moskompensim për punën jashtë orarit, mosshfrytëzim të së drejtës për pushim vjetor.

Për një mbikëqyrje sa ma efikase të dispozitave të Ligjit të Punës, të cilat rregullojnë marrëdhënien e punës, sigurinë dhe mbrojtjen në punë, si në sektorin publik edhe në atë privat, duhet të shtohet numri i inspektorëve të Punës.²⁸⁴ Numri shumë i vogël i inspektorëve e pamundëson mbikëqyrjen efikase e zbatimit të dispozitave ligjore nga punëdhënësit, si në sektorin privat, ashtu edhe në atë publik.

Fakti se edhe në këtë periudhë raportuese IAP ka regjistruar një numër ankesash lidhur me moszbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMK), vazhdon të jetë shqetësues.²⁸⁵ Moszbatimi i vendimeve të KPMK-së, është shkelje e të drejtës nga marrëdhënia e punës, sipas Ligjit nr.03/L-195 për KPMK.²⁸⁶

IAP, ka pranuar ankesën e parashtrueses dhe dhjetë punëtorëve të tjerë të Zyrës për Komunitete në Graçanicë, të cilët ankoreshin për shkak të dështimit të komunës së Prishtinës për ta zbatuar vendimin e KPMK, nr .A 02/64-74/2011.²⁸⁷ Sipas vendimit të KPMK-së, i cili u mor më 20.05.2011, organi i punësimit obligohet që parashtrueses dhe të tjerëve t'ua vazhdojë marrëdhënien e punës, në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me të gjitha të drejtat dhe obligimet nga marrëdhënia e punës. Më 15 nëntor 2011, Avokati i Popullit i shkroi një letër kryetarit të komunës së Prishtinës, duke kërkuar që të zbatohet vendimi i lartpërmendur, por nuk pranoi përgjigje.

Në bazë të ankesave të pranuara në IAP, në këtë periudhë mund të konstatohet se edhe pse ekziston mekanizmi mbrojtës ligjor, në vazhdimësi ka shkelje të së drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat.

Lidhur me shkeljet nga marrëdhënia e punës në këtë periudhë raportuese, falë angazhimit të Avokatit të Popullit tek institucionet publike, duke kërkuar sqarime nga përgjegjësit e autoriteteve , ankuesit janë kthyer në punë.

²⁸⁰ Ligji për Shërbimin Civil, nr. 03/L-145, ka hyrë në fuqi më 28 maj 2010.

²⁸¹ Ligji për Pagat e Nëpunësve Civil, nr. 03/L-147, ka hyrë në fuqi më 13 maj 2010.

²⁸² Ligji për Këshillin Ekonomiko Social, nr. 04/L-008, ka hyrë në fuqi më 21 korrik 2011.

²⁸³ Po aty.

²⁸⁴ <http://mpms.rks-gov.net> "Punëtori mbi zbatimin një (1) vjeçar të Ligjit të Punës", më 16.12.2011.

²⁸⁵ Shih <http://kpmshc.rkc-gov.net>, *Raporti Vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës 2010*.

²⁸⁶ Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, neni 13 "Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit i cili e ka marr vendimin e parë ndaj palës."

²⁸⁷ Po aty.

Në muajin prill 2010, Avokati i Popullit, e pranoi ankesën, e një qytetari nga Rahoveci, i cili pohonte se Drejtoria e Urbanizmit e ka larguar nga puna pa asnjë shpjegim. Më 22 shkurt 2011, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, më qëllim të hetimit të rastit, e kishte takuar drejtorin e drejtorisë së lartpërmendur, i cili i kishte deklaruar se çështja e kthimit në punë të ankuesit do të shqyrtohet së shpejti dhe se IAP do të njoftohet me kohë. Më 27 shtator 2011, drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit e ka njoftuar përfaqësuesin e IAP-së se ankuesi është kthyer në punë. Më 27 tetor 2011, ankuesi e ka njoftuar IAP-në se është kthyer në punë.

Më 11 maj 2011, IAP ka pranuar ankesën e një mësimdhënësi i punësuar në një shkollë të mesme në Prishtinë, i cili pohonte se është duke u trajtuar jo mirë dhe është duke u diskriminuar nga drejtori i shkollës.

Nga ankesa e tij kuptohej se atij nuk i është dorëzuar përshkrimi i detyrave të punës, siç parashihet me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe atij i është propozuar edhe mos vazhdimi i kontratës së punës.²⁸⁸

Më 8 korrik 2011, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit ka zhvilluar një takim me drejtorin e Drejtorisë për Arsim të komunës së Prishtinës, i cili është njoftuar për çështjen e ankuesit. Më 14 korrik 2011, ankuesi u këshillua që lidhur me çështjen të drejtohet KPMK, si organ kompetent për zbatimin e Ligjit të Shërbimit Civil. Më 1 shtator 2011 u mbajt seancë publike në KPMK, ku përpos palëve të përshirë në kontest mori pjesë edhe përfaqësuesja e AP. Në seancë u paraqiten dëshmitë dhe pretendimet ankimore të palëve të përfshira në kontest, si dhe u paraqit konstatimi i IAP-it, i nxjerrë si rezultat i hetimeve të zhvilluara, se ankuesit duhet t'i vazhdohet kontrata e punës. Si rezultat i angazhimit të përfaqësueses së IAP, më 9 shtator 2011, Drejtoria për Arsim e Prishtinës, ia vazhdoi kontratën e punës ankuesit

Një shqetësim tjetër për Avokatin e Popullit, është shkalla e lartë e papunësisë në Kosovë. Sipas të dhënave të UNDP-së, për vitin 2011, rreth 45 % të forcës punuese, vlerësohet të jetë e papunë.²⁸⁹

Në bazë të Raportit Performancës për vitin 2010/2011 të Departamentit të Punës dhe Punësimit (DPP) të MPMS, numri i përgjithshëm i punëkërkuesve të regjistruar si të papunë në shërbimet publike të punësimit në Kosovë është 335.905 persona. Nga ta 162.277 femra dhe 173.628 meshkuj. Në krahasim me periudhën e njëjtë e vitit të kaluar, nuk vërehet asnjë lëvizje pozitive në këtë drejtim. Në vitin 2010, si të papunë ishin të regjistruar 335.926 persona, nga ata 160.065 femra dhe 175.861 meshkuj.²⁹⁰

Sipas këtij raporti, popullsia aktive në Kosovë janë 1.200.000 persona, ndërsa për çdo vit, në tregun e punës në Kosovë hyjnë rreth 30.000 persona, ndërsa nga ai dalin rreth 6.000, kurse papunësia arrin shkallën 39-41 %. Shkalla e papunësisë tek femrat, me 53-59 % është dukshëm më e lartë se ajo e meshkujve.²⁹¹

Sipas Ligjit të Punës, marrëdhënie pune mund të themelojë çdo person prej moshës 18 vjeçare. Ndërsa, për punë të lehta, të cilat nuk e dëmtojnë shëndetin e tyre, mund të punësohen personat në mes të moshës 15 -18 vjeç.

²⁸⁸ Ligji për Shërbimin Civil të Kosovës nr. 03/L-149, neni 45 paragrafi 1.

²⁸⁹ Shih <http://www.kosovo.undp.org>, *Raporti i Pulsit Publik*, shtator 2011.

²⁹⁰ Raporti i Performancës i DPP të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, 2010/2011 (06/2010-06-2011).

²⁹¹ Po aty.

Me gjithë rregullimin ligjor, nëpër rrugët e qyteteve të Kosovës çdo ditë vërehen fëmijë të moshës jomadhore, duke bërë punë që dëmtojnë shëndetin dhe dinjitetin e tyre. Ata i gjejmë si lypsarë në udhëkryqe rrugësh shumë të frekuentuara, si shitës ambulante të duhanit dhe mjeteve të tjera të ndaluara. Lidhur me këtë dukuri, Avokati i Popullit ka shprehur shqetësimin e vet përmes mjeteve të informimit publik, por edhe tek institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës. Avokati i Populli kërkon nga autoritetet publike të Republikës së Kosovës, që t'i respektojnë instrumentet ndërkombëtare dhe legjislacioni vendor, i cili i mbron të drejtat e fëmijëve.²⁹²

Lidhur me gjendjen e të drejtës nga marrëdhënia e punës në Kosovë, si në sektorin publik ashtu edhe në at privat, me qëllim të zbatimit të dispozitave ligjore Avokati i Popullit **rekomandon** që:

- *Qeveria të rrisë buxhetin për Ligjin e Punës dhe të sigurojë zbatimin e ligjit në dy sektorët, publik dhe privat.*
- *Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale të miratojë legjislacionin sekondar për zbatimin sa ma efikas të Ligjit të Punës.*
- *Inspektorati i Punës të shtojë aktivitetin e tij në terren, të informojë punëtorët për të drejtën tyre për të paraqitur ankesa në rast të shkeljes së ligjit nga punëdhënësit dhe të informojë punëdhënësit për obligimet e tyre ligjore ndaj punëtorëve, se mospërmbushja e tyre sanksionohet me gjobat e parapara me ligj.*
- *Inspektoratin e Punës të mbikëqyrë ekzekutimin e vendimeve që kanë të bëjnë me cenimin e Ligjit të Punës.*
- *Qeveria e Republikës së Kosovës të rregullojë me udhëzim të veçantë përvojën e punës për periudhën 1990-1999.*
- *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të ndërmarrë hapa në përpilimin e një plani strategjik për të mbrojtur fëmijët nën moshën 18-vjeçare nga kryerja e punëve në rrugë.*
- *Të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës të respektojnë dhe zbatojnë vendimet e KPMK-së, ndërsa për mosrespektimin e tyre përgjegjësit të merren në përgjegjësi, në pajtim me ligjet në fuqi.*

2.26. Të drejtat e fëmijëve

Korniza ligjore e vendit ofron bazë të mirë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mirëpo në praktikë edhe më tutje zbatimi i saj shpeshherë është i pamjaftueshëm, joadekuat apo edhe joefektiv. Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve, si dhe pozita dhe mirëqenia e tyre është e kushtëzuar edhe me situatën e përgjithshme ekonomike dhe sociale të vendit që vazhdon të mbetet e rënde për shumicën e qytetarëve të Kosovës. Përmirësimi i jetës së fëmijëve, mbrojtja, respektimi dhe promovimi i të drejtave të tyre mbetet sfidë e madhe dhe

²⁹² Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve, neni 32

në këtë drejtim duhet dhe mbetet për t'u bërë edhe më shumë nga e gjithë shoqëria kosovare. Gjatë kësaj periudhe të raportimit nuk janë shënuar përmirësime të dukshme, me gjithë përpjekjet dhe aktivitetet e ndërmarra në këtë drejtim nga institucionet e Kosovës.

2.26.1. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit Nacional të veprimit për të drejtat e fëmijëve

Bazuar në Strategjinë dhe Planin Nacional të veprimit 2009-2013, institucionet e Republikës së Kosovës, me qëllim të përmirësimit të përgjithshëm të situatës së të drejtave të fëmijëve, kanë vazhduar me ndërmarrjen e veprimeve përkatëse në fushat e përcaktuara si prioritare me strategjinë dhe planin nacional të veprimit si qeverisja, arsimi, mirëqenia sociale etj.²⁹³

Sa i përket përparimeve të bëra nga fusha e qeverisjes vlen të përmendet hartimi i raportit të parë shtetëror, lidhur me zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF), si përpjekje e qeverisë së Kosovës për të harmonizuar kornizën ligjore me KDF, përkatësisht për të realizuar disa nga objektivat e përcaktuara me strategjinë dhe planin në fjalë.²⁹⁴ Ky raport i është dorëzuar Komitetit për të Drejtat e Fëmijës të OKB në Gjenevë, i cili ka mandatin e monitorimit të të drejtave të fëmijëve. Ndërsa, ende nuk janë realizuar objektivat që i referohen funksionalizimit të Komitetit Ndërmnistror për të Drejtat e Fëmijëve, si dhe institucionalizimit të plotë të Njësive për të Drejta të Njeriut. Komiteti ndërmnistror për të Drejtat e Njeriut ende nuk është funksional.

Në këtë kontekst, edhe Njësiti për të Drejtat e Njeriut (NJDNJ), në të gjitha nivelet nuk kanë staf të mjaftueshëm, përkatësisht nuk kanë një zyrtar për të drejta të fëmijëve që në orar të plotë do të mbulonte vetëm të drejtat e fëmijëve e jo edhe çështje të tjera. Një gjë e tillë nuk është në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 04/2007,²⁹⁵ gjë që e vështirëson realizimin e Strategjisë dhe Planit Nacional brenda afateve të përcaktuara kohore. Në këtë drejtim është e nevojshme të caktohen zyrtarë përkatës që do të punojnë vetëm në çështjet e të drejtave të fëmijëve.

2.26.2. E drejta e fëmijëve për shkollim

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), duke u nisur nga prioritetet e përcaktuara me këtë plan, për fushën e arsimit ka përgatitur kornizën e re të kurrikulumit për Kosovën. Ka përgatitur kurrikulumin për gjuhën rome, me elemente të historisë dhe kulturës

²⁹³ Strategjia dhe Plani Nacional i Veprimit për të drejtat e fëmijëve në Republikën e Kosovës është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 2009.

²⁹⁴ Konventa për të Drejtat e Fëmijës është e përfshirë në listën e instrumenteve ndërkombëtare, që janë pjesë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shih *Kushtetuta e Kosovës*, neni 22, p. 7.

²⁹⁵ Shih *Udhëzimi Administrativ, nr. 4/2007, për Njësiti për të Drejtat e Njeriut në Qeverinë e Kosovës*, i nxjerr më 19 mars 2007, me qëllim të strukturimit dhe integritimit të njësive për të drejtat e njeriut në ministritë e Republikës së Kosovës.

rome, si lëndë zgjedhore dhe ka vazhduar përgatitjet për hartimin e kurrikulës bërthamë dhe programin mësimor për edukim parashkollor, shkollë fillore dhe të mesme.

Sa i përket synimit për gjithëpërfshirje në arsim është shënuar rritje lidhur me regjistrimin e përgjithshëm të fëmijëve në nivelet e shkollës fillore dhe të mesme, por jo edhe për edukimin parafillor dhe shkollimin e mesëm të lartë. Brenda regjistrimeve të bëra në shkollat fillore dhe të mesme ka dallime sa i përket qasjes në arsim. Fëmijët me aftësi të kufizuara nuk kanë qasje adekuate në arsim, përkatësisht janë të përjashtuar në mënyrë të tërthortë nga e drejta për arsimim, përveç tjerash edhe për shkak të mungesës së burimeve materiale e ndihmës, mungesës së transportit për në objektet arsimore, mungesës së aftësimin special për mësimdhënësit, si dhe për mungesë të infrastrukturës përkatëse. Në këtë drejtim edhe fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian përballen me barriera të shumta, që ndërliken përveç të tjerash edhe me mosregjistrimin civil të tyre, varfërinë, traditat etj., gjë që pengojnë apo u pamundësojnë atyre përfshirjen në arsim, apo i detyrojnë ata të braktisin atë.

Shkollimin e braktisin edhe fëmijë të përkatësive të tjera etnike. Nga të dhënat e siguruar nga MASHT, rrjedh se numri i nxënësve që e kanë braktisur shkollimin në arsimin e detyrueshëm për vitin shkollor 2010/2011 ka shënuar rënie në krahasim me vitin shkollor 2009/2010. Braktisja e shkollës nga 1485 nxënës (prej tyre 718 femra) është shqetësuese. Në këtë drejtim, në vazhden e përpjekjeve për të parandaluar këtë dukuri, MASHT së bashku me partnerë të tjerë relevantë, përveç të tjerash do të duhej të fillonte me zbatimin e përpiktë të Udhëzimit Administrativ nr. 7/2011- Krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar, të miratuar më 14 tetor 2011.

Për të mundësuar qasjen e plotë në arsim për të gjithë fëmijët, institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës do të duhej të siguronin buxhet të mjaftueshëm për gjithëpërfshirje, përkatësisht të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatim efektiv të ligjeve, politikave dhe programeve që mbështesin arsimin cilësor përfshirës.

Në lidhje me çështjen e arsimit Avokati i Popullit ka pranuar ankesë nga disa prindër të nxënësve të një shkolle të mesme, të cilët ishin ankuar kundër MASHT-it, lidhur me përmbajtjen joadekuate të testit të maturës, të cilin ata ishte dashur ta plotësonin, edhe pse ai nuk përkonte me kërkesat dhe përmbajtjen e drejtimit që ata kishin përzgjedhur.²⁹⁶ Ky veprim ata i kishte vënë në pozitë të diskriminuar, krahasuar me nxënës të drejtimit të njëjtë në një shkollë tjetër. Prindërit kishin kërkuar nga Avokati i Popullit që t'iu ndihmohet në mënyrë që testi të përsëritet. Pas ndërmjetësimit të përfaqësuesve të Avokatit të Popullit, testi ishte përsëritur dhe ndryshuar në pajtim me natyrën dhe përmbajtjen e drejtimit të përzgjedhur.

2.26.3. Puna e fëmijëve

Mbrojtja e fëmijëve nga punët e rënda dhe të rrezikshme paraqet një nga objektivat më të rëndësishme në fushën e mirëqenies sociale, e përcaktuar si fushë prioritare me Planin Nacional të veprimit. Varfëria, barrierat në arsim që ndërliken me qasjen, rëndësinë dhe kushtueshmërinë e tij, si dhe qëndrimi tolerant ndaj punës së fëmijëve, detyrojnë shumë

²⁹⁶ Ankesa: A nr. 222/2011.

fëmijë të përfshihen në punë që nga mosha e njomë.²⁹⁷ Puna e fëmijëve është e përhapur dhe mbetet ndër çështjet më shqetësuese në vend.

Qeveria e Republikës së Kosovës më 13 tetor 2011, ka miratuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit për parandalimin dhe eliminimin e formave të këqija të punës së fëmijëve 2011 - 2016. Kjo strategji dhe ky plan i veprimit synon të përcaktojë prioritetet, rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve shtetërore dhe aktorëve të tjerë në luftimin dhe parandalimin e punës së fëmijëve. Me këtë strategji, eliminimi i të gjitha formave të këqija të punës së fëmijëve në Republikën e Kosovës, deri në vitin 2016, është përcaktuar si objektivi strategjik. Duke u nisur nga situata e rëndë ekonomiko-sociale realizimi i këtij objekti, përkatësisht zbatimi adekuat i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve, do të jetë një nga sfidat më të mëdha, jo vetëm për institucionet shtetërore dhe partnerët e tjerë të involvuar në luftimin e kësaj dukurie, por edhe për tërë shoqërinë kosovare në përgjithësi.

Më 25 gusht 2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendimin nr. 09/34, ka themeluar Këshillin për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijët, me qëllim të përmirësimit të mirëqenies dhe mbrojtjes së fëmijëve. Këshilli do të merret me përcaktimin e prioriteteve dhe masave që duhet të ndërmerren nga institucionet përkatëse për përmirësimin e situatës së tanishme sa i përket mbrojtjes dhe drejtësisë për fëmijë, në nivelin qendror edhe në atë lokal.

Këshillin e përbëjnë përfaqësues të institucioneve më relevante që punojnë në fushën e mbrojtjes dhe drejtësisë për fëmijë. Institucioni i Avokatit të Popullit është pjesë e këtij këshilli. Pjesëmarrja e IAP-së, në cilësinë e anëtarit vëzhgues në këtë këshill është një mundësi e mirë për bashkëpunim më të ngushtë me aktorët e involvuar për adresimin e çështjeve që ndërlidhen me mbrojtjen dhe drejtësinë për fëmijë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, IAP ka pranuar disa ankesa kundër qendrave për punë sociale për mosrespektim të procedurave dhe dispozitave ligjore, me rastin e vendosjes për të drejtën e marrjes së fëmijës në mbikëqyrje; ankesa për mosndërmarrjen e veprimeve adekuate të gjykatave për të hetuar dhe vendosur lidhur me disa raste të dhunës në familje, si dhe ankesa për zvarritje të procedurës gjyqësore për të vendosur lidhur me propozimet për ekzekutim të vendimeve të plotfuqishme për pagesën e alimentacionit.

Përkritazi me këto raste IAP u është drejtuar autoriteteve përkatëse, nga të cilat ka kërkuar marrjen e veprimeve të duhura, të parapara me ligj. Në kontekst të vendosjes për çështjen e besimit të fëmijëve, përfaqësues të IAP-së kanë monitoruar seancat gjyqësore në disa gjykata të Kosovës. Po ashtu, me kërkesën e palëve IAP ka monitoruar seanca gjyqësore, të zhvilluara përkritazi me kërkesat për lëshim të urdhrave mbrojtës.

2.27. Mbrojtja shëndetësore dhe sociale

Gjendja e rëndë ekonomike, papunësia e madhe, mungesa e sigurimeve shëndetësore dhe sociale dhe infrastruktura e dobët shëndetësore, vazhdojnë të mbeten shqetësim i gjithë shoqërisë në Kosovë. Bazuar në ankesat e qytetarëve në Institucionin e Avokatit të Popullit,

²⁹⁷ Shih Raporti i ILO IPEC “*Hapat e ILO - IPEC për eliminimin e formave me të rënda të punës së fëmijëve në Kosovë*”, 17 nëntor 2011.

edhe gjatë këtij viti raportues, sa i përket mbrojtjes shëndetësore dhe sociale, gjendja nuk ka lëvizur shumë për të mirë. Vërehen disa lëvizje të vogla pozitive, por jo të kënaqshme për një popull me kushte të rënda ekonomike.

2.27.1. Problemet sociale dhe mungesa e legjislacionit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh rregullimin e kujdesit shëndetësor dhe sigurimin social.²⁹⁸ Megjithatë, ashtu siç e kemi cekur edhe në raportin e kaluar,²⁹⁹ problemi lidhur me bazën ligjore për rregullimin e çështjeve sociale dhe shëndetësore në Kosovë ende është i pazgjidhur.

Gjendja ekonomike dhe sociale e familjeve që jetojnë nga ndihmat sociale, për shkak të rritjes së çmimeve dhe inflacionit është përkeqësuar. Skema e ndihmës sociale në Kosovë, për shkak të buxhetit të kufizuar, ka për bazë ende familjen dhe jo individin. Sipas Ligjit në fuqi, edhe më tej mbesin të diskriminuara shtresat e popullatës së Kosovës, me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale.³⁰⁰ MPMS ka përgatitur Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit 2003/15, mirëpo ky projektligj ende nuk është shqyrtuar në Qeverinë e Kosovës.³⁰¹

Gjithashtu, që nga viti 2005, nga MPMS thuhet se është përgatitur Projektligji për Sigurimin Pensional dhe Invalidor dhe se i njëjti është dërguar për miratim në Qeverinë e Kosovës. Mirëpo, ky projektligj nuk ka kaluar për t'u votuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Infrastruktura ligjore për rregullimin e pensioneve në Kosovë vazhdon të mbetet e paplotësuar. I zbatueshëm është vetëm Ligji mbi Pensionet Bazë.

2.27.2. Gjendja ekonomike dhe sociale në Kosovë

Sa i përket punësimit në Kosovë, edhe gjatë këtij viti raportues, ka shumë ankesa në IAP. Shkalla e papunësisë mbetet ende shumë e lartë. Sipas MPMS-së numri total i personave të papunë në fillim të vitit 2011 ishte 335.260, nga të cilët 160.856 janë femra. Edhe informatat e tregut të punës në Kosovë, për muajin gusht 2011, ofrojnë të dhëna të përafërta me ato të MPMS-së, ku të papunë ishin 335.700, prej tyre 162'526 femra.³⁰²

Shtresat më të prekura nga papunësia e madhe dhe njëkohësisht më të varfra në Kosovë janë familjet e mëdha me fëmijë të vegjël, familjet me kryefamiljarë të papunë, banorët e zonave

²⁹⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 51.

²⁹⁹ IAP, Raporti i 10-të vjetor, në faqen 84, Problemet Sociale dhe mungesa e legjislacionit.

³⁰⁰ Ligji 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë.

³⁰¹ Informatë e siguruar nga Njësia për të drejtat e njeriut në MPMS deri më 31 dhjetor 2011.

³⁰² Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Informatat në tregun e punës për muajin dhjetor 2011, në: http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/ShpalljePublikime/0811_Informatat_ne_tregun_e_Punes.pdf, (09.12.2011).

rurale dhe të atyre malore. Është për t'u shqetësuar për faktin se të gjithë këta nuk trajtohen njëjtë me Ligjin 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë.³⁰³

Edhe më tej, në Kosovë ekzistojnë ligje, të cilat e rregullojnë çështjen e pensioneve të kategorive të caktuara, por ende nuk ekziston një ligj për sigurimin pensional dhe invalidor apo për skemat pensionale të financuara nga shteti. Pensionistët e Kosovës edhe më tej përballen me një situatë të rëndë ekonomike dhe sociale, si pasojë e mungesës së Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor. Kjo pjesë e shoqërisë sonë ka mbetur kategori e rrezikuar dhe kategori sociale, me gjithë kontributin e dhënë. Në IAP janë të regjistruara kërkesat e pensionistëve të Kosovës, lidhur me Projektligjin për skemat pensionale.³⁰⁴

2.27.3. Braktisja e shkollimit

Sipas rasteve të regjistruara në IAP një fenomen mjaft shqetësues është edhe braktisja e shkollimit, për shkak të kushteve të vështira ekonomike. Kjo ndodhë nga mungesa e veshmbathjes, ushqimit, si dhe pamundësisë së familjarëve për t'i transportuar fëmijët deri në shkollë. Madje, çështjen lidhur me transportin e fëmijëve në shkollë, Avokati i Popullit e ka ngritur në MASHT dhe në drejtoritë komunale të arsimit. Sipas MASHT-it, përgjegjëse për sigurimin e transportit të nxënësve janë drejtoritë komunale të arsimit, ndërkohë që drejtoritë komunale të arsimit pohojnë se në buxhetin e tyre nuk ka mjete të dedikuara për transportin e nxënësve. Në mënyrë që çështja e transportit të fëmijëve, në shkolla të mos mbetet si shkak për braktisje të shkollës, MASHT drejtoritë komunale të arsimit në Kosovë duhet që në mënyrë precize dhe të qartë të rregullojnë çështjet e buxhetit për transportin e nxënësve, të cilët kanë vështirësi për të udhëtuar deri në shkollë.

2.27.4. Çështja e strehimit

Çështja e strehimit të familjeve me asistencë sociale edhe këtë vit ka mbetur një problem mjaft i madh në Kosovë.

Një lajm i mirë është se Komuna e Prishtinës ka lëshuar në funksion banesën e vetme të ndërtuar për rastet sociale që pas luftës. Në këtë banesë janë strehuar rreth 60 familje. Mirëpo, në IAP janë paraqitur shumë ankesa kundër komisionit për ndarjen e banesave sociale në Komunën e Prishtinës për parregullsi në procesin e përzgjedhjeve të familjeve përfituese të banesave sociale.

Avokati i Popullit, më 20 shtator 2011, e ka ngritur këtë çështje në Departamentin për shëndetësi dhe mirëqenie sociale në Komunën e Prishtinës dhe me Kryetarin e komisionit për

³⁰³ Për më shumë në pjesën Barazia para ligjit, në Raportin e 11 vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit, Ligjet e zbatueshme në Kosovë me nene diskriminuese.

³⁰⁴ Rasti i regjistruar në IAP, A. 446/2009.

ndarje të banesave sociale. Sipas tyre i tërë procesi ka qenë në rregull dhe se komisioni e ka respektuar rregulloren për ndarje të banesave në shfrytëzim me qira për rastet sociale.³⁰⁵

2.27.5. Shërbimet shëndetësore

Miratimi i Ligjit për sigurime shëndetësore, i cili do të jetë një zgjidhje për shumë probleme në sistemin shëndetësor, edhe më tej ka mbetur çështje e hapur në Kuvendin e Kosovës. Kjo zvarritje nga institucionet përgjegjëse, i dëmton qytetarët e Kosovës, të cilët përballen me një gjendje të rëndë shëndetësore.

Duke marrë parasysh që popullata e Kosovës jeton në varfëri dhe në kushte të rënda ekonomike, e kjo ndikon drejtpërdrejt në shëndetin e tyre, është detyrë emergjente ndërhyrja e Qeverisë së Kosovës, që të investojë në infrastrukturën shëndetësore, në mënyrë që shumica e shërbimeve të avancuara, të kushtueshme financiarisht, të mund të kryhen brenda vendit.

Një shembull pozitiv që duhet ndjekur është zgjidhja e problemit të pacientëve me sëmundje të kancerit. Gjatë këtij viti ata kanë pasur mundësi të drejtohen në Institutin e Onkologjisë, përkatësisht në Departamentin e Onkologjisë Mjekësore të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, për të kërkuar ndihmën mjekësore, sepse tani ky institut ka filluar të bëjë trajtimin e pacientëve me terapi (kimioterapi, hormonoterapi). Kjo ka ndikuar që personat me kancer tani e tutje nuk kanë nevojë të drejtohen në institucionet shëndetësore jashtë vendit.

Përveç kushteve të vështira me të cilat po përballen pacientët në klinikat e QKUK-së, ashtu sikurse vitin e kaluar edhe këtë vit, gjatë dimrit, ata janë ballafaquar me të ftohtin, për shkak të mungesës së furnizimit të QKUK-së me ngrohje nga ana e “Termokosit”. Temperaturat e ulëta kanë bërë që pacientëve të shtrirë në klinika të QKUK-së, përveç sëmundjeve për të cilat janë atje t’u shtohen edhe sëmundje të tjera nga të ftohtit. Në këtë rast kemi të bëjmë me dështim të pafalshëm të institucioneve qendrore dhe lokale, që së paku të sigurojnë kushtet elementare për popullin e Kosovës për trajtim shëndetësor.

Një problem tjetër serioz është edhe tregu i ilaçeve në Kosovë. Edhe më tej në barnatore shiten barna pa receta nga mjeku dhe pa udhëzimet e përdorimit të përkthyer në gjuhën e qytetarëve të Kosovës. Këtë çështje Avokati i Popullit e ka ngritur edhe në Raportin e 10-të vjetor,³⁰⁶ por edhe sot nuk vërehet përkushtim i Mistrisë së Shëndetësisë për të shikuar këtë çështje e cila paraqet rrezik për popullatën e Kosovës.

Një shqetësim tjetër i ngritur nga Avokati i Popullit në raportin e 10-të vjetor, është ai lidhur me pohimet e shumë qytetarëve të Kosovës, të cilët ankohen kundër personelit mjekësor në institucionet publike shëndetësore. Pothuajse në të gjitha rastet, gjatë orarit të punës së rregullt në institucionin publik, mjekët i udhëzojnë dhe shpeshherë edhe i detyrojnë qytetarët, të shkojnë për të njëjtat shërbime në sektorin privat, aty ku ata punojnë, pas orarit të rregullt të punës, e herë-herë edhe gjatë orarit të rregullt të punës. Nuk është vërejtur se Ministria e Shëndetësisë ka vepruar për të evituar situatën e cila është përsëritur edhe gjatë kësaj periudhe

³⁰⁵ Rastet e regjistruara në IAP, A. 314/2011 dhe A. 242/2011.

³⁰⁶ Raporti i 10 vjetor i Institutit të Avokatit të Popullit, 2011, f. 86.

raportuese, edhe pse ky është problem edhe i vetë institucioneve publike shëndetësore, ku janë të punësuar këta mjekë.

Në mënyrë që kjo praktikë të evitohet, Avokati i Popullit, përsëri i rekomandon Ministrisë së Shëndetësisë rishikimin e Ligjit për shëndetësi, nr.2004/4, me qëllim të ndryshimit dhe plotësimit të tij.³⁰⁷ Sipas këtij ligji, punëtori shëndetësor, i punësuar me orar të plotë të punës në institucionin publik shëndetësor, mund të kryejë veprimtari private në kujdesin shëndetësor, vetëm pas orarit të rregullt të punës. Ministria e Shëndetësisë duhet shikuar shumë me seriozitet këtë çështje, sepse një dispozitë e tillë ligjore po keqpërdoret nga personeli mjekësor dhe po e rrezikon shëndetin publik, duke ndikuar sidomos te qytetarët me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale.³⁰⁸

Rekomandime

➤ *Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës të miratojnë infrastrukturën e nevojshme ligjore për rregullimin e skemës pensionale, në mënyrë që pensionistëve t'u sigurohet një jetë e dinjitetshme në pleqëri.*

➤ *Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës të miratojnë infrastrukturën e nevojshme ligjore të skemës së ndihmës sociale në Kosovë, në mënyrë që të gjithë qytetarët e Kosovës, të cilët janë raste sociale të përfitojnë ndihmën sociale, në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.*

Ministria e Shëndetësisë të rishikojë Ligjin për shëndetësi, nr. 2004/4, pikërisht neni 98.2 për ndryshim apo plotësim.

➤ *Qeveria duhet të monitorojë në mënyrë të përpiktë, të vazhdueshme dhe sistematike kualitetin e procedurave mjekësore, kualifikimet e personelit shëndetësor dhe në këtë mënyrë të minimizojë mundësinë e keqpërdorimit të ushtrimit të profesionit në sektorin e shëndetësisë.*

2.28. Përgjegjësia për mjedisin jetësor

Kushtetuta e Republikës së Kosovës,³⁰⁹ mbrojtjen e mjedisit e përcakton si një ndër vlerat në të cilën bazohet rendi kushtetues, ajo njëkohësisht përcakton përgjegjësinë e personave fizikë dhe juridikë për mbrojtjen e tij.

Edhe pse e drejta mjedisore është një ndër të drejtat themelore, me ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtën për jetë, të drejtën e privatësisë, të drejtën familjare, shëndetin publik, , është brengosës fakti, që nga Qeveria e Kosovës edhe në vitin 2011 është ndarë buxhet i vogël, i cili nuk do të mund të përmbush as për së afërmi kërkesat dhe nevojat minimale për tejkalimin e sfidave mjedisore me të cilat ballafaqohet Kosova.

³⁰⁷ Ligji për shëndetësi, nr. 2004/4, neni 98.2.

³⁰⁸ Ankesa e regjistruar në IAP, A. 208/2011.

³⁰⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 52, Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor.

Republika e Kosovës vazhdon të ballafaqohet me probleme mjedisore, ndotje të vazhdueshme, ndërhyrje të pakontrolluara dhe monitorim joadekuat. Ndotja e ajrit, ndotja e lumenjve, shfrytëzimi i rërës dhe zhavorrit, trajtimi i mbeturinave, problemet me deponitë e vjetra urbane, instalimet e gurëthyesve në mënyrë të egër, në çdo cep të territorit, degradimi i biodiversitetit, keqmenaxhimi i zonave të mbrojtura, shkatërrimi i pyjeve, humbja e tokave bujqësore, ndërtimet pa kriter, zhurma enorme, radioaktiviteti i pakontrolluar dhe mungesa e sistemeve monitoruese, janë vetëm disa nga sfidat dhe problemet mjedisore.

Miratimi me vonesë i planit strategjik të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) u ka lënë hapësirë abuzuesve me resurset natyrore dhe mjedisin.³¹⁰

Intervenimet më të shprehura në mjedis që ndotin ambientin pamëshirshëm, duke lënë pasojë të paripariueshme, vijnë nga projektet e mëdha të operatorëve publikë ekonomikë dhe privatë. Pikat e nxehta të krijuara nga operatorë si KEK-u (Obiliq), Ferronikeli (Drenas), Sharcemi (Han i Elezit), kompleksi industrial “Trepça” në Mitrovicë, ngrohtoret publike, deponitë e mbetjeve urbane dhe industriale, si dhe trafiku, përbëjnë varre të mëdha mjedisore dhe gjeneratorë të ndotjeve me përmasa shkatërrimtare.³¹¹ Faktorë motivues i të gjitha këtyre ndërhyrjeve pa kriter dhe i krimeve mjedisore, vazhdojnë të jenë: neglizhenca e organeve të inspektorateve komunale dhe qendrore, si dhe *zvarritjet e proceseve në gjykata, lidhur me çështjet mjedisore.*³¹²

Si lëvizje pozitive dhe inkurajuese për mbrojtjen e mjedisit, Avokati i Popullit përshëndet angazhimin e Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor të Kuvendit të Republikës së Kosovës, bashkëpunimin e Inspektoratit MMPH-së me IAP-në, si dhe përfshirjen e krimeve mjedisore në kuadër të Projektkodit Penal të Republikës së Kosovës. Edhe pse gjatë vitit 2011 janë shënuar përmirësime, bashkëpunimi në mes të OJQ-ve dhe MMPH-së, nuk ishte i kënaqshëm. Pjesëmarrja e publikut dhe e OJQ-ve në politikbërje, vazhdon të mos jetë e kënaqshme.

Në Kosovë, megjithëse mungojnë shënime të sakta zyrtare, mendohet se gjatë vitit 2011, përafërsisht 1000 hektarëve tokë bujqësore u është ndërruar destinimi. Arsyet e ndërrimit të destinimit janë: shndërrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore; fragmentimi i parcelave të mëdha në parcela të vogla, si pasojë e ndarjes së pasurisë së familjeve; mosshfrytëzimi i tokës në mënyrë të qëndrueshme duke mos e kultivuar; ndërtimi i rrugëve dhe autostradave; eksploatimi i mineraleve dhe i zhavorrit³¹³ dhe lënia djerrë e tokës së plleshme bujqësore. Në këtë drejtim, kanë ndikuar dukshëm edhe neglizhenca e organeve komunale në hartimin e planeve zhvillimore të komunave, moskoordinimi i organeve përgjegjëse me qëllim të mbrojtjes së tokës bujqësore, moskërkimi i pëlqimit të disa prej komunave (Mitrovica, Skenderaj, Drenas, Klina, Prizren, Shtime, Gjilani, Kamenica) nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) me rastin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore të kategorisë 1-4, për Planet Zhvillimore Komunale. Komunitat si: Lipjani, Shtërpca

³¹⁰ www.gapmonitor.org, më 27 korrik 2011. Në mbledhjen e 26, Qeveria e Kosovës ka miratuar Planin Zhvillimor Strategjik të MMPH 2011-2014. MMPH është ministria e pestë për të cilën miratohet një plan i tillë zhvillimor trevjeçar.

³¹¹ Magazina Evropiane “Mjedisi”, korrik 2011, fq. 4.

³¹² Informatë e pranuar nga Inspektorati i MMPH-së, datë 23 prill 2012, sipas të cilës gjatë vitit 2011, nga Inspektorati i MMPH-së janë bërë këto inicime gjyqësore si: në sferën e mjedisit 24 raste; në sferën e ujërave 39 raste; në sferën e ndërtimit dhe planifikimit 3 raste; në sferën e natyrës 4 raste.

³¹³ TC “Kosova A, B, C”, Ferronikeli, Trepça.

dhe Suhareka nuk kanë kërkuar pëlqim nga MMPH, lidhur me ndërrimin e destinimit. Ndërtimet kanë vazhduar edhe në tokat nën sistemin e ujitjes dhe komasacion (pjesët e rreth Prizrenit dhe Gjakovës). Po ashtu pjesë të tokës bujqësore cila është në administrimin e Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP), nuk punohet dhe është e mbetur djerrë. Shembuj tipikë të moszbatimit të Ligjit për tokat bujqësore janë ndërtimet e vendbanimeve (lagjeve) të reja në periferi të Prishtinës, jashtë zonës urbane, si dhe zhvillimi i zonës industriale, po ashtu në Prishtinë.

Edhe pse gjatë vitit 2011, sipas planit të APK-së, janë pyllëzuar 350 ha pyje,³¹⁴ nga ana tjetër ka vazhduar degradimi dhe ndërrimi i destinimit të pyjeve, përmes prerjeve të pakontrolluara, dhe të palicencuara, djegieve, si dhe eksplotimit të gurëve nga gurëthyesit. Në këtë drejtim ka ndikuar mospërcaktimi i qartë i përgjegjësive dhe kompetencave ligjore, përkatësisht përzjerja e kompetencave midis nivelit qendror, lokal, zonave të mbrojtura me ligj të veçantë, si dhe zonat e kontrolluara nga organet paralele. Veç kësaj, në këtë drejtim dukshëm ka ndikuar edhe mungesa e përkujdesjes institucionale, si numri i vogël i rojeve të pyjeve (1 roje për 1000 ha pyll), numri i vogël i inspektorëve pyjorë, mosaplikimi i masave ndëshkimore, si dhe zvarritjet procedurale pranë gjykatave. Veç të tjerash, kjo ndodhë, sepse në Republikën e Kosovës një Ligji i ri për Pyjet dhe mbrojtjen e tyre, nuk është miratuar ende. Janë ngritur 190 inicime gjyqësore nga APK, mirëpo nga ana e gjykatave asnjë nga to nuk është proceduar.³¹⁵

Një kaosi të vërtet mjedisor në Kosovë i ka ndihmuar edhe mungesa e planit hapësinor strategjik i Kosovës,³¹⁶ e planeve zhvillimore komunale, si dhe planeve hapësinore që janë obligim i komunave.³¹⁷ Vazhdimi i mbindërtimit të objekteve dhe ngritja e etazheve në sipërfaqe të ngushta hapësinore të dendura, pa u respektuar standardet dhe pa respektim të distancave (shpeshherë ngjitur me njëra-tjetrën), pa ndriçim, pa ajrosje dhe qasje adekuate në hyrjet e ndërtesave; mungesa e infrastrukturës përcjellëse publike, e parkingjeve; formimi i lagjeve joformale; pamundësia dhe liria e kufizuar e qarkullimit të këmbësorëve nëpër rrugë publike, për arsye të zënies së trotuareve me vetura; mungesa e hapësirave të gjelbra, në të gjitha qendrat urbane të Kosovës, por posaçërisht në komunën e Prishtinës, Avokati i Popullit i konsideron shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, cenim të lirisë së lëvizjes, shëndetit publik, të drejtës në familje, e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe posaçërisht të drejtave të fëmijëve, marrë parasysh implikimet e këtyre problemeve në shëndetin psikik dhe fizik të fëmijëve.

Rasti i shembjes së dheut, në lagjen Lakrishte në Prishtinë, më 23 shtator 2011, informatat e pranuar lidhur me rrëshqitjen e dheut në lagjen “Arbëria”, paraqesin shembujt e ndikimit në mjedis, ndikim në qëndrueshmërinë e ndërtesave fqinje, si dhe rrezikim të jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarëve, si dhe të rendit dhe sigurisë publike. Edhe pse këto vendndërtime janë shpesh në lagje të banueshme, jo rrallë janë të parrethuara, punimet në to kryhen gjatë vikendeve dhe në orët e mbrëmjes, duke krijuar rrezik të vazhdueshëm për jetën dhe shëndetin

³¹⁴ Sipërfaqe të pyllëzuara sipas planeve pyjore, nga ana e Agjencia Pyjore e Kosovës, bazuar në informatat e pranuar nga drejtori i Agjencia Pyjore e Kosovës, 8 dhjetor 2011.

³¹⁵ Informate e pranuar nga Agjencia Pyjore e Kosovës, datë 23 prill 2012, sipas të cilës gjatë vitit 2011, ka 190 fletëparaqitje, 161 kundërvajtje dhe 29 vepra penale. Ndërsa nga organet komunale janë ngritur 7635 fletëparaqitje, nga të cilat 4868 kundërvajtje dhe 2767 vepra penale.

³¹⁶ Informatë e pranuar nga Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës, datë 23 prill 2012.

³¹⁷ Magazina Evropiane “Mjedisi”, korrik 2011, fq. 27.

e qytetarëve.³¹⁸ Edhe pse ka shkelje të dukshme të Ligjit për Ndërtimin, Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ligjit për mbrojtje nga Zhurma, reagimi i inspektorateve lokalë vazhdon të mos jetë i kënaqshëm.

Në zonat që dikur kishin, e pjesërisht edhe sot kanë kapacitete industriale, si Mitrovica, Obiliqi, Drenasi, Gjilani, Peja, Ferizaj dhe Hani i Elezit, kemi ndotje të vazhdueshme të tokës, duke mos u respektuar standardet për mbrojtjen e saj. Të gjitha këto ndërmarrje industriale, në shumicën e rasteve tashmë të privatizuara, por edhe ato në pronësi shtetërore, vazhdojnë të eksternalizojnë shpenzimet e ndryshme, sidomos me ndotjen dhe shkatërrimin e mjedisit jetësor. Jashtëzakonisht shqetësues është lirimi i metaleve të rënda nga proceset industriale si mercuri metalik, arseni, plumbi, kadmiumi, beriliumi, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sistemin nervor, sistemin kardiovaskular, sistemin urinar, duke shkaktuar pneumoni dhe plagë të rënda në lëkurë.³¹⁹

Në Kosovë, me gjithë apelet e shumta të ekspertëve dhe institucioneve, vazhdon praktika e djegies së gomave në prag të festave, djegieve të hamulloreve në kohën e korrje-shirjeve, si dhe e pyjeve, që ndikojnë drejtpërdrejt në kualitetin e tokës, humbjen e vlerave të saj, erozionin, pa harruar dëmin që shkaktohet me ndotjen e ajrit. Po ashtu, vazhdon keqmenaxhimi i mbeturinave të ndërtimit, si dhe moszbatimi i udhëzimit administrativ nr. 02-2009 për Administrimin e automjeteve të hedhura, si dhe vendimi i Qeverisë i datës 19 qershor 2009, për këtë lloj mbeturinash.

Krahasuar me vitin e kaluar, ka përparim në fushën e matjeve dhe të mbrojtjes së cilësisë së ajrit. Nga MMPH dhe Komisioni Evropian, janë blerë pajisje për monitorimin e ajrit, nga të cilat vetëm 4 janë vënë në funksionim, ndërsa 5 të tjera janë në kompletim. Sistemi i monitorimit është vendosur edhe në Prishtinë. Në rajonin e Prishtinës janë regjistruar tejkalime të vlerave limite të ndotësit PM10 dhe blozë. Janë regjistruar tejkalime të vazhdueshme PM10, PM2.5, nga Ferronikeli. Sharcemi ka tejkalime të blozës dhe plumbit, stacioni monitorues i vendosur atje nuk është funksional.³²⁰ Nga KEK-u vazhdon të regjistrohet emetimi i pluhurit, SO2 dhe NOX, vlera të cilat i tejkalojnë kufijtë e paraparë me direktivat e BE-së. Prodhimi i xeheve sulfide në Mitrovicë, paraqet ndotësin më të madh të ajrit, duke ndikuar në ujë dhe tokë, me lirim të sasive të mëdha të metaleve të rënda, plumb dhe kadmium.

Kërkesa e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK), për vendosjen e një sistemi monitorues në hapësirat afër Fakultetit Filozofik, janë refuzuar nga komuna e Prishtinës, po ashtu vendosja e një sistemi të tillë është refuzuar nga sistemi paralel në Brezovicë.³²¹ Fatmirësisht, zbrazëtirat ligjore në fushën e monitorimit të ajrit janë mbuluar.

Edhe pse e drejta në ujë të pijshëm është e drejtë elementare, në Kosovë vetëm 70% të popullatës kanë qasje në ujësjellës kurse pjesa tjetër furnizohet nga puset, në të shumtën e rasteve të pakontrolluara. Duke pasur parasysh se vetëm 48% e popullatës kanë qasje në sistemin e kanalizimit, për tërë këtë përqindje të shkarkimit nuk ka trajtim të ujërave të zeza. Duke pasur parasysh rëndësinë e ujit si e drejtë elementare, në këtë lëmi është vërejtur shumë

³¹⁸ Vendndërtimet në lagjet Arbëria, Bregu i Diellit, Mati etj.).

³¹⁹ Raport, Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2008-2010, MMPH, AKMM, 2011.

³²⁰ Bazuar në informatat e pranuar nga drejtori i Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, 15 dhjetor 2011.

³²¹ Po aty.

pak përparim. Edhe sa i përket cilësisë së ujit, ka pasur shumë pak përparim.³²² Numri i impianteve tregon gjendjen e ujërave në Kosovë. Aktualisht në Kosovë është vetëm një impiant për trajtimin të ujërave industriale,³²³ një tjetër është në proces të kompletimit. Zonat e cenueshme të ujërave dhe vendet e mbrojtura nuk janë përcaktuar ende.

Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk është bërë asnjë lëvizje pozitive në sferën e monitorimit të ujërave nëntokësorë. Ka vazhduar degradimi i pakontrolluar i pellgjeve të lumenjve nga nxjerrja e inerteve pa kritere, qoftë në aspektin e ruajtjes së regjimit të ujërave, qoftë edhe nga aspekti i shfrytëzimit të lëndëve minerale, duke shkaktuar ndërrimin e anës së lumenjve dhe bartjen e sipërfaqeve të tokave pjellore.

Fatkeqësisht, edhe pse një pjesë e infrastrukturës ligjore ekziston, një problem jashtëzakonisht të madh të natyrës politiko-juridike paraqet moszbatimi i ligjeve ekzistuese në Republikën e Kosovës. Implementimi i Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis ka filluar, por cilësia e raporteve kërkon përmirësim.³²⁴

Një përparim i kufizuar është arritur në fushën e kontrollit të ndotjes industriale dhe menaxhimit të rrezikut.³²⁵ Ligji për mbrojtje nga zhurma vazhdon të mos ketë zbatim. E njëjta vlen edhe për Ligjin për duhanin. Edhe pse është paraparë ndalimi i pirjes së duhanit në hapësirat publike, ai vazhdon të mos zbatohet, madje nuk zbatohet as ndarja fizike e hapësirave, dhe as vendosja e aparateve përkatëse të ventilimit. me gjithë kërkesat e shumta ende nuk është miratuar Ligji për Fondin për Mbrojtjen e Mjedisit.

Problemet mjedisore në Republikën e Kosovës mbeten alarmante. Ndërmarrja e masave të menjëhershme për parandalimin e ndikimit të pakontrolluar dhe pa kriter në mjedis, është kërkesë urgjente. Ne as si shoqëri, as si institucione dhe as si gjeneratë, nuk kemi kurrfarë të drejte që brezave t'u lëmë një trashëgimi të tillë mjedisore. Qeveria e Kosovës, duhet fillojë me rritjen e buxhetit për MMHP-në, kur kemi parasysh që kostoja e mbrojtjes mjedisore ka çmim të lart, mirëpo çmimi i riparimit të degradimit në të ardhmen, do të jetë shumë më i lartë.

Rekomandimet

- *Të rritet buxheti për MMHP-në.*
- *Të krijohet një trup, organ apo autoritet ndërinstitutional, i përbërë nga institucionet përgjegjëse shtetërore, njohës të fushës mjedisore dhe shoqëria civile, i cili do t'i harmonizonte planet ekonomike me kufizimet mjedisore, dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi.*
- *T'i jepet prioritet çështjeve të mjedisit nga ana e gjykatave.*
- *Të miratohet Ligji për Fondin për Mbrojtjen e Mjedisit.*

³²² http://mei-ks.net/repository/docs/Raporti_i_Progresit_per_Kosoven_2011_-_Shqip.pdf

³²³ Impianti në Skenderaj.

³²⁴ Po aty.

³²⁵ Po aty.

- *Të përforcohen inspektoratet e mjedisit në nivelin qendror dhe lokal, në kuptimin e burimeve njerëzore dhe nga pikëpamja e ndarjes së buxhetit.*
- *Të begatohet rrjeti i monitorimit në pikat e nxehta si Ferronikeli, Sharcemi, KEK, në vendet ku shkarkimet nga mjetet e komunikacionit janë të mëdha, si dhe në qytetet me ngrohtore.*

2.29. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave

Mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të qytetarëve e garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës,³²⁶ Ligji për Gjykatat,³²⁷ si dhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj, e cila zbatohet drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.³²⁸

Realizimi i kësaj të drejte kushtetuese në praktikë vazhdon të përcillet me vështirësi të shumta. Me gjithë përpjekjet, premtimet dhe deklaratimet e shumta për përparim në këtë fushë, edhe gjatë periudhës raportuese qytetarët e Republikës së Kosovës janë ballafaquar me vështirësi të mëdha gjatë realizimit të kësaj të drejte, për shkak të gjendjes jo mire në sistemin gjyqësor në vend.

Reformat e përfunduara në gjyqësor vitin e kaluar, që për qëllim të fundmë kishin funksionalizimin e gjyqësorit kosovar në përputhje me standardet ndërkombëtare, si: procesi i riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, miratimi i ligjeve bazike për gjyqësorin, miratimi i Strategjisë Shtetërore për Reduktimin e lëndëve të vjetra, ngritja e pagave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, ndërtimi i objekteve gjyqësore, nuk kanë dhënë rezultatin e pritur për qytetarët.

Mosfunksionimi i pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit; zvarritja e procedurave civile dhe penale në shqyrtimin e lëndëve; numri i madh i lëndëve të pazgjdhura nga vitet paraprake; shkalla e ulët e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore; parashkrimi i lëndëve gjyqësore nga gjykatat, elementet korruptive në gjykata; moszbatimi në praktikë i Konventës Evropiane për të Drejtat të Njeriut, si dhe mosinterpretimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimet gjyqësore, janë disa nga format e shkeljes së të drejtës së gjyqimit brenda afatit të arsyeshëm kohor që për pasojë ka rrënimin e besimit në sistemin e drejtësisë sundimin e ligjit në Kosovë.

³²⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 54: “Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.

³²⁷ Ligjin për Gjykatat, nr. 03L-199, neni 7. p. 3. (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti V / nr. 79 / 24 gusht 2010): “Çdo person ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës për të kërkuar mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tij të ligjshme. Çdo person ka të drejtë të përdor mjetet juridike kundër një vendimi gjyqësor apo administrativ

që cenon të drejtën apo interesat e tij në mënyrën e caktuar me ligj”.

³²⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22, p (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj

Mosshtrirja pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit, ashtu siç parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës,³²⁹ me gjithë deklaratimet e shumta politike të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, për funksionalizimin e gjyqësorit, mbetet shqetësim i jashtëzakonshëm dhe plagë e hapur për Republikën e Kosovës. Që nga shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës,³³⁰ Gjykata e Qarkut dhe ajo Komunale, Prokuroria e Qarkut dhe ajo Komunale, Gjykata për Kundërvajtje në Mitrovicë, Gjykata për Kundërvajtje në Zubin Potok dhe Leposaviq, vazhdojnë të mbeten jashtë sistemit gjyqësor të Kosovës. Lëndët penale dhe civile, mbi 11.700 lëndë në prokurori dhe 1.615 lëndë në gjykatat e lartpërmendura, rrezikohen të parashkruhen për shkak të kalimit të afateve të parapara ligjore. Po ashtu, shumë dokumente personale si letërnjoftime dhe pasaporta të konfiskuara nga policia, si prova, kanë mbetur në këto institucione.

Mosshqyrtimi i lëndëve gjyqësore të qytetarëve nga gjykatat dhe prokuroritë në Mitrovicë, paraqet shkelje të rëndë të drejtave dhe lirive të njeriut. Ky fakt vazhdon të mbetet një sfidë e madhe për autoritetet e Republikës së Kosovës, për të siguruar funksionimin e shtetit ligjor.

Për shkak të ankesave të shumta të qytetarëve që kanë lëndë gjyqësore të pa proceduara nga gjykatat, Avokati i Popullit, në lidhje me mosfunksionimin e organeve të judikaturës në pjesën veriore të Mitrovicës, më 27 prill 2011, ka dërguar Raportin me Rekomandime institucioneve gjegjëse shtetërore,³³¹ përmes së cilës kërkoi që të merren masa të duhura dhe të sigurohet qasje e qytetarëve në shërbimet gjyqësore sa më shpejtë që të jetë e mundur.

Numri i lartë i lëndëve të pashqyrtuara gjyqësore të trashëguara si të pazgjidhura nga periudhat paraprake po parashkruhen sipas ligjit, pasi kanë kaluar afatet ligjore për shqyrtim. Sipas Raportit vjetor 2011 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK),³³² statistikave të gjykatave të rregullta, vetëm gjatë vitit raportues janë parashkruar 2.371 lëndë dhe kjo paraqet një prej shkeljeve më të rënda të drejtave dhe lirive të njeriut. Po ashtu sipas raportit, shihet se numri i lëndëve të ngelura si të pazgjidhura nga gjykatat në fund të viti 2011 është 213.037 lëndë, ndërsa gjatë viti 2011, gjykatat kanë pranuar 86.394 lëndë të reja dhe i kanë zgjidhur gjithsej 82.805 lëndë. Nga kjo mund të konstatohet se në gjykata ka më shumë lëndë të pazgjidhura se një vit më parë. Po ashtu, nga raporti mund të konstatohet se rritje të numrit të lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2011 në raport me vitin 2010 ka në të gjitha nivelet e gjykatave. Gjykata Supreme e Kosovës ka rritje të numrit të pazgjidhura 16,47%, Gjykata Ekonomike e Kosovës për 26,91 %, gjykatat e qarkut 5,3 % dhe gjykatat komunale prej 1,1 %.

Strategjia shtetërore për reduktimin e lëndëve të vjetra e përpiluar nga KGJK, e miratuar më 18 nëntor 2010,³³³ e cila kishte si pikësynim zvogëlimin e numrit të lëndëve të pashqyrtuara,

³²⁹ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 102, p. 2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.

³³⁰ Më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës shpalli Kosovën shtet të pavarur e sovran.

³³¹ *Raport me rekomandime, lidhur me mosfunksionimin e organeve të judikaturës në pjesën veriore të Mitrovicës*, i datës 27 prill 2011, drejtuar z. Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit të Kosovës, me kopje për z. Enver Peci, kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Fejzullah Hasani, kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës; Ismet Kabashi, kryeprokuror i Kosovës; Xhevdet Abazi, kryetar i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë.

³³² *Raporti vjetor 2011 i Këshillit Gjyqësor të Kosovës*, Statistikat e gjykatave të rregullta, www.kgjk-ks.org, 2.4.2012.

³³³ *Këshilli Gjyqësor i Kosovës*, Vendimi Nr. 22/2010, 18 nëntor 2010, Strategjia Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra.

nuk ka dhënë rezultatet e pritura. Faktor kyç për këtë gjendje jashtëzakonisht të rëndë, sipas KGJK, është numri i vogël i gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ky është edhe konstatimi i Avokatit të Popullit, të paraqitur edhe në Raportin e 10-të vjetor.

KGJK më 23.02.2011 kishte shpallur konkurs për pranimin e 111 gjyqtarëve për të gjitha nivelet e gjykatave.³³⁴ Për shkak të procedurave të komplikuar administrative dhe neglizhencës, deri më tani ishin përzgjedhur vetëm gjyqtarët e Gjykatës Supreme dhe të gjykatave të qarkut, ndërsa gjyqtarët e gjykatave komunale dhe të gjykatave për kundërvajtje ende nuk ishin zgjedhur. Pasi numri më i madh i lëndëve të pazgjidhura gjendet në gjykatat komunale - 196.713 lëndë,³³⁵ KGJK do të duhet t'i përshejtojë dhe miratojë procedurat më praktike dhe efikase për zgjedhjen e gjyqtarëve.

Avokati i Popullit e ka mirëpritur nivelizimin e pagave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në raport me pushtetin ekzekutiv. Njëherit ky ka qenë edhe rekomandim në raportin e vitit 2010 për zbatimin e Ligji për Gjykatat nr. 03/L-199, posaçërisht të neneve 29 dhe 36 dhe sigurisht ka ndikim pozitiv në efikasitetin e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Avokati i Popullit shpreh shqetësimin lidhur me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 04/13, të datës 29.04.2011, për Themelimin e Këshillit Konsultativ për Drejtësi, si ndërhyrje në pavarësinë e gjyqësorit.³³⁶ Ndarja e pushteteve në Republikën e Kosovës rregullohet me aktin më të lartë juridik të vendit, Kushtetutën e cila në nenin 4 dhe kapitullin VII, garanton pavarësinë e gjyqësorit nga pushtet e tjera, legjislativi dhe ekzekutivi.³³⁷

2.29.1. Gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it

Edhe në këtë vit raportues sistemi gjyqësor dhe prokurorial i vendit vazhdon të mbështetet nga një kontingjent i gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, të cilët janë të angazhuar në kuadër të misionit evropian për sundim të ligjit në Kosovë - EULEX.

Qëllimi i punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it është të ndihmojë autoritetet gjyqësore vendore për zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur të drejtësisë, të lirë nga ndërhyrjet politike, i cili punon duke respektuar standardet e njohura ndërkombëtarisht dhe praktikat më të mira evropiane.

Gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it, kanë përgjegjësi ekzekutive në gjyqësor. Ata punojnë me gjyqtarët vendorë, në panele të përziera, në të gjitha nivelet, në gjykimin dhe hetimin e rasteve të krimeve të luftës, gjenocidit, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve ndëretnike, vrasjeve, vrasjeve të rënda, krimet ekonomike dhe të krimeve të tjera. Ata po

³³⁴ *Këshilli Gjyqësor i Kosovës*, Konkursi i datës 23 shkurt 2011, për plotësimin e pozitave të lira në gjyqësor.

³³⁵ Po aty, Raporti vjetor 2011 KGJK, faqe 3, tabela nr.2.

³³⁶ Qeveria e Republikës së Kosovës, vendimi për Themelimin e Këshillit Konsultativ për Drejtësi, nr.04/13, i miratuar më 29.04.2011, www.kryeministri-ks.net (16.12.2011).

³³⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] “*Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë*”. Shih, po ashtu, Kapitulli VII nenet-102-110.

ashtu kanë kompetenca edhe për gjykimin e lëndëve civile të të gjitha natyrave dhe niveleve të gjyqësorit sipas ligjit mbi kompetencat.³³⁸

Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka kurrfarë kompetenca mbi gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it. Ata emërohen/shkarkohen dhe i përgjigjen Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, si dhe shefit të prokurorëve të EULEX-it, i cili vepron nën urdhrat e shefit të Komponentit të Drejtësisë të EULEX-it.

Gjatë këtij viti raportues ka pasur disa ankesa të qytetarëve ndaj gjyqtarëve të EULEX-it, për shkak të zvarritjes së procedurave gjyqësore në vendosjen e lëndëve gjyqësore, por edhe për shkak të parashkrimit të lëndës nga prokuroria.

Mirëpo, shumë më i madh ishte numri i kërkesave të qytetarëve ishte që lëndët e tyre gjyqësore të gjykohen nga gjyqtarët e Eulex-it dhe jo nga gjyqtarët vendorë. Palët këtë e bënin për shkak të dyshimeve të tyre në gjykimin objektiv të lëndës nga gjyqtarët vendor dhe kjo ishte, si pasojë e humbjes së besimit në drejtësinë vendore.

Qytetari nga komuna e Gjilanit, më 5.8.2011, ishte ankuar në IAP, për shkak se Prokuroria e EULEX-it me shkresën PP.no 23/2011, të datës 3.5.2011, kishte marrë Aktvendim mbi hedhjen e kallëzimit penal të policisë G-00-2213/RIU#0073-00, të datës 10 mars 2000, me arsyetimin ligjor se ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale, sipas nenit 208 & 1 (3) të KPPK-së.³³⁹ Në rastin konkret IAP, pas analizimit të rastit mbi bazën e ligjit, palën e këshilloi që rastin e tij ta paraqet në Panelin e të Drejtave të Njeriut të EULEX-it, me seli në Prishtinë.

Avokati i Popullit në të gjitha rastet e ankesave të qytetarëve u është drejtuar me shkresa gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it, duke kërkuar informata lidhur me lëndët dhe në të gjitha rastet ka marrë përgjigje me shkrim. Avokati i Popullit ka hasur në mirëkuptim dhe bashkëpunim të shkëlqyeshëm me gjyqtarët dhe prokurorët e misionit ndërkombëtar të EULEX-it, në hetimin e të gjitha ankesave të qytetarëve. Me këtë rast Avokati i Popullit shfrytëzon momentin për të falënderuar komponentin e drejtësisë të EULEX-it për bashkëpunimin të ndërsjellë.

2.29.2. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,³⁴⁰ Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Vendimet e saj janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Por, në praktikën dyvjeçare, ka raste kur vendimet e saj nuk zbatohen nga institucionet shtetërore.

³³⁸ Ligjin mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Çaktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, nr. 03L 053, neni 5. p. 1. (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti III / nr. 27 / 03 qershor 2008).

³³⁹ Rasti i regjistruar në IAP nr.262/2011.

³⁴⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 1124 [Parimet e përgjithshme], Neni 116 [Efekti juridik i vendimeve].

Disa ish-punonjës të fabrikës së çelikut “IMK” Ferizaj, e kishin ngritur në IAP çështjen e moszbatimit të Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, C.nr.340/2001, të datës 11 janar 2002, kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Gjykata komunale në Ferizaj, me aktgjykimin e datës 11 janar 2002, e ka miratuar kërkesën për kompensimin e rrogave të papaguara të 572 punonjësve në ndërmarrjen e çelikut “IMT” në shumën prej 25.649.250,00 eurosh. Edhe pse u bë i plotfuqishëm aktgjykimi, ai asnjëherë nuk u përmba. Pas përfundimit të procedurave gjyqësore në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, dhe shterjes së të gjitha mjeteve juridike, më 3 mars 2009, Sindikata e pavarur e punonjësve të fabrikës së çelikut “IMT” Ferizaj i parashtroi kërkesë Gjykatës Kushtetuese për përmbaimit të vendimit të plotfuqishëm gjyqësor të Gjykatës Komunale në Ferizaj.

Gjykata Kushtetuese me Aktgjykimin Nr. KI 08/09, e shpall të pranueshme kërkesën dhe konsideron që ka pasur shkelje të nenit 31 (E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm) të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6 (E drejta për gjykim të drejtë) dhe 13 (E drejta për zgjedhje efektive) të KEDNJ. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese konsideron që vendimi final dhe i detyrueshëm i Gjykatës Komunale në Ferizaj duhet të ekzekutohet nga autoritete kompetente, nga Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, si pasardhës ligjor i AKM-së.³⁴¹ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 17 dhjetor 2010, deri në ditën e sotme ende nuk është zbatuar nga ana e autoriteteve shtetërore të obliguara sipas aktgjykimit, Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Nga tërë procesi gjyqësor i të punësuarve në “IMT-Ferizaj” që nga viti 2002 e deri më tani 2012, ka prodhuar grumbuj të letrave të pavlera për ta, humbje të besimit në institucionet shtetërore, dhe shpresa se një ditë do të triumfojnë drejtësia.

2.29.3. Ankesat e qytetarëve ndaj gjyqësorit

Avokati i Popullit, në bazë të Kushtetutës dhe nenit 15.6 Ligjit për Avokatin e Popullit, ka kompetenca të kufizuara në hetimin e ankesave qytetarëve, në fushën e gjyqësorit. Në çdo rast, asnjë veprim i Avokatit të Popullit, nuk prek apo rrezikon pavarësinë e prokurorëve në zhvillimin e hetimeve dhe gjyqtarëve në marrjen e vendimeve gjyqësore.³⁴²

Avokati i Popullit, në rastet e hetimit të ankesave, vëmendje të veçantë i kushton mbrojtjes së parimeve të gjykimit të drejtë, si dhe të drejtës së gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, të garantuara në nenin 6 të KEDNJ.

Edhe në vitin 2011 numri më i madh i ankesave të qytetarëve të paraqitura në IAP i përkasin gjyqësorit si palë përgjegjëse. Ky është një tregues i gjendjes së rëndë të sistemit gjyqësor, i

³⁴¹ Gjykata Kushtetuese Aktgjykimin Nr. KI 08/09, Sindikata e pavarur e punonjësve të Fabrikës së çelikut-IMK Ferizaj.

³⁴² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 132-135; Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, neni 15, p. 6. “Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedurat ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç në raste të zvarritjeve të paarsyeshme apo keqpërdorimit të dukshëm të pushtetit.”

cili ende nuk ka arritur të përmbushë detyrimet ligjore në raport me kërkesat dhe të drejtat e garantuara të qytetarëve, për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të tyre.

Qytetarët, kundër gjykatave si palë përgjegjëse, në IAP kanë parashtruar gjithsej 365 ankesa, prej tyre 162 ankesa janë vendosur si të papranueshme, sipas nenit 19.1.3 të Ligjit për Avokatin e Popullit,³⁴³ ndërsa për 193 ankesa është marrë vendim për të hapur hetime dhe 12 ankesa janë në pritje për shqyrtim. Numri më i madh i ankesave është paraqitur kundër gjykatave komunale, të qarkut, Gjykatës Supreme të Kosovës, por edhe kundër Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Në të gjitha rastet, kur kërkesat apo ankesat e qytetarëve në lidhje me gjyqësorin nuk kanë qenë në përputhje me kompetencat e Avokatit të Popullit, ata janë udhëzuar dhe drejtuar tek institucionet kompetente profesionale për ofrimin e shërbimeve juridike, si në Komisionin për Ndihmë Juridike dhe shoqatat joqeveritare, të cilat kryejnë shërbime ligjore falas për qytetarët.

Nga analiza e natyrës së ankesave të hetuara të qytetarëve, konstatohet se shumica e ankesave ka të bëjë me zvarritje, herë-herë disavjeçare, të procedurave gjyqësore, pastaj për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të plotfuqishme, dyshime në objektivitetin e gjyqtarit në vendosjen e lëndës, përfaqësimit jo të mirë nga avokatët mbrojtës.

Zvarritja e procedurave gjyqësore, para së gjithash është pasojë e numrit të madh të lëndëve të trashëguara nga vitet paraprake. Këtë fakt e rëndon edhe më shumë mbërritja e vazhdueshme e numrit të madh të lëndëve të reja nga sfera të ndryshme. Kurse gjendjen edhe ashtu të vështirë, e bën gati të pa rrugëdalje, sigurisht edhe kufizimi i të gjitha resurseve financiare dhe humane për gjyqësorin. Sipas raportit vjetor 2011 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës statistikat e gjykatave të rregullta, numri i lëndëve të ngelura si të pazgjidhura në gjykata në fund të vitit 2011 është 213.037.³⁴⁴

Me gjithë gjendjen e këtyrë në gjyqësor, Avokati i Popullit nuk gjen arsyetim për zvarritjen e procedurave që kanë të bëjnë me konteste pronësore, kur qytetarët janë të detyruar që vendimet t'i presin me vite të tëra. Këtë gjendje të gjyqësorit, lidhur me vonesat dhe zvarritjet në shqyrtimin e lëndëve e kishin konstatuar edhe organizatat ndërkombëtare për monitorimin e gjyqësorit.³⁴⁵

Edhe gjatë vitit 2011 në IAP kanë ardhur në disa raste ankesa për veprime e qëndrime të njëanshme të gjyqtarëve, për jobektivitet në shqyrtimin e rasteve dhe është kërkuar ndihma e IAP-së për përjashtimin e tyre nga gjykimi i çështjes. Nga Avokati i Popullit ankuesit janë sqaruar mbi kërkesat e ligjit për përjashtimin e gjyqtarëve dhe rrugën ligjore që duhet të ndjekin për realizimin e të drejtave të tyre.

³⁴³ Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, neni 19, p. 1.3.: "Ankesa nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit, ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë me këtë ligj; ankesa është anonime; ankesa paraqet keqpërdorim të së drejtës për paraqitjen e ankesës; ankuesi ka dështuar të sigurojë informatat e kërkuara nga Avokati i Popullit".

³⁴⁴ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti vjetor 2011, Statistikat e gjykatave të rregullta, www.kgjk-ks.org, 2.4.2012.

³⁴⁵ Raporti i OSBE për lëndët civile në Kosovë, www.osce.org/kosovo/.

Të pakënaqur me vendimet gjyqësore, qytetarët i drejtohen Avokatit të Popullit me parashtrës në të cilat e shprehin pakënaqësinë e tyre, me kërkesë për ndërhyrje në procesin vendimmarrjes në gjyqësor, por kërkojnë edhe monitorimin e rastit të tyre në gjykatë. Shumë herë, qytetarët në ankesat e tyre drejtuar Avokatit të Popullit, kërkojnë hartimin e parashtrësve të ndryshme dhe përfaqësimin e tyre në instancat e ndryshme gjyqësore.

Në radhë të parë, kjo është rezultat i mosinformimit të mjaftueshëm të qytetarëve me misionin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit. Por, njëkohësisht kjo dëshmon edhe për humbjen e besimit në drejtësinë e gjyqësorit në përgjithësi, por edhe besimi të qytetarëve që kanë në IAP.

Në IAP kanë ardhur edhe ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për shkak të moszekutimit të tyre nga gjykatat komunale. Në këto raste është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Ekzekutimi vendimeve gjyqësore në nivel të vendit është mjaft i ulët dhe shkaqet të cilat ndikojnë në shkallën e ulët të ekzekutimit të vendimeve të plotfuqishme, sipas KGJK-së, qëndrojnë në numrin e vogël të bashkëpunëtorëve për ekzekutim, mungesa e adresave të sakta etj.

Në të gjitha rastet e ankesave të cilat janë në kompetencë të IAP-së, Avokati i Popullit ka zhvilluar hetime dhe ka kontaktuar përmes letrave dhe takimeve të drejtpërdrejta me zyrtarë të gjykatave komunale, të cilët janë përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Avokati i Popullit ka kërkuar arsyet për zvarritje të ekzekutimit të vendimeve. Në shumë raste, pas veprimit të Avokatit të Popullit, gjykatat kanë ndërmarrë veprime për ekzekutimin e vendimeve, por ka pasur raste kur ato nuk janë ekzekutuar. Ndërsa si problem për ekzekutimin e vendimeve me karakter financiar, sipas zyrtarëve të gjykatave, është moszekutimi i vendimeve nga bankat, përkundër urdhrave të lëshuara nga gjykata.

Në disa raste ka pasur ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë të gjykatave, për të cilat janë shterë të gjitha mjetet e ankimit. Në këto raste Avokati i Popullit i ka këshilluar ankuesit se nëse ende konsiderojnë se i janë shkelur të drejtat e tyre nga procesi dhe vendimi gjyqësor, ata brenda afatit katërmujor pas marrjes së vendimit përfundimtar e kanë të drejtën e ngritjes së çështjes në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Por ka raste që është kërkuar nga AP ngritjen e çështjes së tyre në Gjykatën Kushtetuese, për shkak të shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut edhe në rastet kur Avokati i Popullit nuk është kompetent për të dërguar një rast në Gjykatën Kushtetuese. Kjo është edhe pasojë e mosinformimit të duhur të qytetarëve për natyrën e rasteve që mund të ngriten pranë kësaj gjykate.

Po ashtu, në disa raste ka pasur ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë të gjykatave, për të cilat janë shterë të gjitha mjetet e ankimit, duke përfshirë edhe ankimin kushtetues. Nga Avokati i Popullit kërkohet që çështja e tyre të dërgohet për gjykim në Gjykatën e Strasburgut për të Drejtat e Njeriut.³⁴⁶ Në këto raste palët janë njoftuar për pamundësitë ligjore, pasi Republika e Kosovës nuk e ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe qytetarët e vendit nuk mund të ngritin çështjet në këte gjykatë. Këto veprime të qytetarëve dëshmojnë për besimin e shtuar të qytetarëve tek Avokati i Popullit, edhe pse Avokati i Popullit, bazuar në kompetencat ligjore, nuk mund të zëvendësojë avokatin mbrojtës para gjykatave.

Ankesa kanë ardhur edhe për zvarritje të padrejta nga administrata e gjykatave, për shkak të mosdërgimit të vendimeve gjyqësore brenda afateve ligjore, si dhe për shkak të pamundësisë

³⁴⁶ Në zhargonin popullor Gjykata e Strasburgut përdoret për Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

së palëve për qasje në lëndën e tyre në gjykatë. Avokati i Popullit, në të gjitha rastet e ankesave të kësaj natyre, ka kontaktuar zyrtarët e gjykatave dhe në bashkëpunim me gjykatat, i ka zgjidhur ankesat e palëve. Palëve u janë dorëzuar vendimet gjyqësore apo ata janë informuar lidhur me gjendjen e lëndëve në gjykata.

Po ashtu, një numër i ankesave janë paraqitur edhe për shkak të mos përfaqësimit të mirë të ankuesve nga avokatët e tyre mbrojtës në seancat gjyqësore, të caktuar sipas detyrës zyrtare nga gjykata. Në të gjitha rastet palët janë njoftuar me të drejtën e tyre që të kërkojnë ndërrimin e avokatëve dhe për rastin e tyre ankesën ta paraqesin në Odën e Avokatëve të Kosovës.

2.29.4. Ankesat e qytetarëve ndaj prokurorisë

Gjatë kësaj periudhe raportuese, kundër prokurorisë si palë përgjegjëse qytetarët në IAP i kanë parashtruar gjithsej 11 ankesa, prej tyre 6 janë vendosur si të papranueshme, sipas nenit 19.1.3 të Ligjit për Avokatin e Popullit,³⁴⁷ ndërsa për 5 ankesa është marrë vendim për të hapur hetime. Ankesat që kanë qenë në përputhje me kompetencat e Avokatit të Popullit, janë proceduar në përputhje me Ligjin për Avokatin e Popullit, janë ndërmarrë veprime të duhura administrative hetimore.

Numri i parashtrësive të cilat kishin të bënin me realizimin e të drejtave para organit për ndjekje penale - prokurorive publike, ishte më i vogël krahasuar me ato që kishin të bënin me gjykatat. Nga analizat e bëra rezultoi se, shkak i një pjese të ankesave janë zvarritjet e procedurave hetimore nga prokuroritë publike, deri në marrjen e vendimit. Në shumë raste, për shkak të nevojës për informata plotësuese për vendimin përfundimtar, sipas kallëzimeve penale, kërkohen informata të posaçme nga policia. Në këtë fazë të procedurës, si pasojë pasivitetit dhe iniciativës së pamjaftueshme të prokurorëve publik, shpeshherë vjen deri te ngecjet në punën e prokurorit publik.

Veprimet e tilla më së shpeshti rezultojnë me skadimin e afatit ligjor, brenda të cilit të dëmtuarit kanë të drejtë ligjore për të inicuar ndjekje penale si paditës privat. Në këto raste vërehet se ka mungesë komunikimi midis të dëmtuarit, policisë dhe prokurorit, kur pushon procedura penale sipas nenit 224 të KPPK.³⁴⁸

Një numër i ankesave të qytetarëve të paraqitura në IAP, kanë të bëjnë me mbajtjen në paraburgim dhe të vonësive në ngritjen e aktakuzave nga prokuroritë, për shkak të vonësive në kryerjen e procedurave hetimore lidhur me rastet, por edhe të zvarritjes/shtyrjes së seancave penale për shkak të mospjesmarrjes së prokurorëve në seanca gjyqësore dhe në këto raste, të paraburgosurve u vazhdohet qëndrimi në paraburgim me arsyetimet e njëjta. Avokati i Popullit, në të gjitha rastet e pranueshme, ka hapur hetime për ankesat e palëve dhe ka

³⁴⁷ Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, neni 19, p. 1.3.

³⁴⁸ Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, neni 224: "Prokurori publik e pushon hetimin kurdo që është vërtetuar nga provat e mbledhura se: 1) Nuk ekziston dyshim i arsyeshëm që personi konkret e ka kryer veprën e tillë penale; 2) Vepra e kryer nuk është veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare; 3) Ka kaluar afati i parashkrimit; 4) Vepra penale është përfshirë me amnisti ose me falje ose 5) Ekzistojnë rrethana të tjera të cilat përjashtojnë ndjekjen".

kontaktuar zyrtarët e prokurorive, duke kërkuar sqarime për zvarritjet e procedurave hetimore dhe të vonesave në ngritjen e aktakuzave. Në disa raste, pas veprimit të Avokatit të Popullit, janë vënë në veprim organet për zhvillimin e hetimeve dhe përfundimin e tyre.

Sipas njoftimeve të marra nga Prokurori i Shtetit, arsye kryesore për vonesat në zhvillimin e hetimeve penale dhe procedimin e tyre në gjykata, është numri i vogël i prokurorëve në të gjitha nivelet. Me gjithë ngarkesat e shumta dhe mungesat e theksuara në burime njerëzore dhe të infrastrukturës së nevojshme, për Avokatin e Popullit, arsyetimet për vonesat në ngritjen e çështjeve penale në gjykata brenda afateve të parapara ligjore nga prokuroritë, edhe për vetë Kryeprokurorin e shtetit, janë jo gjithmonë të besueshme.

Gjatë vitit 2011, në Prokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës, kanë qenë gjithsej 75.745 kallëzime-lëndë penale, prej të cilave janë zgjidhur 52.754 ose 69,6 % të lëndëve penale që i ka proceduar dhe në fund të periudhës raportuese i kanë mbetur si të pazgjidhura 22.991 ose 30,4 %, ndërsa në vitin 2010 ishin 22.307 ose 29,5 % të kallëzimeve-lëndëve penale të pazgjidhura.³⁴⁹ Nga kjo gjendje mund të konstatohet se kemi rritje të numrit të lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2011, në raport me vitin paraprak 2010, për 0,9 %.

Ndërkaq është shqetësuese zbulueshmëria e ultë e kryesve të veprave penale nga ana e policisë, sepse nga 11.644 kallëzime të kryesve të panjohur të pranuar gjatë vitit 2011, janë zbuluar vetëm 2,6 % të kryesve, ndërsa edhe me shqetësues është fakti se 3.990 ose 34,2 % të kallëzimeve janë hedhur poshtë, për shkak të parashkrimit të lëndëve.³⁵⁰

Po ashtu, edhe një fakt mjaft shqetësues është numri i lartë i lëndëve-kallëzimeve penale të parashkruara, pas ngritjes së çështjes në gjykatë. Prokuroritë publike të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2011, kanë ngritur akte akuzuese ndaj 25.865 personave, ndërsa gjykatat kanë marrë aktvendime refuzuese ndaj 3.336 ose 16,1 % të personave, për shkak të parashkrimit të kallëzimit penal në gjykatë.³⁵¹

Pamundësia e realizimit të të drejtave të qytetarëve para organeve të drejtësisë ka ndikime negative në opinionin e gjerë publik për punën e gjyqësorit/prokurorisë dhe krijon dyshime për korrupsion në punën e këtij institucioni, për shkak të vonesave me vite të tëra, derisa lëndët përmbyllen me aktgjykim. Besimi i qytetarëve në institucionet e drejtësisë, gjykata dhe prokurori, është shumë i ulët. Këtë e dëshmon edhe raporti agjencisë ndërkombëtare UNDP,³⁵² ku kënaqshmëria e qytetarëve me gjykata është 25,90 %, me prokurori 20,00 %, ku këto institucione janë të fundit në mesin e institucioneve të vlerësuara nga qytetarët sipas raportit.

Nga ankesat e qytetarëve të parashtruara mbi bazën e legjislacionit pozitiv, mund të konstatohet se kemi shkelje të të drejtave të njeriut nga gjyqësori, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 31, 32 dhe 54 dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak të zvarritjeve të procedurave gjyqësore në vendosjen e lëndëve, sipas mjeteve juridike të parashtruara. Qytetarët e vendit nuk kanë një

³⁴⁹ *Raporti vjetor 2011* i Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, f. 4.

³⁵⁰ Pa aty, f. 10.

³⁵¹ Po aty, f. 38.

³⁵² *Raporti Puls i demokratik*, UNDP, publikuar në shtator 2011, Prishtinë, www.ks.undp.org, 07.12.2011, faqe 13, Tabela.1.1. Kënaqshmëria me institucionet e Kosovës; Qeveria 32,60 %, Kryeministri 37,60 %, Parlamenti 41,00 %, Kryetari i Kuvendit 60,90 %, Presidenti 54,10 %, Gjykata 25,90 % dhe Zyra e Prokurorit 20,00 %.

mekanizëm ligjor për mbrojtjen e të drejtës së gjyqimit në afat të arsyeshëm kohor, kur kjo e drejtë e tyre cenohet nga gjyqësori.

Shumë vende të rajonit e kanë mbrojtjen ligjore për cenimin e kësaj të drejte, ashtu që në këto raste shteti ndanë mjete financiare për kompensimin material, për shkak të dëmit të shkaktuar material, për zvarritje të procedurave gjyqësore, përkatësisht për shkelje të të drejtave të njeriut.

Rekomandime

- *Avokati i Popullit i rekomandon Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, shtrirjen e pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit, duke përfshirë pjesën veriore të Mitrovicës dhe komunat e tjera, ashtu si parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.*
- *Avokati i Popullit rekomandon Këshillin Gjyqësor të Kosovës, që procedurat e përzgjedhjes së gjyqtarëve të jenë sa më efikase, racionale në aspektin kohor dhe pa zvarritje administrative mbi bazën e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nr. 03/L-223.*
- *Avokati i Popullit rekomandon që plani për strukturimin e gjykatave, sipas Ligjit për Gjykatat, nr. 03/L-199, të jetë i detajizuar dhe të mos sjellë zvarritje të reja në vendosjen e lëndëve.*
- *Qeveria e Kosovës duhet të anulojë vendimin për krijimin e Këshillit Konsultativ për Drejtësi, pasi një mekanizëm i tillë paraqet ndërhyrje të ekzekutivit në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, gjë që është në kundërshtim me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës.*
- *Avokati i Popullit rekomandon vazhdimin për zbatim e strategjisë dhe të gjitha masave ligjore, të cilat do të ndihmonin në eliminimin e numrit të rasteve të mbetura gjyqësore dhe të deklarohet prioriteti i gjyqësorit dhe pushteteve të tjera në Republikën e Kosovës.*
- *Avokati i Popullit insiston që vështirësitë e gjykatave, të cilat janë shkaktarët kryesorë të zvarritjes në procesin e vendimmarrjes, nuk janë dhe nuk mund të jenë arsye të pranueshme pafundësisht, për shkelje të së drejtës për shqyrtim pa zvarritje, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë dhe kërkon nga bartësit e funksionit të gjyqtarit që në mënyrë konsekuente ta respektojnë parimin e gjyqimit brenda afatit të arsyeshëm në të gjitha procedurat.*
- *Avokati i Popullit rekomandon ofrimin e të gjitha kushteve të domosdoshme për zbatim efikas të aktit ligjor, që rregullon mbrojtjen e të drejtës për gjykim pa vonesa të panevojshme dhe miratimin e amendamenteve për mbrojtje më të mirë të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të klientëve në procedimin lëndëve.*
- *Avokati i Popullit rekomandon miratimin e masave për sigurimin e shqyrtimeve më të shpejta të masave të përkohshme parandaluese, pasi nga hetimet e bëra dhe informatat e pranuar, është vërtetuar se disa gjykatave u duhen disa vite për të nxjerrë një masë të përkohshme parandaluese.*

- *Avokati i Popullit vëren se gjykatat kanë vonesa të gjata kohore në përmbartimin e vendimeve gjyqësore, prandaj rekomandon ofrimin e të gjitha kushteve për përmbartimin dhe zbatimin e vendimeve në afatin e paraparë me ligj.*
- *Avokati i Popullit i rekomandon Odës së Avokatëve të sigurojë kualitet më të madh të ndihmës ligjore, në raste të përfaqësimit sipas detyrës zyrtare (ex officio), apo të ndihmës ligjore falas dhe, të rregullojë qartë dhe pa mëdyshje sigurimin e klientëve të avokatit, në raste të dëmtimit, lidhur me kryerjen e detyrës së avokatit.*
- *Avokati i Popullit rekomandon të gjitha prokurorit, që në të gjitha rastet penale kur kallëzimet penale hidhen poshtë nga prokuroritë dhe nuk ngritet aktakuza, të njoftohen palët e dëmtuara për mundësinë e ngritjes së padive private.*
- *Avokati i Popullit rekomandon Këshillin Prokurorial të Kosovës të rrisë numrin e prokurorëve, ashtu që të mos përsëriten rastet e zvarritjes së procedurave penale në gjykata për shkak të mosprezantimit të prokurorëve në seanca.*

2.30. Përdorimi i gjuhëve

Përdorimi i barabartë i gjuhëve zyrtare në Kosovë është një e drejtë kushtetuese.³⁵³ Gjuha shqipe dhe gjuha serbe, si edhe përdorimi i shkrimit të tyre, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës³⁵⁴ dhe sipas Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve³⁵⁵ janë gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës.³⁵⁶ Gjuha turke, gjuha boshnjake dhe ajo rome kanë status të gjuhëve zyrtare në nivelin komunal, sipas kushteve të parapara me ligj.

Me qëllim të respektimit të identitetit gjuhësor të të gjithëve, si dhe krijimit të një mjedisi të përshtatshëm për pjesëtarët e të gjitha komuniteteve, për të shprehur dhe ruajtur identitetin e tyre gjuhësor, në përputhje me konventat ndërkombëtare,³⁵⁷ tek të cilat sanksionohet edhe e drejta e përdorimit të gjuhës nga ana e komuniteteve, Kuvendi i Kosovës ka nxjerrë Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

Ligji për përdorimin e gjuhëve nëpërmjet dispozitave të tij mbron dhe promovon të drejtat e komuniteteve në sferën e përdorimit të gjuhëve në jetën publike. Ligji, gjithashtu parasheh që secili person mund të komunikojë dhe t'i ketë të gjitha shërbimet dhe dokumentacionin nga institucionet në nivel qendror dhe atë lokal apo nga organet e tyre, në njërën prej gjuhëve zyrtare.

E drejta e pjesëtarëve të pakicave për përdorimin e gjuhës së tyre amtare buron nga dokumentet e shumta ndërkombëtare dhe si e tillë, njëkohësisht, është e drejtë individuale dhe kolektive e njerëzve. Përdorimi i gjuhëve zyrtare, e cila është e rregulluar me *Ligjin për*

³⁵³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 5.

³⁵⁴ Po aty.

³⁵⁵ Ligji për përdorimin e gjuhëve, nr. 02/L-37.

³⁵⁶ Po aty, neni 1.1 dhe neni 1.2.

³⁵⁷ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike; Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe Protokollin i 12 i saj; Konventa Kornizë për Mbrojtjen e të Drejtave të Pakicave Kombëtare; Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe të Pakicave; Rekomandimet e Hagës mbi të Drejtat e Pakicave Kombëtare për Arsimit dhe Rekomandimet e Oslos mbi të Drejtat e Pakicave Kombëtare.

përdorimin e gjuhëve, ndikon në jetën e përditshme të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe kontribuon në integrimin e tyre në shoqërinë kosovare. Sa i përket përdorimit të gjuhëve në Kosovë, gjatë kësaj periudhe raportuese, në krahasim me periudhën e kaluar nuk ka ndonjë ndryshim të madh.

Edhe pse Qeveria e Kosovës i ka krijuar mekanizmat për mbikëqyrjen e përdorimit të gjuhëve,³⁵⁸ megjithatë *Ligji për përdorimin e gjuhëve* ende nuk është duke u përcjellë me kapacitetet e mjaftueshme për zbatimin e tij, në rastet e mosrespektimit të kërkesave për përdorimin e gjuhëve. Aktet nënligjore për zbatimin e ligjit, nuk janë mjaft të qarta kur është fjala për përcaktimin e procedurës për sanksione administrative, në rast të shkeljes së *Ligjit për përdorimin e gjuhëve*, si dhe plotfuqishmërisë së vendimeve.³⁵⁹ Po ashtu, edhe më tutje nuk ka resurse të mjaftueshme njerëzore dhe financiare që do të ndihmonin zbatimin e këtij ligji.³⁶⁰

2.30.1. Komisioni i gjuhëve

Me qëllim të ruajtjes, promovimit dhe statusit të barabartë të gjuhëve zyrtare në Kosovë, si edhe mbrojtjes së gjuhëve të cilat nuk janë zyrtare, *Ligji për përdorimin e gjuhëve* ka paraparë obligimin e Qeverisë së Kosovës që të themelojë Komisionin për gjuhët, i cili do të mbikëqyrte zbatimin e ligjit. Ky Komision i themeluar në vitin 2007, krahas masave për të siguruar statusin e barabartë të gjuhëve zyrtare dhe sigurimin e mbrojtjes së gjuhëve të pakicave, gjuha e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare, zhvillon dhe realizon hetimet sipas ankesave ose me vetiniciativë, ndërmerri masa administrative, në rast të shkeljeve të dispozitave të *Ligjit për përdorimin e gjuhëve*, nxjerr rekomandime dhe vërejtje me shkrim aty ku rekomandimet e Komisionit nuk janë zbatuar. Çdo komunitet që konsideron se i është shkelur e drejta në përdorimin e gjuhës zyrtare dhe gjuhës në përdorim zyrtar ka të drejtë t'i drejtohet Komisionit për gjuhët dhe të paraqesë ankesë kundër institucionit për të cilin mendon se ka shkelur ligjin. Komisioni e ka edhe portalin e vet, ndonëse ende nuk është plotësisht funksional.³⁶¹

Meqenëse e Komisioni i Gjuhëve nuk është plotësisht funksional dhe në këtë aspekt nuk po arrin t'i kryejë plotësisht detyrimet e veta, Qeveria ka vendosur të reformojë Komisionin, veprim ky i cili është në proces.³⁶² Komisioni deri tani nuk ka pasur buxhet të vetin, ndërkaq anëtarët e tij kanë punuar vullnetarisht, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësisë që i kanë pasur në institucionet në të cilat kanë qenë të punësuar. Për të qenë komisioni plotësisht funksional do të duhej të siguroheshin kapacitete përkatëse njerëzore dhe financiare dhe që

³⁵⁸ *Udhëzimi administrativ nr. 2006/10*, mbi rregullat dhe metodat e njësisë për përcjelljen e përdorimit të gjuhëve zyrtare në institucionet qendrore; *Udhëzimi administrativ i kryeministrit nr. 03/2007*.

³⁵⁹ Ministria e Shërbimeve Publike, *Udhëzimi administrativ nr. 2007/01*, mbi përcaktimin e sanksioneve administrative për cenimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, neni 5.2 dhe nenet 6, 7 e 8.

³⁶⁰ Numri i përkthyesve profesionalë nuk është në përputhje me nevojat, po kështu nuk ka mjete të mjaftueshme për rekrutimin e përkthyesve profesionalë, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal.

³⁶¹ <http://www.ks-gov.net/kgjz/>.

³⁶² Informacion nga takimi me kryetarin e Komisionit për gjuhë, më 23.12.2011.

anëtarët e tij të punojnë me orar të plotë pune. Grupi punues i Qeverisë është duke punuar në reformimin e këtij komisioni.

Përbërja e Komisionit nuk siguron pjesëmarrjen efektive të të gjitha komuniteteve gjuhësore. Edhe pse neni 32, paragrafi 10, i *Ligjit për përdorimin e gjuhëve* kërkon që përbërja e Komisionit të përcaktohet: “duke marrë parasysh të drejtat dhe interesat e të gjitha komuniteteve gjuhësore në Kosovë dhe duke marrë parasysh nevojën për të ruajtur diversitetin gjuhësor të komuniteteve në Kosovë”, Udhëzimi administrativ për përbërjen dhe kompetencat e Komisionit për gjuhët, nr. 03/2007, neni 5, rezervon nga një anëtar nga gjashtë ministri dhe një përfaqësues nga Kuvendi, pa u konsultuar me komunitetet gjuhësore. Në përbërjen aktuale të Komisionit janë nga një përfaqësues nga komuniteti serb dhe ai turk, por nuk është asnjë përfaqësues nga komuniteti boshnjak dhe ai rom, apo edhe komunitetet e tjera pakicë.³⁶³

Komisioni ka autoritetin për të lëshuar sanksione administrative për subjektet që shkelin dispozitave të *Ligjit për përdorimin e gjuhëve*,³⁶⁴ mirëpo deri më sot nuk ka asnjë rast të shqiptimit të ndonjë mase, lidhur me shkeljen e këtij ligji, edhe pse përdorimi zyrtar i gjuhëve nuk është në nivelin e kënaqshëm.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Komisioni në bazë të planit vjetor të punës për vitin 2011, ka përpiluar formularët e ankesave në pesë gjuhë (shqip, serbisht, turqisht, boshnjakisht dhe anglisht), të cilat mund t’i përdorin të gjitha komunitetet për të parashtruar ankesat e tyre eventuale në Komision, e që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve zyrtare. Komisioni, gjatë kësaj periudhe raportuese i ka marrë dhe i ka shqyrtuar tetë ankesa, të parashtruara nga qytetarët e përkatësisë turke dhe serbe dhe nga subjektet e tjera. Të gjitha ankesat janë shqyrtuar dhe në bazë të tyre janë ndërmarrë masa përkatëse, si dhe u janë dhënë rekomandimeve institucioneve relevante, me qëllim të eliminimit të shkeljeve të *Ligjit për përdorimin e gjuhëve*.³⁶⁵

Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Policinë e Kosovës, Komisioni, u ka rekomanduar të marrin veprime për zbatimin e *Ligjit për përdorimin e gjuhëve*, në mënyrë që secili shtetas i Republikës së Kosovës të ketë mundësi komunikimi, t’i ofrohet shërbimi dhe t’i marrë dokumentet publike në gjuhën përkatëse zyrtare.³⁶⁶

Me qëllim të zbatimit të *Ligjit për përdorimin e gjuhëve*, Komisioni ka vizituar këto dhjetë komuna: Prizrenin, Mamushën, Malishevën, Pejën, Shtërpcën, Parteshin, Graçanicën, Ranillugun, Kllokotin dhe Mitrovicën, dhe ka konstatuar se, me përjashtim të Prizrenit e Malishevës të gjitha komunat i kanë nxjerrë rregulloret për përdorimin e gjuhëve zyrtare.

³⁶³ Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 05/99 të datës 17.12.2009, mbi përbërjen dhe përgjegjësitë e Komisionit për gjuhët.

³⁶⁴ Ministria e Shërbimeve Publike, Udhëzimi administrativ nr. 2007/01, mbi përcaktimin e sanksioneve administrative për cenimin e *Ligjit për përdorimin e gjuhëve*, neni 1.

³⁶⁵ Informata nga takimi me kryetarin e Komisionit për gjuhë, më 23.12.2011.

³⁶⁶ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 5; *Ligji për përdorimin e gjuhëve*, nenin 1, paragrafi 1.1.ii, neni 2, paragrafi 2.1 dhe neni 4.

Ligji për përdorimin e gjuhës nuk është duke u zbatuar fare në komunat në veri të Kosovës, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, si dhe në veri të Mitrovicës.³⁶⁷

Me qëllim të vendosjes së bashkëpunimit, lidhur me përdorimin e gjuhëve Komisioni i gjuhëve ka vizituar edhe Institucionin e Avokatit të Popullit.

2.30.2. Vështirësitë në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal, në përputhje me urdhëresën e Qeverisë, nr. 2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrive, ka nxjerrë *Udhëzimin Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 2007/06 për përcaktimin e procedurave për zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve në komuna*. Me këtë udhëzim përcaktohet se cilat gjuhë zyrtare duhet të përdoren, trajtimi i kërkesave nga personat gjuha amtare e të cilëve është në përdorim zyrtar si dhe mënyra e përdorimit të gjuhëve zyrtare në komuna.

Edhe më tutje vazhdon të jetë e pranishme praktika në disa komuna, veçanërisht në komunat e sapoformuara, të cilat janë të përbëra me shumicë nga komuniteti serb, të cilat edhe më tutje dokumentet nga institucionet qendrore i marrin vetëm në gjuhën shqipe ose me përkthim të dobët në gjuhën serbe. Pothuajse të gjitha ministrinë, me përjashtim Ministrisë së Pushtetit Lokal, korrespondenca u dërgohet komunave vetëm në gjuhën shqipe, me gjithë vërejtjet dhe kërkesat e adresuara nga zyrtarët e këtyre komunave për të realizuar korrespondencën në të dy gjuhët zyrtare (shqip dhe serbisht). Gjithashtu, gjatë procesit të regjistrimit të popullsisë në këtë vit, e gjithë korrespondenca të cilën Komisioni për regjistrimin në Republikës së Kosovës e dërguar në komunën e Klllokotit është dërguar vetëm në gjuhën shqipe.³⁶⁸

Gjatë kësaj periudhe raportuese, komunat e sapoformuara, Parteshi dhe Ranillugu, kanë punësuar nga një përkthyes në gjuhën shqipe. Komuna e Klllokotit i ka punësuar dy përkthyes, ndërkaq ka nevojë edhe për një tjetër, por për shkak të mungesës së buxhetit këtë nuk mund ta realizojë.³⁶⁹ Me gjithë hapat e bërë në këto komuna, edhe më tutje ka lëshime kur është në pyetje respektimi i *Ligjit për përdorimin e gjuhëve*.

Gjatë procesit të monitorimit të përdorimit të gjuhëve zyrtare Avokati i Popullit ka vërejtur se numri i pamjaftueshëm si dhe reduktimi i numrit të përkthyesve, paraqet një problem të vazhdueshëm dhe për komunat e tjera në Kosovë, me çka në mënyrë të drejtpërdrejtë cenohet zbatimi i *Ligjit për përdorimin e gjuhëve*. Problemi është se disa komuna në Kosovë i kanë përkthyesit në të gjitha gjuhët zyrtare. Gjithashtu, nuk ka pasur trajnime të rregullta për përkthyesit në administratën publike, që ndikon në cilësinë e përkthimeve të tyre pikërisht për shkak të mungesës së mjeteve financiare për rekrutimin e përkthyesve profesionistë.

Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese ka pasur raste kur nuk është respektuar e drejta e komuniteteve që emrat e tyre personalë në librat amë dhe në dokumente personale të shkruhen

³⁶⁷ Po aty.

³⁶⁸ Informata nga takimi me kryetarin e komunës së Ranillugut dhe me nënkryetarin e komunës së Parteshit, i mbajtur më 15.12.2011 si dhe takimi me zyrtarët e komunës së Klllokotit, i mbajtur më 22.12.2011.

³⁶⁹ Informata nga takimi me zyrtarin e komunës së Klllokotit, mbajtur më 22.12.2011.

në gjuhët e tjera zyrtare në komuna, sikurse edhe në dokumentet e tjera të lëshuara nga autoritetet komunale dhe institucionet publike,³⁷⁰ në formën e tyre origjinale të përshtatshme sipas alfabetit dhe drejtshkrimit të komuniteteve gjuhësore të cilëve u përkasin. Kjo situatë është justifikuar me faktin se komunat nuk kanë programe softuerike në gjuhën serbe dhe në atë turke. Prandaj, disa nga shkronjat serbe dhe turke edhe më tutje shkruhen gabimisht dhe shfaqen në formë të parregullt në letërnjoftime, në certifikatat e lindjes, në letrat poseduese dhe në dokumentet e tjera zyrtare. Emrat serbë në dokumentet e Republikës së Kosovës shkruhen kryesisht me alfabetin latin dhe jo në alfabetin cirilik, i cili është alfabet zyrtar i gjuhës serbe.

Për shkak të mungesës së përkthyesve profesionistë në gjuhën serbe, ka ndodhur që të krijohen vonesa në dërgimin e vendimeve gjyqësore, deri në përkthimin e tyre, por gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur ndonjë ankesë lidhur me këtë.

Ndërkaq edhe vendimet nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës vonohen t'i dërgohen ankuesve, pikërisht për shkak se të gjitha materialet duhet të përkthehen në gjuhën angleze, sepse nga nëntë gjyqtarët e kësaj gjykate 3 janë të huaj, megjithëse lidhur me këtë nuk ka pasur ankesa në IAP.

Në faqen e internetit të Zyrës së Kryeministrit, emrat e ministrave të komunitetit serb janë shkruar gabimisht, sepse nuk janë shkruar sipas alfabetit dhe drejtshkrimit të gjuhës serbe.³⁷¹

Gjuha turke, përveç në komunën e Prizrenit, është në përdorim zyrtar edhe në pesë komuna të tjera si në Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Vushtrri dhe Mamushë. Në komunën e Gjilanit në shërbimin e përkthyesve janë punësuar dy përkthyes të gjuhës serbe, mirëpo nuk është asnjë përkthyes për gjuhën turke, e cila është njëra nga gjuhët zyrtare në këtë komunë.³⁷² Përkthyes të gjuhës turke nuk ka as komunën e Mitrovicës dhe të Vushtrrisë.³⁷³ Në komunat në të cilat gjuha turke është gjuhë zyrtare, gjithashtu nuk është duke u respektuar plotësisht detyrimi për vendosjen e emërtimeve zyrtare, brenda dhe jashtë objekteve të të gjitha institucioneve dhe organeve që veprojnë nën autoritetin e komunës.³⁷⁴

Gjuha boshnjake është pranuar si gjuhë në përdorim zyrtar në komunat e Pejës, Prizrenit, Istogut dhe Dragashit. Në këto komuna, aktivitetet e informimit publik kryhen në gjuhën boshnjake, ndërkaq sipas nevojës sigurohet përkthimi me gojë dhe me shkrim, por duhet të theksojmë se numri i dokumente të përkthyer, sikurse edhe cilësia e atyre përkthimeve nuk janë të kënaqshme.

Shenjat topografike që tregojnë emrat e të gjitha vendeve në rrugët rajonale, në territorin e Republikës së Kosovës, janë të vendosura në gjuhët zyrtare, në përputhje me emrat e vendeve,³⁷⁵ por ende nuk janë zëvendësuar me tabelat e reja, pasi emrat në gjuhën serbe ose në gjuhën shqipe janë shlyer dhe nuk mund të lexohen. Një nga rrugët e pakta ku nuk është

³⁷⁰ Ligji për përdorimin e gjuhëve, nr. 02/L-37, neni 27.

³⁷¹ <http://www.kryeministri-ks.net>, më 23.12.2011, 13:40h.

³⁷² Informata nga takimi me kryetarin e Komitetit për komunitete dhe kryetarin e Zyrës për të drejtat e njeriut në komunën e Gjilanit, të mbajtur më 15.12.2011.

³⁷³ Informata e marrë nga zyrtarët e komunës së Mitrovicës dhe të Vushtrrisë, më 22.12.2011.

³⁷⁴ Neni 9.1 i Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe neni 8 i Udhëzimit Administrativ, nr. 2011/02, mbi përcaktimin e sanksioneve administrative për cenimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

³⁷⁵ Ligji për përdorimin e gjuhëve, nr. 02/L-37, neni 9, pika 2.

dëmtuar pothuajse asnjë shenjë, që tregon emrat e vendeve, është rruga Prishtinë-Gjilan.³⁷⁶ Gjithashtu, ka raste në komunat e banuara nga komunitetet pakicë, ku shenjat topografike, që tregojnë emrat e fshatrave dhe qyteteve, nuk janë të shkruara në të dy gjuhët zyrtare.³⁷⁷

Sa i përket përdorimit të gjuhëve të komuniteteve pakicë në vende publike, në disa komuna, si Ferizaj, Viti, Gllogoc dhe Skenderaj, serbët e Kosovës ende nuk ndjehen rehat kur flasin gjuhën e tyre, sepse ata janë të shqetësuar për sigurinë e tyre, edhe pse nuk ka patur asnjë ankesë të individëve apo edhe grupeve të individëve për ndonjë veprim apo shqetësim konkret.

Ndërsa shqiptarët ende nuk ndjehen të sigurt dhe nuk e përdorin gjuhën e tyre amtare, por as të lëvizin të lirë në vendet publike në komunat veriore të Kosovës: Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan. Turqit dhe boshnjakët lirisht e përdorin gjuhën e tyre në vendet publike. Pjesëtarët e këtyre komuniteteve e flasin edhe gjuhën shqipe, e cila ua lehtëson atyre komunikimin e përditshëm, në të gjitha nivelet.

Mund të konkludohet se edhe pse ekziston vullneti dhe ka zhvillime pozitive përkitazi me zbatimin e *Ligjit për përdorimin e gjuhëve*, ende ka probleme dhe dallime në zbatimin e politikës gjuhësore dhe përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare, si në nivelin qendror, ashtu dhe në atë lokal.

Rekomandime

- *Këshilli i gjuhëve të bëhet plotësisht funksional dhe të sigurohen kapacitete përkatëse njerëzore edhe financiare për mbarëvajtjen e punëve të tij.*
- *Në përbërjen e Komisionit për gjuhët të emërohen edhe dy përfaqësues të komuniteteve, një nga komuniteti boshnjak dhe një nga komuniteti rom.*
- *Të krijohen kushtet financiare për rekrutimin e përkthyesve profesionistë në ato institucione ku ndihet mungesa e tyre, si në nivelin qendror ashtu edhe atë lokal.*

2.31. Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre

Të drejtat e komunitetet dhe të pjesëtarëve të tyre të garantuara me nenin 59 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përfshijnë mbrojtjen e të drejtave të tyre nga fusha e kulturës dhe ruajtjen e identitetit të tyre, arsimimin, përdorimin e gjuhës, përdorimin e toponimeve, qasjen dhe përfaqësimin në media, zhvillimin në sektorit joqeveritar brenda komuniteteve të tyre, si dhe pjesëmarrjen në sektorin e OJQ-ve ndërkombëtare në Kosovë.

Kur të kihet parasysh popullata në tërësi, theksojmë të dhënë se regjistrimi i popullsisë në Republikën e Kosovës është zhvilluar nga 1 deri më 15 prill 2011.

³⁷⁶ Shënuar më 15.12.2011.

³⁷⁷ Po aty.

Mirëpo ky regjistrim është përcjellë me shumë mangësi, ndërkaq pjesa dërrmuese e pjesëtarëve të komunitetit serb nuk ka marrë pjesë në regjistrim. Gjithashtu, për arsye politike, regjistrimi nuk është kryer fare në veri të Kosovës, përderisa pjesërisht është kryer në pjesë të tjera të Kosovës, në komunat të banuara me shumicë nga pjesëtarët e komunitetit serb.

Shqiptarët përbëjnë shumicën e banorëve të Kosovës (90%), ndërkohë që komunitetet pakicë, të cilat përbëjnë rreth 10% banorëve, janë: serb, turq, rom, ashkali, egjiptas, goran, boshnjak dhe një përqindje e vogël e kroatëve dhe malazezve.

2.31.1. Komuniteti serb

Gjatë kësaj periudhe raportuese ka pasur edhe lëvizje pozitive, sa i përket çështjes së refugjatëve të Kosovës nga vendet e ndryshme, si dhe personave të shpërngulur brenda vetë territorit të Kosovës.

Në komunën e Klinës, në korrik të vitit 2011, zyrtarisht ka nisur vijimi i punëve në projektin “Pogragja”, i filluar në vitin 2009. me projekt janë ndërtuar 15 objekte në këtë fshat, ndërkaq shtëpitë iu kanë dhënë të kthyerve nga Komisioni teknik i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK), gjatë muajin tetor.

Në komunën e Prizrenit, MKK në bashkëpunim me Qeverinë e Britanisë së Madhe dhe komunën e Prizrenit, ka përfunduar punimet e shtëpive për të kthyerit në qytet, përkatësisht afër kishës së Shën Gjergjit. Projekti zyrtarisht është përfunduar në muajin korrik, ku janë ndërtuar 10 shtëpi ndërkaq gjatë gushtit MKK-ja ka bërë pranimin për shfrytëzimin e objektit. Gjithashtu, është përkrahur edhe procesi i kthimit të 8 familjeve të komunitetit serb në komunë e Shtërpcës. Në fund të nëntorit kanë përfunduar punimet në objektin, i cili u është dhënë në shfrytëzim.³⁷⁸

Komuna më e re e Kosovës Parteshi, ka formuar Grupin punues për riparimin, me qëllim të sigurimit të të drejtës së kthimit të gjithë personave me prejardhje nga Kosova, duke bërë të gjitha përpjekjet që të krijojnë kushtet të volitshme për siguruar një kthim të qëndrueshëm dhe të përhershëm për të gjithë personat me prejardhje nga Kosova. Procesi i riparimit duhet të zbatohet sipas parimit *non-refoulement*³⁷⁹, ndërsa për disa familje, të cilat janë kthyer në këtë komunë është siguruar edhe mbrojtja sociale.

Komuniteti serb e kultivon identitetin e vet kombëtar dhe kulturor nëpërmjet organizatave humanitare dhe kulturore, organizatave joqeveritare, si dhe partive politike. Identitetin e vet fetar ky komunitet e kultivon përmjet Kishës Ortodokse Serbe (KOS), ndërsa kur është fjala për sistemin e arsimimit, ku është i përfshirë arsimit fillor, i mesëm dhe ai i lartë, funksionon sipas plan-programeve të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Serbisë. Mirëpo, sikurse

³⁷⁸ Raporti vjetor 2011, i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, <http://www.mkk-ks.org>.

³⁷⁹ Parimi *non-refoulement* është një ligji i miratuar ndërkombëtarisht. Neni 33 i Konventës së Gjenevës, i vitit 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve, thotë: "Asnjë shtet, si palë nënshkruese nuk guxon të dëbojë ose kthejë ("deportojë") një refugjat në asnjë kuptim, në kufijtë e territorit ku jeta apo liria e tij do të rrezikoheshin për shkak të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të veçantë social ose qëndrimit politik të tij.

sistemi arsimor i komunitetit serb, ashtu edhe Kisha serbe, nuk kanë pothuajse asnjë lloj bashkëpunimi me organet kompetente zyrtare të Republikës së Kosovës.

Situatë e ngjashme është edhe me mbrojtjen shëndetësore të pjesëtarëve të komunitetit pakicë serb. Sistemi i mbrojtës shëndetësore të cilin e menaxhon dhe e financon Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Serbisë edhe më tutje ofron shërbime pjesëtarëve të komunitetit serb si dhe komuniteteve të tjera të cilat jetojnë në pjesët në të cilat serbët përbëjnë shumicën. Në territorin e komunës së Shtërpcës ekziston vetëm mbrojtja primare shëndetësore, ndërsa për kërkesat më serioze mjekësore, pacientët dërgohen në spitalin e Graçanicës ose në veri të Kosovës.

Në fund të vitit 2010 në këtë komunë ka filluar ndërtimi i spitalit, në të cilin do të ofrohet ndihma sekondare shëndetësore. Spitali, ndërtimi i të cilit ka nisur në vitin 2010 është kryer. Mirëpo, meqë gjendja e fondeve shëndetësore është e pakënaqshme dhe shumë larg prej kritereve të pranueshme, si dhe me buxhetin e kufizuar, nuk mund të bëhet bartja e pajisjeve, në mënyrë që t'u mundësohet pjesëtarëve të komuniteteve, kjo mënyrë e mbrojtjes shëndetësore. Një situatë e ngjashme është edhe me spitalin e komunës së Parteshit, i cili është ndërtuar në fshatin e banuar me serbë, në Pasjan. Ndërtesa e dedikuar për spitalin i cili do të ofrojë ndihmën shëndetësore sekondare dhe pjesërisht terciare, është përfunduar dhe priten vetëm instalimet e nevojshme.

2.31.2. Komunitet e tjera

Mundësitë e ruajtjes së gjuhës, zakoneve, trashëgimisë kulturore dhe traditës të komunitetit boshnjak, i cili në numër më të madh është i koncentruar në rajonin e Prizrenit, Gjakovës dhe Pejës nuk janë të mjaftueshme. Në Kosovë mbahet mësimi në gjuhën boshnjake, mirëpo edhe gjatë kësaj periudhe raportuese nuk janë shënuar lëvizje pozitive, në drejtim të zgjidhjes së problemit të mungesës së teksteve në gjuhën boshnjake, që ishte paraparë të zgjidhej gjatë vitit shkollor 2010/11.

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas gjithnjë ballafaqohen me problemin e ruajtjes së identitetit të tyre, në kuptim të besimit fetar, gjuhës, traditës dhe kulturës. Me kultivimin e kulturës dhe traditës rom merret shoqëria kulturore-artistike "Durmish Asllano" nga Prizreni, përderisa të tjerat janë transformuar në OJQ.

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas në Kosovë me vite janë duke u ballafaquar me një shkallë diskriminimi, varfërie dhe skamje, që shpie deri te format e heqjes dorë nga prejardhja e tyre duke shkuar në drejtim të asimilimit, në komunitetet me numër më të madh në rajonet ku ata jetojnë. Si një përgjigje për një situatë të tillë, institucionet kosovare në vitin 2007, e kanë miratuar Strategjinë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali, egjiptas, ndërsa në vitin 2009 është miratuar Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë së lartpërmendur. Edhe pas disa viteve nga miratimi i këtyre akteve, nuk është vërejtur zbatimi i tyre përkatës në terren. Ekzistojnë vetëm aktivitete sporadike financiare nga ana e strukturave qeveritare ose

nga donatorët ndërkombëtar. Një situatë të tillë e vërteton edhe raporti i misionit të OSBE-së në Kosovë për zbatimin e Planit të veprimit të përmendur më lart.³⁸⁰

Gjatë vitit 2011 Komisioni Evropian ka miratuar Kornizën Evropiane për krijimin e një strategjie kombëtare për integrimin e romëve, në bazë të së cilës të gjitha vendet e BE-së por edhe ato që synojnë të bëhen pjesë e BE-së, janë të detyruara të miratojnë strategjitë nacionale për integrimin e këtij komuniteti dhe të mundësojnë zbatimin përkatës, përfshirë edhe Kosovën. Kjo në veçanti është theksuar në takimet e zyrtarëve kosovarë me ata evropianë në prani të përfaqësuesve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në Prishtinë në vitin 2011. Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas në Kosovë edhe më tutje po përballen me shumë probleme, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikojnë në cilësinë e jetës së tyre por edhe në vetë riintegrimin e këtyre në shoqërinë kosovare. Për shkak të diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike, jorrallë pjesëtarët e këtyre komuniteteve vendosin të emigrojnë në vendet evropiane, dukuri kjo e cila është në vazhdim e sipër.

Kosova po ballafaqohet edhe me një problem kur janë në pyetje komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas që ka të bëjë me kthimin e tyre të dhunshëm nga vendet perëndimore. Procesi i kthimit të dhunshëm në shumë raste cenon të drejtat themelore të njeriut. Përkundër faktit se edhe më tutje nuk janë krijuar parakushtet e duhura për kthimin e këtyre njerëzve, ndër të cilat mosrregullimi i çështjes së banimit dhe ekzistenca ekonomike por edhe diskriminimi, megjithatë ku proces edhe më tutje po vazhdon. Janë shënuar rastet që me gjithë këto probleme të theksuara, menjëherë pas aterimit në aeroportin e Prishtinës, këta persona mbesin pa kurrfarë ndihme institucionale. Sipas shkaqeve të lartpërmendura, shpeshherë ndodhë, të mos themi në secilin rast, që këta persona vendosin që sërish ta lëshojnë Kosovën. Megjithëkëtë Qeveria e Kosovës e ka Planin e veprimit për riintegrimin për personat që kthehen në Kosovë. Gjithë procesin e kthimit e përcjellë UNHCR-ja dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

Procesi i kthimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas po zhvillohet ngadalë, por gjatë kësaj periudhe raportuese janë shënuar edhe lëvizje pozitive. Një shembull është Mitrovica, ku gjatë vitit 2011 ka vazhduar kthimi nga kampet nga veriu i Mitrovicës në Mëhallën e Romëve në pjesën jugore. Kampet në Osterode dhe Çeshmilluk janë mbyllur, sikurse edhe kampi në Zhitkovc, afër Zveçanit, ndërsa banorët e këtyre kampeve janë vendosur në shtëpitë e reja ose në banesa të ndërtuara për ta.

Edhe një shembull pozitiv për investimin në mirëqenien e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas përbënë edhe vendimi i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës dhe komunën e Gjakovës, për mbylljen e lagjes johigjienike Kolonia, në të cilën në kushte tepër të këqija higjienike kanë qëndruar 700 pjesëtarë të këtyre komuniteteve. Janë ndarë mjete për ndërtimin e një lagjeje të re, ndërkohë që pjesëtarët e këtyre komuniteteve gjatë këtij viti raportues janë vendosur nëpër shtëpitë e tyre.

³⁸⁰ <http://www.osce.org/sr/kosovo/77416> (20.12.2011).

2.31.3. Sistemi i arsimit të komuniteteve pakicë

Kur flitet për arsimimin në përgjithësi edhe më tutje ekzistojnë dy sisteme në Kosovë. Shkollimi të cilin e menaxhon dhe e financon Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë, edhe më tutje ekziston në të gjitha rajonet ku jetojnë serbët, romët të cilët flasin serbisht, si dhe goranët. Ky shkollim zhvillohet sipas plan-programit të arsimit serb, i cili ndryshon nga sistemi i arsimit në Republikën e Kosovës, ku natyrisht zbatohen plan-programet mësimore të Republikës së Kosovës. Personeli profesional dhe teknik i shkollave që funksionojnë sipas plan-programeve mësimore serbe, pagat i marrin nga buxheti i Qeverisë së Serbisë, ndërsa nga Ministria Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), kjo bëhet në formë të stimulimit financiar, që në mënyrë lineare është përcaktuar për të gjithë të punësuarit në shkolla.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, nuk ka risi kur është fjala për arsimimin në rajonin e Gorës, ku janë të pranishme dy sisteme arsimore, sipas plan-programeve të Republikës së Kosovës dhe atyre të Republikës së Serbisë, ku shumica e pjesëtarëve të komuniteti goran janë përcaktuar për arsimim në gjuhën serbe, kryesisht për shkak të kushteve më të mira për të ndjekur shkollimin e lartë, duke i shfrytëzuar tekstet sipas plan-programeve të Ministrisë së Arsimit të Serbisë. Nga ana tjetër, një pjesë e banorëve të komunës së Dragashit, duke u identifikuar me komunitetin boshnjak, i kanë pranuar plan-programet mësimore të MASHT-it në gjuhën boshnjake.

Mësimi në shkollën fillore dhe të mesme në gjuhën turke zhvillohet sipas plan-programeve mësimore të MASHT-it. Mirëpo, ka mungesë të teksteve dhe mjeteve mësimore për shkollat fillore dhe të mesme në gjuhën turke. Gjatë kësaj periudhe raportuese, për nevojat e shkollimit fillor në gjuhën turke nuk është botuar asnjë fletore pune, përderisa për shkollimin e mesëm, përveç librave të leximit për klasat I, II dhe III, mungojnë tekstet e tjera në gjuhën turke. MASHT-i, me qëllim të zbutjes së mungesës së këtij problemi, ka marrë tekste nga Turqia. Mirëpo, arsimtarët ballafaqohen me probleme të mëdha gjatë zbatimit të plan-programeve, sepse tekstet e tilla nuk janë në përputhje me plan-programet e MASHT-it. (Shembull: në tekste flitet për kryeqytetin Ankara dhe jo Prishtina).

Niveli i ulët i arsimit si dhe vetëdija e ulët për rëndësinë e vijimit të shkollimit është edhe një problem, me të cilin përballen komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas. Për shkak të gjendjes së vështirë materiale, shumë familje vendosin që fëmijët e tyre t'i privojnë nga e drejta në arsim. Kësaj i ndihmon edhe fakti se ata shkollohen në gjuhët joamtare, si në gjuhën shqipe apo atë serbe. Natyrisht se problemi i arsimit të dobët në masë të madhe ndikon edhe në cilësinë e jetës së anëtarëve të këtyre komuniteteve, si dhe në jetëgjatësinë e tyre, e cila është dukshëm më e shkurtër në krahasim me jetëgjatësinë e përgjithshme në Kosovë.

Në Republikën e Kosovës edhe më tutje nuk ekziston arsimimi në shkollimin fillor në gjuhën rome, edhe pse ekzistojnë indikacionet nga ana e MASHT-it, që të zhvillohet potenciali arsimor në gjuhën rome, gjë që në masë të madhe do të ndikonte në ruajtjen e identitetit kulturor dhe gjuhën e këtij komuniteti.

OJQ “Voice of Roma, Ashkali and Egyptians“ (“Zëri i romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve”) e ka selinë në Gracanicë dhe misioni themelor i kësaj organizate është që t’iu ndihmojë romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve që sërish të integrohen në shoqërinë kosovare, si dhe t’i sigurojë

atyre kushte më të mira të jetës. Aktualisht punohet në implementimin e programit për socializimin dhe përmirësimin e kushtetev të jetës së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas, të cilin e financon Qeveria Zvicerane, nëpërmjet fondeve zvicerane HEKS.

Programi parasheh investimet në fushën e arsimit (puna me fëmijët parashkollorë dhe fëmijët e shkollave fillore në qendrat arsimore, programet e bursave për nxënësit e shkollave të mesme, për studentët e fakulteteve si dhe trajnime profesionale); të ekonomisë (krijimi i bizneseve të vogla familjare, me qëllim të zvogëlimit të shkallës së lartë të papunësisë dhe krijimi i mundësive për arritjen e profitit) dhe të infrastrukturës (lobimi tek qeveritë komunale për investimet në projektet e infrastrukturës në lagjet rome, siç janë instalimi i rrjetit të kanalizimit, riparimi i rrugëve etj.)

Fëmijët e komuniteteve ashkali dhe egjiptas, kryesisht i ndjekin mësimet në gjuhën shqipe. Mirëpo, fatkeqësisht, fëmijët e këtyre komuniteteve shumë herët përcaktohen për të braktisur shkollimin.

2.31.4. Mediat dhe komunitetet pakicë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton qasje dhe përfaqësim të komuniteteve pakicë në mediat publike,³⁸¹ që kanë të bëjnë me themelimin dhe shfrytëzimin e mediave të tyre, ofrimin e informatave në gjuhën e tyre, mes të tjerash edhe nëpërmjet gazetave ditore dhe shërbimeve kabllorike, si dhe shfrytëzimi i frekuencave të rezervuara për mediat elektronike, por në përputhje me ligjet dhe standardet ndërkombëtare.

Sipas shënimeve të cilat i ka në dispozicion Institucioni i Avokatit të Popullit, në Kosovë funksionojnë 92 radiostacione dhe 22 stacione televizive. Komuniteti serb i ka tri stacione televizive lokale, komuniteti turk e ka një stacion televiziv, i cili shfaq program edhe në gjuhën shqipe dhe atë boshnjake, përderisa komunitetet e tjera pakicë në Kosovë nuk kanë stacionet e tyre televizive. Në Prishtinë funksionon radio “Kent FM”, e cila emiton program na gjuhën turke, ndërsa “Mehmetcik FM” është radisotacion i KFOR-it turk, në muajin maj ka ndërprerë punën.

Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) është i vetmi institucion medial publik, puna e të cilit financohet nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe ndihmohet nga donacionet ndryshme. RTK, përpos programit në gjuhën shqipe, përgatit dhe emiton TV dhe radioprograme në gjuhët serbe, boshnjake, turke dhe rome, si dhe ekzistojnë indikacionet që në vitin 2012 të hapet edhe RTK 2, e cila do të japë program kryesisht në gjuhët e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë.

Sa u përket mediave të shtypura, komuniteti serb e ka gazetën e vet “Jedinstvo”, që shtypet në Mitrovicë, ndërkaq financohet nga Qeveria e Republikës së Serbisë. Në gjuhën boshnjake del revista “Alem”, e cila gjatë kësaj periudhe raportuese është shtypur vetëm periodikisht.

³⁸¹Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 59, p 10 dhe 11,

Në Prizren ekziston revista në gjuhën rome “Yekhipe”, e cila del 6 herë në vit, ndërkaq OJQ-të lokale në Prizren kanë themeluar një uebsajt informativ në gjuhën rome³⁸²

Pas ndërprerjes së botimit të javores në gjuhën turke “Yeni Donem”, në vitin 2008, përpjekjet për të nxjerrë ndonjë revistë tjetër në gjuhën turke kanë dështuar, për shkak të mjeteve materiale. Shoqata e gazetarëve të mediave turke në Kosovë, me seli në Prishtinë, gjatë kësaj periudhe ka filluar botimin e gazetës familjare “Tan Haber” ku janë nxjerrë 4 numra. Në kuptimin e informimit nëpërmjet internetit, ekzistojnë dy uebsajta në gjuhën turke, dhe atë “Kosova haber”, me seli në Prizren, i cili lexuesve të vet shërbimet ua përkthen edhe në gjuhën shqipe dhe atë boshnjake dhe uebsajti “Kosovaport”, me seli në Prishtinë.

³⁸² <http://roma.courriers.info>

3. Aktivitetet e Institucionit të Avokatit të Popullit

3.1. Aktivitetet e Grupit për Barazi Gjinore

Në kuadër të Institucionit e Avokatit të Popullit (IAP) ekziston Njësia për Barazi Gjinore (NJBGJ), e cila është e themeluar në bazë të nenit 6 të Ligjit për Barazi Gjinore,³⁸³ si dhe Ligjit për Avokatin e Popullit,³⁸⁴ me qëllim të hetimit, mbikëqyrjes dhe mbrojtjes kundër diskriminimit në baza gjinore. NJBGJ angazhohet edhe për avancimin e parimit të barazisë gjinore. Gjithashtu, NJBGJ është përgjegjëse për rishikimin e ligjeve dhe ngritjen e ndërjegjes për zbatimin e duhur të Ligjit për Barazi Gjinore në veçanti.

Gjatë vitit 2011 NJBGJ ka zhvilluar shumë aktivitete për promovimin dhe mbrojtjen e barazisë gjinore në Kosovë.

Më 6-8 prill 2011, dy këshilltare ligjorë të IAP-së kanë marrë pjesë në konferencën me temën “Roli i strukturave nacionale të drejtave të njeriut në mbrojtjen e drejtave të fëmijëve në përkujdesje”, të mbajtur në Talin të Estonisë. Pjesëmarrja në këtë trajnim ka pasur për qëllim avancimin e kapaciteteve profesionale të stafit, i cili heton dhe monitoron drejtat dhe liritë e njeriut.

Më 18 maj 2011, NJBGJ ka marrë pjesë në projektin “Indeksi i Sigurisë së Grave në Kosovë”, i cili është organizuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore. Qëllimi i projektit ishte realizimi i një metodologjie të re, të standardizuar, që mundëson matjen periodike të parametrave më të rëndësishëm të sigurisë së grave në Kosovë. Matja e nivelit të sigurisë së grave, në disa fusha shërben për ndërtimin e një indeksi të sigurisë përmes të cilit do të përcillet zhvillimi i sigurisë në Kosovë, në periudha afatgjata. QKSGJ synon të krijojë një bazë për zhvillimin dhe promovimin e sigurisë së grave në Kosovë dhe promovimin e Rezolutës 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

Më 24 dhe 25 maj 2011 dy këshilltare ligjore morën pjesë në konferencën e mbajtur në Kievë (Ukrainë), me temën “Roli i strukturave nacionale për drejtat e njeriut në promovimin dhe mbrojtjen e drejtave të personave me aftësi të kufizuar”. Qëllimi i vizitës ishte ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit të Departamentit e diskriminimit dhe Njesisë për Barazi Gjinore.

Më 8 qershor 2011, Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase të Kosovës ka organizuar një konferencë, me qëllim të krijimit të iniciativës konkrete nga aktorët kyç për mbështetjen e riintegritit dhe riadhesimit të grave dhe vajzave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas të kthyer nga vendet perëndimore, me temat:

- Strategjitë dhe marrëveshjet institucionale të rikthimit për integrimin e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptase në Kosovë përfshirë edhe aspektin gjinor në procesin e integritit të rikthyerve;
- Bashkëpunimi ndërmjet organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve të vendit në integrimin e të rikthyerve;
- Integrimi i rikthyerve në sistemin arsimor;
- Bashkëpunimi rajonal i OJQ-ve të grave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas.

³⁸³ Ligji për Barazi Gjinore, nr. 2004/2, , neni 6.

³⁸⁴ Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, neni 31; Rregullorja e punës së IAPK-së, 2011.

Më 3 qershor 2011, NJBGJ mori pjesë në tryezën me temën “Pushimi i lehonisë, dispozitë që favorizon apo disfavorizon gruan sipas ligjeve në fuqi”, të organizuar nga QKSGJ. Qëllimi i kësaj tryeze ishte harmonizimi i Ligjit të Punës dhe Ligjit për Shërbim Civil, përkitazi me pushimin e lehonisë, si dhe i çështjes se sa favorizohet ose disfavorizohet gruaja me dispozitat e pushimit të lehonisë.

Më 6 korrik 2011, organizata joqeveritare “Norma” ka organizuar tryezën e rumbullakët “Hulumtimi dhe monitorimi i Ligjit për Barazi Gjinore”, në të cilën mori pjesë edhe NJBGJ. Në këtë tryezë është monitoruar niveli i zbatimit të këtij ligji.

Më 18 tetor 2011, NJBGJ mori pjesë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ku është mbajtur debati “Dhuna në familje”, i organizuar nga gratë deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Gjatë takimit u konstatua se ka një mungesë të kurajës për lajmërimin e rasteve të dhunës familjare dhe gjithashtu është propozuar miratimi i akteve normative nga Qeveria e Kosovës për zbatimin e Ligjit kundër dhunës në familje.

Më 4 tetor 2011, NJBGJ ka marrë pjesë në promovimin e raportit “Indeksi i sigurisë së grave 2010 - Raport për Kosovën”, të organizuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore.

Më 25 nëntor 2011, me rastin e shënimit të Ditës për eliminimin e dhunës ndaj gruas, Avokati i Popullit, i shoqëruar nga me përfaqësuesit e NJBGJ-së, ka vizituar Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Prishtinë, ku është informuar nga drejtoresha e kësaj strehimoreje për punën dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohet kjo organizatë.

Më 12 dhjetor 2011, NJBGJ ka marrë pjesë në një konferencën me temë, “Përfaqësimi i barabartë politik për gratë në Kosovë”. Qendra për Studime Gjinore, së bashku me organizatën “Kvina till Kvina” ka organizuar ligjëratë lidhur me çështjen e kuotës gjinore në sistemin zgjedhor.

Më 19 dhjetor 2011, NJBGJ mori pjesë në konferencën “Ndikimi i Ligjit të Punës tek gratë në Kosovë”, të organizuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore. Qëllimi i këtij projekti ka qenë promovimi i raportit të hulumtimit dhe të dhënave të cilat do të shërbejnë si burim i informacionit të rëndësishëm për institucionet dhe organizatat që merren me të drejtat e grave në punë.

3.2. Aktivitetet e Grupit për të Drejtat e Fëmijëve

Grupi për të Drejtat e Fëmijëve (GDF) në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) është themeluar me qëllim të mbikëqyrjes, mbrojtjes dhe hetimit të rasteve të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve nga autoritetet publike në Kosovë.

GDF, gjatë vitit 2011, përveç se ka shqyrtuar ankesat e paraqitura në IAP, ka ndërmarrë edhe aktivitete të tjera, në drejtim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, si dhe të ngritjes së kapaciteteve profesionale.

Më 1 - 4 mars 2011, në Durrës u mbajt një nga punëtoritë e parapara për zhvillimin e projektit “Hartëzimi, vlerësimi dhe zhvillimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë”, organizuar nga UNICEF, në bashkëpunim me agjencinë këshillëdhënëse DeLegibus Consulting, në të cilën mori pjesë edhe GDF.

Gjatë kësaj punëtorie u siguruan informatat për situatën e mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë, nëpërmjet plotësimit të disa pyetësorëve, që përbënin një pjesë të së ashtuquajturës bashkësi të instrumenteve analitike, e nevojshme për vlerësimin e legjislacionit, shërbimeve dhe politikave ekzistuese për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë, si dhe për të identifikuar pengesat dhe mundësitë e zbatimit të tyre. Pas analizimit dhe vlerësimit të këtyre informatave dhe të dhënave të tjera, në relacion me mbrojtjen e fëmijëve, drafraporti përmbledhës, përkatësisht gjetjet dhe rekomandimet, lidhur me situatën e të drejtave të fëmijëve në Kosovë, u rishikuan dhe u diskutuan në punëtorinë tjetër, që u mbajt në Prishtinë, më 10 qershor 2011. Në këtë punëtori u diskutua edhe për hapat e mëtejshëm që duhet të ndërmerren me qëllim të finalizimit të vlerësimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë.

“Roli i ombudsmanëve në mbrojtjen e fëmijëve nga ndëshkimi fizik dhe psikik” ishte temë diskutimi në takimin vjetor të Rrjetit të Ombudsmanëve për Fëmijë të Evropës Juglindore (CRONSEE),³⁸⁵ anëtar i të cilit është edhe IAP, që u mbajt më 20 maj 2011 në Shkup.

Nga prezantimet e bëra në këtë takim, përveç të tjerash doli se, në vendet anëtare të CRONSEE-it, ndëshkimi fizik dhe psikik i fëmijëve, ende është i përhapur në familje, në shkolla, në institucione për përkujdesje ndaj fëmijëve dhe në rrugë dhe si i tillë nuk njihet dhe nuk trajtohet si shkelje e të drejtave të fëmijëve. Duke u nisur nga kjo situatë, me qëllim të përmirësimit të mbrojtjes së fëmijëve, nga të gjitha llojet e ndëshkimit fizik dhe psikik, si dhe nga keqtrajtimi, pjesëmarrësit e takimit, përveç të tjerash, u pajtuan për ndryshime, sidomos në legjislacionin e vendeve, ku ndëshkimi fizik duhet të parashihet dhe të ndalohet në mënyrë eksplicite, në të gjitha segmentet e shoqërisë (familje, arsim, institucione, rrugë etj.) dhe se personat që përdorin ndëshkimin fizik ndaj fëmijëve duhet të dënohen me dënime më të ashpra.

“Mbrojtja e fëmijëve nga eksploatimi ekonomik”, ishte temë tjetër diskutimi e CRONSEE, në konferencën e mbajtur më 6 - 7 shtator 2011, në Ohër (Maqedoni). Në këtë konferencë nga të gjithë pjesëmarrësit u tha se çështja e eksploatimit ekonomik të fëmijëve, e veçanërisht kërkimi i lëmoshës mbetet dukuri mjaft shqetësuese (përveç në Slloveni). Konkludimi i përbashkët në konferencë ishte që shtetet përkatëse duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për parandalimin dhe eliminimin e saj, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit dhe mirëqenies së fëmijëve.

Më 14 - 16 shtator 2011, në Varshavë (Poloni), u mbajt konferenca vjetore e Rrjetit të Ombudsmanëve për Fëmijë të Evropës (ENOC), në të cilën, përveç shteteve anëtare të këtij rrjeti, morën pjesë edhe përfaqësues të ombudsmanëve për fëmijë të disa shteteve joanëtare. GDF ishte pjesë e kësaj konference në cilësi të vëzhguesit të konferencës. Tema kryesore e kësaj konference ishte “Respektimi i të drejtave të fëmijëve në institucionet për përkujdesje” për çka më herët ishte zhvilluar hulumtimi për të vlerësuar situatën lidhur me këtë temë në shtetet anëtare të ENOC.

Nga prezantimi i rezultateve të hulumtimit doli se në shumë vende ekziston një shpërputhje e madhe në mes të kornizës ligjore, që rregullon këtë fushë dhe zbatimit të saj në praktikë. Ndërkaq, në shumicën e vendeve arsyet për vendosjen e fëmijëve në institucione për përkujdesje nuk janë mjaft të qarta dhe lënë hapësirë për interpretime nga ana e gjykatave apo të organeve të tjera kompetente.

³⁸⁵ www.cronsee.org/.

Më 4 - 6 tetor 2011, GDF mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Zyra e Kryeministrit dhe UNICEF-i, në Durrës. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte funksionalizimi i Këshillit për Mbrojtjen dhe Drejtësinë për Fëmijë³⁸⁶. Në punëtori u hartua draftregullorja e punës dhe plani i veprimit për këtë këshill, për tre muajt pasues.

Më 7 dhjetor 2011, GDF ka marrë pjesë në punëtorinë “Rishikimi vjetor i aktiviteteve të parapara në planin e veprimit të UNICEF- it, për vitin 2011”, të organizuar nga UNICEF-i. Në këtë punëtori u diskutua për aktivitetet e ndërmarra, të parapara me planin e veprimit për vitin 2011, si dhe për sfidat e hasura gjatë ndërmarrjes së tyre. Po ashtu, në këtë punëtori u përcaktuan edhe aktivitetet, që do të ndërmerren nga ana e Këshillit për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë për vitin 2012, të cilat do të mbështeten nga ana e UNICEF-it.

Me qëllim të shënimit të Ditës Universale të Fëmijëve³⁸⁷, GDF ka realizuar disa takime me nxënës të shkollave fillore, në disa nga fshatrat e komunave të rajoneve të Prizrenit, Pejës, Mitrovicës dhe të Gjilanit. Në këto takime ata i kanë njoftuar nxënësit e këtyre shkollave, lidhur me misionin e IAP-së, përkatësisht të GDF-së, për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në Kosovë. Në këto takime është diskutuar edhe për situatën e të drejtave të fëmijëve, në shkollat përkatëse dhe mënyrën e adresimit të shqetësimeve dhe problemeve të nxënësve në shkolla.

Nga diskutimet e bëra rezultoi se në disa nga shkollat e vizituara nxënësit janë pak të informuar për të drejtat e fëmijëve dhe rolin e IAP-së, në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, disa shkolla nuk kanë kushte përkatëse për mësim, ndërsa në shkollën fillore “Zenun Çoçaj” të fshatit Gjonaj, nxënësit përballen edhe me mungesë të ujit të pijshëm dhe të tualeteve.

Në Prishtinë me rastin e shënimit të Ditës Universale të Fëmijëve, fëmijë të shkollave fillore të Prishtinës kanë vizituar zyrën qendrore të IAP-së, janë takuar me Avokatin e Popullit dhe janë njohur për së afërmi me punën që bëhet në këtë institucion, me misionin dhe angazhimin e IAP-së, në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

3.3. Aktivitetet e Grupit për Mosdiskriminim

Grupi për Mosdiskriminim (GMD), i formuar si grup i veçantë, i cili funksionon në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit, që nga 8 marsi 2004, gjatë kësaj periudhe raportuese ka pranuar dhe shqyrtuar një numër të madh ankesash, ku parashtruesit e tyre kanë pohuar se janë viktima të diskriminimit.

³⁸⁶ Këshilli është themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, më 25 gusht 2011. Mandati i Këshillit ka të bëjë, përveç të tjerash edhe me përcaktimin e prioritetëve masave të nevojshme që duhet të ndërmerren, me qëllim të përmirësimit të situatës, në lidhje me mbrojtjen dhe drejtësinë për fëmijë. Ai përbëhet nga përfaqësues të institucioneve qeveritare dhe joqeveritare, që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve. Institucioni i Avokatit të Popullit është pjesë e këtij këshilli, në cilësinë e anëtarit vëzhgues.

³⁸⁷ Dita Universale e Fëmijëve shënohet më 20 nëntor të çdo viti nga shumë vende të botës, që nga viti 1956, duke u nisur nga rekomandimi i Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës Kombeve të Bashkuara. Ajo kishte rekomanduar shënimin e kësaj dite, me qëllim të inkurajimit të vëllazërisë dhe mirëkuptimit në mes të fëmijëve, si dhe promovimit të mirëqenies së fëmijëve.

Ankesat e paraqitura janë të natyrave të ndryshme. Numri më i madh i tyre ka të bëjë me diskriminim në sferën sociale, shëndetësore, pronësore, marrëdhënie pune. Ndërkaq disa prej tyre janë ankesa nga persona me aftësi të kufizuar dhe ankesa për diskriminim në baza fetare.

Gjatë kësaj periudhe raportuese GMD ka realizuar disa vizita nëpër spitale, shkolla, OJQ, përfaqësues të personave me aftësi të kufizuar dhe vendbanime të banuara kryesisht me komunitetin serb. Gjithashtu, GMD ka marrë pjesë në disa debate me qytetarët në komuna të ndryshme, ku për së afërmi është njoftuar me problemet e qytetarëve në terren.

Në mënyrë që të njihet më për së afërmi me problemet e komunitetit serb për t'i pranuar ankesat eventuale, lidhur me lirinë e lëvizjes, GMD ka vizituar komunat: Ranillug, Gjilan, Klllokot, Viti, Shtërpçë, Prizren, Dragash, Pejë, Klinë si dhe fshatrat Gorazhdec dhe Osojan, të banuara kryesisht me komunitetin serb.

GMD, gjatë vitit 2011, ka marrë pjesë në disa takime dhe tryeza të rrumbullakëta:

- 29 mars 2011, tryezë e mbajtur në Prishtinë me temën “Zbatimi i ndërmjetësimit në Agjencisë Kosovare të Pronës, metodë alternative për zgjedhjen e kontesteve pronësore”. Rekomandimi i dalë nga tryeza ishte që AKP-ja të përdorë ndërmjetësimin, si metodë për zgjidhjen e kontesteve pronësore.
- 5 maj 2011, takim i përbashkët në Zyrën e Kryeministrit me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas për ecurinë e strategjisë për integrimin e këtyre komuniteteve, në periudhën 2007-2017.
- 24 - 25 maj 2011, Kiev (Ukrainë), punëtorja e katërt tematike me temën “Roli i mekanizmave kombëtar për të drejtën e njeriut për mbrojtjen dhe promovimin e drejtave të personave invaliditet fizik”, nën organizimin e Këshillit të Evropës/ Komisionit Evropian në programin e tyre të përbashkët: "Promovimi i mekanizmave të pavarur kombëtarë jogjyqësor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut".
- 8 qershor 2011, Hotel Grand në Prishtinë, Konferenca me temë "Integrimi dhe ripranimi në shoqërinë kosovare i grave të kthyera të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas", organizuar nga Qendra e Kosovës për Barazi Gjinore.
- 9 - 11 qershor 2011, GMD ka marrë pjesë në konferencën regjionale të mbajtur në Ohër, Maqedoni, për rolin e Avokatit të Popullit në luftën kundër diskriminimit dhe torturës. Nga vendet pjesëmarrëse në këtë konferencë, përfaqësues të institucioneve të Avokatit të Popullit nga rajoni kanë shkëmbyer përvojat e punës në trajtimin e ankesave me baza diskriminuuese dhe kundër torturës. Gjithashtu secili përfaqësues ka prezantuar ligjin kundër diskriminimit në vendin e vet, çështjet të cilat i rregullon ky ligj, si dhe implementimin e tij.
- 28 qershor 2011, “Vila Lira”, Prishtinë, trajnimi "Aftësitë praktike dhe organizative", organizuar nga OSBE-ja, në kuadër të projektit "Mbështetje për mekanizmat lokalë ëpr mbikëqyrje të vendeve ku janë vendosur personat e privuar nga liria”.
- 29 qershor 2011, në Prishtinë, GMD ka qënë pjesëmarrëse në konferencën për gazetarë lidhur me publikimin e raportit vjetor të Agjencinë Kosovare të Pronës.

- 8 korrik 2011, është mbajtur tryeza me temën “Sigurimet shëndetësore - një e drejtë e munguar”, ku GMD ka pasur rol aktiv, duke i prezantuar shqetësimet e qytetarëve të Kosovës për mungesën e Ligjit për Sigurime Shëndetësore.
- 28 - 29 shtator 2011, Sarajevë (Bosnje dhe Hercegovinë), Punëtorja e pestë tematike "Roli i mekanizmave kombëtare për të drejtat e njeriut në mbrojtje ndaj të gjitha formave të diskriminimit", organizuar nga Këshilli i Evropës / Komisioni Evropian, në programin tyre të të përbashkët "Promovimi i mekanizmave të pavarur kombëtarë jogjyqësorë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut”.
- 1 nëntor 2011, GMD ka qenë pjesë aktive në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga Avokati i Popullit, me temën "Avokati i Popullit - të drejtat e njeriut - mediat".
- 2-5 nëntor 2011, “Brilant”, Prishtinë, trajnimi në temën "Zbatimin i standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në Kosovë – Standardet e zbatueshme dhe metodologjia juridike – Strategjitë dhe teknikat hulumtuese”, organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë - Departamenti i Demokratizimit.
- 29-30 nëntor 2011, në Gjenevë (Zvicër), Pallati i KB-së, Sesion i Katërt i Forumit të OKB-së për Çështje të Pakicave, tema "Garantimi i të drejtave të grave të komuniteteve pakicë.
- 2 dhjetor 2011, nën koordinimin e GMD-së është mbajtur tryezë e rrumbullakët e organizuar nga Avokati i Popullit me temën “Stop diskriminimit - barazi për të gjithë”. Në këtë tryezë është diskutuar lidhur me problemet me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuar në Kosovë, të gjeturat e Avokatit të Popullit, lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut, si dhe për veprimet e ndërmarra apo të planifikuara nga institucionet publike përgjegjëse, në nivel qendror dhe lokal, për implementimin e ligjeve dhe Planit kombëtar të veprimit për personat me aftësi të kufizuar për vitet 2009-2011. Nga kjo tryezë kanë dalë rekomandime, të cilat janë përcjellë nga Njësia për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, e cila është themeluar në kuadër të Departamentit për mosdiskriminim, në IAP.
- 15 dhjetor 2011, përfaqësuesi i GMD-së ka marrë pjesë si pjesëtar i panelit në “Media Centar”, ku është diskutuar për implementimin e Ligjit kundër diskriminimit.
- 19 dhjetor 2011, përfaqësuesi i GMD-së ka qenë prezent në tryezën e mbajtur nga Zyra për Qeverisje të Mirë e Zyrës së Kryeministrit, me temën “Plani i veprimit për zbatimin e ligjit kundër diskriminimit”.
- 20 dhjetor 2011 përfaqësuesi i GMD ka qenë prezent në tryezën e mbajtur nga Institucioni i Avokatit të Popullit me temën “Dëshmimi i përvojës së punës”.

4. Bashkëpunimi i IAP-së

4.1. *Bashkëpunimi me institucionet vendore*

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka pasur bashkëpunime me institucione vendore, siç janë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës/ministritë, komunat, si dhe institucionet dhe agjencitë e pavarura dhe gjykatat.

Me Kuvendin e Republikës së Kosovës IAP ka bashkëpunuar në vazhdimësi, ka paraqitur raportin vjetor, ka njoftuar për moszbatimin e rekomandimeve të IAP-së, ka marrë pjesë në punën e komisioneve të Kuvendit, si dhe ka njoftuar për vështirësitë objektive të IAP-së³⁸⁸. Gjithashtu, ka bashkëpunuar për zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të Popullit me komisionet relevante parlamentare dhe ka njoftuar për problemin e pagave të zëvendësve.³⁸⁹

Sa i përket bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës së Kosovës, IAP ka dërguar letra dhe rekomandime për hetimin e ankesave, por nuk mund të thuhet se ka qenë bashkëpunim i mirë, sidomos për shkak të mospërgjigjes në letrat e dërguara, si dhe moszbatimit të rekomandimeve të IAP-së. IAP ka pasur bashkëpunim edhe me komunat. Ka dërguar letra dhe rekomandime, por ka pasur edhe vështirësi, në disa komuna për mospërgjigjen e zyrtarëve rajonale për IAP-në. Me mbështetjen e OSBE-së janë organizuar tri tryeza të rrumbullakëta nga IAP-ja me temën: “Bashkëpunimi ndërinstitucional në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut”. Aktivitetet janë zhvilluar në Mitrovicë, Prizren Gjilan dhe Gjakovë. Në këto tryeza kanë marrë pjesë koordinatorë të njësive komunale për të drejtat e njeriut, zyrtarë të tjerë publik nga niveli komunal, si dhe OJQ të ndryshme. Ky aktivitet është zhvilluar në kuadër të fushatës publike të vitit 2011 “Avokati i Popullit, një hap me afër qytetarit”, që është shtrirë në tërë Kosovën. Diskutimet janë përqendruar në metodat e një bashkëpunimi dhe komunikimi më efektiv në dobi të qytetarit.

Në anën tjetër, ka vazhduar edhe bashkëpunimi me gjyqësorin, ndaj të cilit janë adresuar ankesat më të mëdha të qytetarëve, janë dërguar letra, raporte dhe ka pasur kontakte të shumta me gjykata të ndryshme.

Ndërsa sa i përket bashkëpunimit me Gjykatën Kushtetuese, IAP ka bashkëpunuar në çështjet e ngritura nga IAP dhe qytetarët. IAP ka ngritur në Gjykatën Kushtetuese edhe çështjen e Ligjit për Avokatin e Popullit.³⁹⁰

IAP i kushton rëndësi të veçantë edhe bashkëpunimit me mediat. Në kuadër të këtij bashkëpunimi është organizuar tryeza e rrumbullakët “Avokati i Popullit - Të Drejtat e Njeriut - Mediat”, e cila ka ofruar mundësinë e diskutimit të përbashkët në mes përfaqësuesve të

³⁸⁸ Raporti mbi pengesat në përmbylljen e misionit kushtetues të IAP-së, si pasojë e cenimit të pavarësisë së tij, dërguar Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 17 qershor 2011.

³⁸⁹ Mosekzekutimi i vendimit të IAP-së për procedimin e pagave për zëvendësit e Avokatit të Popullit, nga Ministria e Administratës Publike, dërguar Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 29 nëntor 2011.

³⁹⁰ Kërkesë drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës për vendosjen e masave të përkohshme në zbatimin e nenit 32, pika 1, të Ligjit Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, më 6 dhjetor 2011.

mediave në Kosovë dhe Avokatit të Popullit, lidhur me të drejtat dhe liritë e njeriut, hapësirën që i jepet këtij dimensionit në media dhe bashkëpunimin reciprok.

4.2. Bashkëpunimi me shoqërinë civile

Institucioni i Avokatit të Popullit konsideron se bashkëpunimi me shoqërinë civile është mjaft i rëndësishëm për sigurimin e një sistemi efektiv për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Një bashkëpunim i tillë ndihmon në ndikimin që IAP mund të ketë në realizimin e misionit të tij. Ky bashkëpunim ndihmon në ngritjen e vetëdijes për të drejtat e njeriut dhe në pjesëmarrjen e grupeve të cënueshme të shoqërisë në sistemin e të drejtave të njeriut.

Si dëshmi e këtij bashkëpunimi është vendimi i Gjykatës Kushtetuese për Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve, të cilin e inicioi Avokati i Popullit, me kërkesën e shoqërisë civile, përkatësisht organizatave si: Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), Iniciativa e të Rinjve për të Drejta të Njeriut (YIHR), Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), Iniciativa për Progres (INPO), Lëvizja Fol, Instituti Ballkanik i Politikave (IPOL), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMLDNJ), Ndërtimi i Komunitetit Mitrovicë (CBM), Qendra për Politika dhe Avokim (QPA) dhe Syri i Vizionit, të cilat çmuan lartë punën e IAP-së, në mbrojtjen e interesave të qytetarëve të Kosovës, gjë e cila forcon integritetin e këtij institucioni dhe e rrit besueshmërinë e qytetarëve të Kosovës për ndërtimin e një shteti ligjor.³⁹¹

Një bashkëpunim tjetër shumë i mirë vazhdon të ekzistojë në mes të IAP-së, Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) dhe Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), të cilët kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit, i cili shënon iniciimin e një mekanizmi transparent dhe të qëndrueshëm për monitorimin e vendeve ku mbahen personat e privuar nga liria dhe do të punojë në krijimin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT).

Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje pasuan një seri aktivitete nga palët nënshkruese. Vlen të përmendet vizita studimore në Shqipëri, e cila është organizuar nga IAP, në bashkëpunim me OSBE-në, qëllimi i së cilës ishte që pjesëmarrësit të njihen me funksionimin e MKPT-së në Shqipëri dhe përfitimi nga praktikat dhe përvoja disavjeçare e Avokatit të Popullit në Shqipëri si MKPT. Po ashtu gjatë vizitës pjesëmarrësit janë njoftuar edhe me metodologjinë e punës, planet e veprimtimit si dhe mënyrën e raportimit të MKPT-së.

Institucioni i Avokatit të Popullit, më 2 dhjetor 2011, organizoi tryezën e rrumbullakët me temën "Stop Diskriminimit - Barazi për të gjithë", me rastin e ditës ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuar.

Nga kjo tryezë dolën shumë rekomandime, ndër të tjera: nevoja për amendamentimin e Ligjit kundër diskriminimit; integrimi i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kushtetutën e Kosovës; krijimi i strategjisë gjithëpërfshirëse për persona me aftësi të kufizuar; zyrtarizmi i gjuhës së të shurdhërve; përmirësimi i bashkëpunimit të organizatave të

³⁹¹ Instituti Demokratik i Kosovës, Letër e hapur, 27 dhjetor 2011, www.kdi-kosova.org.

personave me aftësi të kufizuar dhe institucioneve që kanë mision realizimin e të drejtave të tyre, krijimi i kushteve për edukim, punësim dhe lëvizjes së lirë të këtij grupi të personave.

4.3. Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare dhe ngritja e kapaciteteve

Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare, si në Kosovë, ashtu edhe jashtë saj, është i një rëndësie të veçantë për IAP-në. Prandaj, IAP ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme, duke përfshirë pjesëmarrjen aktive të punonjësve të Avokatit të Popullit në shumë takime e konferenca ndërkombëtare, punëtori, seminare dhe vizita studimore, në lidhje me zhvillimet në fushën e të drejtave të njeriut.

IAP vazhdon të ketë bashkëpunim të ngushtë me Misionin e OSBE-së në Kosovë. Për të krijuar mbrojtje institucionale dhe afatgjate, Misioni i OSBE-së e mbështet IAP-në, si institucion i vetëm kombëtar për të drejtat të njeriut në Republikën e Kosovës, përmes këshilltares së misionit të OSBE, znj. Jerina Dampier në IAP, e cila ndihmon punën e përditshme të IAP-së.

Përveç kësaj OSBE mbështet IAP-në edhe në ngritjen e kapaciteteve, duke organizuar dhe mbështetur shumë aktivitete dhe trajnime në fushën e të drejtave të njeriut, të cilat ndikojnë në mënyrë direkte në ngritjen e performancës së punonjësve të IAP-së.

Vlen të përmendet vizita studimore në Strasburg, ku 17 punonjës të IAP-së, patën rastin të vizitojnë Këshillin e Evropës dhe Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të shohin nga afër punën, si dhe të mësojnë nga kjo përvojë, të cilën do të mund ta transferojnë në punën e tyre të përditshme. Gjatë kësaj vizite pjesëmarrësit patën rastin që të dëgjojnë ligjërata nga gjyqtarë të Gjykatës Evropiane dhe nga punonjës të tjerë, lidhur me punën dhe sfidat kryesore të tyre, si duhet të procedohen rastet në këtë gjykatë, kriteret e pranueshmërisë së tyre etj. Ata ishin të pranishëm si vëzhgues, gjatë një seance të Dhomës së Madhe në Gjykatën e Strasburgut,³⁹² ku mësuan për punën dhe mënyrën e funksionimit të saj. Përveç kësaj, pjesëmarrësit dëgjuan ligjërata nga disa departamente të Këshillit të Evropës si: Departamenti për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, Komiteti për Agjencinë e BE-së për të Drejtat Themelore, Sekretariati për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve dhe Komiteti për Parandalimin e Torturës.

Po ashtu, OSBE ka mbështetur IAP-në edhe për organizimin e disa trajnimeve të fushave të ndryshme për të drejtat e njeriut, siç janë: aplikimi i normave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, me ligjërues-ekspertë nga Gjykata e Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Planifikimi strategjik dhe aftësitë e komunikimit me personat e privuar nga liria, trajnim për planifikimin e punës në monitorimin e qendrave të ndalimit së bashku me anëtarët e tjerë të grupit punues, të cilët janë pjesë e iniciativës për MKPT.

IAP ka bashkëpunim të mirë edhe me Këshillin e Evropës (KE). Edhe pse Kosova nuk është anëtare e KE-së, IAP është ftuar rregullisht në takime, seminare dhe konferenca të ndryshme,

³⁹² Seanca e Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, lidhur me rastin nr. 9300/07, Herrman vs. Gjermani, mbajtur më 30 nëntor 2011, në orën 9.15.

të cilat gjithashtu kanë ndikuar në avancimin e bashkëpunimit të IAP-së me institucione simotra për të drejtat e njeriut në Evropë.

Një projekt i rëndësisë së veçantë është projekti Peer-to-Peer, i mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, i cili ka këto objektiva: promovimin, mbështetjen dhe fuqizimin e funksionimit të institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut, në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe evropiane (duke përfshirë edhe Parimet e Parisit); promovimin e mekanizmave kombëtarë parandalues kundër torturës; promovimin e bashkëpunimit/rrjetit të strukturave kombëtare për të drejtat e njeriut dhe mekanizmave kombëtar parandalues.³⁹³

Në kuadër të këtij projekti IAP ka marrë pjesë në disa aktivitete, siç është punëtorja me temën “Roli i strukturave kombëtare për të drejtat e njeriut në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në përkujdesje”, i cili u mbajt në prill të vitit 2011 në Tallin, Estoni. Në këtë punëtori është diskutuar për mekanizmat ligjorë ndërkombëtarë, të cilët mbrojnë të drejtat e fëmijëve në përkujdesje, për adoptimin e fëmijëve nga ana e një familje dhe janë parashtruar mendimet e ndryshme, lidhur me përkujdesjen familjare dhe përkujdesjen institucionale nga ana e shtetit.

Takimi tjetër nën kornizën e këtij projekti ishte edhe takimi i pestë, i personave kontaktues në institucione për të drejtat e njeriut, i cili u mbajt më 8 dhjetor 2011, në Lubjanë (Slloveni). Në këtë takim u diskutuan çështje të ndryshme në interes të së ardhmes.

Bashkëpunim të mirë IAP ka edhe me Zyrën e Komisionarit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, prej së cilës ka marrë ftesa për takime dhe konferenca të ndryshme të organizuara, por gjithashtu ka raportuar edhe për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Më 15 mars 2011 kësaj zyreje iu dërgua raporti për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, sipas pyetësorit të dërguar. Po ashtu, IAP, më 24 shkurt 2011, ka marrë një pyetësor, lidhur me gjendjen e të drejtave të njeriut të personave të moshuar në të cilin është përgjigjur për këtë kategori të personave.³⁹⁴

Në maj të vitit 2011, Avokati i Popullit, më një bashkëpunëtor të institucionit, mori pjesë në takimin e 24-të të Komitetit Koordinues Ndërkombëtar të institucioneve për të drejtat e njeriut (KKN).³⁹⁵ Në këtë takim morën pjesë shumë përfaqësues të vendeve të ndryshme të botës, ku u diskutuan shumë çështje për të drejtave të njeriut. U diskutua për raportin e progresit të KKN-së, të drejtën në edukim; të drejtat e personave me aftësi të kufizuara; Konventën Kundër Torturës dhe implementimin e saj; të drejtat e grave; luftën kundër racizmit; institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut, në situata konfliktuale.

Në kuadër të bashkëpunimit të IAP-së, në këtë sferë, Avokati i Popullit ka zhvilluar takime me shumë personalitete, ku është diskutuar për tendencat dhe zhvillimet aktuale në Kosovë dhe si rezultat i këtyre takimeve, ai mori premtime për angazhim intensiv në lidhje me IAP-në dhe akreditimin e tij në KKN, në pajtueshmëri me Parimet e Parisit³⁹⁶. Në kuadër të këtij

³⁹³ Council of Europe, Joint European Union - Council of Europe Programme, 26 dhjetor 2011, www.coe.int

³⁹⁴ Pyetësori i Zyrës së Komisionarit të Lartë për rolin e institucioneve dhe shoqërisë civile në parandalimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të drejtat e personave të moshuar në Republikën e Kosovës.

³⁹⁵ Komiteti Koordinues Ndërkombëtar i institucioneve kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, është një mekanizëm ndërkombëtar i pavarur që promovon themelimin dhe forcimin e institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut në pajtueshmëri me Parimet e Parisit.

³⁹⁶ Parimet e Parisit janë standarde të cilat duhet të plotësohen nga të gjitha institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut që të mund të konsiderohen kredibile dhe të funksionojnë drejt.

takimi u zhvillua edhe punëtorja me temën "Roli i parandalimit në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut", në të cilën u diskutua për rolin e parandalimit të shkeljeve të të drejtave politike dhe civile, parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit, parandalimin e shkeljeve të të drejtave sociale dhe kulturore, trafikimin me qenie njerëzore, migrimin dhe diskriminimin.

Me rastin e shënimit të ditës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, IAP në bashkëpunim me Zyren e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, ka organizuar tryezën e rrumbullakët me temën "Çfarë do të thotë të jesh mbrojtës i të drejtave të njeriut", ku morën pjesë shumë aktivistë për të drejtat e njeriut, të cilët shpërfaqen motivin dhe sfidat me të cilat ata ballafaqohen gjatë punës së tyre.

IAP edhe në të ardhmen do të bashkëpunojë me institucione vendore, me shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare, me shpresën që do të këtë mbështetje më të madhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, respektim më të madh të shkresave dhe rekomandimeve nga Qeveria e Republikës së Kosovës, bashkëpunim edhe më të madh nga shoqëria civile dhe mbështetje nga OSBE-ja edhe në të ardhmen, me qellim bashkërisht të punohet për përmirësimin e gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë.

5. Buxheti i Institucionit të Avokatit të Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) është institucion i pavarur publik, i cili financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit “*IAP e përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës*”.³⁹⁷ Po sipas kësaj dispozite ligjore, IAP-së i sigurohet buxhet i nevojshëm “Pavarësisht nga dispozitat e ligjeve të tjera”.³⁹⁸

5.1. *Financimi i IAP-së nga buxheti i Kosovës*

Avokati i Popullit, mbështetur në legjislacionin pozitiv për pavarësinë buxhetore dhe financiare të IAP-së, më 29.6.2010, ia ka dërguar kërkesën e vetë buxhetore për vitin 2011, Kuvendit të Republikës së Kosovës, bazuar në procesin ligjor për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesës së rregullt buxhetore.

Kërkesa buxhetore e Avokatit të Popullit për vitin 2011 është bazuar në planin e punës dhe të aktiviteteve të planifikuara, si dhe mbi bazën e kompetencave të reja të Avokatit të Popullit, të caktuara me legjislacionin e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit të kërkesës buxhetore për financimin e Avokatit të Popullit për vitin 2011, Avokati i Popullit nuk është ftuar nga Kuvendi i Kosovës / Komisioni për Buxhet dhe Financa, për arsyetimin e kërkesës buxhetore, me gjithë të drejtën dhe obligimin ligjor.

Avokati i Popullit është mjaft i shqetësuar dhe shpreh pakënaqësinë, që nga institucioni më i lartë ligjvënës i vendit nuk i është dhënë mundësia dhe e drejta ligjore dhe kushtetuese për mbrojtjen dhe arsyetimin e kërkesës buxhetore.

Kërkesa buxhetore e IAP-së, për vitin 2011, ka qenë e përgatitur në dy variante, si në vijim:

- a) Në variantin e parë, është kërkuar buxhet në shumën prej 1.595.025.60 €. Në këtë kërkesë është përllogaritur buxheti për këto kategori buxhetore: *paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale dhe shpenzime kapitale* (propozim-projekt për ndërtimin e një objekti për zyre pune të IAP-së).
- b) Në variantin e dytë, kërkesa buxhetore ka qenë në shumë prej 765.025.60 €. Me këtë kërkesë buxhetore është përllogaritur buxheti për këto kategori buxhetore: *paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale dhe shpenzime kapitale*. Me këtë kërkesë buxhetore, në mënyrë të veçantë ka qenë i përllogaritur dhe është kërkuar buxhet i domosdoshëm për qira të zyrave të punës për selinë e IAP-së në Prishtinë.

Përkundër kërkesës së rregullt, kërkesa buxhetore e IAP-së për vitin 2011 nuk është vlerësuar, shqyrtuar dhe miratuar në mënyrë ligjore dhe meritore nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Buxheti i miratuar në shumë prej 629.319.00 € ka qenë i pamjaftueshëm dhe nuk i ka plotësuar nevojat dhe kërkesat reale për punë dhe funksionim të rregullt të IAP-së.

³⁹⁷ Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, neni 34, par. 2.

³⁹⁸ Po aty.

Buxheti i ndarë për vitin 2011 ka qenë i pamjaftueshëm, sidomos për këto kategori buxhetore:

- a) Për Paga dhe Mëditje, kërkesa buxhetore ka qenë e lidhur me rritjen e numrit të punonjësve - plotësimin e nevojave me personel të ri, në shërbimin profesional dhe të administratës, për këto vende të punës: jurist hetues (6 pozita); menaxher të zyrës së personelit; menaxher të zyrës për marrëdhënie ndërkombëtare; zyrtar certifikues; auditor i brendshëm; zyrtar të teknologjisë informative (2 pozita), lektor; arkiv dhe bibliotekë etj.
- b) Për Mallra dhe Shërbime, veçanërisht ka qenë buxhet i pamjaftueshëm për qira të selisë së IAP-së në Prishtinë. Si rezultat i procesit të privatizimit të objektit shoqëror (objektin për punë IAP e ka shfrytëzuar pa qira deri në muajin maj 2011). IAP ka hyrë në obligime të reja kontraktuese për qiranë e selisë së IAP-së në Prishtinë.

Për shkak të kufizimeve buxhetore nga organet vendimmarrëse, Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, me gjithë pavarësisë e garantuar normative me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me këtë mënyrë të ndarjes së buxhetit për vitin 2011, IAP-së i është kufizuar dhe vështirësuar përmbushja e obligimeve dhe realizimi i misionit të vetë kushtetues dhe ligjor. Specifikat e punës dhe përgjegjësi të IAP-së, të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, natyrshëm kanë implikime financiare. Përmbushja e misionit dhe të IAP-së, varet dhe ndikohet drejtpërsëdrejt nga mjetet financiare të siguruar nga buxheti i shtetit të Kosovës.

Tabela 1: Kërkesa buxhetore e IAP dhe buxheti i ndarë për IAP në vitin 2011

Kategoritë ekonomike	Kërkesa buxhetore Varianti I	Kërkesa buxhetore: Varianti II	Buxheti i aprovuar për vitin 2011	Buxheti për vitin 2010
Paga dhe mëditje	382,274.60	382,274.60	361,080.00	271,425.00
Mallra dhe shërbime	246,751.00	246,751.00	224,239.00	188,205.00
Shpenzime komunale	44,000.00	44,000.00	44,000.00	46,000.00
Shpenzime kapitale	992,000.00	92,000.00	-	7,000.00
Gjithsej	1,595,025.60	765,025.60	629,319.00	512,630.00

Kjo paraqitje tabelare e buxhetit prezanton kërkesën buxhetore për vitin 2011, para rritjes së pagave dhe mëditjeve për 30 % të shërbyesve civilë, krahasuar me bazën e ndarjes buxhetore, sipas Ligjit për Buxhetin më 2011. Ndërsa për IAP-në nuk është bërë ndarje meritore, sipas kërkesës buxhetore për vitin 2011.

Për shkak të rritjes së pagave të nëpunësve civilë për 30 % për vitin 2011, IAP e ka riplotësuar kërkesën e vetë buxhetore më 23.03.2011 për kategorinë buxhetore për *paga dhe mëditje* në shumë prej 160.789.26 €, në raport me kërkesën e parë buxhetore të datës 29.06.2010.

Meqë buxheti për IAP-në për vitin 2011 ka qenë i ndarë dhe i miratuar pa dëgjimin e rregullt të kërkesës buxhetore të IAP-së nga Ministria e Financave (MF) dhe Komisioni parlamentar për buxhet dhe financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës, natyrshëm ka ndodhë që edhe ndarja e buxhetit për IAP-në, brenda kategorive ekonomike të bëhet në mënyrë jo të drejtë dhe jo sipas nevojave të IAP-së. Sipas kësaj ndarjeje arbitrare të buxhetit për IAP-në, nga MF, me miratimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, dëshmon për cenimin antiligjor dhe

antikushtetues të pavarësisë buxhetore të IAP-së nga Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës. Si pasojë, IAP ka pasur buxhet të ndarë jofunksional. Mjete të tepërta dhe të panevojshme janë ndarë për kategorinë buxhetore të shpenzimeve komunale, kurse nuk ka ndarë mjete të nevojshme për kategoritë *paga dhe mëditje* si dhe *mallra dhe shërbime*. Për shkak të kësaj ndarjeje arbitrare të buxhetit për IAP-në, IAP duke shfrytëzuar të drejtën ligjore, është detyruar të bëjë transferim të buxhetit nga kategoria buxhetore e *shpenzimeve komunale* në kategorinë buxhetore *mallra e shërbime* - për qira, në shumë prej 6,400.00 €, për të kryer obligimet e marra ndaj palëve të kontraktuara.

5.2. Ndërhyrjet e Qeverisë së Kosovës në buxhetin e Avokatit të Popullit

Menaxhmenti i IAP-së, më 22 nëntor 2011, ka konstatuar se nga Sistemi Informativ i Menaxhimit Financave Publike – Free balance, MF ka bërë ndërhyrje të paautorizuar dhe arbitrare në buxhetin e IAP-së pa paralajmërim dhe konsultim të IAP-së. Me këtë rast është bërë tërheqje e buxhetit, ngrirje e mjeteve buxhetore në shumë prej 13,454.00 € në kategorinë buxhetore *mallra dhe shërbime*. Me këtë ndërhyrje arbitrare në buxhet nga ana MFs-ë, drejtpërdrejt është cenuar pavarësia financiare e IAP-së, e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Avokatin e Popullit. Kjo ndërhyrje ka pamundësuar kryerjen e obligimeve për shërbimet dhe furnizimet e planifikuara dhe të kontraktuara deri në fund të muajit dhjetor 2011.

Për këtë ndërhyrje arbitrare të MF-së në buxhetin e IAP-së, IAP ka reaguar më 22 nëntor 2011, duke njoftuar kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Me gjithë pranimin e gabimit dhe premtimin për kthim të buxhetit “të ngrirë” nga MF-ja, kthimi i mjeteve “të ngrira” nuk është bërë. Me gjithë transferimin e mjeteve buxhetore, në shumë prej 13,454.00 € nga “fondi rezervë” i MF-së në Free Balance, këto mjete buxhetore nuk janë lejuar për përdorim. Kjo nuk është bërë edhe pas kërkesës me shkrim më 5.12.2011, drejtuar MF-së nga IAP, me qëllim të lejimit të përdorimit të buxhetit dhe të qasjes në Sistemin Informativ për menaxhimin e financave publike për kryerjen e zotimeve nga IAP. Kjo dëshmon për ndërhyrjen arbitrare kundërkushtetuese dhe të kundërligjshme të MF-së në buxhetin e IAP-së.

Tabela 2: Raporti i përgjithshëm i buxhetit dhe shpenzimeve të realizuar 1 janar -31 dhjetor 2011

<i>Kategoritë ekonomike</i>	Buxheti final më 2011	Mjete të paalokuara	Buxheti i shpenzuar	Mjete të pashlyera	Mjete të lira	Realizimi në %
Paga dhe mëditje	361,080.00	-	314,118.00	-	46,961.87	86.99 %
Mallra dhe shërbime	229,845.03	13,454.00	209,301.77	6,367.93	14,175.33	91.06 %
Shpenzime komunale	22,733.26	-	12,525.65	10,192.31	15,30	55.10 %
Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	613,658.29	13,454.00	535,945.55	16,560.24	61,152.50	87.33 %

5.3. Shkaqet e mos realizimit të shpenzimeve sipas buxhetit të ndarë të Avokatit të Popullit

Menaxhimi dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore, sipas kategorive ekonomike, nuk është realizuar sipas buxhetit të ndarë të IAP-së, si rezultat i rrethanave, si në vijim:

1. Realizimi i shpenzimeve buxhetore për kategorinë *paga dhe mëditje* ka qenë 86.99%. Mbetja prej 46,961.87 € ose 13.01% të mjeteve të pashfrytëzuara buxhetore për kategorinë *paga dhe mëditje*, është pasojë e drejtpërdrejtë e moszgjedhjes së pesë (5) zëvendësve të Avokatit të Popullit deri në muajin tetor 2011. Për pagat e pesë (5) zëvendësve të Avokatit të Popullit buxheti i pashpenzuar është në shumë prej 39,773.96 €, përkatësisht për 11.02 %. Kjo domethënë se IAP, sipas planifikimit ka shpenzuar mbi 98% të mjeteve të parapara. Ndërsa pjesa e pashpenzuar është pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Si rrjedhojë e pushimeve pa pagesë të dy punonjësve, për pushim të lindjes dhe për avancim profesional, si dhe si pasojë e lëvizjes së personelit nga IAP - ndërprerjes vullnetare të marrëdhënies punës dhe të procesit të rekrutimit dhe të zëvendësimit të këtyre vendeve të punës me punonjës të ri, buxheti i pashpenzuar është në shumë prej 7,187.91 €, përkatësisht për 1.99%.
3. Realizimi i shpenzimeve buxhetore për kategorinë ekonomike *mallra dhe shërbime* ka qenë në shumë prej 209,301.77 €, përkatësisht për 91.06%. IAP ka shpenzuar me nikoqirllëk rreth 97% të buxhetit të planifikuar. Mbetja që figuron e pashpenzuar, në shumë prej 13,454.00 € ose 5,85%, për *mallra dhe shërbime* është pasojë e drejtpërdrejtë e ndërhyrjes arbitrare, të qëllimshme dhe kundërligjore të Ministrisë së Financave në buxhetin e IAP-së, më 21 nëntor 2011. Kjo është ndërhyrje e drejtpërdrejtë në pavarësinë buxhetore të IAP-së nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
4. Realizimi i shpenzimeve buxhetore për kategorinë buxhetore *shpenzime komunale* ka qenë në shumë prej 55.10 %. Ky nivel i shpenzimeve komunale është rezultat i rënies së shpenzimeve komunale, si shpenzimeve të rrymës elektrike dhe shpenzimeve të telefonisë fikse.
5. Rënia e shpenzimeve të rrymës lidhet me procesin e kursimit nga IAP, sepse IAP gjatë vitit 2011 ka filluar në përdorimin e ngrohjes së zyrave për punë, përmes sistemit të ngrohjes me derivate të naftës - si rezultat i ndryshimit të lokacionit të zyrave në objekt privat, duke mos e përdorur rrymën për këtë destinim. Kurse rënia shpenzimeve për telefoninë fikse është rezultat i politikave të IAP-së për kufizimin e komunikimit përmes rrjetit të telefonisë fikse, duke iu dhënë përparësi komunikimit përmes telefonisë mobile - me qëllim të shfrytëzimit sa më efektiv të shërbimeve të telefonisë mobile - meqë çmimet e telefonisë mobile janë më të ulëta për komunikim brenda telefonisë mobile sesa nga komunikimi telefoni fikse në telefoninë mobile. Prandaj, shfrytëzimi i buxhetit për këtë kategori buxhetore nuk ka mund të realizohet sipas destinimit, për shkak të ndryshimeve të brendshme, por edhe nga faktorët e jashtëm.

Tabela 3: Paraqitja e shpenzimeve komunale për vitin 2011, në raport me vitet 2010 dhe 2009

Shpenzimet komunale	2011	2010	2009
1. Rryma elektrike	7,619.27	9,489.15	8,850.00
2. Telefonua fikse	4,273.62	7,223.70	14,175.95
3. Mbeturinat	632,76	1,128.70	944.63
Gjithsej	12,525.65	17,345.55	23,971.48

Në tërësi, për funksionimin dhe realizimin e misionit dhe të aktiviteteve të ndryshme të IAP-së, ndikim të madh dhe pozitiv ka pasur buxheti nga ana e donatorëve të ndryshëm. Prandaj, në menaxhimin dhe realizimin i shpenzimeve buxhetore nga buxheti i Republikës së Kosovës kanë ndikuar në masë të madhe edhe posedimi i mjeteve financiare nga donatorët. Posedimi i këtyre donacioneve në masë të madhe ka ndikuar në plotësimin e nevojave të IAP-së, sidomos për kategoritë ekonomike *paga e mëditje, mallra dhe shërbime*, për angazhimin e një zyrtari për teknologji informative dhe të një zëdhënësi të IAP-së.

5.4. Mosekzekutimi i pagave të zëvendësve të Avokatit të Popullit

Pas zgjedhjes së pesë zëvendësve të Avokatit të Popullit, më 7 tetor 2011, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, IAP ka nxjerrë vendim për caktimin e pagave për zyrtarët e zgjedhur, me qëllim të plotësimit të zbrazësisë ligjore të nenit 32 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195. Ky vendim është marrë, sepse sipas Ligjit për Avokatin e Popullit paga e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij caktohet në pajtim me Ligjin për Pagat e zyrtarëve të Lartë Publik – ligj i cili nuk ekziston.

Mirëpo, Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht MAP dhe MF nuk e kanë zbatuar vendimin e IAP-së për ekzekutimin e pagave të zyrtarëve të zgjedhur, të pesë zëvendësve të Avokatit të Popullit dhe të Avokatit të Popullit. Kështu që për muajin nëntor dhe dhjetor 2011, dy nga zëvendësit e Avokatit të Popullit nuk kanë marrë fare pagë për punën e tyre në IAP, kurse tre zëvendësit e tjerë të Avokatit të Popullit, kanë marrë paga për këta dy muaj si punonjës të shërbimit civil. Me këtë rast MAP, si ministri përgjegjës për ekzekutimin e pagave të punonjësve të institucioneve të Republikës së Kosovës, bën shkelje të dispozitave ligjore për ekzekutimin e pagave për zyrtarët e zgjedhur, si dhe ka bërë diskriminim direkt të pesë zëvendësve të Avokatit të Popullit.

Për dhe rreth mos ekzekutimit të pagave për zëvendësit e Avokatit të Popullit, nga ana e Ministrisë së Administratës Publike, për muajin nëntor dhe dhjetor 2011, më 29.11.2011, është njoftuar kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryeministri i Republikës së Kosovës, ministrat e MAP dhe të MF, si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa në Kuvendin e Republikës. Por, përgjigje zyrtare, IAP nuk ka marrë deri më 31 dhjetor 2011, nga ana e këtyre institucioneve përgjegjëse.

Që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, IAP i ka parashtruar kërkesa disa herë Kuvendit të Republikës së Kosovës për definimin e pagave të zyrtarëve të zgjedhur, meqë Ligji për Pagat e Zyrtarëve të Lartë Publikë nuk ekziston. Kërkesat e IAP-së,

të datës 25 tetor 2010, të datës 10 mars 2011, si dhe kërkesa e riplotësuar buxhetore e datës 23.03.2011, kanë pasur për qëllim plotësimin e vakumit ligjor lidhur me caktimin - definimin e pagave të zyrtarëve të zgjedhur, përkatësisht të caktimin e pagës meritore për pozitën e tyre si zyrtarë të lartë publikë.

Në kërkesën e 10 marsit 2011 dhe në kërkesën e riplotësuar buxhetore të datës 23.03.2011, IAP i bërë kërkesë Kuvendit të Republikës së Kosovës për caktimin - ndarjen e buxhetit, sipas bazës së pagave të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, bazuar në dispozitat ligjore të ish-Rregullores 2006 të UNMIK-ut për IAP-në. Mirëpo, deri më 31 dhjetor 2011 IAP nuk ka marrë përgjigje, sipas këtyre kërkesave. Pagat e zyrtarëve të zgjedhur të IAP-së për vitin buxhetor kanë qenë më të vogla sesa pagat e zyrtarëve të shërbimit civil në IAP, si rezultat i vakuimit ligjor dhe të mosdhënies së përgjigjeve për ofrimin e zgjidhjeve për caktimin e pagës apo ndarjes së buxhetit, sipas kërkesës buxhetore të IAP-së.

Kjo gjendje e pagave të zyrtarëve të zgjedhur, përkatësisht statusi dhe niveli i bazës së pagave të zyrtarëve të zgjedhur të IAP-së, paraqet rast unik antiligjor dhe antikushtetues në institucionet e Republikës së Kosovës, meqë pagat e tyre caktohen me një ligj inekzistent, kurse në anën tjetër pagat e tyre të jenë më të ulëta se pagat e punonjësve - shërbyesve civilë në vetë IAP!

5.5. Financimi i IAP-së nga donatorët

Gjatë vitit 2011, IAP është mbështetur financiarisht edhe nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë. Donacionet, që IAP i ka pasur në dispozicion, janë realizuar në dy forma të financimit: donacione në mjete të gatshme financiare (të lira për përdorim), si dhe donacione për mbështetje të trajnimeve dhe vizitave studimore (këto trajnime dhe vizita studimore janë financuar drejtpërdrejt nga vetë donatorët).

IAP ka marrë donacione (mjete të gatshme financiare dhe të lira për përdorim dhe destinim të tyre) nga Ambasada e Norvegjisë, Ambasada e Turqisë dhe nga zyra e UNICEF-it në Kosovë. Ndërsa, për trajnime dhe vizita studimore, IAP ka pasur mbështetje nga OSBE, UNICEF, UNDP etj. Kurse donacioni vendor nga PTK është buxhet për obligimet e pakryera të IAP-së për vitin 2010. Ky donacion është transferuar në buxhetin e IAP-së nga PTK, pas mbylljes së procedurave ligjore për kryerjen e zotimeve - pagesave për vitin 2010.

Rëndësia e donacioneve për IAP-në për vitin buxhetor 2011, ka qenë shumë e dobishme për ngritjen profesionale dhe për realizimin e shumë aktiviteteve të IAP-së, pikërisht për shkak të kufizimeve nga buxheti i konsoliduar i Republikës së Kosovës.

Tabela 4: Raporti për donacionet e IAP-së, për vitin 2011

Donatorët	Buxheti sipas kat. ekonomike	Shuma e buxhetit	Mjete të paalokuara	Mjete të shpenzuara	Mjete të pashlyera	Mjete të lira	Realizimi në %
Ambasada e Norvegjisë	Paga dhe mëditje	10,897.42	-	9,735.02	-	1,162.40	89,33 %
Ambasada e Norvegjisë	Mallra dhe shërbime	47,691.82	-	41,648.93	3,268.80	2,773.67	87,33 %
Ambasada e Turqisë	Mallra dhe shërbime	6,468.28	-	4,094.20	-	2,374.08	63,30 %
UNICEF-i	Mallra dhe shërbime	2,548.52	-	2,548.52	-	-	100,00 %
PTK	Mallra dhe shërbime	2,981.00	-	2,981.00	-	-	100,00 %
Ambasada e Belgjikës	Paga dhe mëditje	1,846.11	1,846.11	-	-	1,846.11	0 %
Ambasada e Belgjikës	Mallra dhe shërbime	721.20	721.20	-	-	721.20	0 %
	Gjithsej	73,153.9	2,567.31	61,007.67	3,268.80	8,877.80	83,39%

6. Përmbledhja statistikore e ankesave dhe rasteve për vitin 2011

Nga 1 janari 2011 deri më 31 dhjetor 2011, 1453 persona janë paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit, në selinë e tij në Prishtinë dhe në zyrat rajonale, për të parashtruar ankesa ose për të kërkuar këshilla dhe ndihmë juridike. Prej tyre 546 janë proceduar si raste për t'u hetuar, ndërsa për pjesën tjetër të ankesave, palët janë udhëzuar apo këshilluar për hapat që duhet të ndjekin. Gjatë kësaj periudhe 238 persona janë takuar personalisht me Avokatin e Popullit apo zëvendësit e Avokatit të Popullit, gjatë "Ditëve të hapura" të mbajtura në periudhën raportuese.

Numri më i madh i rasteve që janë hetuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë periudhës raportuese kanë qenë të lidhura kryesisht me: të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën e punës dhe ushtrimin të profesionit, mbrojtjen e pronës, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, të drejtën për mjete juridike, barazinë para ligjit, etj.

Tabela 1: Ankesat e pranuar (1 janar 2011 – 31 dhjetor 2011)

	Ankesat e pranuar	1453
Përkatësia etnike e ankuesve		
	Shqiptarë	1284
	Serbë	87
	Boshnjakë	39
	Romë	18
	Turq	16
	Të tjerë	9
Gjinia		
	Meshkuj	1099
	Femra	354

Tabela 2: Rastet e hetuara (1 janar 2011 – 31 dhjetor 2011)

	Rastet e hapura për hetim (nga ankesat e pranuar)	546
	Rastet e hapura <i>ex officio</i>	13

Tabela 3: Rastet e mbyllura (1 janar 2011 – 31 dhjetor 2011)

	Numri total i rasteve të mbyllura	269
	Të zgjidhura pozitivisht	162
	Të shpallura të papranueshme	86
	Arsye të tjera	21

Tabela 4: Përkatësia etnike e ankuesve, bazuar në rastet e hetuara

	Shqiptarë	471
	Serbë	39
	Boshnjakë	14
	Turq	9
	Romë	8
	Të tjerë	5
Gjinia		
	Meshkuj	414
	Femra	132

Tabela 5: Palët përgjegjëse të rasteve të hetuara

	Gjykatat	193
	Ministritë	141
	Komunat	107
	Ndërmarrjet publike	35
	Policia	28
	Të tjera	84

Tabela 6: Raportet, letër rekomandimet si dhe kërkesat për masa të përkohshme

	Raporte mbi rastet	5
	Raporte <i>ex officio</i>	4
	Letër rekomandime	2
	Kërkesë për masë të përkohshme	1

Tabela 7: Palët përgjegjëse individuale të rasteve të hetuara

SISTEMI GJYQËSOR DHE PROKURORIAL		
	Gjykata Komunale në Prishtinë	30
	Gjykata Komunale në Prizren	23
	Gjykata Supreme e Kosovës	20
	Gjykata Komunale ne Gjilan	16
	Gjykata e Qarkut në Prishtinë	15
	Gjykata e Qarkut në Prizren	15
	Gjykata Komunale në Pejë	12
	Gjykata e Qarkut në Pejë	7
	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	6
	Gjykata Komunale në Mitrovicë	5
	Gjykata e Qarkut ne Gjilan	5
	Gjykata Komunale ne Suharekë	5
	Gjykata Komunale në Dragash	4
	Gjykata Komunale në Malishevë	4
	Gjykata Komunale ne Ferizaj	3
	Gjykata Komunale në Viti	2
	Gjykata Komunale ne Kaçanik	2
	Gjykata Komunale ne Gjakovë	2
	Gjykata e Qarkut në Mitrovicë	2
	Gjykata Komunale në Rahovec	2
	Gjykata Komunale në Vushtri	1

	Prokuroria Publike e Qarkut në Gjilan	1
	Prokuroria Publike Komunale në Gjilan	1
	Prokuroria Publike Komunale në Prizren	1
	Prokuroria Publike Komunale në Drenas	1
	Gjykata Komunale në Deçan	1
	Gjykata Komunale në Istog	1
	Gjykata Komunale në Klinë	1
	Gjykata Komunale në Lipjan	1
	Gjykata Komunale në Shtërpce	1
	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1
	Gjykata Komunale në Skenderaj	1
	Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë	1
	Prokuroria Publike Komunale në Prishtinë	1
	Gjykata Komunale në Podujevë	1
	Prokuroria Publike e Qarkut në Prizren	1
	Gjykata Komunale në Kamenicë	1
AUTORITETET QEVERTARE		
	Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës	21
	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	14
	Ministria e Punëve të Brendshme	8
	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	8
	Ministria e Shëndetësisë	7
	Qeveria e Kosovës	7
	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	5
	Ministria e Infrastrukturës	5
	Administrata Tatimore e Kosovës	5
	Burgu i Dubravës	3
	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	3
	Ministria e Administratës Publike	3
	Paneli për Lirim me Kusht	2
	Ministria e Drejtësisë	2

	Qendra e Paraburgimit në Lipjan	2
	Qendra e Paraburgimit në Gjilan	2
	Burgu i Lipjanit	2
	Burgu i Prizrenit	1
	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1
	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	1
	Shërbimi Korrektues i Kosovës	1
	Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport	1
	Qendra e Paraburgimit në Prishtinë	1
	Dep. për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile	1
PUSHTETI LOKAL		
	Komuna e Prishtinës	31
	Komuna e Gjilanit	22
	Komuna e Prizrenit	17
	Komuna e Pejës	7
	Komuna Mitrovicë	7
	Qendra për Punë Sociale në Gjilan	5
	Komuna e Podujevës	5
	Komuna e Ferizajt	4
	Komuna e Gjakovës	3
	Qendra për Punë Sociale në Prizren	3
	Komuna e Dragashit	3
	Komuna e Ranillugut	3
	Komuna e Obiliqit	3
	Komuna e Rahovecit	2
	Komuna e Skenderajt	2
	Komuna e Drenasit	2
	Komuna e Kamenicës	2
	Komuna e Lipjanit	2
	Komuna e Mamushës	2

	Komuna e Graçanicës	2
	Komuna e Vitisë	2
	Komuna e Kaçanikut	1
	Komuna e Istogut	1
	Qendra për Punë Sociale në Pejë	1
	Qendra për Punë Sociale në Gjakovë	1
	Komuna e Novo Bërdës	1
	Komuna e Fushë Kosovës	1
	Komuna e Suharekës	1
	Qendra e Mjekësisë Familjare në Podujevë	1
	Qendra e Mjekësisë Familjare në Prizren	1
	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Prishtinë	1
TË TJERA		
	Policia e Kosovës	28
	Korporata Energjetike e Kosovës	18
	Agjencia Kosovare e Pronës	14
	Agjencia Kosovare për Privatizim	13
	Universiteti i Prishtinës	8
	Autoritetet e huaja	6
	Kombinati Trepça	6
	N.P. Hidroregjioni Jugor	5
	Kuvendi i Kosovës	5
	Ndërmarrjet private	4
	PTK	3
	Aeroporti i Prishtinës	3
	Palë private	3
	Doganat e Kosovës	2
	RTK	2
	Arkivi i Kosovës	2
	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	2
	Zyra e Rregullatorit për Energji	2

	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës	1
	Këshilli Qendror Zgjedhor	1
	Ndërmarrja Publike Banesore	1
	Ndërmarrja Publike “NBI Suhareka”	1
	Agjencia Pyjore e Kosovës	1
	Agjencia Kosovare për Kadastër	1
	Korporata Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi”	1
	Shoqata e Sigurimeve e Kosovës	1
	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit	1
	EULEX	1
	Banka Qendrore e Kosovës	1
	Spitali Rajonal i Prizrenit	1
	UNMIK	1

Tabela 8: Lënda e rasteve të hetuara

	E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	111
	E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit	102
	Mbrojtja e pronës	81
	Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	81
	E drejta për mjete juridike	76
	Barazia para ligjit	21
	Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	18
	Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës	14
	Të drejtat e fëmijës	13
	E drejta për arsimin	12
	Përgjegjësia për mjedisin jetësor	11
	E drejta e qasjes në dokumente publike	10
	Raste për ndërmjetësim	8
	E drejta e lirisë dhe sigurisë	7
	E drejta e martesës dhe familjes	7


	Të drejtat e të akuzuarit	5
	Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore	5
	E drejta për jetën	4
	Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë	4
	Dinjiteti i njeriut	3
	Liria e lëvizjes	3
	Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut	3
	Shërbimet e mira	2
	E drejta e integritetit personal	1
	E drejta e privatësisë	1
	Konfesionet fetare	1
	Liria e tubimit	1
	Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes	1
	Liria e artit dhe e shkencës	1



Tabela 9: Dështimet e autoriteteve për t'u përgjigjur në letrat e IAP-it



SISTEMI GJYQËSOR DHE PROKURORIAL		
	Gjykata Komunale në Prishtinë	5
	Gjykata Komunale në Prizren	3
	Dhoma e veçantë e Gjykatës Supreme	3
	Gjykata Supreme e Kosovës	2
	Gjykata Komunale në Gjiilan	2
	Gjykata Komunale në Pejë	2
	Gjykata Komunale në Suharekë	1
	Gjykata Komunale në Shtërpce	1
	Gjykata Komunale në Viti	1
	Gjykata Komunale në Skenderaj	1
AUTORITETET QEVERITARE		
	Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale	4
	Ministria e Financave	2

	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor	2
	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	2
	Ministria e Punëve të Brendshme	1
	Ministria e Shëndetësisë	1
	Qendra e Paraburgimit, Prishtinë	1
PUSHTETI LOKAL		
	Komuna e Prishtinës	10
	Komuna e Gjilanit	2
	Komuna e Vitisë	1
	Komuna e Mitrovicës	1
	Komuna e Prizrenit	1
TË TJERA		
	Agjencia Kosovare e Pronës	1
	Agjencia Kosovare e Privatizimit	1
	Policia e Kosovës	1
	Universiteti i Prishtinës	1

Figura 1: Paraqitja grafike e statistikave 1 janar 2011 - 31 dhjetor 2011







7. Struktura organizative e IAP-së

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Avokatin e Popullit, struktura e IAP-së përbëhet nga të zgjedhurit nga Kuvendi i Kosovës, si dhe nga nëpunësit civil të IAP-së, të cilët përzgjidhen në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbim Civil.

Me gjithë nevojat për rritje të numrit të punonjësve në IAP, Ministria e Financave ka aprovuar numrin prej 48 të punësuarve për 2011, përfshirë të emëruarit dhe nëpunësit civilë. Ky numër punonjësish është i shpërndarë në Zyrën qendrore në Prishtinë dhe në Zyrat rajonale në Prizren, Pejë, Gjilan, Mitrovicë me dy zyra – në jug dhe në veri, si dhe në Graçanicë.

Në bazë të nenit 31 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 03/l-195, Avokati i Popullit me Vendimin nr. 01/2011 të datës 21 mars 2011, ka miratuar Rregulloren e punës së IAP-së. Në bazë të kësaj rregulloreje parashihet struktura organizative e IAP-së, e cila përbëhet nga:

- Avokati i Popullit;
- Zëvendësit e Avokatit të Popullit;
- Drejtori Ekzekutiv;
- Shërbimi profesional;
- Shërbimi administrativ.

Paraqitja skematike (organigrami) e strukturës organizative pasqyron ndërvarësinë reciproke të strukturave dhe është miratuar me vendim të brendshëm të Avokatit të Popullit.

Ndërtimi i organigramit të IAP-së është bërë në mënyrë të atillë që të definohet qartë struktura organizative, si një parakusht për një funksionim të mirëfilltë të institucionit, duke respektuar vertikalen hierarkike, si dhe duke krijuar hallkat e nevojshme të funksionimit horizontal.

Përzgjedhja e zëvendësavokatëve në tetor 2011, ka ndihmuar në funksionalizimin e strukturës organizative, në pajtim me kërkesat dhe nevojat që janë identifikuar gjatë punës së përditshme.

Duke e konsideruar se të drejtat e njeriut nuk kërkojnë në mënyrë eksplicite vetëm përgatitje shkollore dhe profesionale, por gjithashtu edhe përkushtim njerëzor dhe gatishmëri për t'u përballur me situata të caktuara, që të shumtën e herave janë sfiduese dhe të vështira, punonjësit e IAP-së janë obliguar që të japin kontributin e tyre nëpër njësitë e krijuara, sipas fushave ku parashihet mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut.


Këto njësi janë grupuar në pesë departamente:

- Departamenti i Gjyqësorit,
- Departamenti i Ekzekutivit,
- Departamenti i Diskriminimit,
- Departamenti i Legjislacionit,
- Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun.

Këto departamente udhëhiqen nga zëvendësavokatët, duke mundur të kështu efektivitet dhe planifikim më të qartë e objektiva të arritshme.

Si pasojë e kufizimeve të mjeteve financiare, IAP ka mungesë të stafit, veçmas atij profesional, e së këndejmi njësi të caktuara nuk arrijnë të përmbushin obligimet që kanë.

7.1. Skema organizative e IAP-së



7.2. Gjendja e personelit

Për funksionimin e IAP-së, buxheti i ndarë për personel për vitin 2011 ka qenë gjithsej për 48 punonjës. Kjo ndarje e buxhetit dhe me këtë numër të punonjësve si tërësi ka qenë e njëjtë si për vitin 2010, kurse sipas kësaj gjendje të këtij numri të punonjësve për vitin 2011, IAP-së ka pasur pengesa dhe kufizime të mëdha në realizimin e mandatit e kushtetutës dhe ligjor, lidhur me realizimin e misionit, detyrimeve dhe përgjegjësive në punë.

Numri dhe struktura e personelit, sipas buxhetit të miratuar, përbëhet prej 48 zyrtarëve, të cilët janë të ndarë në dy kategori, si në vijim:

1. Gjashtë (6) zyrtarë publikë, të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe
2. Dyzetë e dy (42) zyrtarë, shërbyes civilë.

Bazuar në këtë numër të personelit, në IAP ekzistojnë kufizime dhe numër i pamjaftueshëm i personelit me rastin e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive në punë, në raport me rritjen e numrit të ankesave prej së paku 20 % nga viti 2010, si dhe të shumë obligimeve dhe përgjegjësive të reja që IAP-së i janë deleguar me shumë ligjeve të miratuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në anën të tjetër edhe shumë ligje të tjera për administratën caktojnë obligime dhe përgjegjësi ligjore për menaxhimin dhe funksionimin e administratës, si psh. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit për Auditim të Brendshëm dhe dispozitave të tjera ligjore që kanë të bëjnë me teknologjinë informative, Ligji për Arkivin e Kosovës etj.

Me gjithë kërkesën buxhetore për personel të ri prej 16 punonjësve për vitin 2011, kjo kërkesë e IAP-së nuk është miratuar me asnjë rritje të punonjësve për shërbimin civil, si nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht nga Ministria e Financave dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kërkesa buxhetore për vitin 2011 ka qenë për këto 16 (gjashtëmbëdhjetë) pozita - punonjës, duke mos llogaritur personelin për vitin 2010 për 47 punonjës, si në vijim:

1. Një (1) Zëvendës i Avokatit të Popullit,
2. Dy (2) Juristë hetues, për Zyrën në Prishtinë,
3. Katër (4) Juristë hetues, për zyrat rajonale në Kosovë,
4. Një (1) Drejtor për marrëdhënie ndërkombëtare,
5. Një (1) Zyrtar i lartë i personelit,
6. Një (1) Zyrtar certifikues,
7. Një (1) Auditor i Brendshëm,
8. Një (1) Zyrtar të teknologjisë informative,
9. Një (1) Asistent ekzekutiv për zëvendësit e Avokatit të Popullit,
10. Një (1) Arkivist - bibliotekist,
11. Një (1) Redaktor dhe lektor,
12. Një(1) Përkthyes nga gjuha angleze në gjuhën serbe.

Mosmiratimi i kërkesës buxhetore për rritjen e numrit të punonjësve të IAP-së për vitin 2011, bazuar në nevojat për punë për pozitat e vendeve të punës që i emërtuam më sipër, IAP-së i janë shkaktuar pengesa dhe pasoja në punë në menaxhimin e shumë përgjegjësive në punë, gjatë realizimit të detyrave dhe aktiviteteve të IAP-së me rastin e realizimit të mandatit kushtetues dhe të detyrimeve ligjore të ndryshme.

Ndarja e numrit të punonjësve të shërbimit civil sipas zyrave ku ata aktualisht punojnë është si në vijim: 30 punonjës janë të angazhuar në zyrën qendrore në Prishtinë dhe 12 punonjës janë të angazhuar në zyrat rajonale.

Nga vlerësimet e bëra mbi burimet njerëzore të disponueshme në IAP, rezulton se numri i punëtorëve të lejuar me buxhetin e Kosovës për vitin 2011, me gjithsej 42 punonjës të shërbimit civil ka qenë dhe është i pamjaftueshëm për funksionimin e IAP-së. Sepse në rastin konkret është e pamundur të punojë dhe funksionojë një institucion publik pa asnjë zyrtar të

teknologjisë informative, pa zyrtar përgjegjës të zyrës së personelit, pa zyrtar për auditim të brendshëm, pa zyrtar të arkivit si dhe pa zyrtarë kyç dhe të pamjaftueshëm në shërbimin profesional, p.sh. si në zyrën në qendrore në Prishtinë apo në zyrat rajonale.

Nevojat e mëdha për personel, të vërejtura gjatë vitit 2010 janë bartur në vitin 2011, me ç'rast duhet konstatuar se pritjet për funksionim dhe menaxhim në nivel më efikas dhe të qëndrueshëm të IAP-së janë të kufizuara.

7.3. Lëvizjet e nëpunësve

Gjatë kësaj periudhe raportuese, më 7 tetor 2011, janë zgjedhur pesë (5) zëvendësit e Avokatit të Popullit, bazuar në procedurat e Ligjit për Avokatin e Popullit, nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kurse, gjatë kësaj periudhe raportimi, vullnetarisht kanë ndërprerë marrëdhënien e punës 3 nëpunës të shërbimit civil, ndërsa janë punësuar 6 nëpunës të rinj (dy prej tyre janë financuar nga donacionet, vetëm deri më 31.12.2011). Shkaqet kryesore për lëshimin vullnetar të marrëdhënies së punës, sipas dorëheqjeve të tyre me shkrim, janë gjetja e vendeve të tjera të punës, qoftë në institucionet ndërkombëtare apo vendore, ku të ardhurat personale janë më të larta dhe kushtet e punës shumë më të favorshme.

7.4. Struktura e personelit

Numri i pozitave të punonjësve të IAP-së për vitin 2011, si dhe numri dhe pozitat - vendet e punës që janë kërkuar për punonjës të ri për vitin 2011, është paraqitur në tabelën, si në vijim:

Nr.	Emërtimi pozitave të punonjësve - personelit	Kërkesa e buxhetore për personel më 2011	Numri i pozitave të aprovuara më 2011
I.	1. AVOKATI I POPULLIT	1	1
	2. Zëvendës të Avokatit të Popullit	5	5
	3. Asistent/e Ekzekutiv/e – për Avokatin e Popullit dhe zëvendësit e Avokatit të Popullit	2	1
II.	1. DREJTORI EKZEKUTIV	1	1
	2. Asistent/e Ekzekutiv/e	1	1
	3. Zyrtar Certifikues	1	1
	4. Auditor i Brendshëm	1	0
	5. Zyra për Marrëdhënie Ndërkombëtare	1	0
	6. Zyra për Buxhet dhe Financa	2	1
	7. Zyra e Prokurimit	1	1

III.	DEPARTAMENTI I HETIMEVE		
	1. Drejtori i Departamentit të Hetimeve	1	1
	1.1 Sektori – Juristë të Përgjithshëm të Hetimeve	7	5
	1.2 Sektori – Grupi për Antidiskrimin		
	1.3 Sektori – Grupi për të Drejtat e Fëmijëve	3	3
	1.4 Sektori – Njësia për Barazi Gjinore	1	1
	1.5 Asistent Ligjor	1	1
	2. Zyrrat Rajonale:	3	3
	2.1 Zyra në Prizren		
	2.2 Zyra në Gjiilan	2	2
	2.3 Zyra në Pejë	2	2
	2.4 Zyra në Mitrovicë (dhe nën zyra në veri)	2	2
	2.5 Zyra në Graçanicë	3	3
	2.6 Zyra në Gjakovë	2	2
	2.7 Zyra në Ferizaj	1	0
	2.8 Zyra në Shtërpçë	1	0
	2.9 Zyra në Dragash	1	0
		1	0
IV.	DEPARTAMENTI ADMINISTRATËS		
	1. Drejtori i Departamentit të Administratës	1	1
	1.1 Sektori i Mediave	2	1
	1.2 Sektori i Logjistikës	1	1
	1.3 Sektori i Përkthimit	3	2
	1.4 Zyrtar i Lartë për Personel	1	0
	1.5 Zyrtar të Teknologjisë Informativë	2	1
	1.6 Redaktor dhe Lektor	1	0
	1.7 Arkivist - Bibliotekist	1	0
	1.8 Zyrtar i Depos dhe Pasurisë	1	1
	1.9 Zyrtar i Pranimit/ Operatori	1	1
	1.10 Vozitës	2	2
	1.11 Shtëpiak	1	1
	Gjithsej pozitave dhe numri i personelit:	64	48

8. Shkurtesat

AECID	Agencia Española de Cooperación Internacional para el Desarrollo (Agjencia Spanjolle për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar)
AKM	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKMM	<i>Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit</i>
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
AP	Avokati i Popullit
BE	Bashkimi Evropian
CEDAW	Convention on the Elimination of Discrimination Against Women (Konventa Ndërkombëtare mbi Eleminimin e Diskriminimit ndaj Gruas)
CLARD	Center for Legal Aid and Regional Development (Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal)
CBM	Community Building Mitrovica (Ndërtimi i Komunitetit Mitrovicë)
CPT	Committee for the Prevention of Torture (Komiteti për Parandalimin e Torturës)
CRONSEE	Ombudsmanët për Fëmijë të Evropës Juglindore
DKA	Drejtoria Komonale të Arsimit
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
DSHS	Departamenti i Shërbimeve Sociale
DUDNJ	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
EBU	European Broadcasting Union (Unioni i Transmetuesve Evropian)
ENOC	European Network of Ombudspersons for Children (Rrjeti Evropian i Ombudsmanëve për Fëmijë)
EPF	Edukimi parafillor
EPSH	Edukimi parashkollor
EULEX	European Union Rule of Law Mission (Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit)
FIQ	Forumi për Iniciativë Qytetare
GAP	Organizatë Joqeveritare
GDF	Grupi për të Drejtat e Fëmijëve
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GMD	Grupi për Mos-diskriminim
GZRK	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës
HEKS	Hilfswerk der Evangelischen Kirchen in Schweiz (Ndihma e Kishave Protestante në Zvicër)
HRRP	Human Right Review Panel (Paneli Shqyrtues për të Drejtat e Njeriut)
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
IFP	Instituti i Forenzikës Psikiatrike
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

INPO	Inciative for Progress (Iniciativa për Progres)
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
IPO	Instituti Ballkanik i Politikave
ISCED	International Standard Classification of Education (Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit)
KB	Kombet e Bashkuara
KDF	Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
KE	Këshilli i Evropës
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KIPRED	Kosovar Institute for Policy Research and Development (Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave)
KK	Kuvendi Komunal
KKN	Komiteti Koordinues Ndërkombëtar
KKZ	Komisionet Komunale Zgjedhore
KMDLNJ	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut
KMSHK	Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
KOS	Kisha Ortodokse Serbe
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KPM	Komisioni i Pavarur për Media
KPMK	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës
KPMSHCK	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës
KPPK	Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës
KPPPK	Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës
KQZ	Komisioni Qendror Zgjedhor
KRK	Kushtetuta e Republikës së Kosovës kuadër të EULEX-it
LESP	Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale
LQDP	Ligji për Qasje në Dokumente Publike
MAP	Ministria e Administratës Publike
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKPT	Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPDL	Movimiento por la Paz (Lëvizja për Paqe MPDL)
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MT	Ministria e Transportit
NJBGJ	Njësia për Barazi Gjinore
NJDNJ	Njësitë për të Drejtat e Njeriut
OJQ	Organizata Joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OPCAT	Optional Protocol to the Convention Against Torture (Protokolli Opsional i Konventës së OKB kundër Torturës)
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PLK	Paneli për Lirim me Kusht
PTK	Postë-Telekomi i Kosovës
QKRMT	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
QKSGJ	Qendra Kosovare për Studime Gjinore
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QPA	Qendra për Politika dhe Avokim
QPM	Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë
QPS	Qendra për Punë Sociale
RCT	Rehabilitation and Research Centre for Torture Victims (Qendra për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës)
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SEEMO	South East Europe Media Organization (Organizata e Mediave të Evropës Juglindore)
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
TIK	Teknologjisë Informative dhe Komunikimit
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNDP	United Nations Development Programme (Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara)
UNESCO	United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë)
UNHCR	United Nations High Commissioner for Refugees (Komisariati i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë)
UNICEF	United Nations International Children's Emergency Fund (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët)
UNMIK	United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë)
USAID	United States Agency for International Development (Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar)
YIHR	Youth Initiative for Human Rights (Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut)